

BLENDI FEVZIU

43/ scripta manent

RESIDENTI QË U BË MBRET

AHMET ZOGU

Ai ishte i vështirë për t'u përkufizuar.
Për Orientalët ishte shumë oksidental; për oksidentalët,
zbatonte stilet më bizantine të Orientit.
Asnjëra palë nuk e pranonte edhe pse kjo nuk e pengoi,
që në jetë, t'ju imponohej të dyja palëve.



UETPRESS

lokan

AHMET ZOGU

Presidenti që u bë Mbret

BLENDI FEVZIU

Tiranë, tetor 2014



Verba volant, scripta manent.

AHMET ZOGU

Titulli i librit: **Ahmet Zogu**. Presidenti që u bë mbret.

Autor: **Blendi FEVZIU**

Dallina e librit realizuar nga: **VATRA**

Art grafik: **Dritan LLESHI**

Libri është pjesë e kolanës "Scripta manent".

© 2014 UET Press. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 9380, dt. 28.04.2005 i Shtetit Shqiptar "Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të", nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanimë, dixhitalizim, rrjet web apo sisteme të tjera, pa lejen me shkrim të botuesit.

Universiteti Europian i Tiranës

Shtëpia Botuese Universitare "UET Press"

Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd.70, H.1, Kodi Postar 1023, Tiranë, Shqipëri.

uetpress@uet.edu.al

www.uet.edu.al/uetpress

Botimet UET Press certifikohen pranë Zyrës Shqiptare për Mbrojtjen e të Drejtave të Autorit.
International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-190-09-3

Libri është kataloguar në datën e publikimit pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Bibliotekës së Universitetit Europian të Tiranës.



AHMET ZOGU

Presidenti që u bë Mbret

BLENDI FEVZIU



Shtëpia Botuese Universitare

"UET Press" është pjesë e

Universitetit Europian të Tiranës.

Tiranë, tetor 2014

- 1 Prolog
- 3 Dasma Mbretërore. 27 Prill 1938
- 17 Nga Burgajeti në Stamboll, fëmijëria dhe shkollimi. 1895 - 1912
- 25 Nga Pavarësia tek "internimi" në Vjenë. 1912 - 1919
- 39 Kongresi i Lushnjes dhe vitet e triumfit. 1920 - 1923
- 57 Njeriu i 50 atentateve
- 67 Ngjarjet e 1924-ës. Ikja dhe rikthimi
- 77 Zogu dhe kundërshtarët e tij politikë
Noli, Konica, Hasan Prishtina apo Bajram Curri
- 87 Shpallja Mbret dhe Oborri Mbretëror
- 105 "Koha e Zogut". 1925 - 1939
- 115 Zogu dhe gratë
- 125 Kush ishte Ahmet Zogu?
- 137 Pushtimi i Shqipërisë
- 159 Në rrugët e Europës. 1939 - 1940
- 175 Vitet e luftës në Angli. 1940 - 1946
- 191 Zogu dhe Shqipëria komuniste
- 203 Vitet e fundit të Mbretit Zog
- 215 Vdekja e Mbretit
- 221 Epilog. 15 nëntor 2012, 51 vjet më pas
- 223 Apendiks - Foto
- 271 Bibliografi

Ahmet Zogu citonte shpesh thënien e
Napoleonit se fjala "E pamundur" duhej
hequr nga fjalori.
Ndaj këtë libër, ia dedikoj pikërisht gjërave
"të pamundura" të botës. Atyre që duam dhe
s'i arrijmë dot kurrë...

PROLOG

Autokolona e makinave u shfaq në krye të rrugës së përbaltur, në fund të së cilës, lartohej një shtizë e lartë druri me flamurin shqiptar. Trau i kufirit ishte gjysmë i ngritur. Në ato orë, ai ishte hapur aq herë sa nuk kish ndodhur kurrë që kur mes dy vendeve që caktuar një kufi zyrtar. Ishin orët e para të mëngjesit, ose herët në mëngjes, mbase edhe drekë. Dëshmitarët janë konfuzë dhe japin versione kontradiktore. Dokumente nuk ekzistojnë. Me gjasë nuk u mbajtën kurrë, ose humbën në vrullin e luftës së përbotshme.

Në anën tjetër, ca ushtarë të hutuar, një major dhe një kolonel grek, po sodisnin skenën e pabesueshme. Makinat ndaluan. Patën ende kohë për të kryer një ritual të fundit. Një burrë i gjatë zbriti nga një veturë diku në qendër.

- Mbreti Zog! - foli koloneli.

I veshur me kostum civil, blu të errët, ai u vendos para flamurit. Një skuadër e Gardës mori qëndrim për nder të tij me armë. Një burrë foli disa fjalë dhe flamuri i ngritur në anë të postbllokut u ul. Dikush e palosi me nxitim, e mbajti me solemnitet mes duarve dhe ia dorëzoi Mbretit që qëndronte aty, krejt i ngrirë, thuase kjo ceremoni nuk kishte lidhje me të.

Pastaj makinat ndezën sërish motorët. Ishte një karvan i gjatë. 1300 vetë dhe dhjetëra makina u nisën me ngulç nëpër rrugën e ngushtë që lidhte Kapshticën me Follorinën.

Ishte data 8 Prill 1939. Të tjerë thonë 9 prill. Ishte ora 2 e

mëngjesit, por disa thonë mesditë. Askush s'di ta thotë me saktësi. 75 vjet më pas, historia ende s'e ka rindërtuar atë skenë me saktësi, por detajet e mëpasme janë të njohura tashmë.

Mbreti Zog po largohej nga Shqipëria. Në jetën e tij qe larguar shumë herë. Kishte ikur drejt Stambollit, Vjenës, Beogradit. Kish ikur dhe qe kthyer, herë me dëshirë dhe herë i përzënë forcërisht. Tani besonte se cikli i historisë po përsëritej sërish.

Edhe pse, thellë-thellë, e dinte që ky ishte një moment ndryshe, një moment kur gurët e fatit, nuk i kishte më në dorë ai.

Po ikte duke lënë pas një nga vitet më të lumtura të jetës së tij, vitin kur ishte martuar plot shkëlqim dhe kur zoti i kishte falur një trashëgimtar.

DASMA MBRETËRORE

27 Prill 1938

“Herët në mëngjes, u gjenda në kuvertë, pasi s'kisha vënë gjumë në sy gjithë natën. Përpara meje shtrihej Durrësi. Hodha vështrimin mbi muret e lashta romake dhe më tutje ato veneciane, të shpuara nga plumbat turq, dhe prapa maleve, shkëmbinj të lartë graniti gri, që lartësoheshin mbi det. Peizazhi i pazbutur ishte krejt ndryshe nga gjithçka kisha parë deri atëherë.

Na kërkuan të qëndronim në bord derisa të zbarkonin të gjithë udhëtarët e tjerë dhe, kur kalata u boshatis, u shfaq një Mercedes i zi. U përshëndeta nga kolonel Sotir Martini, një ministër i Oborrit, i cili i ndenji pranë Mbretit deri në momentin që vdiq në mërgim në vitin 1950.”

Ky është rrëfimi i Geraldina De Nagy Appony për kontaktin e parë që pati me vendin që do t'i vinte mbi kokë kurorën. Ishte 21 vjeçe dhe e emocionuar. Qe nisur drejt një të panjohure duke besuar në një *happy-end*.

Në port e priste adjutanti i Mbretit që e akomodoi si mysafire në familjen Toptani dhe e sqaroi me takt se udhëtimi i saj ishte dhe do të mbetej sekret derisa ajo dhe Mbreti të merrnin një vendim. Geraldina u ftua të merrte pjesë në ballon e Vitit të Ri 1938. Gjatë gjithë jetës së saj, në dhjetëra intervista dhe biografi, ajo ka kujtuar gjithnjë momentin e parë kur u gjend përballë me atë që do të bëhej burri i ardhshëm i saj:

“Më dridheshin këmbët dhe nuk shikoja asgjë. Isha jashtë mase e frikësuar. Dhoma ishte aq e gjatë, sa dukej e pafund dhe unë doja vetëm të zhdukesh. Befas, u gjenda ballë për ballë me një fytyrë të hijshme, një burrë i gjatë, pa të meta, i veshur me uniformën e bardhë të kolonelit të përgjithshëm të ushtrisë. Ishin pikërisht sytë që i vura re të parët, sy depërtues bojëqielli.

Kisha praktikuar një përkulje si ato që mësojmë në orët e kërcimit, por e harrova nga hutimi dhe thjesht bëra një përkulje të lehtë. Mbreti menjëherë më ngriti me një buzëqeshje tërheqëse, më falenderoi për vizitën në vendin e tij dhe më pyeti nëse udhëtimi kishte kaluar mirë”.

Geraldina nuk e dinte se pavarësisht fshehtësisë, lajmi për mbërritjen e saj kishte intriguar tej mase kryeqytetin. Pothuajse i gjithë oborri, njerëzit me ndikim dhe diplomatët e dinin që kishin ardhur me aprovimin e Mbretit dhe ishte kandidatura kryesore për t'u bërë Mbretëreshë e Shqipërisë. Mbreti që aty, së bashku me princeshat që ai ia prezantoi njëra pas tjetrës. Geraldina e kujtonte gjithnjë atë moment:

“Asnjëherë nuk e largoi vështrimin nga unë, ndërsa më ofroi një gotë shampanjë. Gishtat tanë u prekën dhe në atë çast dritat u vagëlluan. Ishte pikërisht mesnatë dhe kështu e donte zakoni shqiptar. Ngaqë isha në angështi, e lëshova gotën, e cila u thërrmua në mijëra cifla kristalesh të vogla.

E ndjeva se u zbeha në fytyrë, por Mbreti qeshi. Ciflat sjellin fat, - tha ai në gjermanisht dhe më ra në dorë si për të më siguruar. Jehona e dymbëdhjetë tik-takeve të mesnatës ende nuk ishte fashitur, kur një valë e fortë duartrokitjesh dukej se do ta shembte dhomën. Nga të gjitha anët dhe në të gjitha gjuhët u dëgjua thirrja: Fat të bardhë!

U ndjeva si asnjëherë më parë. Kisha rënë në dashuri.”

Ishte viti 1938, viti i martesës së Mbretit Zog I me Mbretëreshën Geraldinë. Geraldina nuk iku më nga Shqipëria që atë ditë. Fejesa u mendua të shpallej në janar dhe martesa në prill. Më 25 janar 1938, ambasadori britanik në Durrës, njoftonte ministrin e Jashtëm Anthony Eden:

“Kontesha Apony ka ardhur në Tiranë në pjesën e fundit të muajit dhjetor. Më 31 dhjetor Mbreti Zog vallëzoi me atë në vigjilje të Vitit të Ri në mbrëmjen e organizuar në oborrin mbretëror. Kur u takova me ministrin e Jashtëm Shqiptar në datën 24 janar, ai pohoi fejesën e Mbretit Zog me Konteshën Apony. Mendohet se shpallja zyrtare do të jepet brenda pak ditësh.”

Fejesa u shpall më 31 janar 1938. Shpallja u bë në një seancë të jashtëzakonshme parlamentare e thirrur me kërkesën e vetë Mbretit Zog. Kushtetuta e Shqipërisë, parashikonte që kërkesa për fejesën e Mbretit të kalonte për miratim në dy Dhomat e Parlamentit. Salla ishte e mbushur plot dhe në llozhën kryesore qëndronin motrat e Mbretit. Kryetari i Parlamentit njoftoi se të dyja dhomat e kishin aprovuar fejesën dhe se Geraldina mund të bëhej Mbretëreshë e Shqipërisë. Sipas biografes së Geraldinës, atë mbrëmje, Geraldina bëri prezantimin e parë të plotë me familjen e dhëndrit:

“Në darkë, Geraldina kishte veshur një fustan mëndafshi të hollë, në ngjyrën e safirit, të cilin e kishte zgjedhur Mbreti në Uorth të Parisit, si surprizë për të. Gishti i unazës vezullonte nga një diamant i mahnitshëm katërmbëdhjetëkaratësh ngjyrë bojëqielli të lehtë. Për herë të parë dhe të vetme Mbreti mbante një unazë fejesë nga Hungaria, prej floriri, rubini dhe safiri, e cila kishte qenë e gjyshit të Geraldinës, kontit Giula Aponi. Gjashtë motrat e Mbretit përfaqësonin familjen.

Para darkës, Mbreti kishte kërkuar që familja të mblidhej në paradhomë, ku Princesha Geraldinë, e zbukuruar, u shfaq përkrah Mbretit.

Jam shumë i lumtur dhe shpresoj që edhe e fejuara ime të jetë e lumtur, foli në gjermanisht me një zë të gëzuar e të pazakontë dhe këto ishin fjalët e tij të vetme rreth fejesës. Duke vazhduar me zërin e tij të butë, shtoi:

Do t'ju isha shumë mirënjohës, nëse do të mbanit disa çaste heshtje për t'u lutur. E di që shpirti i nënës sime është me ne në këto çaste. Bekuar qoftë kujtimi i saj!”

Geraldina kujton se përpara fejesës ishte bërë një tjetër bisedë delikate për lidhjen e tyre. Ajo i kishte kujtuar mbretit diferencën në besimin fetar dhe vështirësinë që në këtë rast i vinte nga kisha:

“E di që mund t’ju dua përgjithmonë, por ju jeni mysliman dhe unë katolike. Si do ta rregullojmë këtë? Asgjë në këtë botë nuk do të më bëjë ta ndryshoj besimin tim fetar.”

Mbreti buzëqeshi dhe tha: Edhe unë e kam menduar këtë dhe as që bëhet fjalë që ti të bësh një gjë të tillë. Ne jemi myslimanë europianë dhe kam respekt të madh për kishën tuaj.”

Problemi i parë i martesës sapo kishte dalë. Ishte leja që Vatikani duhet t’i jepte një katolikeje për t’u martuar me një mysliman. Kjo çështje u bë lajm botëror dhe u shtjellua në më shumë se 180 gazeta në gjithë botën. Qysh më 16 shkurt të 1938-ës “The daily telegraph and morning post” i Londrës sqaronte në artikullin me titull “Papa në pritje të garancive nga Mbreti Zog”:

“Siç qe parashikuar, Shikimi i Bekuar nuk i ka dhënë të drejtën Konteshës Geraldinë Appony për lejen për të cilën kishte aplikuar, për t’u martuar me Zogun, Mbretin e Shqiptarëve, që është mysliman.”

Një martesë fetare sipas riteve katolike do të solemnizohet përpara martesës civile; dhe fëmijët e dalë nga martesë e Konteshës Geraldinë do të rriten si katolikë romanë. Mbreti Zog deri tani nuk ka marrë asnjë hap për të firmosur këto garanci.”

Me gjasë, diçka ka ndryshuar në negociatat e fshehta, sepse një muaj e ca më vonë, më 22 mars 1938, “Daily mirror”, e Nju -Yorkut shkruante:

Me disa rregullime Vatikani ka lejuar martesën e ardhshme të Mbretit të Shqiptarëve, Ahmet Zogu, me Konteshën Geraldina Appony të Hungarisë, njoftoi shërbimin ndërkombëtar të lajmeve nëna e nuses Mme Girauld. “Papa Pius lejoi martesën, - tha ajo - me kushtin që fëmijët e dalë nga martesë të rriten sipas fesë së krishterë.”

Më 31 Mars 1938 në një intervistë me motrat e Zogut që gjendeshin tranzit në hotel “Ritz” në Londër, Daily Mail kishte

dhënë detaje për martesën, ku përfshihej edhe lajmi se do të ishte thjesht një martesë civile.

“Martesa do të bëhet në pallatin e vjetër në Tiranë dhe ajo do të jetë tërësisht civile, e njëjta me çdo martesë civile të çdo vendi tjetër. Pavarësisht se fati i shqiptarëve është mysliman dhe kontesha katolike, kjo procedurë është tërësisht konstitucionale. Për më tej, do të kalohet vështirësia për të marrë aprovimin e Papës. Nuk ka asnjë dyshim që vëllai im dhe mbretëresha e tij do të vizitojnë Papën gjatë muajit të tyre të mjaltit për të marrë bekimin e tij, - tha privesha Myzejen.”

Po në të njëjtën intervistë Princesha Myzejen kishte sqaruar:

“Ne të treja do të jemi shoqëruese të nuses së bashku me mbesëtonë. Fustanet tona do të jenë të bardha dhe nuk do të vendosim vello. Dasma do të jetë shumë moderne”.

Muajt e fejesës duhet të kenë qenë si një magji për Mbretin Zog po aq sa për Geraldinën. Edhe pse ata kishin 21 vjet diferencë në moshë, Geraldina shprehej se nuk e ndiente këtë në asnjë rast. Ai u dashurua fort me gruan e re. Nëse u referohesh sërish raporteve të ambasadorit britanik në Durrës:

“Thuhet se ai ka rënë në dashuri me të, aq shumë sa është gati të përballet me mospëlqimin e palës italiane nëse shfaqet, dhe sipas kolegëve të mi jugosllavë të cilët kanë folur me mua në lidhje me aspektet financiare, do të sakrifkohet edhe një ndihmë financiare italiane, të cilët ishin përgatitur për ta dhënë për marrjen e një nuseje italiane.”

Mbreti filloi të bënte shpenzime marramendëse dhe të pajustificueshme për gruan e re. Çdo mëngjes Geraldinën e priste një buqetë e freskët me lule dhe një dhuratë. Çdo mbrëmje, kur shkonte në shtrat, gjente dy tufa me lule dhe një surprizë nën jastëk. Bigrafja e Geraldinës që i referohet kujtimeve të saj shkruan: “Me zyrtarizimin e fejesës, Mbreti e mbuloi të fejuarën me stoli të blera tek argjendari Osterisher, nga Vjena.” Vetë Geraldina kujton:

“Një mëngjes, kur unë me Mbretin mbaruam së biseduari, ai thirri një nga oficerët, i cili hyri me një tabaka të madhe plot me kuti. I hapëm një e nga një. Në fillim ishte një diademë që vezullonte nga diamantët, me një gur në qendër, ku ishte gdhendur përkrenarja e Skënderbeut.

Midis gjerdanëve ishte një lidhëse me një diamant të madh. Unë mbeta pa frymë nga ngazëllimi, kur Mbreti zgjodhi një byzylk me diamante dhe ma vuri në dorë. Pastaj zgjodhi vathë me një diamant që të kombinoheshin me diademën. Pashë një kuti që kishte një zinxhir prej floriri të bardhë me një kryq me diamante. E kisha të vështirë t’ia ndaja sytë. Mbreti e hoqi mënjanë dhe nuk tha asnjë fjalë. E pashë, gjithashtu, të hiqte mënjanë tri kuti të tjera, njëra më e vogël se dy të tjerat.”

Biografia e Geraldinës, vijon:

“Pjesa më e madhe e plaçkave u soll nga Parisi prej vetë Mbretit, i cili kishte shije të hollë dhe i pëlqente shumë të zgjidhte veshjet për Geraldinën. Ai kishte porositur një rrobaqepës të vinte nga Franca për të marrë masat e Geraldinës, ndërsa dy shtëpitë e modës Channel dhe Worth, të zgjedhura nga Mbreti, bënë një kallëp me përmasat e saj. Geraldina nuk pati mundësi të këshillohej me askënd, pasi Mbreti zgjodhi personalisht tre fustane mëngjesi, gjashtë fustane pasditeje, tre palë kostume, gjashtë fustane balloje dhe rroba sportive. Nga Maison de Blanc në Paris, ai porositi fustane shumë të bukura për në shtëpi dhe dhjetëra komplete të brendshmesh prej mëndafshi, të stolisura me dantella elegante. Secila veshje kishte këpucët, kapelet, dorashkat dhe çantat e veta të kombinuara, bashkë me çorapet e holla prej mëndafshi. Me të vërtetë që ishte një garderobë që i shkonte për shtat një mbretëreshe.”

Asgjë më shumë sesa shtypi shqiptar dhe ai botëror nuk mund të japë atmosferën që ekzistonte në botë dhe në Shqipëri për këtë dasmë. Por nëse shtypi vendas është i mbushur me lëvdata dhe diti-rambe shpesh të mërzitshme, ai botëror është prirur më shumë nga sensacionet, si këto të dyja të marra nga dy gazeta amerikane, “New York Herald Tribune”, më 14 prill të 1938-ës me titull, “Regjimi nazist mund të prishë planet për martesën e Zogut. Arrestohet në Vjenë rrobaqepësi joarian”:

“Vjenë, 15 prill. Planet për dy martesat aristokratike kanë hasur në vështirësi në kampin gjerman në Vjenë. Mbretëresha e ardhshme e Shqipërisë mund të mos marrë fustanin e saj të nusërisë.

Hedi Raab, rrobaqepës nga Vjena, i cili bashkë me Chanel de Paris po përgatisin fustanin e nusërisë për martesën e Konteshës Geraldina Appony me Mbretin Zog të Shqiptarëve më 27 prill, nuk mori dot lejen të shkojë në Tiranë për provat përfundimtare.”

Apo “The Sun” e Baltimores, më 24 prill të 1938-ës me titull, “Martesa e Zogut për ndalimin e bisedimeve italiano- franceze”:

“Negociatat e marrëveshjes italiano-franceze do të pezullohen deri sa ministri i Jashtëm italian, Konti Galeazzo Ciano, të kthehet të enjten e ardhshme nga martesa midis Mbretit Zog të Shqiptarëve dhe Konteshës Geraldina Appony.

Meqenëse, vetë Konti Ciano drejton negociatat për Italinë, nuk pritet ndonjë e re, derisa ai të kthehet nga Tirana, kryeqyteti shqiptar, ku do të zhvillohet të mërkurën ceremonia e Dasmës Mbretërore. Konti Ciano do të jetë një nga dëshmitarët zyrtarë të Monarkut.”

Dasma nisi më 23 prill, me një pritje që Mbreti dhe Mbretëresha e ardhshme dhanë për trupin diplomatik dhe për gazetarët e huaj që kishin mbërritur në Tiranë. Shpenzimet e dasmës nuk u mësuan kurrë. Gazeta “Shtypi” e datës 24 prill të 1938-ës, raportoi në faqen e parë: “Banka Kombëtare vuri në dispozicion të Sovranit 10.000 franga ari/me rastin e martesës së tij”. Por shuma zyrtare ishte shumë më e vogël sesa ajo që derdhën individë dhe kompani private për këtë rast. Duket se pagesa tek Mbreti u bë një lloj manie, siç dëshmojnë këto tituj të shtypit shqiptar: “Shoqëria “SITA” vë në dispozicion të N.M.T. Mbretit shumën prej 5000 fr. ari.” (Java, 1938, nr. 46, 18 prill, f. 12). “Shoqëria e Elektrikut vuri në dispozicion të L. M. T. Mbretit 15.000 fr. ari me rastin e martesës së tij. Shoqëria e Selenicës fr. ari 20.000 dhe Shoqëria E. i. A. A fr. ari 1000” (Gazeta e Korçës 1938, nr. 2943, 23 prill, f. 4).

Dasma u bë eveniment botëror. Hotelet e paktë të kryeqytetit qenë rezervuar për të ftuarit e Mbretit dhe 79 fotografët e gazetarët e ardhur nga e gjithë bota, përfshi Afrikën e Jugut, Argentinën dhe

Japoninë. Dhuratat zunë vendin kryesor në shtypin e huaj. Regjenti, Horti, i Hungarisë pati ofruar një pajton tërhequr nga dy kuaj lipizan, Franca, një servis prej porcelani Sevre, Musolini disa vazo që dikur i përkisnin Napoleonit, ndërsa Mbreti Viktor Emanuel një statujë antike prej bronxi. Dhurata që binte më shumë në sy ishte ajo e bërë nga kancelari i Gjermanisë, Hitler, një Mercedes sportiv kabriole të kuq. Sipas "Corriere della sera" ekzistonte vetëm një ekzemplar tjetër i këtij modeli, ai i Hitlerit. Në fakt, gazeta italiane gabonte. Mercedes - Benzi që i ishte dorëzuar Mbretit Zog, më 19 prill të 1938-ës, ishte model 540K kabriolet, i njëjtë me atë që Hitleri i kishte dhuruar po atë vit për martesën, Mbretit Faruk të Egjiptit dhe liderit sovjetik, Stalinit, me rastin e 60 vjetorit të lindjes. Makina ishte e kuqe, me veshjen e brendshme bezhë, me stemën mbretërore të stampuar në të dyja dyert. Pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia, Zogu e mori atë me vete në Britani. Ajo figuron e regjistruar në Londër me targën ENX 957, por Mbreti doli me të vetëm një herë. Në vitin 1944 nën shtytjen e Geraldinës, ai ia dhuroi makinën Kryqit të Kuq Britanik dhe ky i fundit, ia shiti një personi privat në vitin 1946. Për herë të fundit figuron pronë e një koleksionisti makinash, që në vitin 1987 e vendosi në një muzeum në Illinois për 3 vjet. Më pas, u shënuar se e mori i zoti dhe nuk dihet se ku gjendet më. Mendohet se është pjesë e koleksionit të makinave të stilistit amerikan Ralph Lauren. Simotra e saj identike, makina e Mbretit Faruk, u shit në vitin 2006 në një ankand në Monte Carlo për shumën 921 mijë euro.

Siç ndodh rëndom në këto raste, shtypi botëror dhe diplomatët e huaj i kushtuan mjaft vend dhuratave. "Time" shkruan:

"Kur mbërritën dhuratat, u bë e qartë se komplikimet ndërkombëtare nuk patën kaluar pa u vënë re. Adolf Hitleri i dërgoi një Mercedes-Benz sportiv. Musolini i dërgoi katër vazo bronzi, që dikur i përkisnin Napoleonit, një statujë dragoi erdhi nga Mbreti Vittorio Emanuele, tapete orientale nga diktatori Metaxas i Greqisë dhe një skrivani e përpunuar e shekullit XVII nga Generalissimo Franco i Spanjës"

Geraldina pa vetëm pak dhurata, pasi shumica u depozituan në kazermat pranë pallatit që po ndërtohej dhe ku çifti mbretëror nuk

u vendos kurrë. Ato mbetën aty shumë kohë dhe u morën më 8 prill të 1939-ës nga ushtria pushtuese italiane. Pas vitit 1950 Geraldina hapi një çështje të gjatë gjyqësore në Itali për të marrë mbropsht dhuratat, ose vlerën e tyre sipas listës që kishte në dispozicion, por nuk mori asgjë.

Dita e dasmës ishte më 27 prill. Geraldina kujton se ajo u zgjua në orën gjashtë, pavarësisht faktit që kishte rënë të flinte shumë vonë. Veshja e dasmës ishte zgjedhur sërish nga Mbreti. Ajo veshi një fustan të qëndisur me perla dhe diamante të bërë nga Uorth, posaçërisht për të. Në orën 11.00 nusja hyri në sallën e nderit të pallatit. Shtypi amerikan i kushtoi reportazhe të gjata dasmës si dhe atmosferës së saj, si ky i "The New -York Sun" i datës 27 prill 1938, i titulluar: "Shqipëria bëhet me Mbretëreshë".

Tiranë, Shqipëri 27 prill, (A.P.) Në një ceremoni qytetare e dalluar për thjeshtësinë malësore, Kontesha Geraldina Appony, nëna e së cilës është amerikane, u bë Mbretëresha e parë e shqiptarëve, kur u pranua në martesë nga Mbreti Ahmet Zogu.

Një breshëri prej 101 të shtënash, jehonat e këmbanave të kishave dhe thirrjet e muezinëve muhamedanë, që luteshin nga minaretë, sinjalizuan martesën. Ceremonia u mbajt në një atmosferë gjysmë perëndimore e gjysmë orientale.

Ata u deklaruan burrë e grua nga Hiqmet Delvina, nënkryetar i Parlamentit, pasi ai kishte lexuar kërkesat e kodit civil për martesën para 200 të ftuarve dhe anëtarëve të Familjes Mbretërore.

Pra, Mbretëresha Geraldina iu bashkëngjiti Mbretëreshës Farida të Egjiptit, si Mbretëreshat më të reja të Botës. Mbretëresha Geraldina ishte 22 vjeç dhe Mbretëresha Farida ishte 17 vjeç. Mbretëresha Geraldina ishte e vetmja Mbretëreshë që përmban gjak amerikan. Ceremonia u zhvillua në një aneks të Pallatit Mbretëror. Muret qenë mbushur me armë antike shqiptare.

Nusja, pak më e gjatë se Mbreti, shkëlqente në një fustan nusërie prej sateni të bardhë, Chanel, thurur me perla dhe fije argjendi në formë lulësh. Bishti i fustanit të saj mbretëror ishte i gjatë. Nga një vello prej tyli të bardhë varej një diademë me lule portokalli.

Mbreti veshi një uniformë parade, mbushur me dekorata, si

Kryekomandant i Ushtrisë.

Mijëra malësorë të veshur në mënyrë piktoreske – gegë nga Veriu dhe toskë nga Jugu – përshëndesnin Mbretin, që nga një kryetar fisi u bë Monark dhe me një Mbretëreshë. 50 mijë nxënës, të veshur me kostume kombëtare, binin në sy me xhandarët dhe përfaqësuesit zyrtarë nga çdo cep i Shqipërisë.

...Pasi morën urimet nga Konti Ciano dhe të ftuarit e tjerë të rëndësishëm, Mbretëresha kapi për krahu Mbretin dhe së bashku dolën përpara turmave të entuziazmuara që qëndronin para Pallatit Mbretëror.

Edhe ambasadori britanik në Tiranë vijoi raportimet e tij me një stil shumë gazetaresk. Më 30 prill ai i shkruante ministrit të Jashtëm Eden:

“Kam nderin të raportoj se martesë e Mbretit Zog me Konteshën Appony ndodhi në Pallatin e Tiranës në datën 27 prill. Martesa u bë në një sallon që ishte shtruar gjatë festimeve të pavarësisë, e improvizuar, por me mjaft hapësirë.

Ceremonia ishte tepër e shkurtër. Një detaj ishte butësia dhe kthjelltësia e fjalës “po” nga kontesha në gjuhën shqipe. Dëshmitarët e dhëndrit ishin Princi Abid i Turqisë dhe Konti Çiano, ndërsa të nuses ishin kushëriri i saj, konti Karl Appony si dhe ministri hungarez. Gjithçka nga këto ishin organizuar në mënyrë ekselente.”

Por, duket se ambasadori ndryshon mendim për pjesën tjetër të dasmës kur raporton:

“Pasdite Mbreti dhe Mbretëresha shtruan drekë për 120 të ftuar duke përfshirë edhe krerët e misioneve të huaja me gratë e tyre. Përgatitjet linin për të dëshiruar, pasi të ftuarit u ulën rrëmuqshëm si dhe kishte mungesë menyje. Më vonë ajo u zhvendos në tri dhoma të tjera pasi ra një shi i rrëmuqshëm i cili kishte penetruar në tavan. Tirana kaloi një ditë festimesh të mëdha atë ditë. E njëjta gjë edhe në Durrës.

Në mbrëmje u kthyem sërish në Tiranë në një pritje të organizuar nga Kryeministri Kota në Ministrinë e Jashtme. Një detaj vlen të thuhet. Përfaqësuesi i gjeneral Frankos ishte ulur afër- afër me

gruan e ambasadorit sovjetik. Ai kishte kërkuar që një gjë e tillë të mos ndodhte por madje më keq pasi në darkë e gjeti veten përkrah vetë ambasadorit sovjetik.”

Dy javë më pas, më 9 maj, revista më e madhe amerikane, “News Week”, i kushtoi një reportazh po kaq interesant dasmës, me titullin: “Shqipëria, kënaqësi dhe dëshpërim. Fatkeqësia ajrore shënon martesën e Zogut me Geraldinën”, ku jepte edhe një lajm të trishtë:

“Abdikimi i Eduartit V në dhjetor 1936 e la Mbretin Zog I i Shqiptarëve si beqarin e vetëm në Europë. Shqipëria festoi javën e shkuar, me festime 3-ditore, martesën e Mbretit mysliman dhe Konteshës katolike romane Geraldinë Appony...

...Dhurata e Zogut për Mbretëreshën e tij – një kurorë diamantesh, vendosur mbi kurorën shqiptare, një byzylyk, një varëse – u zgjodhën nga bizhuteritë e dërguara në Tiranë nga firmat e Parisit dhe të Vjenës. Të shtunën ai vendosi t’i kthente bizhuteritë që nuk i bleu, me vlerë 1.052.000 dollarësh, me një avion. Avioni u përfshi nga furtuna dhe u përplas në malin Maranola të Apenineve. Barinjtë gjetën trupat e 19 pasagjerëve, por pak gjurmë të bizhuterive. Diamantet dhe gurët e tjerë të çmuar u dogjën, platini dhe floriri u shkrinë. (Kthimi ishte i siguar.) Midis pasagjerëve ishin ministri shqiptar në Romë, gazetarë, që përshkruan martesën dhe amerikania, zonja Helen Lindhein e New - York-ut.

Geraldina kujton se rrëzimi i avionit ku ishin dhe disa prej dasmorëve, ishte si një shenjë e keqe që ajo nuk e harroi asnjëherë. Ngjante më shumë si paralajmërim për lumturinë e tyre të shkurtër në Shqipëri. Shtypi italian raportonte deri në mes të viteve ‘70 se banorët e zonës dhe të ardhur, vijuan të kërkojnë për disa dekada në zonën rreth vendit ku u rrëzua avioni, gurët e çmuar të firmës “Cartier” që po udhëtonin me një valixhe speciale. Në asnjë rast nuk u raportua që të ishte gjetur diçka me vlerë.

Çifti i sapomartuar udhëtoi në mbarim të ceremonive nga Tirana në Durrës me një Mercedes të hapur. Mijëra vetë kishin dalë

në anë të rrugës për të parë Mbretëreshën 21-vjeçare. Geraldina kujton se ata u ulën në verandë për një kafe, përpara se Mbreti t'i tregonte dhomën e madhe të pritjes të mobiluar sipas stilit klasik, dhomën e ngrënies sipas stilit perandorak të Napoleonit dhe dhomën e gjumit në stilin e Maria Terezës. Pallati veror sapo ishte restauruar me rastin e martesës dhe Mbreti Zog mburrej për tavanin e gdhendur, larë në ar. Në të qenë shtruar sixhade të shtrenjta, pjesë e koleksionit të rrallë të Mbretit. Sixhadet, qenë bashkë me armët një prej pasioneve të tij.

“Nusja zgjodhi një këmishë nate mëndafshi të bardhë me mëngë të gjata me dantella si këmbanë dhe priste e tmerruar Mbretin në shtratin me tendë.” – dëshmon biografia e Geraldinës.

Pikërisht këmisha e natës u bë incidenti i fundit i dasmës. Të nesërmen në mëngjes ajo nuk gjendej më nga shërbyesja e Mbretëreshës. E shqetësuar, kjo e fundit, ia referoi këtë bashkëshortit. Përgjigjja ishte befasuese:

“Të kam folur shumë për mënyrën se si i respektojmë ne femrat, veçanërisht nënat. Ishte e domosdoshme që ti të ishe e virgjër dhe çdo vajzë e huaj që vjen për martesë, duhet t'i nënshtrohet një vizite mjekësore. Unë mburrem me faktin se kam aftësinë t'i njoh njerëzit dhe më mjaftoi vetëm të shikoja sytë e tu. Nuk të thashë asgjë për këtë vizitë, pasi e dija që nuk do të kishe pranuar. Por, në të njëjtën kohë, më duhej t'i jepja prova Parlamentit, kështu që e mora këmishën tënde të natës dhe ia dërgova kryetarit.”

Këmisha e natës kishte shërbyer si provë shtetërore e virgjërisë së Geraldinës. Pavarësisht kësaj, siç dëshmon edhe vetë, ajo ishte tejet e lumtur atë natë, natën që konkludoi qëndrimin e saj thujse 4- mujor në Shqipëri.

“Po, e dashuroja shumë! Më dukej shumë i pashëm me atë lëkurën e bardhë, flokët e hapur, me sytë bojëqielli, me karakterin e tij të drejtpërdrejtë dhe imponues. Kurse duart, me gishtat e gjatë e të hollë dhe thonjtë e trajtuar me kujdes, bënë kontrast me jetën e vështirë që kishte bërë si ushtar. Përpos, buzëqeshjes së tij të mrekullueshme, më shumë përshtypje më bëri butësia e tij. Gjatë atyre javëve para

martesës, më llastuan aq shumë, sa kurrë herë tjetër në jetë. Më dukej sikur po jetoja në përrallat e “Një mijë e një netëve”.”

Zogu dhe Geraldina jetuan të pandarë për 23 vjet, derisa ai ndërroi jetë në Paris në Prill 1961. Geraldina vdiq në Tiranë në Tetor 2002. Në fund të jetës, i ishte plotësuar amaneti i vetëm, të vdiste dhe të varrosej në vendin që i kishte vënë mbi kokë kurorën.

Në vitin 2014, Revista “The Richest” e shpalli atë mbretëreshën e pestë më të bukur në historinë e martesave mbretërore. Pas Mbretëreshës Gres Kelli, të Monakos, Mbretëreshës Rania të Jordanisë, Mbretëreshës Jetsun Pema të Bhutanit dhe Mbretëreshës Soraja të Iranit. Për të u shkruajtën shumë libra dhe përcaktimi më i shpeshtë që haset është: “Trëndafili i bardhë i Budapestit”!

NGA BURGJETI NË STAMBOLL, FËMIJËRIA DHE SHKOLLIMI

1895 - 1912

Ahmet Zogu lindi në Burgajet, Mat, një fshat i vogël dhe tashmë thuajse i harruar, në shtëpitë e familjes Zogolli. Të parët e tij kishin administruar prej një kohe të gjatë dhe asnjëherë të dokumentuar plotësisht zonën që shtrihej nga Mati deri në Dibër. Vasalë të sulltanit ata kishin arritur t'u mbijetonin rebelimeve lokale dhe armiqësisë së shtëpive të tjera me influencë të zonës. Në mbijetesën e tyre në krye të krahinës kishte ndikuar edhe izolimi i saj me male të larta dhe larg rrugëve kryesore të komunikimit në vend.

Për origjinën e fisit Zogolli kanë qarkulluar mjaft legjenda, sidomos pas ngjitjes së Ahmet Zogut në fron. Shumica e tyre e çojnë fisin mbrapa deri në kohët e Skënderbeut duke e bërë në rastin më modest një fis aleat me heroin kombëtar të shqiptarëve, ndërsa më entuziaztët, një fis trashëgimtar direkt të Skënderbeut. Librat e shkruajtur për të, i veshin shpesh paraardhësve të tij, gjyshit dhe babait, merita që nuk dokumentohen dot historikisht. Vetë Ahmet Zogu thuajse nuk ka folur kurrë për këtë gjë, por duket qartë që ai ndihej i përkëdhelur nga ky zbulim i historisë dhe nga tisi i madhësisë që u vishej të parëve. Në dy rastet e vetme kur ka folur për jetën, në librin "Intervistë me diplomatin amerikan Bernshtein" dhe në citimet që i ka bërë adjutantit të tij, Hysen Selmanit, Zogu

ka qenë shumë i kujdesshëm për të mos lënë asnjë gjurmë falsifikimi. Ai është përqëndruar më shumë tek gjyshi, një njeri që kishite lënë gjurmë në zonë, Xhelal Pashë Zogolli e më pas tek babai, Xhemal Pasha. Të dy këta, personazhe të njohur të zonës, kanë luajtur një rol në vitet e Rilindjes Kombëtare, edhe pse aktiviteti i tyre është dukshëm modest. Babai, Xhemal Pasha, kishte një miqësi me Rexhep Pashë Matin, një gjeneral i njohur osman, ish-Gubernurator i Tripolit dhe ministër i Emëruar i Luftës në Perandori, detyrë që ai s'e ushtroi kurrë, sepse vdiq rrugës duke shkuar në Stamboll për ta marrë atë.

Por Zogu i kushton mjaft vëmendje nënës, Sadije Toptanit, gruaja e dytë e Xhemal Pashë Zogollit që vinte nga një familje e famshme e Tiranës dhe me ndikim në gjithë Shqipërinë. Xhemal Pasha dhe Sadije Toptani u martuan në vitin 1883. Ata patën 7 fëmijë. Ahmet Zogu ishte fëmija i dytë dhe djali i vetëm. Nëna, Sadija, ndërroi jetë shumë vjet pas vdekjes së burrit të saj, më 24 Nëntor 1934 në Durrës. Ajo u bë dëshmitare e karrierës së jashtëzakonshme të djalit të vetëm e, madje, edhe e kurorëzimit Mbret. Ajo e mbajti për thujse 6 vjet titullin *Nënë Mbretëreshë Sadije* dhe ishte pjesë e protokollit të shtetit.

Ahmet Zogu u lind më 8 Tetor 1895, por në dokumentet zyrtare figuron data 8 tetor 1898. Nuk dihet përse ai mbajti në dokumente si vit lindjeje këtë të dytin, por në kujtimet e adjutantit të tij sqarohet qartë që viti i lindjes është 1895:

"Viti i vërtetë i lindjes së Ahmet Zogut është 8 tetor 1895, por në kohën pas Kongresit të Lushnjës i shtoi 3 vjet duke u regjistruar më 8 Tetor 1898".

As Selmani nuk jep shpjegime të mëtejshme se përse e bëri këtë gjë, por kjo nuk duket se ka rëndësi. Ahmet Zogu ishte djali i dytë i Xhemal Pashë Zogollit dhe i pari me gruan e re, Sadije Toptanin. Nga martesja e parë e babait ai kishte edhe një vëlla, Xhelal Pashë Zogollin që ruajti gjithë jetën një profil të ulët publik dhe që vdiq në mërgim më 1944. Më pas familja u shtua edhe me 6 motra të cilat u shndërruan në personazhe tejet të njohur të jetës publike dhe

politike në vitet e Mbretërisë. Të quajtura "Princeshat" ato patën, siç shprehet diplomati italian Kuaron, një jetë të mërzitshme dhe një fund të trishtë.

Gjatë jetës ai shfaqet me shumë emra, por me të njëjtin identitet. Kur lindi, më 8 Tetor 1895, emri zyrtar ishte Ahmet Muhtar. Kështu figuron i regjistruar në vitet e shkollimit në Stamboll; me këtë emër ka firmosur dokumentet e para politike dhe me po këtë emër njihet në Protokollin e Kuvendit të Vlorës që shpalli Pavarësinë e Shqipërisë më 1912.

Në vitin 1914 figuron në vizitën që i bën Mbretit të Shqipërisë, princ Vidit me emrin Ahmet Zogolli, ndërsa pas Kongresit të Lushnjës, firmos me emrin Ahmet Zogu, duke lënë pas në harresë prapashtesën - olli. Me gjasë, ky gjest ishte pjesë e një fushatë oksidentalizmi që u ndërmor në ato vite, ku shumë elementë të kohës Osmane u hoqën, duke përfshirë këtu edhe titullin Bej apo Pashë në Parlamentin e ri të Shqipërisë.

Së fundmi, në vitin 1928, kur u shpall Mbret, ndërroi emrin Ahmet Zogu që kishte mbajtur si president Republike me emrin Zog I, Mbreti i shqiptarëve. Deri në fund të jetës ai firmosi dhe përdori vetëm këtë emër, pa e kuptuar, që pjesa jo më e pushtetshme, por padyshim më e lavdishme e jetës së tij, ishte ajo kur njihej me emrin Ahmet Zogu. Zogu I, edhe pse më i pushtetshëm dhe më pompoz, nuk e arriti kurrë lavdinë politike që pati parardhësi i tij, Ahmet Zogu.

Ka fare pak dëshmi për marrëdhëniet e Ahmet Zogut me të atin, ndërkohë që marrëdhëniet me të ëmën është e dokumentuar dhe në shumë raste e komentuar me detaje. Zogu jetoj pak vite me të atin. Xhemal Pashë Zogu ndërroi jetë në tetor 1911, po ato ditë që djali i tij i dytë mbushi 16 vjeç. Në fakt, data e saktë e vdekjes së babait është e vështirë të përcaktohet, sepse ajo varion nga viti 1904 në disa dokumente, deri në 1911 në disa të tjera. Sipas dëshmive të besueshme ai ndërroi jetë nga një e ftohur, në moshën 42 -vjeçare, por në librat e mëvonshëm hidhet dyshimi se ka qenë i helmuar nga autoritetet osmane për aktivitetin e tij patriotik, gjë shumë pak e besueshme kjo. I vetmi dokumentim është se deri ditën që ndërroi jetë, Xhemal Pasha kishte bërë përpjekje t'i jepte djalit një edukim

të mirë, madje të sforcuar në kushtet e vështira të Burgajetit. Në kujtimet e cituara, Ahmet Zogu kujton se në vitet e fëmijërisë kishte si mësues të gjuhës shqipe Sali Toron dhe Dervish Himën, ndërsa të gjuhës turke Hafiz Muharremin nga Dibra.

Në moshën 10- vjeçare, Zogu e kuptoi për herë të parë, siç dëshmon edhe vetë, që bota përtej kufijve të fshatit e tërhiqte në një mënyrë magjike, një tërheqje që s'do t'i rreshtte gjatë jetës së tij. Herë për hir të dëshirës e herë për hir të rrethanave, ai ndërroi në jetë aq shumë vendbanime dhe aq shumë shtete sa vështirë se mund të ketë ndërruar një tjetër njeri politik në Shqipëri. Jetoj për një kohë të gjatë në Perandorinë Osmane, në Perandorinë Austro-Hungareze, në Itali, në Jugosllavi, në Greqi, në Turqi, në Francë, në Britani, në Egjipt dhe vizitoi edhe shumë vende të tjera të botës, nga Hungaria, Çekosllovakia, Polonia, Rumania, Estonia, Letonia, Lituania, Suedia, Norvegjia, Belgjika, Jordania dhe SHBA –të.

Por në vitin 1904, Ahmet Zogu 9- vjeçar kishte të tjera shqetësime. Familja Zogolli vendosi që djali i saj të nisej për shkollim më profesional në Stamboll. Në citimet e tij, Ahmet Zogu sqaron se babai kishte dëshirë ta dërgonte për studime në Collegium Theresianum të Vjenës, por nuk sqaron se përse vendimi përfundimtar ishte ai i dërgimit në Stamboll. Djali i ri, 10-vjeçar u nis për në kryeqytetin e Perandorisë Osmane më 15 Shtator 1905. Ai shoqërohej nga një kujdestar besnik i familjes, i quajtur Abdurrahman Mati, ose Abdurrahman Krosi siç njihej në publik. Ky njeri që jetoj me Zogun për 8 vjet në Stamboll u bë për gjithë jetën ndër njerëzit më të afërt. Në vitet e shkëlqimit të Mbretit Zog, ai u bë personazhi më i komentuar i shoqërisë shqiptare, por edhe ndër më të urryerit e saj. I njohur me emrin Lalë Krosi, ai gëzonte një pushtet oskur tipik për Shqipërinë edhe shumë dekada më vonë.

Ahmet Zogu udhëtoi drejt Stambollit me tren, nga Shkupi në Selanik e prej këtu në kryeqytet. Ai u regjistrua në Liceun Shtetëror dhe u vendos të banonte në muajt e parë në shtëpinë e dajës së tij, Fadil Pashë Toptanit. Në dhjetor u transferua në një shtëpi të vogël me qira ku qëndronte bashkë me shoqëruesin e tij.

Ka shumë paqartësi për shkollimin e mëtejshëm të Ahmet Zogut. Ai qëndroi në Stamboll plot 7 vjet, deri më 1912. Sipas disa

rrëfimeve madje edhe citimeve personale, ai kreu studimet e para në Lycée Impérial de Galatasaray, një shkollë elitare me program francez, por kjo është e vështirë të verifikohet dhe pranohet. Liceu i Gallatës i zhvillonte mësimet vetëm në frengjisht, gjuhë që Ahmet Zogu nuk e përdori asnjëherë mirë. Në një intervistë të vitit 2004, djali i tij Leka I, rrëfen:

“Në vitet që jetuam në Egjipt ai filloi të lexonte në frëngjisht...”

Mosnjohja e frengjishtes vë një pikëpyetje të madhe dyshimi në shkollimin e Ahmet Zogut në Liceun e Gallatës.

Mustafa Kruja, një shqiptar që studioi në atë kohë në Stamboll, me përkrahjen e Esat Pashës dhe që më pas do të ishte kundërshtari i madh dhe tradicional politik i Zogut, e kujton kështu takimin me djalin e ri në shkollën “Nynume i Terakij” të Stambollit, një shkollë shumë e famshme dhe elitare që përgatiste punonjës të administratës:

“Shqiptarë s'mbaj mend të kem gjetur në atë shkollë. Në vit të fundit na erdh një djalë i vogël, flokëverdhe, mjaft i hijshëm, veshun elegant, pastër e mirë, aristokratishit i mbyllët. Ishte prej matje dhe më tha se ishte djali i Xhemal Pashë Zogut, 12 vjeç, e quhej Ahmet Murtar.

Miqësi nuk mund të bajshim me njëri-tjetrin, ndryshimi i moshës ishte tepër i madh. Por u shihshin për ditë në bahçe e u përshëndetshim. E pyetsha shpesh nëse kishte ndonjë nevojë për mu. S'kishte kurrë. Studjonte mirë. Ma t'shumën i pëlqente vetmija. S'u zdatte me kurrkënd”

Në një biografi të Ahmet Zogut që ambasadori amerikan në Tiranë, Grant Smith i dërgonte Uashingtonit më 16 Maj 1923 thuhet se ai studioi në një gjimnaz në Stamboll, por u detyrua t'i ndërpriste studimet e mëtejshme për të marrë pjesë në lëvizjet antiosmane.

Po sipas biografëve të tij, pas Liceut të Gallatës ai vijoi studimet në shkollën Ushtarake të Stambollit, por asnjë s'di të thotë se sa vjet studioi atje, nëse u diplomua dhe nëse mori ndonjë gradë ushtarake. Në përgjigjet që i ka dhënë diplomatit amerikan Bernshtajn,

për librin biografik, Ahmet Zogu sqaron se shpesh mungonte në mësim, se ishte kryeneç dhe se më shumë se sa mësimet atij i interesonin personazhet e shquar që njohu atje dhe zhvillimet e rëndësishme politike. Në disa kujtime të pavërtetuara mirë, thuhet se ai nuk ndoqi asnjë shkollë ushtarake, por qëndroi si nxënës ka-det në gardën e Sulltanit, një strukturë ku me sa duket ka mësuar shumë nga përvoja ushtarake.

Në vitet që qëndroi në kryeqytetin e Perandorisë, Stambolli ziente nga lëvizjet politike. Ai mbërriti aty në kulmin e pushtetit të Sulltan Abdyl Hamitit II dhe u largua kur Xhon Turqit tentonin të administronin një shtet të dominuar nga 100 konflikte. Në Stamboll mbante lidhje me shqiptarë në poste të larta që kishin miqësi me familjen e nënës së tij, Toptanasit. Në Stamboll u takua për herë të parë me Esat Pashë Toptanin, gjeneral, komandant i Armatës së Janinës dhe deputet në Parlamentin Osman. Esat Pasha ishte bërë i famshëm në Perandori dhe në Europë në vitin 1908, kur kishte kryesuar delegacionin që i kërkoi Sulltan Abdyl Hamitit II largimin nga fronin.

Është i dukshëm admirimi që Ahmet Zogu i ri kishte për të dy këta burra. Por ndërsa admirimi për Esat Pashën u kthye më pas në rivalitet dhe armiqësi, ai për Sulltanin ngeli i pandryshuar. Zogu nuk ka folur kurrë publikisht për të, por i referohej atij shpesh në bisedat private. Në vitet e Mbretërisë, motrën e martoi me djalin e Sulltan Abdyl Hamitit, Princin Abid dhe ky i fundit, me nënshtetësi shqiptare u emërua ambasador i Shqipërisë në Paris.

Në rrëfimet për Zogun, gjatë gjithë kohës që ishte mbret dhe më pas, është shënuar fakti që në moshën 11-vjeçare ishte pritur në një audiencë nga Sulltan Abdyl Hamiti II. Kjo legjendë qarkullon në të gjitha librat, por edhe shënimet për të në portalet bashkëkohore. Në librin e Hysen Selmanit, sipas citimeve të Mbretit Zog thuhet:

“Fadil Pashë Toptani dhe Halil Pashë Kraja, i cili ishte njeriu më i afërt i Sulltan Hamidit, i krijuan mundësinë e paraqitjes në audiencë me Sulltan Hamidin. Meqenëse Zogu nuk e zotëronte aq mirë turqishten, Halil Pasha ia përkthente. Sulltanit i bëri përshtypje pasi Zogu nuk e zotëronte aq mirë turqishten, por Sulltani i donte shumë shqiptarët dhe kur Zogu u paraqit, ai i vuri dorën në sup dhe i tha:- Të studioni mirë se familja juaj i ka dhënë shërbime të mëdha

Perandorisë, po ashtu duhet të bëheni edhe ju, dhe urdhëroi Halil Pashën që ta kishte në kujdesin më të madh.”

Takimi në fjalë nuk vërtetohet në asnjë dokument historik, madje ngjan disi i pabesueshëm. Vetë Zogu në dëshmitë që i ka dhënë Bernshtajnit nuk flet në asnjë rast për këtë takim, por duket qartë që frymëzuesi i kësaj legjende është ai vetë.

Në fakt, një fill i çuditshëm i lidh bashkë Sulltanin, sfidantin e tij Esat Pashën dhe sfidantin e Pashait, Ahmet Zogun. Kur Esat Toptani mori titullin Pasha, në fillim të viteve 1900, Sulltani i dhuroi një prej shpatave të tij, një armë e shkurtër dhe e stolisur bukur që shenjonte titullin Pasha. Më 12 Shtator 1914, gjatë një vizite në Burgajet, Esat Pasha, në tentativë për të fituar përkrahjen e Ahmet Zogut i fali atij shpatën e Sulltanit. Në vitin 1925 Presidenti Ahmet Zogu e dërgoi shpatën tek disa argjendarë në Vjenë për t'i fshehur simbolet otomane. Me uniformë parade, Zogu shfaqet në të gjitha fotot me këtë shpatë. Ai e mbajti kudo me vete. Gjurmët e saj zhduken pas vdekjes derisa shpata rishfaqet në ankandin e Shën-Gjergjit në Itali në vitin 2008.

Në vitet e mëvonshme të jetës, Zogut i shfaqet adhurimi për një tjetër personalitet turk, Mustafa Qemalin, të cilin e imitoi në shumë vendime të viteve të para të karrierës së tij.

Në kujtime Zogu dëshmon se shkonte shpesh në “Pera Palace”, hotel në Stamboll për të takuar deputetët shqiptarë të Parlamentit Osman dhe për të dëgjuar diskutimet e tyre. Ai përmend ndër të tjerë emrat e Ismail Qemalit, Hasan Prishtinës dhe Xhaferr Breshtanit. Nuk është çudi që të ishte pjesë e rretheve politike, sepse në moshën 17-vjeçare, interesi i tij për politikën ishte shumë i lartë. Edhe pse, në librin e hotelit “Pera Palacë”, ai është shënuar thjesht si një klient nderi në vitin 1939 me titullin *Mbreti i Shqipërisë*.

Ahmet Zogu qëndroi në Stamboll plot 7 vjet, pa u kthyer asnjë ditë në Shqipëri. Jeta në kryeqytet i kishte dhënë një tjetër dimension djalit nga Burgajeti dhe ai e parandjente se një e ardhme e ndryshme e priste. Më 20 korrik 1912 u nis nga stacioni i trenit “Sekercy” i Stambollit drejt Selanikut. Dy ditë më parë i kishte dërguar një telegram të ëmës ku i thoshte:

Po kthehem në Shqipëri. Lajmëroni njerëzit të mblidhen në Burgajet. Me shpresë, brenda javës jam aty.
Ahmet Murtar

Djali 17- vjeçar ishte gabuar dy javë në parashikim. Ai arriti në Burgajet më 12 gusht 1912, pas 7 vjetësh mungesë, pa mbushur ende 17 vjeç dhe pasi kishte ndërmarrë një udhëtim të gjatë nga Selaniku për në Resnjë, Ohër dhe Dibër. Atë ditë nis edhe karriera e tij politike, karrierë që do të zgjaste aktive për 27 vjet, duke e ngjitur në majat më të larta të pushtetit, Ministër, Kryeministër, President dhe Mbret, si askush tjetër në historinë e Shqipërisë.

NGA PAVARËSIA TEK “INTERNIMI” NË VJENË

1912 - 1919

U sgjodha përfaqësues i Matjes. Ndëshkruani për mua vendimet e kongresit. Të nisem për aty apo jo? Pres me nxitim urdhënin tuaj.
Ahmet Murtar

Ky telegram mbërriti në postën e Vlorës, i vetmi institucion publik që kontrollohej nga Qeveria e Ismail Qemalit, më 2 dhjetor 1912, 4 ditë më parë, Kuvendi që vijonte punimet kishte kryer aktin më të madh, Shpalljen e Pavarësisë. Ai që nënshkruar nga një emër i panjohur në jetën publike dhe politike të Shqipërisë së asaj kohë, Ahmet Murtar.

17- vjeçar, Ahmet Murtari ose Ahmet Zogu siç po përmendet në këtë libër kishte mbërritur në vendlindjen e tij më 12 Gusht 1912. I përfshirë nga atmosfera politike e kohës, kishte tentuar të mblidhte në shtëpitë e tij parinë e zonës, duke synuar një lloj organizimi politiko – ushtarak, qëllimi i të cilit nuk bëhet i qartë. Në kujtimet e cituara, Zogu sqaron se synonte shpejtimin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në kushtet e kërcënimit të fqinjve. Vështirë të imagjinosh se sa do të impononte vullnetin e tij një djalë që ende nuk kishte mbushur 17 vjeç në një vend të trazuar dhe kaotik. Nuk

dihet se sa lidhje kishte ai me Ismail Qemalin, Syrja Vlorën dhe Hasan Prishtinën që ndërkohë kishin nisur projektin e shpalljes së Pavarësisë. Nuk dihet se sa i informuar ishte për zhvillimet politike në Stamboll në një moment që lajmet ndryshonin me orë, por duket qartë ambicia për të komanduar dhe për të ecur përpara në jetë. Në harkun e 8 vjetëve, nga 1912 deri më 1920, ai shfaqet në momente kyçe, në pozicione shumë të çuditshme e imponuese; në takime me personazhe politikë dhe ushtarakë, shumë herë më të lartë se sa rangu dhe mosha e tij. Takon jo vetëm aleatë, por edhe kundërshtarë, takon ata që e ndihmojnë dhe ata që e luftojnë, nënshkruan marrëveshje apo lidh pakte në një mënyrë të pabesueshme.

Dokumenti i parë zyrtar ku shfaqet emri i tij i takon tetorit të vitit 1912, kur me një telegram njofton nënprefektin e Matit, Xhemal Beun së është nisur drejt Lezhës me rezervistët e zonës për të përforcuar mbrojtjen e Shkodrës. Telegrami është nënshkruar nga Ahmet Murdar dhe mban datën 13 tetor 1913.

Në ditët në vijim një seri telegramesh nisen drejt Lezhës, Shkodrës dhe Tiranës. Kuptohet që si drejtues i Matit, djali 17-vjeçar është vënë në krye të një force rezerviste në ndihmë të ushtrisë osmane që po mbronte qytetin e Shkodrës. Më 8 Tetor 1912, Mali i Zi u bë vendi i parë ballkanik që i shpalli luftë Perandorisë Osmane. Në ditët në vijim, Greqia, Serbia, Bullgaria dhe Rumania i shpallën po ashtu luftë Stambollit.

Trupat e Knjaz Nikollës e rrethuan Shkodrën, ndërsa ato serbe pushtuan gjithë zonën e Kosovës duke iu afruar Dibrës. Osmanët u shpartalluan në gjithë frontet, duke rezistuar vetëm në dy pika të përforcuara, në qytetin e Shkodrës dhe atë të Janinës. Mbrojtja e Janinës drejtohej nga një oficer me origjinë shqiptare, Esat Pashë Janina, ndërsa Shkodra nga një oficer me origjinë perse, gjeneral Hasan Riza Pasha. Zëvendës i tij ishte gjeneral Esat Pashë Toptani që kishte mbërritur në Shkodër me rezervistët e Tiranës, Kavajës, Shijakut dhe Durrësit.

Emri i Zogut shfaqet dendur në komunikimin e asaj kohe, por asnjë e dhënë nuk verifikohet dot. Në kujtime Zogu dëshmon se ai drejtonte një forcë prej 8 mijë matjanësh, por padyshim që kjo forcë do ketë qenë dukshëm më inferiore. Mjafton ta krahasosh me faktin që e gjithë ushtria e Malit të Zi përbëhej nga 30 mijë vetë

dhe që në mbrojtjen e Shkodrës qenë mobilizuar afro 12000 trupa të ushtrisë osmane dhe rezervistëve. Gjatë 2 javëve të muajit tetor ai shfaqet në periferi të Lezhës, ndërsa më 1 nëntor njofton se ka hyrë në Lezhë dhe ka rënë në kontakt me komandantin e qytetit Ali Fehmi Kosturin.

Ahmet Zogu rishfaqet në dokumentet zyrtare më 12 Nëntor 1912, kur njoftohet Shkodra se forcat e tij kishin rënë në përleshje me trupat malazeze në Kakarriq dhe në Malin e Velës dhe qenë thyer rëndë. Vetë Zogu dëshmon se ushtria e tij humbi afro 400 veta dhe u plagosën 700 të tjerë, por shifrat duken të hiperbolizuara.

Mbas dështimit në tentativën për t'u bashkuar me Hasan Riza Pashën ai kthehet në Mat. Ishte aty, kur më 30 nëntor 1912, mori një telegram që ishte nisur nga Vlora dhe ripërcillej nga Elbasani. Telegrami ishte fare lakonik dhe ishte nisur në orën 20:00 të datës 28 Nëntor 1912.

"Kongresi u hap. indipendenca u proklamue. Ismail Qemal Beu u zgjodh kryetar. Sonte do t'i komunikohet shteteve të mëdha me kablo. Ju urojmë"

Kuvendi i Vlorës kishte shpallur Pavarësinë e Shqipërisë më 28 Nëntor 1912 mbasdite. Pak minuta më vonë, mbërriti një tjetër telegram i firmosur nga Kryeministri i ri i Shqipërisë që jepte më shumë shpjegime:

Sot u hap kongresi i për bamun prej përfaqësuesvet të gjithë Shqipniës dhe vendosi proklamimin e indipendencës së Shqipnies dhe formimin e Qeveriës së Përkohshme. Kryesia e Qeverisë dhe formimi i këshillit m'u ngarkue mue. Lutem e shpallni në qendrat e në për ndënprefekturat dhe ua komunikoni zyrtarisht konsujve t'atyshëm, tua na bamë me ditë edhe neve.

Ismail Qemal

Ahmet Zogu ishte informuar për mbledhjen e Kuvendit disa ditë më parë përmes Ibrahim Koloçit nga Elbasani. Ai kishte organizuar një mbledhje në Burgajet për të caktuar delegatët dhe ishte në pritje të sqarimit për vendin dhe ditën e fillimit të Kuvendit.

Telegrami, njoftonte tashmë se zhvillimet kishin qenë më të shpejta se sa mendonte ai.

Më 2 dhjetor në zyrën e Vlorës mbërriti telegrami i Ahmet Zogut:

“Usgjodha përfaqësues i Matjes. Ndëshkruani për mua vendimet e kongresit. Të nisem për aty apo jo? Pres me nxitim urdhënin tuaj. Ahmet Murtar.”

Nuk dihet se kur ishte nisur telegrami ose nëse ai mori përgjigje, por procesverbali i mbledhjes së fundit të Kuvendit të Vlorës, më 7 dhjetor të 1912-ës shënon:

“Lajmërohen të ardhurit e delegatëve të Ohrit, Hamdi Beu dhe Dervish Him, nga Starova z. Hajdar Blloshmi dhe Mustafa Efendiu dhe nga Mati, Ahmet Muhtar Beu, Riza Beu dhe Kurt Agai!”

Pra, Ahmet Zogu kishte mbërritur me mandatin e Matit, plot 9 ditë me vonesë. Ai nuk arriti ta firmoste dokumentin e Pavarësisë dhe ky mbetet një mister për të dhe gjithë delegatët që erdhën me vonesë. Sipas dëshmimeve të mbledhjes, u vendos që të gjithë të vonuarit me mandat ta firmosnin atë në fund, përpara mbylljes së punimeve, por kjo gjë s'ndodhi kurrë. Mbi dokumentin më të rëndësishëm të shtetit shqiptar mbetën vetëm firmat e personave që u gjendën në shtëpinë e Vlorave mesditën e datës 28 nëntor 1912.

Historia e Pavarësisë u manipulua shpesh gjatë 100 vjetëve. Në vitin 1937, në një biografi zyrtare të Mbretit Zog, u nënvizua fakti që Mbreti kishte qenë në Vlorë dhe kishte firmosur dokumentin më të rëndësishëm të historisë sonë. Në kujtimet për Hysen Selmanin dhe amerikanin Bernshtajn, Zogu deklaroi vetëm që udhëtoi drejt Vlorës me 25 besnikë dhe se Ismail Qemali me ta parë i deklaroi:

“Mirë se erdhe biri im! Ja ku erdhi koha, por duhet ta dish se për këtë punë që po bëjmë ne sot, për shpëtimin e Shqipërisë, kemi pasur si mësues gjyshin tënd, Xhelal Pashë Zogun, dhe këtë po e them që ta dinë gjithë bashkatdhetarët që ndodhen sot këtu në këtë mbledhje historike”!

Duket se fraza që Zogu ia atribuon Ismail Qemalit është më shumë produkt i zbukurimeve të mëvonshme se sa një dëshmi reale e momentit.

Zogu qëndroi në Vlorë thujse një javë. Më 10 dhjetor ai u njoftua se forcat serbe po hynin në Mat nga Dibra dhe në krye të disa trimave të armatosur u nis urgjent për në vendlindje.

Gjatë 27 vjetëve të karrierës politike, Ahmet Zogu u përball sërish me shumë prej protagonistëve të shpalljes së Pavarësisë. Shumica e tyre u bënë kundërshtarë dhe armiq politikë të tij, ashtu si edhe më pas të regjimit komunist. Zogu i la në heshtje ata.

Më 23 Prill 1913 mbasdite, një telegram i nisur nga Shkodra drejt gjithë qyteteve të Shqipërisë, njoftonte se qyteti kishte rënë pas një rrethimi thujse 7- mujor. Ai ishte firmosur nga komandanti i Shkodrës, Esat Pashë Toptani.

Shkodra u dorëzua më 23 prill. Qyteti ishte rrethuar më 8 tetor 1912, në fillim të Luftës Ballkanike dhe kishte arritur të rezistonte për 7 muaj. Fati i madh i vendit ishte se Shkodra u dorëzua plot një muaj pasi Fuqitë e Mëdha kishin përcaktuar kufijtë e Shqipërisë dhe kjo kishte mbetur brenda saj. Princi Danilo hyri në Shkodër më 23 prill, por ai s'qëndroi dot aty për shumë kohë. Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit i kërkoi të largohej dhe ia la qytetin nën administrim një force ndërkombëtare të drejtuar nga një kolonel britanik pasi e plaçkiti atë natën midis 15 dhe 16 majit.

Ndërkohë, Esat Pasha me ushtrinë e mbetur u vendos në Tiranë. Ahmet Zogu, 17- vjeçar e takoi aty, më 15 qershor 1913.

Mbërritja e Zogut në Tiranë duhet të ketë qenë mbresëlënëse. Përveç disa kujtimeve ajo dëshmohet edhe nga Eqerem bej Vlora, i afërm i Esat Pashës dhe Zogut. Djali i ri mbërriti në krye të parisë së Matit e Dibrës i shoqëruar nga afro 200 kalorës të armatosur dhe u vendos në sarajet e Esat Pashës. Familja e nënës së Zogut ishte nga Tirana dhe Esat Pasha ishte i afërm i tij, por jo “daja” siç përmendet gabimisht në disa libra.

Takimi i Esat Pashës me Zogun ka qenë një takim publik. Nuk kuptohet se përse një burrë që po i afrohej të 60 – tave, me gradën gjeneral dhe ndër shqiptarët më të famshëm, i rezervoi një pritje të tillë një 17 -vjeçari thujse të panjohur. Me gjasë, Esat Pasha kishte

dalluar tek Zogu karakteristikat e një lideri që po ngjitej ose donte të manipulonte dhe të mbante në krahun e tij forcën e konsiderueshme ushtarake që Zogu kishte arritur të ngrinte. Mund të kenë qenë të dyja bashkë, sepse siç dëshmon Eqrem Bej Vlora në kujtimet e tij, Esat Pasha i kishte thënë i menduar pas një takimi me Zogun:

“A e vure re mirë këtë djalosh? Do të vijë një ditë kur ai do të shkojë shumë larg dhe do të na mënjanojë të gjithëve, po të jetë se ne nuk ia shkurtojmë këmbët në kohën e duhur.”

Zogu qëndroi në Tiranë për thujse një javë. Bisedat e Zogut me Esat Pashën duhen të kenë qenë shumë të gjera, por thelbi i tyre ishte angazhimi i Esat Pashës në qeverinë e Ismail Qemalit. Në kujtimet e tij 45 vjet pas këtij takimi, Zogu sqaron se i shprehu Esat Pashës edhe opinionin personal që kryeqytet i ardhshëm i Shqipërisë të bëhej Durrësi.

Përgjatë një viti, djaloshi, 18- vjeçar shfaqet dhe zhduket në dokumentet e kohës gjithnjë në rrethinat e krahinës së tij. Herë në një takim e herë në një përplasje, ai edhe kërcënon, edhe negocion me të gjitha palët: Qeverinë e Vlorës, Qeverinë e Durrësit, forcat pushtuese serbe dhe rivalët e tjerë aty. Historia e takimeve të tij me personazhe të rëndësishëm politikë dhe ushtarakë nga viti 1913 deri më 1919 është impresionuese.

Më 16 Prill 1914 në ora 11:00 ai u prit në takim nga Mbreti i sapongjitur në fron i Shqipërisë, Princi gjerman Vilhelm Fon Vied. Princi Vilhelmi I kishte mbërritur në Durrës në fillim të marsit me bekimin e gjashtë fuqive të mëdha dhe plani i tij impresionues për ngritjen e një shteti të vërtetë shqiptar rezultoi thjesht një iluzion. Me gjasë Princ Vidi ishte i paaftë ta zbatonte atë ose rrethanat gjeopolitike e bënë inekzistent. 3 muaj pas mbërritjes së Princ Vidit në Shqipëri filloi Lufta e Parë Botërore dhe gjashtë fuqitë e mëdha u ndanë në kampe armike.

Por më 16 prill 1914, kur Ahmet Zogu i shoqëruar nga Eqrem Libohova, adjutanti i Princit kaloi portën e Sarajit, Pallatit Mbretëror, përplasja e madhe nuk ndihej ende. Zogu ishte nisur më 12 prill nga

Mati dhe kishte mbërritur në Durrës më 14 prill. Ai që vendosur në hotel “Europa”, buzë detit dhe takimin e parë e kishte pasur me Esat Pashën. Zogu nuk kishte qenë në delegacionin që i dorëzoi kurorën Princ Vidit dhe ky ishte takimi i parë mes tyre. Nuk dihet se cila ka qenë biseda, por rindërtimi i asaj skene në të ardhmen ngjan tejet interesant. Në sallonin e fronit qëndronin përballë njëri-tjetrit, Mbreti i Shqipërisë i caktuar nga fuqitë e mëdha, Vilhelm Vid dhe 18- vjeçari, Ahmet Zogu që do t’i zinte fronin Vilhelmit 14 vjet më pas. Ai që do bëhej Mbret i Shqipërisë jo duke u zgjedhur, por duke iu imponuar fuqive të mëdha. Mbreti në fuqi dhe mbreti i ardhshëm qëndronin përballë njëri-tjetrit në praninë e Eqrem Libohovës, adjutantit të Princit që 20 vjet më vonë, do të bëhej adjutant i Mbretit Zog I!

Biseda e tyre ka qenë e shkurtër, sepse 30 minuta më vonë Ahmet Zogu rishfaqet në shtëpinë e Esat Pashës ku takon Kryeministrin Turhan Pashë Përmeti dhe Esat Pashën. Në mbrëmje ai prezantohet me dy vëllezër mjaft interesantë që do ishin të pranishëm përgjatë karrierës së tij, Mehmet dhe Faik Konicën.

Pavarësisht rrethanave dhe momentit, Ahmet Zogu i qëndroi besnik Princ Vidit, ose së paku nuk u përfshi në vorbullat politike kundër tij me gjithë ofertat që s’i mungonin. Kur nisi rebelimi islamik i Shqipërisë së Mesme ai u kontaktua nga krerët e saj. Më 7 qershor 1914, u takua në Tujan me Musa Qazimin, ideologun e lëvizjes. Ai shoqërohej nga Qamil Fejza e Man Picarri. Zogu refuzoi t’i bashkohej lëvizjes së tyre, por për hir të së vërtetës as nuk i luftoi ata.

Zogu ishte nisur në mbështetje të Qeverisë së Durrësit që ishte e rrethuar nga kryengritësit pas konfliktit të Princit me Esat Pashën, por kishte ndaluar në Krujë. Në fakt Qeveria e Princ Vidit nuk pati mbështetje. Ajo mblodhi fare pak forca. Nga 6000 trupat e premtuar të vetmit që u vunë në lëvizje qenë 1200 trupat besnikë të Zogut. Ahmet Zogu me besnikët mbërriti deri në Krujë, mori qytetin, por mbështetësit e tij refuzuan të luftojnë me rebelët që po ashtu ishin myslimanë si dhe ai.

Pas ikjes së Princ Vidit më 3 Shtator 1914, Zogu e kishte shtrirë zonën e tij të influencës dhe pas fillimit të Luftës së Parë Botërore ishte në pritje të zhvillimeve. Kërcënimi më i madh ishin serbët, që

po zbrisnin nga veriu drejt Durrësit në mbështetje të Esat Pashës. Zogu u takua me Esat Pashën më 12 shtator 1914, në shtëpinë e tij në Burgajet. Ishte takimi më delikat, por edhe i fundit mes tyre. Esat Pasha tentoi ta joshte, duke i dhuruar ndër të tjera edhe shpatën e gjeneralit, që kishte marrë nga Sulltan Abdyl Hamiti II. Zogu dëgjoi propozimin për të qenë ministër në qeverinë e Esat Pashës, por nuk pranoi. Esat Pasha qëndroi 3 ditë në shtëpinë e Zogut dhe u largua. Ishte takimi i tyre i fundit. Esat Pasha u vra në qershor 1920 në Paris. Zogu vdiq po në Paris në prill 1961. Fati e solli që dy kushërinjtë rivalë, të varroseshin në të njëjtën varrezë, pak metra larg njëri-tjetrit në Tie të Parisit. Qëndruan aty për 51 vjet derisa eshtrat e Zogut u rivarrosën me një ceremoni zyrtare në atdhe.

Në gjithë këta vjet, Ahmet Zogu, ende adoleshent, vijon të jetë aktiv dhe pjesëmarrës në takime befasuese. Më 7 janar 1915 takohet në Qafë Murrë me komandantin e ushtrisë serbe, gjeneralin Milotin Mishkoviç. Biseda është thjesht pragmatiste dhe synon tërheqjen e Zogut dhe mbështetësve në favor të Serbisë. Në takimin me Mishkoviçin, Ahmet Zogu merr ftesën për t'u takuar në Nish me Kryeministrin serb dhe njeriun më me ndikim atje, Nikolla Pashiçi. Takimi u realizua në janar dhe Zogu shoqërohej nga Nikolla Ivanaj që luante edhe rolin e përkthyesit. Takimi, që ishte i pari, por nuk do të ishte i fundit mes tyre, kishte po atë synim, tërheqjen e Zogut në anën e serbëve.

Zogu dhe Pashiçi do të takoheshin në mënyrë të dokumentuar së paku edhe 2 herë. Takimi i fundit ishte në Beograd në dhjetor 1924. Ka pak dokumente për atë që ata kanë folur. Është aluduar shpesh për marrëveshje e madje kanë qarkulluar edhe tekste të tyre. Askush nuk di të thotë se ç'ka ndodhur realisht, por kur Pashiçi ndërroi jetë më 1928, Ahmet Zogu, siç shprehet ai vetë, ishte zhgënjimi i tij më i madh politik në Ballkan.

Pas shpartallimit të serbëve dhe mbërritjes së austro – hungarezëve Zogu vijon po atë stil politik. Ai di të manovrojë me mjeshteri dhe të krijojë përshtypjen e një njeriu influent që mund të trazojë situatën dhe të përmbysë stabilitetin. Ia arrin të tërheqë vëmendjen dhe më 15 shtator 1915 thirret në një takim nga

komandanti austro – hungarez, Princi Vindishgraltz. Pak ditë më pas takon komandantin e Ushtrisë Bullgare në Ballkan, gjeneralin Bozief dhe në fund, komandantin austro – hungarez në Shqipëri e Mal të zi, gjeneralin Trollman. Duket sikur djali që s'ka mbushur ende 20 vjeç ngjall pështjellim dhe ushtritë që kalojnë në Ballkan kërkojnë ta kenë aleat dhe jo kundërshtar. Austro – hungarezët arrijnë që vullnetarët e tij t'i inkuadrojnë në formën e një batalioni brenda ushtrisë së rregullt dhe Ahmet Zogut i japin gradën e Kolonelit të Ushtrisë, një gradë shumë e lartë dhe thuajse e pamundur për një 20 vjeçar. Siç e komenton edhe ambasadori amerikan Grant Smith në një shënim biografik të Zogut, dërguar për Uashingtonin më 16 maj 1923: "Mori rangun e Kolonelit, me një emërim të veçantë."

Në janar të vitit 1916 trupat austro – aungareze marshuan drejt Shqipërisë, ndërkohë që Esat Pasha u kishte deklaruar luftë. Por trupat e tij modeste u shpartalluan bashkë me ushtrinë serbe e cila i shpëtoi katastrofës falë ndihmës së flotës italiane që barti pjesën më të madhe të saj nga Durrësi drejt Korfuzit. Bashkë me to u largua edhe Esat Pasha. Durrësi u zbraz më 25 janar 1916 dhe me 26, trupat austriake së bashku me ta edhe Zogu, hynë në kryeqytet.

Duket se Zogu e pa këtë si një shans të tijin për të ardhur në krye të shtetit. Brenda javës krijoi një Këshill Provizor të qeverisë dhe emëroi një kryetar Bashkie. Ai njoftoi të gjitha zonat që qenë nën pushtimin austriak që t'i bindeshin autoritetit të Këshillit Provizor dhe i dha atij atributet e një qeverie të përkohshme.

21 vjeçar, Ahmet Zogu tentoi t'i jepte peshë qeverisë së tij duke ftuar në të personazhe të njohur dhe me karrierë të gjatë politike si Aqif Pashë Elbasani. Ai lëvizi disa herë nga Durrësi në Tiranë e Elbasan dhe besoi se thirrja e një kongresi kombëtar do legjitimonte qeverinë, siç kish ndodhur në Vlorë më 1912.

Më 3 mars 1916, në zyrat postare të thuajse gjithë qyteteve shqiptare, edhe ato që ishin nën pushtimin italian dhe grek si dhe në drejtim të gjithë kolonive shqiptare në botë mbërriti ky telegram:

Të gjithë bashkive të Shqipërisë, parisë së Kosovës, kolonive shqiptare në Bukuresht, Sofje, Turqi, Lozanë, kemi nderin t'ju njoftojmë se u vendos të mblidhet këtu në qytetin e Elbasanit më 18 mars

1916 Kongresi Kombëtar për të diskutuar mbi problemet e Shqipërisë. Ju lutem dërgoni nga dy delegatë, të cilët duhet të sjellin me vete një akt përfaqësimi të rregullt të popullit.

Kryetar i Komisionit, Iniciator i Kongresit.

Elbasan më 3 Mars 1916 A. Zogu d.v.

Por Kongresi nuk u mbledh dot kurrë. Edhe pse në historinë e Shqipërisë ai njihet si Kongresi i Elbasanit, në fakt ishte vetëm një tentativë e tillë. Austro – hungarezët e ndaluan, duke e konsideruar Shqipërinë vend të pushtuar. Ata qenë kundër një administrate shqiptare indipendente dhe ndërtuan një të tillë që varej nga autoritet e pushtimit. Të gjitha këto ia tha Ahmet Zogut në sy gjenerali Trollman, gjatë një takimi në Shkodër më 14 prill 1916.

–“Ky djalë po kthehet nga një mbështetje në një problem”, -shkruan August Kral, autoriteti më i lartë civil austriak në Shqipëri në qershor në vitin 1916. Me gjasë nuk është autoriteti i vetëm austriak që mendon kështu. Sorrollatja plot rrëmujë e Zogut, lidhjet me personazhe që Austro – Hungaria i konsideronte armiq dhe tentativat e vazhdueshme për të krijuar një administratë paralele, duket se e lodhën gjeneralin Trollman. Ai po kërkonte një shkak për arrestimin e Zogut ose në rastin më të mirë, largimin nga Shqipëria.

Rasti erdhi në fund të vitit 1916. Perandori Franz Jozef i Austrisë, që kishte drejtuar vendin për 68 vjet, ndërroi jetë në Kështjellën e Shënbrynit pranë Vjenës dhe nipi i tij, Karl do kurorëzohej Perandor. Përfaqësi nga gjithë vendet që kishte pushtuar Austria u ftuan të merrnin pjesë, përfshi edhe nga Shqipëria. Ahmet Zogu 21 vjeç, i veshur me uniformën e kolonelit dhe me një dekoratë të lartë në gjoks, ishte pjesë e delegacionit.

Askush s’di të thotë me saktësi nëse Zogu u nis me delegacionin apo ai ishte më parë në Vjenë. Në kujtime Zogu është qëllimisht i vagullt, duke dhënë një version që nuk kuptohet mirë. Rrëfen se ka qenë në Vjenë më parë, por nuk tregon nëse ishte atje kur vdiq Perandori apo shkoi me rastin e kurorëzimit.

Për thujse 3 vjet, nga fundi i vitit 1916 deri në fillim të vitit 1920, jeta dhe karriera e Ahmet Zogut është e mbushur me mister. Ai mori pjesë në kurorëzimin e Perandorit Karl, por ndryshe nga anëtarët e tjerë të delegacionit nuk u lejua të kthehej në Shqipëri. U

konsiderua kolonel në prapavijë dhe i shoqëruar nga një adjutant, qëndroi në Vjenë dhe në zonat e tjera larg frontit.

Askush s’di të thotë se ku qëndroi, çfarë aktiviteti pati dhe cilët qenë miqtë e tij? Si mund të zhytej në heshtje të tillë një djalë që kishte qenë aq aktiv? Rrëfimet e vetë Zogut ngjajnë të pabesueshme. Përmes tyre tenton të krijojë një jetë që padyshim nuk e ka pasur. Rrëfen se ishte familjar në Kështjellën e Shënbrynit dhe se njihte Perandorin dhe Perandoreshën.

Disa dëshmi vijnë nga shqiptarët e tjerë që kanë jetuar ato vite në Vjenë. Ai shoqërohej me Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Faik Konicën e Nexhip Dragën. Faik Konica është i vetmi që ka lënë ca dëshmi të zbehta të jetës së Zogut në Vjenë. Ai kujton se djali i ri kishte një pasion të çuditshëm për operan ku ishte vizitor i rregullt.

“Vetëm një herë kam parë lot në sytë e këtij njeriu, - rrëfen Konica, në aktin e fundit të operas “Palaçot”. Ishte pranë meje dhe dukej aq i emocionuar”

Konica vetë nuk di të thotë se ç’e lidhte me operan këtë djalë që nuk kishte as kulturën dhe as rafinimin e një fansi të muzikës klasike.

Për ironi të fatit, 15 vjet më vonë, një grup kundërshtarësh, ku përfshihej edhe një prej miqve të kohës së Vjenës, Hasan Prishtina, do tentonte t’i bënte një atentat duke dalë nga opera e Vjenës pikërisht pas shfaqjes “Palaçot”.

Vjena ishte kryeqyteti i dytë i madh ku Zogu jetoi përpara ngjitjes në pushtet. Pas 7 vjetësh në Stamboll, 2 vjetët e Vjenës dhe thujse 8 muaj të kaluar në Romë qenë një eksperiencë mbresëlënëse për të. Ndryshe nga Stambolli oriental, Vjena kishte shkëlqimin dhe finesën e perëndimit. Jetesa aty i vlejti për të mësuar gjermanishten, një nga dy gjuhët e huaja që fliste dhe për të njohur më mirë manierat e një shoqërie të edukuar.

Në Vjenë, Ahmet Zogu 21- vjeçar duhet të ketë pasur eksperiencat e para serioze me femrat. Konica kujton se ai ishte i pëlqyer nga gratë dhe zonjat e Vjenës. Prania e një djali 21- vjeçar, të gjatë dhe me sy blu, dallohej lehtësisht në kafenetë e Vjenës, të shkretuara nga lufta. Burrat ishin në front dhe oficeri i ri me uniformë, aq më shumë kolonel, tërhiqte vëmendjen. Zogu nuk foli kurrë për historitë e tij të dashurisë, por një prej shqiptarëve më të famshëm

në Vjenë, mecenat i gjithë studentëve, doktor Pekmezi, ka rrëfyer më vonë se ai frekuentonte mjaft zonja të njohura në mungesë të burrave të tyre.

E panjohur dhe e zbehtë, jeta në Vjenë e Ahmet Zogut mbetet për t'u dokumentuar. Por veç kësaj, ajo luajti një rol vendimtar në formimin dhe në vendimet e mëpasme për modernizimin e Shqipërisë.

Fundi i Luftës së Parë Botërore e gjeti në Vjenë, por ai nuk mundi të largohej menjëherë prej andej. Së bashku me koloninë politike shqiptare ndiqte me ankth zhvillimet në Shqipëri pas largimit të Austro - Hungarisë dhe zërat për një shpërbërje të shtetit në favor të Greqisë dhe Serbisë. Rrugët e komunikimit qenë ndërprerë dhe gjithë tentativat për t'u kthyer në Shqipëri po dështonin. Vendi që i pushtuar nga italianët, me përjashtim të Korçës e Shkodrës që kontrolloheshin nga francezët.

Ata ishin ende në Vjenë kur mësuan për mbajtjen e Kongresit të Durrësit dhe ngritjen e Qeverisë. Duket se ai, Hasan Prishtina, Bajram Curri, por edhe Abdi Toptani kishin dyshime për italianizimin e Qeverisë së Durrësit.

Më 1 shkurt 1919, grupi i shqiptarëve ku bënë pjesë Ahmet Zogu, Faslli Frashëri, Refik Toptani, Hasan Prishtina dhe Faik Konica u nis nga Vjena për Romë. Ata udhëtuan dy ditë dhe në datën 3 shkurt 1919 mbërritën në stacionin Termini në Romë.

Turhan Pasha, Kryeministri i Qeverisë së Durrësit ishte aty. Ai u takua me dërgatën shqiptare në hotel "Excelsior" në Via Veneto. Turhan Pasha ishte nisur për në Konferencën e Paqes dhe diskutimi me ta duhet të ketë qenë i tensionuar. Turhan Pasha mendonte se mbrojtjen e Pavarësisë së Shqipërisë duhej të bënte Italia ndërsa të tjerët qenë dyshues.

Zogu qëndroi në Romë për disa muaj. Transferimi i tij drejt Shqipërisë ishte i ndaluar, sepse autoritetet italiane që kontrollonin vendin nuk e pajisnin me vizë. Nuk dihet se ku jetoi ato muaj dhe cili ishte impenjimi kryesor. Nga kujtimet dhe rrëfimet e Eqrem Bej Libohovës mësohet se në gusht 1919 është takuar me ministrin e Jashtëm Italian, Kontanino. Takimi duhet të ketë qenë i shkurtër. Ideja e italianëve ishte përfshirja e Zogut në Qeverinë e Durrësit në

postin e zëvendëskryeministrit mbetur bosh pas vrasjes së Preng Bib Dodë Pashës. Ai konsiderohej një personazh me ndikim dhe italianët preferonin që ta kishin në anën e tyre.

Zogu kujton se nuk e pranoi ofertën italiane. Rrëfimi duket i sinqertë dhe përputhet edhe me kujtimet e Hasan Prishtinës. Ai po e priste në hotel dhe ishte i pari që dëgjoi rrëfimin e Zogut. Ata ishin përsëri bashkë më 10 gusht 1919, kur Sejfi Vllamasi, mbërriti nga Parisi me një letër të firmosur nga 4 anëtarët e delegacionit shqiptar të Konferencës së Paqes. Teksti i saj që i shkurtër dhe lakonik:

"Më dëshpërim të madh po ju vëmë në dijeni se gjendja e Shqipërisë është në rrezik për mosekzistencën e saj. Nga ana e konferencës, nuk është marrë parasysh asnjë e drejtë e jona. Shqipëria në momentin aktual është bërë pajë për Italinë, Greqinë, Jugosllavinë.

I vetmi mjet për shpëtimin e Shqipërisë është të ngrihem në një kryengritje e të luftojmë kundër italianëve, grekëve, jugosllavëve, që ndodhen në tokat shqiptare. Në këtë mënyrë, ka mundësi që të shpëtojë se përndryshe me vendimet që janë dhënë, Shqipëria ka mbaruar. Nuk kemi asnjë përkrahje"

Askush s'di ta përshkruajë emocionin e personave që ishin përballë Vllamasit në hollin e hotel "Grand" në Romë. Ngjarja ka zënë vend në kujtimet e së paku 3 personave të ulur aty, përfshi Ahmet Zogun. Por nuk ka asnjë dyshim që kjo letër e shkruajtur direkt dhe pa asnjë zbulim, që kishte mbërritur ndërkohë edhe në tavolinën e punës së Abdyl Ypit në Durrës, luajti një rol vendimtar në ngjarjet e mëvonshme.

18 ditë më pas, më 28 gusht 1919, Ahmet Zogu me 3 miq arritën të hipin ilegalisht në anijen e linjës Brindizi - Durrës duke paguar nën dorë kapitenin. Më 29 gusht, anija zbarkoi në Durrës. Prefekti i qytetit, një kundërshtar i italianëve dhe qeverisë së Durrësit, Abdyl Ypi, po e priste në skelë.

Së bashku me Fazlli dhe Eshref Frashërin ata biseduan gjatë atyre dy ditëve me detaje. Më 1 shtator 1919 mbërritën në Tiranë në shtëpinë e Abdi Toptanit. Pothuajse të gjithë përfaqësuesit e Toptanasve qenë bashkë në atë mbledhje. Takimi vendosi thirrjen e një kongresi kombëtar në Tiranë në fillim të janarit 1920. Deri

atëherë, përfaqësuesit e mbledhjes dhe patriotët në të gjithë vendin do shpërndaheshin për të siguruar mandatet e përfaqësimit dhe do mobilizonin vullnetarët e armatosur. Zogu, deklaroi se gjithë oficerët shqiptarë të Qeverisë së Durrësit duhej të kontaktoheshin për t'u bashkuar me ta.

Muajt në vijim qenë aktivë. Kuvendi u caktua me 5 janar në Tiranë, por trupat italiane e ndaluan mbledhjen aty. Bindja e personave me ndikim qe e vështirë dhe më 15 janar Abdyl Ypi u vra në Durrës prej vrasësish të paguar nga Mustafa Kruja dhe Qeveria e Durrësit.

Më 6 janar Zogu i kërkoi të gjithë delegatëve që të grumbulloheshin në Lushnje në datën 16 janar.

KONGRESI I LUSHNJES DHE VITET E TRIUMFIT

1920 - 1923

Kongresi u hap më 21 janar të 1920-ës, në orën 10 paradite. Meleq Frashëri, komandanti ushtarak i qytetit që pati braktisur Qeverinë e Durrësit dhe ishte bashkuar me delegatët kishte vendosur batalionin e xhandarmërisë shqiptare, në lartësitë mbi qytet. Ahmet Zogu kishte mbërritur një ditë më parë, duke kaluar përmes Shijakut dhe Kavajës i shoqëruar nga Abdi Toptani dhe disa qindra trima të armatosur. Udhëtimi i tyre ishte manifestim force që kishte impresionuar komandantin italian të Durrësit.

Një pjesë e delegatëve kishin mbërritur herët në mëngjes dhe qenë ende të përbaltur. Pa ndaluar ishin ngjitur nëpër kodër drejt shtëpisë së Kase Fugës ku do të zhvillohej kongresi. Asnjë prej 50 përfaqësuesve të 27 qyteteve nuk e dinte se pa dashje, ata po hynin në një ndër mbledhjet më të rëndësishme që do të njihje historia e Shqipërisë. Atë ditë, pa e ditur, ata po nisnin historinë moderne të Shtetit Shqiptar dhe për herë të parë, po i dilnin atij zot vetë, pa ndihmën e askujt.

Kongresi u hap me pesë minuta heshtje në nderim të Abdyl Ypit, ish-prefekt i Durrësit dhe organizator i kongresit që ishte vrarë më 15 janar, 6 ditë më parë, nga vrasës të paguar prej Qeverisë së Durrësit. Atij i kishin vjedhur pothuajse të gjitha aktet e parapërgatitura

të Kongresit dhe listat e delegatëve. Daja i gruas së tij, Abdi bej Toptani ishte aty. Ai kishte refuzuar të hakmerrej, duke u shprehur se Shqipëria kishte shumë haqe për të marrë. Pjesa më e madhe e delegatëve vinin drejtpërdrejt nga varrimi, që ishte bërë më 17 janar në Durrësin e kontrolluar nga italianët, një manifestim madhështor që sikur dëshmonte edhe suksesin e Kongresit. Trima të armatosur që shoqëronin delegatët endeshin kudo nëpër qytet, ndërsa në periferitë e tij, besnikë të Ahmet bej Zogut 24 -vjeçar dhe një batalion ushtarësh shqiptarë kishin marrë masat që askush të mos hynte në qytet. Në kujtime Zogu dëshmon se kishte të gatshëm afro 12 mijë pushkë, por në rrethinat e qytetit qenë instaluar më shumë se 2000 besnikë të tij, kryesisht nga zona e Matit dhe Tiranës. Dy topa të kalibrit të vogël qenë vendosur në kodrat mbi qytet me tytat drejtuar nga rruga që të çonte në Durrës.

Kongresi i Lushnjës nisi më 21 janar të 1920-ës dhe u mbyll zyrtarisht më 31 janar. Ai mori disa nga vendimet më të rëndësishme të historisë së Shqipërisë. E para dhe kryesorja ishte shprehja e vullnetit për t'i zgjidhur vetë problemet e Shqipërisë dhe për ta ruajtur unitetin territorial të saj me forcë. Ditën e mbylljes, më 31 janar ministri i ri i Brendshëm, Ahmet Zogu lëshoi një proklamata për gjithë prefekturat e vendit. Proklamata në thelb thoshte:

Lushnjë, 31 janar 1920

Është e ditur prej gjithë popullit që këtu në Lushnjë u mbajt një kongres kombëtar, i përfaqësuar prej gjithë viseve të Shqipërisë, veç Shkodrës, Lezhës dhe Krujës, delegatët e të cilëve të zgjedhur prej popullit të këtyre krahinave nuk mundën t'i mbërrijnë bisedimet.

... Vendimet e kongresit të votuara njëzëri prej përfaqësuesve fuqiplotë të popullit janë:

1-Rrëzimi njëzëri i Qeverisë së Përkohshme të Durrësit.

2-Zgjedhja e mërgatës shqiptare pranë konferencës së paqes në Paris me këta anëtarë: imzot Luigj Bumçi, Mehmet Konica dhe z.Mihal Turtulli.

3-Zgjedhja e Këshillit të Lartë për të përfaqësuar mëvetësinë e shtetit shqiptar deri sa të vijë mbreti në fron në Shqipëri. U zgjodhën shkëlqesia e tij Aqif pashë Elbasani, z.Abdi Toptani, imzot Bumçi, doktor Mihal Turtulli.

4-Zgjedhja e kabinetit të përkohshëm në kryesinë e Sulejman bej Delvinës me zëvendës z.Eshref bej Frashërin deri sa të kthehet prej Parisi z.Sulejman beu. ministri i Punëve të Brendshme u zgjodh Ahmet bej Mati; ministri i Punëve të Jashtme u zgjodh z.Mehmet Konica

5-Formimi i një këshille kombëtare prej 37 këshilltarësh me kompetenca parlamentare.

Të lajmëroni popullin sa më shpejt e të çoni kopjen e shpalljes nëpër katunaritë.

Ministria e Punëve të Brendshme.

Zgjedhja e qeverisë dhe e Këshillit të Naltë, kapërcimi i ngërçit juridik që vinte nga mungesa e mbretit, ndërtimi i një parlamenti të përkohshëm, denoncimi i Traktatit të Fshehtë të Londrës dhe kundërshtimi i çdo vendimi diskriminues të Fuqive të Mëdha qenë befasuese për fqinjët, Fuqitë e Mëdha dhe mbi të gjitha Italinë.

Ahmet Zogu ishte më këmbëngulësi për të ruajtur të drejtën e Princ Vidit mbi Fronin e Shqipërisë, pa e ditur se 5 vjet më pas, do të ishte ai vetë që do ta rrëzonte përgjithnjë nga froni dhe më 1928-ën, do t'i zinte vendin.

Zgjedhja e Qeverisë kishte qenë një vendim tejet i mençur. Sulejman Delvina, ish-punonjës i administratës osmane dhe jashtë ndikimit të klaneve krahinore në vend u zgjodh Kryeministër pikërisht për pajtimin. Ahmet Zogu, njeriu më me ndikim që kishte edhe ndihmën e Abdi Toptanit dhe Aqif Biçakut në atë moment mori postin e ministrit të Brendshëm. Ai ishte i vetmi që mund të mobilizonte një forcë të aftë për të mbështetur ushtarakisht qeverinë e re.

Veprimi i parë ishte të instalonte Qeverinë e Sulejman Delvinës në kryeqytet, në Durrës. Ai e dinte se problemi më i madh nuk do të ishte Qeveria e Durrësit që e kontestonte këtë, por italianët që qëndronin pas saj.

Më 5 shkurt Ahmet Zogu njoftoi se qeveria po priste në Kavajë, në gatishmëri për të hyrë në Durrës, ku kontrollonte ende ushtria italiane. Po atë ditë, gjenerali Raimondo, deklaroi se me urdhër të gjeneral Piacentinit, komandantit italian në Shqipëri, ata nuk mund të hynin në Durrës. Ai dërgoi një detashment mitraljerësh në afërsi të Shkëmbit të Kavajës për të ndaluar çdo mundësi avancimi drejt kryeqytetit.

Ahmet bej Zogu nuk tentoi të përplasej me ta. Një ditë më pas, kaloi nëpër rrugët dytësore nga Kavaja në Shijak dhe deklaroi se do ta vendoste qeverinë përkohësisht në Tiranë, derisa Durrësi të lirohej nga italianët.

Gjeneral Piacentini reagoi sërish. Në zyrën e postës në Shijak mbërriti një telegram që sqaronte se komandanti italian i Tiranës kish mbledhur parinë e qytetit dhe i kishte kërkuar atyre që të mos e mbështesnin Qeverinë e Lushnjës. Gjuha dhe toni i tij kishte qenë kërcënues.

Më 11 shkurt, duke shpërfillur gjithë paralajmërimet italiane, qeveria udhëtoi për në Tiranë. Pritja dhe entuziazmi i qytetarëve ishte thujtë i pabesueshëm dhe i tronditi mbështetësit e italianëve dhe ata vetë. Popullariteti i anëtarëve të qeverisë po ashtu. Pas një periudhe 8-vjeçare kaosi, shqiptarët po besonin tek vetvetja. Hyrja në Tiranë e qeverisë ngjan triumfuese. Një aparat fotografik e ka fiksuar këtë moment si dhe drejtuesit kryesorë të saj, të rrethuar nga mijëra vetë. Zogu qëndronte në qendër, më i gjati dhe më i riu ndër anëtarët e kabinetit. Pak muaj më parë kishte mbushur 24 vjeç.

Tirana nuk kishte as zyra dhe as kushte për t'i strehuar, por siç pati ndodhur edhe në Vlorë më 1912-ën dhe në Durrës më 1914-ën ndërtesat e vjetra të administratës osmane u shndërruan në seli të qeverisë. Parlamenti dhe Kryeministria, u vendosën të dyja bashkë në shtëpinë e Zija bej Toptanit (aktualisht selia e Akademisë së Shkencave), njëra në katin e parë dhe tjetri në katin e dytë.

Më 15 shkurt të vitit 1920, pas një kërcënimi të ri italian, qeveria e zgjedhur në Lushnjë dhe e vendosur në Tiranë, njoftoi gjeneralin Piacentinin, se nuk e njihte më qeverinë e Durrësit. Ajo kërcënoi se do përplasej ushtarakisht me të. Telegarami iu drejtua Durrësit, por për dijeni edhe gjithë qyteteve të Shqipërisë.

Ministri i Brendshëm, Ahmet Zogu, shpalli mobilizimin e përgjithshëm të popullsisë. Të trembur nga zhvillimi i ngjarjeve, nga mbështetja e madhe në vend dhe nga etiketimi "tradhtarë", 3 përfaqësuesit e Qeverisë së Durrësit dhanë dorëheqjen. Po atë ditë ata i dorëzuan në Shijak arkivin ministrit të Brendshëm. Ky gjest i befasoi italianët. Ata vendosën të kalojnë nga gjuha e forcës dhe e kërcënimit, tek ajo e diplomacisë dhe reciprocitetit.

Qeveria e Tiranës kishte korrur fitoren e parë, që do të pasohej,

befas, nga një seri të tjerash. Për nga intensiteti dhe përmasat, kjo fitore nuk është përsëritur në këto 100 vjet të historisë së Shtetit Shqiptar.

Pas tërheqjes së italianëve dhe kapitullimit të Qeverisë së Durrësit, më 20 shkurt të 1920-ës, vetëm 9 ditë pasi ishte vendosur në Tiranë, Qeveria e Kongresit të Lushnjës u njoh zyrtarisht nga gjithë qytetet e Shqipërisë. Por një numër qytetesh, madje ndër më të rëndësishmit, ishin ende nën kontrollin ushtarak të fituesve të luftës, në pritje të vendimeve të Konferencës së Paqes në Paris.

Në Paris, delegacioni shqiptar ishte bërë befas aktiv dhe kishte nisur të fliste me një gjuhë më të sigurt dhe më kërcënuese. Shqipëria po transformohej. Në mungesë të mjeteve financiare, qeveria shpalli më 8 Mars 1920 një hua kombëtare dhe ftoi gjithë qytetarët e Shqipërisë t'i jepnin borxh qeverisë. Borxhi njihej me shkrim dhe caktohej një afat kthimi. Ajo që nuk pritej ndodhi. Në dy javët e para qeveria mblodhi një buxhet me të cilin mund të niste funksionimin.

Më 11 mars të 1920-ës, trupat franceze, që kontrollonin Shkodrën, nënshkruan një protokoll me Qeverinë e Tiranës dhe xhandarmëria shqiptare mori në dorëzim qytetin. Ministri i Brendshëm, Ahmet Zogu, dhe ai i Drejtësisë, Hoxha Kadria, hynë në qytet si triumfatorë. Trupat serbe që tentuan të hyjnë forcërisht në territorin shqiptar disa orë më pas u gjendën përballë xhandarëve dhe vullnetarëve të Qeverisë së Tiranës. Zogu kishte arritur të grumbullonte një forcë prej afro 3500 vetësh të armatosur dhe kishte negociuar direkt me gjeneralin francez D'Fourtou që mbante qytetin. Në urën e Bahçallëkut ishte kryer edhe ceremonia ushtarake e dorëzimit të qytetit dhe përcjelljes së forcës franceze. Ishte ceremonia e parë zyrtare ndërkombëtare e qeverisë së re.

Pak muaj më pas, më 18 gusht, një numër forcash vullnetare malazeze dhe mercenarësh të udhëhequr nga një person i quajtur Alush Lohja nisën një inkursion kundër Shkodrës për ta bashkuar atë me Mbretërinë e sapokrijuar serbo - kroato - sllovene. Trupat e drejtuar nga ministri i Brendshëm i goditën sërish dhe i shpartalluan. Pak ditë më pas, po këto trupa shpartalluan edhe një tjetër lëvizje pro serbe në Dibër.

Më 27 mars të 1920-ës në Tiranë, u mblodh për herë të parë

Parlamenti. Kryeministri dhe ministri i Brendshëm raportuan përpara tij. Asnjëherë një qeveri shqiptare në ato 8 vjet nuk kish pasur kaq shumë suksese në vetëm 2 muaj.

Ahmet Zogu po fitonte një mbështetje dhe popullaritet që nuk e kishte pasur figurë tjetër. Ende pa mbushur 25 vjeç kishte fituar disa beteja dhe kishte shtrirë autoritetin në gjithë vendin. Kryeministri Sulejman Delvina nuk kishte energjinë e karizmën e tij dhe dukej se e kishte lënë drejtimin e qeverisë thujse krejt në duart e Zogut. Ministri i Brendshëm nuk po ndalej. Ai kishte tashmë nën kontroll gjithë Forcat e Ushtrisë Kombëtare shqiptare dhe komandantët e tyre.

Më 24 prill të vitit 1920, duke përfituar nga një lëshim italian dhe nga thirrja e drejtuesve lokalë, xhandarmëria shqiptare hyri në Gjirokastrë dhe një ditë më pas në Sarandë. Ato kompani me xhandarë shqiptarë të mbetur nga koha e oficerëve holandezë dhe ata pak oficerë që vinin kryesisht nga ushtria e Perandorisë Osmane, u bënë befas engjëjt mbrojtës të popullatës shqiptare. Hyrja e tyre dhe parakalimi nëpër rrugët kryesore të Shkodrës dhe të Gjirokastrës që pritur me një besim që shqiptarët nuk e kishin ndier më parë.

Më 26 maj të 1920-ës në Korçë u hap fjala se në Follorinë ishte duke u përgatitur një ushtri e vogël greke e cila do të hynte dhe do të merrte në dorëzim Korçën. Në këtë mënyrë, ajo do ta vinte përpara faktit të kryer Konferencën e Paqes që atë moment po shqyrtonte pretendimet e Athinës për kufirin me Shqipërinë. Protagonist i manovrën politike ishte Dhespot Jakovi, një klerik grek që kishte krijuar mjaft probleme në Korçë. Patriotët lokalë u alarmuan dhe përpara ndërtesës së Prefekturës u mblodhën qindra vetë, myslimanë dhe të krishterë që kërkonin të mbronin qytetin. Ata kërkonin bashkimin e tij me Qeverinë e Tiranës. Një delegacion i kësaj qeverie, i kryesuar nga zëvendëskryeministri, Eshref Frashëri, mbërriti aty dhe i kërkoi komandantit francez që të dorëzonte qytetin. Ai e bëri vërtet dhe trupat greke që ishin gati të kalonin vijën e kufirit u përballën me një kundërshtim të vendosur dhe të prerë të shqiptarëve. Për të mos shkuar më tej me përplasjen, ata kërkuan negociata dhe si pasojë e tyre u nënshkrua në Kapshticë, "Protokolli i Kapshticës". Ideja e tij ishte që grekët dhe shqiptarët do të qëndronin në kufijtë e vitit 1913, në pritje të një vendimi të Konferencës së Parisit. Protokolli i

Kapshticës i dha legjitimitet të plotë Qeverisë së Sulejman Delvinës. Ahmet Zogu kujton se ajo ka qenë nata më vendimtare dhe më e rëndësishme e Qeverisë së re.

Bashkimi i Korçës, Gjirokastrës dhe Shkodrës me Shqipërinë, mbi të gjitha me insistimin e vetë shqiptarëve, provokoi një ndjenjë të pashembullt entuziazmi dhe besimi të Qeveria e Tiranës. 4 muaj pas krijimit, ajo dominonte thujse gjithë territorin e përcaktuar nga Konferenca e Ambasadorëve, me përjashtim të Vlorës. Kjo e fundit, bashkë me zonat përreth ishte ende nën pushtimin italian. Sipas një Traktati të Fshehtë, të nënshkruar në Londër më 26 prill të vitit 1915, Italia përfitonte Vlorën me rrethinat dhe ruante të drejtën e një protektorati mbi shtetin e mbetur shqiptar. Traktati midis Italisë, Britanisë, Ruisë dhe Francës që bërë publik në vitin 1917 nga gazeta "Izvestija" me vendim të drejtuesve sovjetikë që kishin marrë në dorë Rusinë cariste. Në dijeni të të gjithë këtyre zhvillimeve, Qeveria e Tiranës i kërkoi Qeverisë së Romës, largimin e trupave italiane dhe vendosjen e kontrollit të saj mbi territorin e krahinës. Roma refuzoi. Në fakt, komanda italiane në Vlorë që njoftuar se në datën 29 maj të vitit 1920 në Barçalla të Dukatit që mbajtur një kuvend për fillimin e kryengritjes antiitaliane dhe që krijuar një Komitet i Mbrojtjes Kombëtare.

Në fund të majit të 1920-ës, Qazim Koculi, Qazim Kokoshi, Qazim Haxhiu dhe Duro Shasha udhëtuan drejt Tiranës ku u takuan me Kryeministrin dhe ministrin e Brendshëm. Takimi u zhvillua në banesën private të Ahmet Zogut, fare pranë selisë së Parlamentit dhe të Qeverisë. Roje të armatosur kishin zbratur gjithë zonën për ta ruajtur takimin nga syri kurioz i spiunëve të Italisë.

Midis Qeverisë së Tiranës dhe Komitetit pati një koordinim që është dokumentuar qartë. Qeveria e Tiranës do të mbështeste kryengritjen kundër italianëve, por nuk do t'i shpallte luftë Italisë. Ajo do të ishte në prapavijë të veprimeve ushtarake që do merreshin nga Komiteti dhe do të dërgonte në ndihmë disa batalione me "vullnetarë".

Qeveria e Tiranës lëvizi e para sipas planit. Ahmet Zogu emëroi nënprefekt të Tepelenës Mustafa Luzatin dhe ky i fundit, u urdhërua që bashkë me administratën të hynte dhe të vendosej në qytet për të shpallur bashkimin e tij me Qeverinë e Tiranës. Tepelena ishte

pjesë e shtetit shqiptar, por ajo ishte nën komandën dhe administratën italiane. Nënprefekti, Luzati, dhe zyrtarët që e shoqëronin mbërritën në qytet të pritur me një entuziazëm të madh, por ata u arrestuan. Disa orë më vonë, Qeveria e Tiranës urdhëroi batalionin e Përmetit nën komandën e major Mustafa Maksutit të hynte në Tepelenë dhe të lironte nënprefektin. Batalioni, i përforcuar nga dhjetëra vullnetarë lokalë, arriti të mposhtë mbrojtjen italiane dhe të marrë nën kontroll qytetin. Forcat ushtarake italiane u shoqëruan jashtë qytetit pasi u çarmatosën. Rënia e Tepelenës ishte shenja e parë e luftës.

Më 3 qershor në mesditë, gjeneral Piaçentini komandanti i forcave italiane të pushtimit u njoftua se në paradhomë kishte mbërritur një ultimatum. Gjenerali nuk u befasua nga lajmi, por nga përmbajtja e tij. Komiteti i Mbrojtjes Kombëtare, i cili zyrtarisht nuk kishte lidhje me Qeverinë e Tiranës, i kërkonte lirim të menjëhershëm të Vlorës dhe i jepte vetëm 24 orë kohë për tërheqjen e afro 30 mijë trupave.

Gjeneral Piaçentini s'pati kohë as të merrte përgjigje nga Roma kur njoftoi telegrafikisht përmbajtjen e ultimatumit. Më 5 qershor të 1920-ës, disa mijëra vullnetarë nga Labëria, bashkë me disa mijëra të tjerë të ardhur nga i gjithë vendi nisën sulmin frontal kundër pozicioneve të avancuara italiane. Italianët nuk prisnin një sulm dhe organizim të tillë, edhe pse e dinin që në krye të trupave dhe me stërvitjen e tyre, qenë marrë oficerë karriere të dërguar nga Qeveria e Tiranës. Disa prej tyre, kishin mbajtur grada të larta në ushtrinë e Perandorisë Osmane dhe kishin luftuar në Tripoli me forcat italiane.

Më 15 qershor qeveria ra dhe Kryeministri i ri, Xhovani Xhiolitti, la të kuptohet se për Vlorën nuk do të luftohej, por do të negociohej. Ai nisi baronin Alioti dhe Baronin Kastoldi për bisedime në Durrës. Të dy diplomatët qenë njohës të vjetër të Shqipërisë që nga koha e Princ Vidit. Roma nuk negocoi me Komitetin e Mbrojtjes Kombëtare, por drejtpërdrejt me Qeverinë e Tiranës. Baroni Alioti takoi Kryeministrin Delvina, ministrin e Brendshëm Zogu dhe Spiro Kolekën. Alioti foli me arrogancë dhe nuk pranoi asnjë nga kërkesat e shqiptarëve. Por as Qeveria e Tiranës nuk u tërhoq. Ugo Sola, një diplomat që shoqëronte Aliotin dhe që më pas

do të bëhej i njohur në Shqipëri, kujton se negociatat me Zogun ishin një ferr i vërtetë. Ai nuk pranonte asnjë përgjegjësi kur bëhej fjalë për sulmet ndaj italianëve dhe vinte kushte kur ishte fjala për të drejtat e shqiptarëve. Bisedimet dështuan.

Largimi i Aliotit nuk zgjidhi gjë dhe më 30 korrik në Tiranë mbërriti me instruksione të reja, konti Manzoni, i dërguari i ri i Romës. Kësaj here bisedimet qenë të suksesshme. Më 2 gusht të 1920-ës midis dy qeverive u nënshkrua protokoll i tërheqjes së italianëve nga Vlora. Ky ishte territori i fundit i kontestuar që i bashkohej Shqipërisë. 7 muaj më parë, qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës ishte krijuar pa pasur asnjë perspektivë të qartë. Ajo nuk kish arritur dot të merrte në dorëzim as kryeqytetin, Durrësin. Por në shtator, ajo kontrollonte thuajse gjithë vendin dhe autoriteti i saj u njoh nga të gjithë.

Por nëse rreziku i brendshëm po reduktohej ndjeshëm dhe qeveria po ushtronte aktivitetin normal, një tjetër rrezik vinte nga jashtë. Problemi më i madh në Paris mbetej prania e Esat Pashë Toptanit, që njihej ende si Kryetar i Qeverisë Shqiptare. Ai nuk e njihte Qeverinë e Tiranës dhe po drejtonte një qeveri paralele siç kishte bërë më 1913 me Ismail Qemalin. Forcat e tij të armatosura vijonin të qëndronin kërcënuese në Dibër, por edhe në periferitë e Tiranës.

Esat Pasha kishte mbërritur në kryeqytetin francez në janar të vitit 1919 dhe që vendosur së bashku me qeverinë dhe ndihmësit në hotel "Kontinental", një ndër më të njohurit e qytetit në rrugën "Kastilione". Ai mbante gradën e gjeneralit dhe kishte qenë aleat me komandantin francez Sarrail, në Selanik. Në Konferencën e Paqes pretendonte se përfaqësonte shtetin shqiptar. Ai lëvizte i veshur me uniformën që e kishte qepur tek një rrobaqepës hebre në Selanik dhe ngulte në gjoks, dekoratën e Oficerit të Lartë të Legjionit të Nderit. Esat Pasha kishte hijen ekzotike të një njeriu që kishte kuriozuar shtypin perëndimor që në kohën e largimit të Sulltan Abdyl Hamitit më 1908.

Në Maj 1920 Kryeministri dhe ministri i Brendshëm u informua se esadistët e Shqipërisë së Mesme qenë organizuar nën komandën e Osman Balit dhe në 15 prill kishin kërcënuar kryeqytetin provizor. Për të mos hapur luftë në disa drejtime, Qeveria e

Tiranës iu kish kërkuar atyre një armëpushim disajavor, derisa, një delegacion i saj, i përbërë nga Fuat bej Toptani, peshkop Koleci, major Bajram Fevziu dhe Ymer Deliallisi, të takohej me pashanë në Paris. Delegacioni mbërriti vërtet në Paris, por veç një lloj qetësimi të përkohshëm psikologjik, nuk arriti ndonjë përfundim tjetër në bisedimet me të. I informuar telegrafikisht për dështimin e bisedimeve, ndërsa delegacioni nuk ish kthyer ende, ministri i Brendshëm Ahmet Zogu ngarkoi Bajram Currin të drejtonte operacionin për shpartallimin e esadistëve. Sulmi i xhandarmërisë shqiptare që i befasishëm dhe esadistët u tërhoqën. Ata tentuan të organizoheshin për të sulmuar sërish.

Zogu ishte padyshim njeriu më i shqetësuar për kërcënimin e Esat Pashës. Ai e njihnte mirë dhe e dinte që prania e tij në Paris apo kudo tjetër, do ta kërcënonte punën e kryer nga qeveria. Sejfi Vllamasi kujton se ato qenë ditët më të trishtuara të Ahmet Zogut. Duke shëtitur natën nëpër rrugët e qytetit i kishte thënë:

- "Me Esat Pashën ky vend nuk ka qetësi!"

Por fati nuk e la në baltë djalosin që e kishte përkëdhelur jo pak deri atë ditë. Më 13 qershor të 1920-ës, Esat Pasha i shoqëruar nga nipi i tij, Xhemil bej Vlora, dhe nga një balerinë me të cilën bashkëjetonte prej disa muajsh, Dyfour Elise, 22- vjeçare, po dilte nga hotel "Kontinental" për të ngrënë drekë në një restorant në Aveny Montenjë. Ai i kërkoi portierit që të njoftonte shoferin e tij dhe i kërkoi së dashurës e nipit të hipnin përpara sa të thyente në sportel disa franga. Xhemil Vlora dhe e dashura e Esat Pashës kishin hipur në makinë kur dëgjuan 2 krisma. Ata dolën të shihnin ç'kish ndodhur, kur dëgjuan njerëzit që thërrisnin: "Kanë vrrarë pashanë!"

Një i ri shqiptar, i ardhur nga Vlora, Avni Rustemi, e kish qëlluar Esat Pashën me dy plumba nga mbrapa. Rustemi do të bëhej shpejt deputet i Parlamentit.

Më 13 qershor të 1920-ës kur telegrami që njoftonte vrasjen e Esat Pashës mbërriti mbi tavolinën e ministrit të Brendshëm, ai u ndje i lehtësuar. Reagimi i parë ishte: -Sa e vërtetë është? Meleq Frashëri, komandanti i xhandarmërisë që ishte pranë tij, vështroi edhe një herë tekstin. Ishte lakonik dhe s'linte vend për dyshime!

- E kanë vrrarë!- i tha.

Lëvizja esadiste që kërcënonte qeverinë nuk ekzistonte më dhe

djaloshi që s'kish mbushur ende 25 vjeç, ishte pa dyshim njeriu më i fuqishëm politik në vend. Në rrugën drejt pushtetit nuk mund ta ndalte më askush.

30 prill 1922, e shtunë

Ishte një mëngjes i gjatë me pritje të shumta. Fan Noli më paraqiti grupin më të rëndësishëm të deputetëve në Parlament. Përveç tij ishin edhe Ahmet Bej Zogu dhe Bajram Fevziu i Prefekturës së Matit, Agathokli Gjtoni i Prefekturës së Gjirokastrës. I pyeta për partitë e përfaqësuar. Më thanë se janë dy: Partia Popullore dhe ajo Konservatore. Partia e parë ka tanimë anëtarë 29 deputetë, nga 78 që ka parlamenti. Partia e dytë nuk e ka përpiluar edhe programin. Programi i Partisë Popullore është demokratik dhe ka si synim arsimin, reformën agrare, kushtetutën republikane.

Agathokli Gjtoni më tha se mund të krijohet edhe një parti e tretë, ajo e të rinjve, e cila do të ishte si "E mjata" e Partisë Popullore. Konservatorët, tubojnë pronarët e mëdhenj të tokave, por jo të gjithë, sepse Ahmet bej Zogu është në anën popullore...

Ky është shënimi që Zhysten Godar, deputet i Parlamentit francez dhe mik i madh i Shqipërisë ka bërë në ditarin e tij gjatë njëjës prej vizitave në Shqipëri. Shënimi i Godarit riprodhon përmes fjalëve të Gjtonit, ndarjen ideologjike që ishte ravijuar në Parlamentin shqiptar në zgjedhjet demokratike të 21 prillit 1921. Një përkrahje që dëshmon se bashkimi i vitit 1920 për shpëtimin e trojeve, po ecte tashmë drejt një sistemi politik më të konsoliduar dhe demokratik, të panjohur deri atë ditë në Shqipëri.

Pas sukseseve befasuese të vitit 1920, Qeveria e Tiranës i kishte vënë vetes si detyrë organizimin e zgjedhjeve dhe legjitimitimin e një parlamenti që shprehte vullnetin e popullit. Zgjedhjet u zhvilluan për 12 ditë sipas parimit "një deputet për çdo 12 mijë banorë". Zgjedhësit duhet të ishin mbi 22 vjeç, ndërsa të zgjedhurit, për të qenë në listën për deputetë duhet të kishin moshën mbi 30 vjeç. Lëshimi i vetëm u bë për ministrin e Brendshëm Ahmet Zogu, organizator i zgjedhjeve, që në atë kohë ishte 25 vjeç e gjysmë. Këshilli Kombëtar ose Parlamenti, përbëhej nga 78 deputetë.

Jeta partiake shqiptare, që lulëzoi në zgjedhjet e prillit të vitit

1921 nuk ishte pa traditë. Që në vitin 1914 ishte krijuar grupimi politik "Krahu kombëtar" apo "Klika", sipas modelit që xhonturqit kishin aplikuar në Perandorinë Osmane në fillim të shekullit. Pas zgjedhjeve të vitit 1921, më 24 prill, prej "Klikës" u krijua, Partia Popullore. Në kundërpërgjigje të Partisë Popullore, pak ditë më pas, u krijua në Parlament, Partia Përparimtare ose konservatorët siç njiheshin.

Zgjedhjet e dyta kushtetuese u zhvilluan më 26 – 28 nëntor të vitit 1923, por parlamenti u mblodh më 27 dhjetor. Rregullat e zgjedhjeve u modifikuan. Në zgjedhjet e dyta, kandidatët nuk konkurronin më vetëm si individë, por edhe si formacione politike. Nëse i referohesh studiuesit, Kastriot Dervishi, formacioni kryesor politik në vend ishte Partia Popullore, ku aderonte Kryeministri Ahmet Zogu, por ku kishte marrë një rol dominues edhe Shefqet Vërlaci, beu më i pasur i Shqipërisë.

Zogu dhe Vërlaci qenë afruar mes tyre në kohën e ndërmjetme midis dy zgjedhjeve. Njeriu më i fuqishëm dhe më i pasur në vend, ish- deputet në parlamentin osman dhe italo-fil i njohur, Vërlaci i kishte dhënë jo vetëm mbështetje djalit të ri që drejtonte Ministrinë e Brendshme, por ishte lidhur me të edhe më fort. Më 1921 Ahmet Zogu ishte fejuar me vajzën e Vërlacit, Behijen. Fejesa kishte mbetur pezull, sepse në bazë të traditave Zogu duhet të priste daljen nga shtëpia me martesë të gjashtë muajve të tij. Vërlaci kishte qenë plotësisht dakort me këtë konstatim.

Nuk dihet nëse lidhja me Behije Vërlacin ishte një tentativë e Zogut 26- vjeçar për të krijuar familje, apo një aleancë e domoshme politike sipas stilit osman, ende shumë i përhapur në Shqipëri.

Konkurrentja kryesore e Partisë Popullore ishte Partia Liberale e drejtuar nga përmetari, Agathokli Gjitoni, ku njerëzit më të rëndësishëm ishin Fan Noli, Aqif pashë Elbasani dhe Faik Konica.

Jeta politike dhe parlamentare e viteve 1921 – 1924 prodhoi një shoqëri përparimtare me gjithë kontradiktat dhe problematikën e saj. Në fakt, në vend që ta stabilizonin, zgjedhjet e prillit të vitit 1921 e dobësuan më shumë qeverisjen. Veç debatit normal demokratik, jeta politike dominohej nga intrigat, grushtet e vogla të shtetit dhe imponimi me forcën e armëve.

Ngjarja më flagrante që ajo e nëntor – dhjetorit e 1921-it. Më 4 nëntor të 1921-it, Këshilli i Naltë vendosi befasi të shpërndajë Parlamentin e zgjedhur në prill. Motivacioni ishte se qeveria kishte nevojë për liri që të përballonte situatën tejet të rëndë në veri ku kish shpërthyer kryengritja e Mirditës. Parlamenti në fillim kundërshtoi, por më pas pranoi duke menduar që rimbledhja e tij do të bëhej në një datë të dytë. Po në këtë kohë, Kryeministri, Pandeli Evangjeli, nën tryshninë e kryengritjes së Mirditës vendosi krijimin e dy komandave, një në Lindje nën drejtimin e Ahmet Zogut dhe një në Perëndim nën komandën e Bajram Currit. Por regjenti Aqif pashë Elbasani refuzoi të firmoste emërimin e Zogut duke menduar se fuqia e tij po kalonte fuqinë që duhej lejuar. Në mungesë të dekretit të Këshillit të Naltë, qeveria e emëroi vetë Ahmet Zogun dhe e konsideroi këtë një të drejtë të sajën. Aqif Pasha, duke shfrytëzuar faktin që dy ministra të Pandeli Evangjelit kishin dhënë dorëheqjen, kërkoi largimin e vetë Kryeministrit. Shkarkimi i Pandeli Evangjelit ishte vendosur nga një grup që njihej me emrin "Bashkimi i shenjtë" dhe që drejtohej nga Hasan Prishtina, Mustafa Kruja, Riza Dani, Ramiz Daci dhe Irfan Ohri. Më 6 dhjetor të 1921-it, Aqif pashë Elbasani dhe Imzot Bumçi, dy anëtarë të Këshillit të Naltë firmosën shkarkimin e Kryeministrit Evangjeli. Ky i fundit nuk e pranoi, duke deklaruar se do ta jepte kur të mblidhej Parlamenti. Po atë mbasdite, Hasan Prishtina, Mustafa Kruja dhe Ramiz Daci, të shoqëruar nga një forcë e armatosur, rrethuan hotel "Internacionalin" ku flinte dhe banonte Kryeministri. Evangjeli refuzoi kërkesën e ministrit të Brendshëm, Bajram Fevziu, për të goditur rrethuesit me forcat e kompanisë së Osman Gazepit dhe nën kërcënim dha dorëheqjen. Në vend të tij, për krijimin e qeverisë u ngarkua Qazim Koculi. Por Koculi u tremb nga reagimi në gjithë Shqipërinë me t'u dhënë lajmi dhe 7 orë më vonë, dha dorëheqjen. Po atë natë, për krijimin e qeverisë u ngarkua Hasan Prishtina. Ky ngriti një kabinet, por 5 ditë më pas, më 12 dhjetor, nën presionin e qytetarëve dhe pas një demonstrate të madhe në Tiranë dha dorëheqjen. Në vend të tij, u ngarkua me krijimin e një qeverie tranzicioni, Idhome Kosturi. Më 16 dhjetor, trupat qeveritare, të drejtuara nga Zogu, hynë në Tiranë. Zogu kishte udhëtuar në pararojë me 50 njerëz besnikë të armatosur për t'u gjendur në kryeqytetin provizor. Parlamenti

u rimblodh më 22 dhjetor të vitit 1921 dhe dëgjoji raportin e ish-Kryeministrit, Pandeli Evangjeli, që deklaroi se ai u detyrua ta japë dorëheqjen nën kërcënimin e forcave të armatosura dhe nga frika e gjakderdhjes. Parlamenti njohu fajtor Aqif Pashën dhe imzot Bumçin dhe i zëvendësoi ata me dy të tjerë. Kur Abdi Toptani dhe dr. Turtulli dhanë po ashtu dorëheqjen, duke e quajtur këtë shkelje, në vend të tyre anëtarë të Këshillit të Naltë u emëruan Sotir Peci dhe Refik Toptani. Idhomeno Kosturi ia dorëzoi detyrën pas 12 ditësh Xhaferr Ypit që u emërua Kryeministër.

Në vetëm 18 ditë, si pasojë e kësaj situatë u ndërruan 3 Kryeministra. Qazim Koculi për një ditë, Hasan Prishtina për 5 ditë dhe Idhomeno Kosturi për 12 ditë. Të tre këta protagonistë të jetës politike dhe patriotike shqiptare patën një fund të përbashkët. Të tre u vranë me atentate në kohë të ndryshme dhe për arsye po kaq të ndryshme.

Por jeta parlamentare provokoi një debat që preku thelbin e problemeve në Shqipëri edhe pse nuk dinte t'u jepte drejtim dhe zgjidhje atyre. Fjalimet e Fan Nolit, Ali Këlcyrës, Stavro Vinjaut, Luigj Gurakuqit, por edhe ato të Bahri Omarit, Ahmet Zogut etj., përcjellin ende stilin e një klase politike tejet të talentuar, por disi jashtë nivelit të përgjithshëm të shoqërisë. Jo rrallë, grupimet politike kishin edhe ngjyrimë të dukshme ideologjike.

Aleanca me Shefqet Vërlacin dhe imponimi si ministër i Brendshëm po e fuqizonte tej mase Ahmet Zogun. Më 2 dhjetor 1922, pas largimit të Iljaz Vrionit, ai u emërua për herë të parë Kryeministër në moshën 27-vjeçare. U bë jo vetëm Kryeministri më i ri deri në atë kohë, por edhe më i riu në historinë 102 vjeçare të shtetit shqiptar. Po atë ditë ai mbajti këtë deklaratë të shkurtër në Parlament:

Jam i bindur se qeveria e re do t'u përgjigjet dëshirave të popullit, njëkohësisht dëshirën e tij për të krijuar një shtet Perendimor, plotësisht të civilizuar. Qeveria kurrë nuk do të pengojë të drejtat e qytetarëve dhe lirinë e shtypit. Shqipëria është një vend i vogël dhe politika e saj duhet të jetë e qartë, transparente dhe e realizueshme. Në përkrahim shtetet fqinje dhe kërkojmë që këto shtete të respektojnë plotësisht e njëkohësisht pavarësinë dhe sovranitetin e shtetit tonë.

Deklarata ngjan mjaft e avancuar për kohën, por askush nuk di të thotë se sa i sinqertë ishte Zogu. Opozita shihte tek ai tendencën për t'u shndërruar në diktator dhe bëri gjithçka mundej për t'ia frenuar fuqinë. Por në një Shqipëri të sflitur nga mungesa e gjatë e rregullit, veprimet e Ahmet Zogut për stabilitet shiheshin me dashuri nga publiku. Ai që shndërruar në një figurë poullore siç dëshmon sërish Zhysten Godar në një prej ditareve të tij:

Nga këndvështrimi politik gjendja është shumë e qëndrueshme dhe Ahmet Zogu po ecën drejt një diktature. Por kjo diktaturë më duket mjaft interesante meqenëse nga njëra anë Ahmet Zogu si njeri është një shqiptar i kulluar, tepër atdhetar dhe jashtë çdo ndikimi të huaj, kurse në anën tjetër është një punëtor i papërtuar. Ai e mban qeverinë me një frymë... Ahmet Zogu është shumë popullor.

Të njëjtën gjë nënvizonte në një shkrim të saj edhe gazeta Franceze "La Patrie" në një reportazh me titullin: "Përse e duan shqiptarët Zogun", shkruajtur nga Pierre Chanlaine:

...përpara Ahmet Zogut, duhet ta themi troç se vendi nuk ishte shumë i sigurt. Ky vend i vogël ishte molepsur prej mikrobeve - komitet - të cilët po e shkatërronin. Nuk kishte një pushtet qendror. E nëse rastësisht Fuqitë e Mëdha do të tentonin të vendosnin një të atillë (pushtet) askush nuk do t'i bindej.

Anarkia po bënte kërdinë dhe, me gjithë simpatinë që shqiptarët kishin ditur të nxisnin dhe pavarësisht protestave të tyre të zjarra e të ligjshme - po kërkohej që, nëse do të ishte e detyrueshme, të bëhej copëtimi i shqiptarëve ndërmjet Greqisë dhe Jugosllavisë. Por erdhi Ahmet Zogu dhe vendi u transformua.

Zogu ndërmori vendime energjike si në administratë ashtu edhe në rrafshin politik. Në shtator 1923 ai u zgjodh Kryetar i Partisë Popullore. Ndërkohë vendi po stabilizohej pavarësisht tentativave të vazhdueshme për kryengritje të armatosura dhe rrëzimin e qeverisë. Në vitet 1920 - 1924 u garantua unifikimi territorial i vendit, qeveria e shtriu autoritetin thuajse në të gjitha krahinat. Ajo kërko

më 6 maj të 1920-ës emetimin e monedhës së parë shqiptare që për nder të Skënderbeut u quajt "Lek", siç njihet ende. Nisi disa punë publike dhe hartoi një plan rregullues për Tiranën që nga kryeqytet i përkohshëm ishte shndërruar në kryeqytet real. Por këto ishin njëra anë. Qeverisja vetë u turbullua nga dhjetëra kryengritje që lulëzonin aty-këtu, por që kryesisht organizoheshin nga fiset dhe drejtuesit e tyre në veri të vendit. Kryengritja e Mirditës zgjati gjatë dhe solli mjaft humbje për forcat qeveritare, por në fund trupat e rregullta, të drejtuara nga komandanti i operacionit, Ahmet Zogu ia dolën ta nënshtrojnë zonën dhe të nxjerrin jashtë saj mbështetësit jugosllavë.

Në shumë prej kryengritjeve dhe sulmeve mbi qeverinë legale, kjo e fundit kishte mbështetjen e banorëve nga e gjithë Shqipëria e sidomos Tirana. Më 8 mars të 1922-it, në Tiranë mbërriti lajmi se një fuqi e madhe kryengritëse, e udhëhequr nga Cen Elezi i Dibrës ishte shfaqur papritur në Fushë Krujë. Për fatin e keq të qeverisë, në Tiranë ndodheshin vetëm 2 kompani, sepse trupat e tjera qenë angazhuar në luftime kundër Halit Lleshit në Martanesh dhe në Mirditë. Ministri i Brendshëm, Ahmet Zogu, iu drejtua komandantit të përgjithshëm të xhandarmërisë, një prej oficerëve më të shquar e patriotë në vend, Meleq Frashërit:

- Meleq, njëri prej nesh duhet me ato pak forca që kemi t'i dalë para Elezit pa humbur asnjë minutë!

-Si ushtar më takon mua të shkoj-!, - u përgjigj Kapiteni.

Meleq Frashëri u nis i shoqëruar nga 25 xhandarë dhe u përball, në Kamëz me disa mijëra vetë që vinin drejt Tiranës. Ai vetë u vra, bashkë me 13 ushtarë nga 25 që kishte me vete. Refik Toptani, anëtar i Këshillit të Naltë, që gjendej në çifligun e tij, e pa skenën. Ai mori kalin e Meleq Frashërit dhe mbërriti në Tiranë për të dhënë lajmin e vrasjes së oficerit të lartë dhe mbërritjes së trupave të Cen Elezit. Ato mbërritën vërtet në periferitë e Tiranës dhe bënë barrikadë aty. Cen Elezi shoqërohej nga Mustafa Kruja dhe Zija Dibra. Ai kishte edhe mbështetjen e Bajram Currit që ishte rebeluar, por kishte mbetur në Shkodër.

Më 9 mars, qeveria dhe deputetët u nisën për në Elbasan. Në Tiranë qëndroi vetëm ministri i Brendshëm Ahmet Zogu me rojet e tij dhe ministri i Punëve Botërore, Spiro Koleka, që deklaroi se do vdiste në detyrë. Zogu me ordinancat bënë barrikadë në zyrë.

Eqrem bej Vlora, që u ndodh aty dhe që i takoi të dyja palët, kujton se ai mbahej me rreth 20 oficerë kryesisht nga jugu, trima dhe të vendosur për të qëndruar. Por vetë Cen Elezi hezitoi. Ai mendonte se Zogu kishte një kompani të zgjedhur në Kryeministri dhe kishte frikë se në përballje me të, do t'i vriteshin shumë njerëz. Ndaj priti që Zogu të dorëzohej vetë. Vija ndarëse ishte Rruga e Dibrës. Me ndërhyrjen e konsullit britanik, Cen Elezi u tërhoq nga Tirana 2 ditë më pas. Rasti Elezi ishte më i vështiri dhe më kërcënuesi për Qeverinë legjitime të Tiranës.

Një prej problemeve më të rëndësishme të qeverisë ishte edhe caktimi përfundimtar i kufijve që po dizenjoheshin në vend nga një komision i fuqive fituese të luftës. Ato u mbyllën përfundimisht më 1925-ën me protokollin e Firences.

NJERIU I 50 ATENTATEVE

Shoferi qëndronte me derën e makinës hapur përballë selisë së Qeverisë, por konsulli britanik Eden nuk arriti të hipte në të. Pas shpinës u dëgjuan dy krisma dhe menjëherë pas tyre një seri britmash dhe ulërimash. Konsulli u kthye mbrapsht dhe 2 hapa më tutje u ndesh me përkthyesin e qeverisë i cili i shqiptoi vetëm tri fjalë:

- *Kanë qëlluar Kryeministrin.*

Më 23 shkurt të vitit 1924, gati të gjithë në deputetët, thuasë kishim zënë vendet tona për seancën e pasdites së Asamblesë. Mungonte vetëm qeveria, pra edhe Kryeministri Ahmet Zogu. Unë rrija si gjithmonë pranë metropolitit Fan Noli, në bankën e radhës së parë pranë hyrjes. Më ra në sy se atë ditë, grupi i Partisë Demokratike prapa meje, që po rrinte çuditërisht i heshtur dhe i merakosur. Befas ushtuan dy krisma në shkallët e ndërtesës, që u pasuan nga një qetësi e ngrirë. Pastaj u hapën me vrull dyert e sallës dhe brenda hyri Ahmet Zogu me revolver në dorë. Ai ishte prerë në fytyrë, por ecte me shtatin drejt dhe pas disa çastesh e mori veten, madje buzëqeshi dhe vajti me çap të sigurt te bangoja e qeverisë, ku u ul në një vend të caktuar për sekretarët.

Ky rrëfim i deputetit Eqrem bej Vlora i takon një prej momenteve që ndryshoi radikalisht situatën parlamentare në Shqipëri. Ishte data 23 shkurt, ora 14:30 mbasdite. Në vendin ku qe ulur

Kryeministri po rridhte një rrëke gjaku. Ahmet Zogu vijonte të qëndronte aty, por ai ndjeu dhimbje. Kishte marrë dy plagë në trup, por për fat jo në organe jetike.

Ahmet Zogu ishte zgjedhur Kryeministër më 2 dhjetor të 1922-it në Asamblenë e vjetër, duke mbajtur njëkohësisht postin e ministrit të Brendshëm. Kishte arritur të siguronte mbështetjen më të madhe se çdo qeveri tjetër, duke marrë 37 vota pro, 13 kundër dhe 6 abstenime. Ishte qeveria më jetëgjatë që Shqipëria njihte, dhe Kryeministri do të qëndronte në detyrë edhe për dy ditë të tjera. Me siguri do të kishte qëndruar edhe më, sepse një ditë më parë, më 22 Shkurt, kishte siguruar një mazhorancë të qëndrueshme falë koalicionit me Partinë Indipendentiste. Por Zogu nuk arriti të rivotëbesohej si Kryeministër.

Më 23 shkurt të 1924-ës, në ora 14:30, ndërsa ngjiste shkallët që ndanin zyrën e Kryeministrit nga salla e Parlamentit, u qëllua pas shpine me dy plumba nga një djalë i panjohur që kish mbështjellë pistoletën me gazetë.

Selia e Qeverisë dhe ajo e Parlamentit qenë vendosur në të njëjtën godinë, në shtëpinë e Zija bej Toptanit, aktualisht Selia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Zyra e Kryeministrit dhe salla e mbledhjeve të Qeverisë ishin në katin e parë, ndërsa salla e Parlamentit në katin e dytë. Parlamenti që mbledhur në seancën e radhës gati për të filluar, kur Kryeministri doli nga zyra ku sapo kish mbaruar një takim me konsullin anglez, Eden, dhe u ngjit drejt katit të dytë. Ai nuk vuri re se në hollin ku shpesh prisnin miq të deputetëve, gazetarë, trima të armatosur, një djalë i ri që ai e kishte parë diku po e ndiqte me sy. Rojet e Kryeministrit qenë jashtë dhe komandanti që ruante Parlamentin, Osman Gazepi, nuk e dinte që djali ishte i armatosur. Quhej Beqir Valteri, vinte nga Mati dhe dy vjet më parë, Ahmet Zogu e kishte ndihmuar të shkonte për studime në Itali. Beqir Valteri i thirri: "Qëndro Zog", e qëlloi dy herë nga mbrapa dhe u fut në banjën e Parlamentit që e mbylli nga brenda. Kryeministri hyri në sallë, i zbehtë, në një situatë të elektrizuar. E ndjeu që i rridhte gjak dhe kishte dhimbje. Situata ishte e nderë dhe askush nuk po kuptonte ç'kishte ndodhur. Edhe pse në sallë kishte disa persona që me siguri ishin në dijeni të krismave që ishin dëgjuar në korridor. Deputetët mbështetës të Zogut iu afruan në

krah, ndërsa ata të opozitës në cepin tjetër. Të gjithë ishin të armatosur dhe shpërthimi që mund të kthehej në masakër ishte fare afër. Eqrem bej Vlora mori nga llozha doktor Simonidhin, një mjek nga Vunoi, për të parë të plagosurin. Zogu refuzoi. Ai nuk e njihte doktorin dhe në atë moment nuk i besonte askujt. Një çast më vonë, i garantuar nga mbërritja me vrull e rojeve të tij u bind. Doktor Simonidhi konstatoi se kishte marrë dy plagë të thella, por që nuk e vinin në rrezik jete. Ia lidhi plagët dhe e këshilloi të nisej urgjent për në shtëpi. Zogu refuzoi. Ai iu drejtua kryetarit të seancës.

- Zotërinj, nuk është hera e parë në botë që në një parlament ndodh një gjë si kjo që më ndodhi mua. Unë u lutem miqve të mi, ta peshojnë rastin me gjakftohtësi dhe pastaj të veprojnë.

Ndërkohë në godinë filluan krisma. Përfaqësuesi i SHBA-ve, Grant Smith, mbërriti në sallë në këtë moment. Më 24 shkurt, ai i dërgon një raport qeverisë në Uashington ku rrëfen: *Kur arrita në vendin e atentatit, pak më vonë, e gjeta Zogun ende në sallë. Ishte bashkë me doktorin dhe kolegun tim britanik. Ai vuante dukshëm nga shoku dhe dhimbja.*

Grant shton se në derën e sallës qëndronin besnikë të Ahmet Zogut dhe oficerët kërcënonin se do vrisnin të gjithë ata që nuk u bindeshin urdhrave. Kryetari i Parlamentit ishte larguar me ngut dhe që mbyllur në llozhën e regjentëve që ruhej nga rojet e tyre.

Beqir Valteri ishte mbyllur në banjë, këndonte këngë patriotike dhe refuzonte të dorëzohej. Osman Gazepi dhe mbi 30 xhandarë e qëllonin me pushkë. Ai përgjigjej nga brenda me revolver. Plumbat fërshëllenin në selinë e Parlamentit dhe situata vijoi edhe pak kohë, derisa një delegacion deputetësh i përbërë nga Qazim Koculi dhe Ali Këlcyra e bindi Valterin të dorëzohej. Gjatë gjithë hetimeve atentatori deklaroi se kishte vepruar i vetëm, se e pati bërë gjestin në shërbim të atdheut dhe nuk ishte i shtyrë nga askush. Edhe Gjykata e Tiranës arriti muaj më vonë në përfundimin që nuk ishte një komplot. Beqir Valteri u fal, por ai u pushkatua 21 vjet më pas nga komunistët, më 1945, që nuk e falën më.

Ahmet Zogu që ishte paralajmëruar për atentatin 2 javë më parë arriti të mësonte se Valteri ishte i shtyrë nga kundërshtarët e tij. Kujtimet e shumë protagonistëve të kohës, shënojnë faktin që ai u takua edhe vetë kokë më kokë me atentatorin. Ai mësoi se atentati

përflitej në çdo kafene të Tiranës dhe njerëzit e tij, vunë gishtin mbi Avni Rustemin si organizator.

Atentati i 23 shkurtit i vitit 1924 nuk ishte i vetmi që Ahmet Zogu përballi në jetë. Sipas të dhënave të biografëve dhe sidomos sipas shtypit ndërkombëtar, ndaj tij u organizuan mbi 55 atentate, 7 prej të cilëve më seriozë. Cracked.com, një portal që merret me kuriozitete nga jeta e personazheve të famshëm e vendos atë të dytin në radhën e njerëzve më të vështirë për t'i vrarë. Ai u shpëtoi më shumë atentateve se De Goli dhe kur ndërroi jetë, më 1961, kjo ndodhi nga shkaqe natyrore dhe jo për hir të një atentati.

Padyshim atentatet më problematike qenë ai i Parlamentit në 1924 dhe ai i 21 shkurtit të vitit 1931 në Vjenë.

Në fillim të vitit 1931 Ahmet Zogu i shndërruar tashmë në Mbret, me titullin, Zogu I –, Mbret i Shqiptarëve, udhëtoi në Vjenë për një ekzaminim mjekësor. Mjekët austriakë që e kishin vizituar kishin rekomanduar një operacion ose një lloj mjekimi me rreze X. Ishte rasti i vetëm që u largua nga Shqipëria gjatë karrierës në krye të shtetit. Zogu udhëtoi nga Durrësi në Trieste dhe prej këtej në Vjenë me tren. Ai shoqërohej nga 4 motrat. Së bashku me mbretin udhëtuan Abdurrahim Krosi, mjeku personal dr. Jani Basho, major Llesh Topollaj dhe kapiten Çupi, të dy këta roje personale të Zogut, ministri i Oborrit Eqrem Libohova, Sotir Martini dhe Kolonel Serreqi, adjutanti i mbretit i cili ishte nisur për në Vjenë për të bërë përgatitjet e nevojshme.

Zogu kishte jetuar në kryeqytetin austriak për dy vjet në vitet 1916-1918 dhe ishte njohës i gjuhës gjermane. E ndërgjegjshme për një grup emigrantësh politik agresivë, kundërshtarë të Zogut, policia austriake u kërkoi atyre që në ditët kur Mbreti do të ndodhej në Vjenë, të qëndronin sa më larg tij. Ata e premtuan këtë gjë, por grupi kishte vendosur ta vriste Zogun. Për ditë me radhë qenë shpërndarë me grupe që vëzhgonin se ku mund ta ndeshnin atë.

Mbreti Zog qëndroi në hotel "Imperial". Ai i kursente në maksimum lëvizjet, por gjatë tyre ishte i pakujdesshëm. Nuk i besonte sigurimit austriak, nuk njoftonte më parë lëvizjet dhe shfaqej befas në dyqane luksi apo muzeume i shoqëruar nga e dashura, Fançeska Janko që ishte vendosur në një suitë ngjitur me të tijën në hotel.

Ndër vendet ku shfaqej më shpesh ishte Opera, që ndodhej veç pak metra larg nga hotel "Imperial". Pikërisht aty e pa duke hyrë një prej emigrantëve shqiptarë dhe njoftoi grupin. Ishte 21 shkurt i vitit 1931. Mbreti Zog që po shihte operën "Palaçot", për arsye sigurie u largua në aktin e fundit, përpara përfundimit, nga dera anësore. Ai po hynte në makinë kur dy atentatorët, të dy ish-oficerë, Azis Çami dhe Ndok Gjeloşi hapën zjarr mbi të me pistoletë dhe pushkë. Nga zjarri mbeti i vrarë në vend adjutanti i Mbretit, Llesh Topallaj, dhe u plagos, Eqrem bej Libohova. Sejfi Vllamasi, njëri prej pjesëmarrësve në atentat, rrëfen:

Zogu e pa Ndok Gjeloşin dhe bashkë me Eqrem Libohovën hynë në automobil. Kur pas këtyre ishte duke hyrë Llesh Topallaj, i gjatë dhe i shëndoshë, Gjeloşi duke e kujtuar për Zogun e qëlloi prapa kokës duke e lënë të vdekur në vend. Gjeloşit nuk i punoi më pushka. Detektivët austriakë, duke u kapur dorë më dorë, e rrethuan automobilin e Zogut. Aziz Çami, me të dëgjuar pushkët, e çau rrethimin e detektivëve. Sulmoi automobilin dhe qëlloi 7 herë me nagant. Sikur Zogu të kish qenë në pozitë normale të 7 plumbat do ta kishin kapur, por ai qëndroi shtrirë...

Shtypi austriak raportoi të nesërmen se Mbreti Zog kishte nxjerrë revolen dhe kishte qëlluar 7 herë në drejtim të atentatorëve. Robert Lou, një agjent sekret amerikan në pension që e njohu Mbretin Zog në vitet '50 në Aleksandri i deklaroi BBC-së në vitin 1984:

Ai është i vetmi Mbret, President apo Kryetar Shteti në historinë e botës, që nuk qëndroi mënjanë, por nxorri pistoletën për t'iu përgjigjur atentatorëve!

Atentati bëri bujë në Vjenë dhe policia austriake arrestoi gjithë emigrantët. Gjatë hetimit ajo zbuloi se dy atentatorët qenë të pajisur me pasaporta diplomatike jugosllave. Zbuloi po ashtu një listë të pagesave të përmuajshme që emigrantët merrnin nga Jugosllavia dhe Italia. Hetimi ngarkoi me përgjegjësi Hasan Prishtinën e Mustafa Krujen si organizatorë. Një proces i rregullt nisi disa javë më vonë

në Austri dhe po në të njëjtën kohë në Tiranë. Në Austri, dy atentatorët u dënuan me 7 dhe 3 vjet burg, kurse në Tiranë me vdekje. Fati i mëvonshëm i atentatorëve që po kaq tragjik. Ata nuk u ekzekutuan nga Zogu, por të dy bashkë u vranë nga komunistët në vitin 1944, të dy me atentate.

Të gjithë emigrantët politikë u përzunë nga Vjena dhe iu refuzua leja e qëndrimit. Mbreti Zog u kthye në Tiranë, ku kishte nisur një histeri solidarizimi me të. Me mijëra vetë vizitonin shtëpinë e së ëmës për ta uruar që djali shpëtoi dhe me mijëra telegrame me një tekst naiv dhe tejet servil u nisën drejt Pallatit nga zyrtarë të të gjitha niveleve.

Ahmet Zogu kishte një fobi të jashtëzakonshme nga atentatet. Pietro Kuarone, zv.ambasadori italian në Tiranë që e takoi atë shpesh në fundvitet '20 kujton:

Ai nuk largohej kurrë nga banesa e vet, qoftë edhe i shoqëruar, nga një eskortë. Ai i trembej ndonjë atentati dhe nga ana e tij, pranonte shumë sinqerisht:

-Jam gati të vdes si luftëtar, por nuk kam asnjë dëshirë, të vritem me një plumb në një qoshe rruge si një qen.

Ai nuk ndërronte vend veçse në intervale kohe të gjata, për të shkuar në Durrës, për të kaluar disa javë në bregdet, por jo pa marrë një luks të padëgjuar masash mbrojtëse.

Në biografinë e Zogut shfaqen edhe një seri atentatesh apo tentativash të tjera, disa prej të cilave thuajse të pabesueshme. Më 30 shtator 1925, ambasadori amerikan në Tiranë, Charles Hart, i shkruante Uashingtonit:

Problemi më i madh i Presidentit do të thoja që është ai personal, të ruajë veten fizikisht. Shumë raste atentatesh janë zbulur. Ditët e fundit është arrestuar edhe shoferi i tij që po e çonte në një pritë...

Në të njëjtin raport, Hart informon Sekretarin e Shtetit edhe për një tjetër tentativë vrasjeje:

Myfit Libohova dhe Eshref Frashëri u organizuan me Cen beun.

Ai po organizon një përбетim me një fond prej 1800 napolonash flori nga një hotel në Beograd.

Raporti vetëm sa hedh dritë mbi komplotin e Ceno bej Kryeziut, kunatit dhe ministrit të Brendshëm që në vitin 1925 u bashkua me Eshref Frashërin për të rrëzuar Zogun përmes eliminimit fizik. Në fakt, ndryshe nga sa shprehet ambasadori amerikan, atentati u dekonspirua nga Myfit Libohova që ia rrëfeu Zogut. Ky e vuri nën përgjim të plotë Ceno Beun, ndërsa Eshref Frashëri u izolua.

Zogu zbuloi se kunati, i pakënaqur nga raporti që Zogu kishte krijuar me italianët në vitin 1925 dhe nga anashkalimi i Jugosllavëve, kishte komplotuar me Nolin dhe disa oficerë. Eliminimi i Zogut do të bëhej gjatë vizitës së pritshme në Beograd, vizitë që s'u bë kurrë. Në vend që të eliminonte Zogun, Ceno Beu u vra në Pragë, siç do të shihet në kapitujt në vijim.

Në fund të shtatorit 1925 një njeri i panjohur hodhi një bombë në Vilën e Zogut, pa arritur të vriste njeri. Në fillim po të këtij viti u zbulua një komplot tjetër që dështoi pasi disa roje besnike njoftuan Presidentin.

Dy atentatet e radhës figurojnë në vitin 1938 - 1939. Ato kishin si protagonistë italianët që po tentonin eliminimin e Zogut për të siguruar kështu bashkimin e Italisë me Shqipërinë pa pasur kundërshtim.

Më 13 dhjetor 1938, ambasadori i SHBA-ve Grant i dërgonte Departamentit të Shtetit telegramin sekret n. 769. Telegrami ende mban titullin: "Një udhëtim mbretëror në Adriatik" në arkivat diplomatike amerikane. Telegrami ka këtë përmbajtje:

Mbreti dhe Mbretëresha kanë dalë në një shëtitje me jaht ditët e fundit, por kjo aventurë rrethohet nga një farë misteri. Të gjithë ata që ishin në bord, duke përfshirë Mbretin dhe Mbretëreshën, me përjashtim të ministrit të Punëve të Jashtme, i zuri keq deti për shkak të motit të lig, siç u tha. Me urdhër të Mbretit Zog, anija u kthye në port. Sipas informacioneve shumë të besueshme, Mbreti ishte ftuar në Venecie nga autoritetet italiane, të cilat kishin komplotuar "ta bindnin të pranonte kushtet" kur ai të ndodhej në tokën e tyre. Për të shpëtuar nderin karshi italianëve, Zogu përdori metodat orientale.

Ai doli në det dhe pastaj, me arsyeën e "motit të keq", u kthye mbrapsht në port. Çfarëdo që të thonë armiqtë, ata nuk mund të mohojnë se ai ishte i zgjuar dhe dinak.

Aventura e rrëmbimit nga italianët është mbështetur edhe në kujtimet e Mbretëreshës Geraldinës. Në një prej dëshmimeve ajo kujton:

Më 25 qershor, gjeneral Françesko Jakomoni, ambasadori italian, i ofroi Mbretit, në emër të qeverisë së tij, një jaht me ekuipazh italian. Mbreti Zog e refuzoi dhuratën nga frika se ushqimi në bord mund të ishte i helmuar. Mbreti tha se do ta merrte me qira për të shkuar në Venecia, i shoqëruar nga disa prej shërbyesve të tij. Nëse atij dhe Mbretëreshës do t'u pëlqente ideja e jahtit, ai do ta blinte.

Teksa po hipnim në jaht, më pëshpëriti: "Nuk më pëlqen mjedisi. Nuk më pëlqejnë fytyrat e ekuipazhit". Deti ishte i trazuar, kështu që, kur pas disa orësh udhëtim mua më zuri deti, Mbreti i kërkoi kapitenit të kthehej në port. Kapiteni refuzoi kërkesën dhe vetëm në mesditë ai iu bind urdhrave të Mbretit. Më vonë morëm vesh se, nëse do të kishim zbarkuar në Itali, nuk do të lejoheshim më të ktheheshim në Shqipëri.

Tentativa e dytë ndodhi disa ditë përpara pushtimit me protagonist Jak Koçin, një njeri i afërt i Mbretit që ishte vënë në shërbim të italianëve. Më gjasë, Zogu ishte i informuar sepse ai e ftoi Koçin për drekë. Geraldina, e ulur në atë tavolinë, e kujton kështu:

Dy ditë më vonë, Jak Koçi, dikur njeri i besuar i Mbretit, por që tani na doli se ishte një tradhtar me dy fytyra, erdhi për drekë. Teksa po hanim ëmbëlsirën, unë nuk e mbajta dot pjesën time dhe e nxorra. Koçi u zbeh, u drodh dhe tha: "Mos hani më!" Unë nuk e kuptova dhe u përpoqa të shpjegoja se në vend që të bënte strudel me mollë, kuzhinierja kishte përdorur lakër, një gatim hungarez që s'e honepsja dot. Mbreti reagoi menjëherë, e tërhoqi Koçin për veshi, e nxori nga dhoma dhe përplasi derën pas vetes.

Mbretëresha kujton se e pa që Mbreti e goditi vetë Koçin madje e hodhi shkallëve poshtë. Ai tha vetëm dy fjalë: Pas dy orësh, ai njeri nuk ka për të qenë më në territorin e Shqipërisë.

Sipas Geraldinës, Koçi i kishte dhënë ryshfet kuzhinieres dhe gruas hungareze që punonte në kuzhinë duke u kërkuar të hidhnin helm në strudel. Të dyja, me qëllim që ta paralajmëronin, i kishin shkuar Mbretit me floririn që u kishte dhënë Koçi.

Zogu iu ruajt atentateve edhe në mërgim. Kur regjimi komunist erdhi në fuqi, ai u vu nën mbikqyrje të rrepte dhe disa herë u tentua eliminimi. Skënder Zogu, djali i vëllait që jetoi me të pas vitit 1945, e rrëfen kështu kujdesin e Zogut dhe tentativën për ta eliminuar atë:

Mbreti ishte largpamës. Ai e dinte se dhe në emigracion kishte spiunë dhe njëri prej tyre ishte Isuf Mullai që rrinte në Belgjikë dhe kish ardh me misionin për të vrarë Mbretin Zog...

Isuf Mullai, një agjent i Sigurimit të Shtetit i infiltruar tek Mbreti Zog rrëfen se asnjëherë s'e ka pasur objektiv eliminimin e Zogut:

Nuk ka ekzistuar një plan për helmimin e Zogut. Po të donim një gjë të tillë e bënim, ishin të tëra mënyrat. Por nuk na lejonin ta bënim dhe unë sot nuk e di atë enigmë, pse nuk më lejonin. Bëja ndonjë farë pune dhe të thoshin "Stop", këtu jo! Dhe stop ka thënë vetë Enver Hoxha!

Me gjasë Mullai nuk ishte informuar për të gjitha. Pas rrëzimit të Komunizmit në vitin 1990, në dosjet e Sigurimit të Shtetit u zbulua një material që në mënyrë të detajuar shpjegon se si shërbimi sekret komunist do të kryente eliminimin e Zogut.

Me vajtjen e Zogut në Francë, vigjilencës tonë i del përpara detyra të organizohet atentati për vdekjen e tij. Për këtë qëllim ne do të drejtojmë "Elmetën" e cila do të shkojë për vizitë dhe me anën e saj do të bëjmë studimin e shoqëruesve. Studimi do të konsistojë në kontaktet morale dhe materiale të personelit që shoqërojnë Zogun, cilët janë këto, lidhjet familjare që kanë në Shqipëri dhe sa të lidhura janë ato me njerëzit e tyre në vendin tonë. Nga një studim i hollësishëm që do t'i bëjmë këtij objekti do të marrim propozime konkrete për rekrutimin e elementit që paraqitet me kushte të mira, do të

shfrytëzohen kontradiktat që ekzistojnë midis tyre dhe cdo mundësi tjetër që paraqitet duke përdorur më në fund përvojën pozitive për punën tonë, duke përdorur më në fund paranë dhe premtimet për të siguruar jetesën. Në qoftë se arrijmë të rekrutojmë për agjent në shërbim të punës sonë, ndonjë nga njerëzit besnik që shoqërojnë Zogun, do të marrim masa mbasi të kemi studiuar mundësinë për zhdukjen e Zogut. Në këtë studim do të parashikojmë helmimin e tij dhe të birit ose të krejt familjes duke përdorur helmin në ushqim ose në pije. Nga ana tjetër duke u informuar nga "Elmeta" së cilës do t'i ngarkohet për detyrë ose nga burime të tjera, do të studiojmë doktorin që mjekon Zogun. Në këtë drejtim do të bëjmë studimin e rrethit të doktorit, qëndrimin e tij dhe të rrethit shoqëror e miqësor për të bërë të mundur që nga një studim të gjithanshëm të gjejmë elementin e përshtatshëm i cili i udhëzuar nga ne të organizojë zhdukjen e Zogut me anë të doktorit...

Plani vijon me një përshkrim të detajuar të personave që mund të përdoren për këtë gjë, duke numëruar gjithë pikat e tyre të dobëta, përfshi borxhet dhe tradhëtitë bashkëshortore. Materiali prej 11 faqesh mbyllet me frazën:

...Duke shfrytëzuar të gjithë mundësitë tona me anën e agjencurës, kandidatëve dhe miqve do organizojmë punën në drejtim të objektit në fjalë për të bërë përpunimin e tij dhe sipas kandidatëve që do të na paraqiten, do të hartojmë planin për zhdukjen e Zogut. Qendra do të vihet rregullisht në korrent të çështjes. Do t'i paraqiten propozimet konkrete.

"Algjeriani"

Në fakt Zogu i mbijetoi edhe këtij plani dhe ndërroi jetë 6 vjet më pas në Paris, nga po ajo sëmundje që i ishte shfaqur që në rininë e hershme.

NGJARJET E 1924-ËS. IKJA DHE RIKTHIMI

Viti 1924 nisi si një vit i vrullshëm dhe problematik. Atentati në Parlament ndaj Kryeministrit Ahmet Zog, e ndërlikoi situatën politike në Tiranë. Më 25 shkurt 1924 Ahmet Zogu dha dorëheqjen nga posti i Kryeministrit. Vendin ia zuri vjehri, Shefqet Vërlaci, njeriu më i pasur dhe ndoshta më influent i Shqipërisë. Zogu ishte i fejuar me vajzën e Vërlacit, Behije Hanëmin, fejesë të cilën ai vetë e prishi në momentin që filloi të mendonte kurorëzimin si mbret. Prishja e fejesës ishte edhe prishja përfundimtare mes Zogut dhe Vërlacit. Ky i fundit u kthye si Kryeministër me italianët, më 12 prill të 1939-ës, pasi këta të fundit kishin përzënë Mbretin Zog I. Por në shkurt të vitit 1924 raportet mes tyre qenë ende të mira dhe në një aleancë solide. Shefqet bej Vërlaci mori votëbesimin si Kryeministër më 3 mars të 1924-ës. Zogu u mbyll në shtëpi. Sipas ligjeve të krahinës së tij nuk mund të dilte derisa porositësi i vrasjes të ndëshkohej.

Avni Rustemi ishte duke ecur me Hoxha Kadriun në rrugën e "Bamit", në afërsi të Pazarit të Ri të sotëm, kur një person që iu afrua nga mbrapa e qëlloi me revolver. Atentatori quhej Isuf Reci, një mullixhi dhe shërbëtor i vjetër i Esat Pashës. Ishte 20 prill i 1924-ës. Avni Rustemi u dërgua urgjent në spitalin civil të Tiranës, qëndroi aty për 48 orë, por mjekët nuk arritën ta shpëtojnë. Avni Rustemi vdiq. Vdekja ishte fillimi i shpërthimit të gjithë kontradiktave të kohës. Mbështetësit e opozitës ngarkuan me përgjegjësi

Zogun për atentatin. Ata besonin se e kishte bërë këtë në përgjigje të atentatit të Valterit ndaj Zogut i shtyrë nga Avni Rustemi.

Varrimi i Avni Rustemit nisi më 28 prill të 1924-ës nga Tirana. Trupi vijoi për në Durrës e prej këtu në Vlorë, ku ishte vendosur të prehej përfundimisht. Drejt Vlorës lëvizën edhe shumica e deputetëve të Partisë Demokratë. Më 30 prill, 26 prej tyre dhe anëtarë të tjerë të Parlamentit që kishin mbërritur aty, u takuan në Bashkinë e Vlorës dhe dolën me thirrjen që Kuvendi Kushtetues të mblidhej në Vlorë dhe jo në Tiranë. Në kryeqytet ata ndiheshin të kërcënuar nga fuqia e Ahmet Zogut. Grupi i të 26-tëve tentoi të gjejë edhe një argument juridik për këtë. Ali Këlcyra iu referua nenit 127 të Statutit Kombëtar sipas të cilit, në raste kërcënimi të demokracisë, popullit i jepej e drejta të rrokë armët për mbrojtjen dhe shpëtimin e atdheut. Nga fjalimet që vijuan deri vonë atë natë në sheshin e Vlorës, dukej sikur realisht Shqipëria po sulmohej.

Në të njëjtën kohë kur zhvillohej mbledhja e Vlorës, 49 deputetë vijuan punimet në Tiranë. Midis tyre, veç 26 deputetëve të ikur në Vlorë, mungonte Ahmet Zogu që po mjekohej në shtëpi pas atentatit. Faik Konica kishte dhënë dorëheqjen disa kohë më parë me një telegram ku i quante gjithë deputetët e Parlamentit parazitë. Deputetët e Tiranës i akuzuan ata në Vlorë se po bënë grusht shteti. Akuza u përforcua edhe nga përfaqësuesit e huaj në Shqipëri. Në përgjigje të akuzave, Fan Noli, deputeti më karizmatik dhe më i kulturuar i opozitës i dërgoi më datën 26 maj të 1924-ës një telegram nga Vlora ministrit të Legatës Italiane me seli në Durrës, Markezit Durazzo. Në telegram nuk i fshihte planet e opozitës:

...E jona nuk është një luftë klasash, por një luftë mes elementëve patriotikë e të ndershëm të vendit nga njëra anë dhe kusarëve mercenarëve e reaksionarëve moskuptues ndaj çdo përparimi civil nga ana tjetër...

... Nuk na mbetet tjetër, veçse të rrokim armët dhe të marshojmë mbi Tiranë, duke ndjekur shembullin klasik të Duçes suaj të ndritur...

Musolini e kishte marrë pushtetin 2 vjet më parë duke iu imponuar Parlamentit me marshimin e besnikëve mbi Romë. Me gjasë

këtë ka pasur në mend edhe Fan Noli. Pak muaj më pas, kur ishte zgjedhur Kryeministër, në një intervistë ekskluzive për gazetën e Athinës, "Eleftheron Vima", të datës 17 tetor 1924, pyetjes së gazetarit se ç'ishte kjo që kishte ndodhur në Shqipëri, Fan Noli iu përgjigj:

- Ishte më shumë një coup d'état politik bashkë me një pronun-
ciamento ushtarake.

Studiuesi Bernd Fisher, që është marrë me studimin e asaj kohe deklaroi:

Mendoj se më shumë ishte një grushti shteti. Për të folur për një revolucion demokratik në vitet '20 duhet t'i atribuojmë një ndërgjegje politike një numri të madh shqiptarësh në atë kohë që ndoshta e parakohshme. Mendoj se ndërgjegjja politike për shumicën e shqiptarëve në vitet '20 ishte shumë e kufizuar.

Përpara vdekjes, në autobiografinë që la pas, Noli i quante ngjarjet e 1924-ës "Revolucion".

Në fund të majit, Parlamenti realisht ishte çarë më dysh dhe rrezikonte që kështu të ndodhte me të gjithë vendin. Hapin e parë të lëshimit, e bëri Qeveria e Tiranës. Më 30 maj të 1924-ës, Kryeministri, Shefqet Vërlaci, që kish ardhur më 3 mars dhe që shihej si njeri i Zogut dha dorëheqjen. Pak javë më parë nga qeveria qenë larguar dy ministra, njëri prej të cilëve ai i Financave, Luigj Gurakuqi. Ata të dy qenë bashkuar me deputetët e opozitës në Vlorë. Në vend të Vërlacit, Parlamenti emëroi po atë ditë, Iljaz Vrionin. Vrioni kishte qenë edhe më parë Kryeministër. Ai vinte nga Berati dhe ishte një prej firmëtarëve të Pavarësisë. Iliaz Vrioni u betua më 31 maj dhe premtoi që nuk do të derdhte gjak shqiptari, përkundrazi do të gjente pajtim mes palëve. Vrioni sapo zbriti në zyrë nga salla e Parlamenti kur e njoftuan se në Shkodër, pushtetin e kishin marrë deputetët e opozitës. Prefekti dhe xhandarmëria kishte refuzuar të bashkohej me ta, ndaj pas një përleshje me armë, ishte vrarë një prej drejtuesve ushtarakë të qytetit, kapiten Ferit Frashëri. Qyteti kishte rënë. Në mbrëmje vonë, Kryeministri u njoftua se komandanti i Veriut, kolonel Rexhep Shala, me qendër në Shkodër, ishte bashkuar me kryengritësit dhe nuk i bindej më autoritetit të qeverisë. 2 orë më

pas erdhi njoftimi se edhe kolonel Kasëm Qafëzezi, komandanti i Jugut, me qendër në Përmet, nuk e njihte më autoritetin e Qeverisë. Vendimi i dy oficerëve për të mos iu bindur Parlamentit të çonte në një grusht shteti. Për të shmangur këtë keqkuptim, në Vlorë u krijua Komisioni Administrativ i Përkohshëm, një lloj qeverie me 4 anëtarë ku bënin pjesë edhe Fan Noli dhe Sulejman Delvina. Funkzioni i saj ishte administrimi i zonave që nuk ishin më nën kontrollin e Qeverisë së Tiranës dhe drejtimin e forcave ushtarake, pra një autoritet civil mbi ushtarakët që kishin thyer betimin.

Që nga data 1 deri më 10 qershor, Kryeministri Iljaz Vrioni refuzoi të përballej ose të qëllonte ndaj trupave kryengritëse. Por, edhe nëse do ta bënte këtë, vështirë se do të arrinte gjë. Qytetet filluan të binin njëri pas tjetrit dhe autoriteti i Vrionit rrudhej me orë. Më 8 qershor, pjesa më e madhe e qeverisë u largua nga Tirana.

Ahmet Zogu qëndroi edhe një ditë më shumë. Më 9 qershor herët në mëngjes ai u largua me një shpurë të madhe që disa thonë se kapte afro 1500 vetë. Udhëtoi nga Shkalla e Tujanit në Klos, Bulqizë dhe hyri në Dibër të madhe. Prej këtej u drejtua në Shkup dhe më pas me tren në Beograd. Ai u vendos në hotel "Moska", në qendër të qytetit i shoqëruar nga afro 300 vetë. Shefqet Vërlaci kaloi me anije nga Durrësi në Bari, bashkë me disa deputetë.

Më 10 qershor, forcat kryengritëse të Shkodrës, të drejtuara nga Ndok Gjeloşi dhe në shoqërimin e deputetit Xhemal Bushati hynë të parët në Tiranë. Ato shpallën të rrëzuar Qeverinë e Iliaz Vrionit dhe deklaruan krijimin e një Qeverie të re.

Po më 10 qershor, Këshilli i Naltë që ushtronte funksionet e regjencës dhe që përbëhej nga Sotir Peci, Refik Toptani, Xhaferr Ypi dhe Ndoc Çoba la drejtimin e vendit. Dy u larguan nga Shqipëria, i treti deklaroi se nuk pranonte një qeveri të ardhur me forcë, ndërsa i fundit, Sotir Peci qëndroi në detyrë. Ai tha po atë ditë se nuk do të firmoste asnjë akt ose ligj. Ligji i vetëm që pranonte të firmoste ishte ai i zgjedhjeve që do të legjitimonin Qeverinë e re. Peçi, një patriot i vjetër, i ardhur nga kolonia shqiptare e Amerikës dhe ish-botues i gazetës "Kombi" qëndroi në detyrë deri në datën 4 korrik të 1920-ës. Nuk firmosi asnjë dekret deri atë ditë dhe kur e pa që zgjedhjet nuk u shpallën dhe që ai vetë nuk mund të firmoste se ligjshmëria kërkonte së paku 3 veta që të merreshin vendimet, u largua edhe ai.

Komisioni Administrativ i përkohshëm me 3 ministra u zhvendos në Tiranë. Deputetët e ardhur nga Vlora, si dhe disa që kishin mbetur aty, thirrën seancën e Parlamentit. Ata i quajtën të vlefshme mandatet e dala nga zgjedhjet e dhjetorit 1923 edhe pse më shumë se gjysma e deputetëve ishin larguar nga vendi. Më 15 qershor, Parlamenti i përgjysmuar shpalli rrëzimin e Qeverisë së Iliaz bej Vrionit dhe shpalli krijimin e një Qeverie të re. Kryesimi iu besua pas shortit Imzot Fan Nolit, padyshim deputetit më të kulturuar dhe brilant të opozitës, por njeri që nuk merrte vendime të prera dhe që e njihte pak Shqipërinë.

Fan Noli u zgjodh Kryeministër i Shqipërisë më 16 qershor të vitit 1924. Ai ndërtoi një qeveri ku ministër i Financave ishte Luigj Gurakuqi dhe shpalosi një program mjaft ambicioz që duhet thënë se bëri bujë. Foli për reformë agrare, për një Shqipëri të mbështetur te borgjezia dhe lançoi mjaft ide të majta që deri atë moment kishin qenë herezi në Shqipëri. Por Qeveria e Fan Nolit kishte rrëzuar Parlamentin legjitim dhe për këtë arsye nuk u njoh nga asnjë qeveri e huaj. Më kryesorja, Britania e Madhe nuk pranoi asnjë kontakt së paku derisa në Shqipëri të zhvilloheshin zgjedhje që legjitimonin Qeverinë me vullnetin e popullit.

Noli tentoi të gjente mbështetje tek italianët. U dërgoi atyre disa mesazhe dhe arriti një takim me Kryeministrin. Musolini e priti Fan Nolin zyrtarisht më 10 tetor, në Pallatin e tij në Piazza Venezia, por ndryshe nga sa Noli mendonte nuk i premtoi asgjë. Sipas shtypit të kohës, takimi Noli – Musolini qe një dështim. Po në Romë, Fan Noli takoi përfaqësuesin diplomatik sovjetik të cilit i premtoi njohjen e Bashkimit Sovjetik nga Shqipëria. Moska zyrtare ishte ndër të paktat vende që e përkrahu Qeverinë e Fan Nolit. Ky i fundit u premtoi atyre se do t'i lejonte të hapnin ambasadë në Tiranë, por kur dërgata me diplomatët sovjetikë mbërriti në Durrës, Noli nën presionin e britanikëve, u deklaroi se duhej të ktheheshin mbrapsht.

Noli ndoqi një politikë të ashpër ndaj kundërshtarëve të qeverisë. Gjyqet qenë intensive dhe shumica e tyre përfunduan me dënime të rënda edhe pse 90 % në mungesë.

Më 12 dhjetor të 1924-ës, Ahmet Zogu u dënua me vdekje bashkë me Iljaz Vrionin dhe Shefqet Vërlacin. Zogu ishte ato ditë në Pragë. Ishte hera e tretë në jetë që dënohej me vdekje në mungesë.

Dënimi e shtyu të shpejtonte lëvizjet. Më 13 dhjetor, 2 anëtarë të Këshillit të Naltë që ishin jashtë, autorizuan Iliaz Vrionin, të cilin e konsideronin Kryeministër legjitim, të organizonte operacionin e rikthimit të Qeverisë legale në Tiranë. Ahmet Zogu u emërua komandant i përgjithshëm i operacionit. Ato muaj ai kishte qenë mjaft aktiv në politikë. Ishte takuar me përfaqësues diplomatikë, kishte udhëtuar në Beograd, Vjenë dhe Pragë. Nga Jugosllavia dhe Italia kishte marrë aprovimin për rikthimin në Shqipëri. Në kujtimet e mëpasme, të gjithë kundërshtarët e tij sqarojnë se Zogu u mbështet, madje edhe u financua nga Britania e Madhe në këtë veprim, por kjo nuk vërtetohet dot.

Mëngjesin e 8 dhjetorit të vitit 1924 Ahmet Zogu mbërriti në Beograd nga Praga dhe kërkoi takim me Mbretin Aleksandër. Takimi u bë atë mesditë. Një orë më pas, u prit nga Kryeministri Pashiç, njeriu që e kishte takuar edhe në vitin 1915 në Nish, kur ishte vetëm 17 vjeç. Pashiçi i premtoi gjithë mbështetjen jugosllave. Për shumë vjet është shkruar se mes Zogut dhe Pashiçit pati edhe një marrëveshje, por askush s' di të thotë gjë për origjinalitetin e saj. Palët e kanë mohuar, madje Zogu ka deklaruar se s' ka pranuar as ndihmë nga Pashiçi. Historianët jugosllavë, po ashtu e mohojnë të ketë një marrëveshje me shkrim, por ata shtojnë se në bisedën mes tyre janë prekur 4 pika që mund të konsiderohen edhe një marrëveshje xhentëlmenësh, marrëveshje së cilës, sipas tyre, Zogu nuk i qëndroi pas ardhjes në pushtet. Një historian i Beogradit flet edhe për ndihmën që Jugosllavia dha për Zogun edhe pse teksti i tij, nuk është shumë i qartë në kontekstin që vendoset:

Organizimi i sulmeve diversive të fuqive të Zogut në Shqipëri, i kushtonte qeverisë Jugosllave afro 30.000 napolona ari.

Më 9 dhjetor paradite, Ahmet Zogu dhe shpura e tij doli nga hotel "Moska" dhe u nis drejt Dibërës. Kishte me vete edhe 60 rusë të bardhë me dy bateri topash, Skoda.

Operacioni për rikthimin e qeverisë legale, ose "Triumfi i legalitetit" siç u njoh për shumë kohë, nisi në datën 20 dhjetor të 1914-ës. Trupat e Ahmet Zogut hynë nga 7 drejtime në Shqipëri. Më kërcënuese qenë trupat e komanduara nga vetë Zogu në Dibër dhe

kolona e Myfit Libohovës në Kakavijë. Nga Kapshtica ndërkohë sulmoi Koço Kota, ndërsa vetë Vrioni hyri nga Italia. E paralajmëruar për lëvizjet, Qeveria e Nolit nuk bëri asnjë reagim. Pak forca ushtarake që u dolën para u shpartalluan në fare pak orë nga Zogu. Ato kryesoret të drejtuara nga Bajram Curri ngelën të izoluara dhe nuk vepruan dot. Për shumë vjet, në kujtime është hapur një legjendë sipas së cilës, kur shkuan t' i thonë se Zogu po vinte, Kryeministrin Noli e gjetën duke i rënë flautit apo violinës. Nuk dihet sa reale është kjo histori. Me gjasë është pjesë e thashethemeve denigruese që hapen sa herë dikush bie nga pushteti. Ajo që është e sigurt, është se Noli nuk ia doli dot as ta ndalte dhe as t' i bënte rezistencë Ahmet Zogut. Ai, qeveria e tij dhe rreth 350 vetë, u larguan për në Itali me anije. Gjesti i fundit i qeverisë ishte një shkresë që urdhëronte të paguheshin rrogat e ministrave dhe të deputetëve në avancë.

Të ikurit mbërritën në Brindisi ku zhvilluan një mbledhje në hotel "International". Njëri prej ikanakëve, Sejfi Vllamasi e kujton kështu atë takim:

Në atë mbledhje historike Noli ndër të tjera, duke iu drejtuar Gurakuqit, tha: - Gurakuq, ne kemi bërë shumë gabime. ... Me gjithë të metat e tij, Noli pati guximin e me plot sinqeritet pranoi gabimin e bërë...

Bernd Fisher e sqaron kështu raportin mes Zogut e Nolit dhe dështimin e qeverisë së këtij të fundit:

Noli nuk pati mbështetjen e brendshme që kishte Zogu. Dhe nga ana tjetër Zogu kishte klanin dhe shërbyesit e tij tek të cilët mund të mbështetej. Mendoj se ai e dinte procesin e debatit të brendshëm politik shumë më mirë sesa Noli. Noli ishte mbushur me shumë ide perëndimore dhe në një farë mase ato ishin pjesa më e madhe e njohurive të tij bazë që përjashtuan njohuritë e nevojshme për t' ia dalë mbanë në një sferë shumë të vështirë politike në Shqipëri në vitet '20.

Sërish sipas Vllamasit:

Noli rrojti mustaqet dhe mjekrën e tij madhështore, duke thënë:

“Këtë borxh që ia pata Shqipërisë, po ia laj dhe nuk ia vlen barra qiranë për përpjekjet për një popull njëmilionësh...”

Në një farë mënyrë, ajo mbledhje ishte angazhimi i fundit i Nolit në politikë. Për disa vjet ai u bë themelues i një organizate antizogiste, majtiste të quajtur KONARE, udhëtoi për në Moskë, u vendos në Amerikë, ku ndërkohë, miku i afërt, Faik Konica, ishte bërë ambasador i Shqipërisë, i emëruar personalisht nga Ahmet Zogu. Nga mbështetës, Konica qe kthyer në kritik të Nolit. Në një artikull të botuar në gazetën “Afrimi”, në vitin 1926 Konica e argumenton kështu dështimin e Nolit, por edhe të tijin:

Fan Noli dhe unë kemi lëftuar që t’i japim Shqipërisë një gubernë të një tipi të përparuar. Ahmed Zogu ka lëftuar për një gubernë të një tipi më konservativ. Ahmed Zogu na mundi dhe na mundi me themel.

Më pas ai rreshton disa nga arsyet e humbjes së tyre, ku nuk harron:

Deshmë të tregojmë se të paktën në sheshin e diplomatisë kemi më tepër zotësi se Ahmed Zogu. Po edhe në këtë shesh maloku genial na mundi. Ne nuk e bëmë dot gubernën tonë të pranohet dhe të njihet nga bota e qytetëruar... Ahmed Zogu nga ana tjetër qe i zoti të fitojë besimin e Europës e të Amerikës dhe e bëri gubernën e tij të pranohet zyrtarisht!

Më 24 dhjetor të vitit 1924, pak pas mesditës, Ahmet Zogu me trupat u shfaq në kthesën e Brarit. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Ali Derhemi dhe paria e qytetit kishin dalë në rrugën e Tujanit, në afërsi të Rrapit të Trishtit që në mëngjes herët. I shoqëruar nga afro 3000 vetë Zogu ndaloi të përshëndetej me parinë dhe prej aty, vijoi një copë rrugë në këmbë në respekt të atyre që kishin dalë për ta pritur. U vendos në shtëpinë e vjetër të Zija Toptanit, ngjitur me të renë që shërbente si Seli e Parlamentit dhe e Qeverisë.

Tellalli doli po atë mbasdite duke deklaruar se Qeveria do të mbante qetësinë dhe do të respektonte qytetarët.

Më 25 dhjetor, Iljaz Vrioni që ishte larguar nga zyra më 8 qershor të 1924-ës, u rikthye si Kryeministër. Por ishte vetëm një kthim simbolik për të vërtetuar atë që Ahmet Zogu e quante “Triumfi i Legalitetit”. Ngjarjet e 6 muajve të fundit kishin dëshmuar se personi më i fortë politik në vend ishte Ahmet Zogu dhe se ky i fundit nuk kishte ndër mend të bënte më as lëshime dhe as manovra politike. Madje veproi shpejt dhe kësaj here, mjaft i vendosur.

Më 5 janar të vitit 1925, Qeveria e Iljaz Vrionit dha dorëheqjen. Më 6 janar Zogu hyri në zyrë si Kryeministër. Ai s’do të dilte më kurrë nga zyra e drejtuesit të shtetit, pavarësisht pozicionit që mbannte, deri më 8 prill 1939. Zogu kishte të gjithë fuqitë në dorë. Ndryshe nga Noli, ai veproi ligjërisht, por tashmë s’bëhej më fjalë për metoda demokratike.

Gjesti i parë ishte zëvendësimi i deputetëve të ikur me të tjerë nga po ato zona. Me Parlamentin e kompletuar dhe krejt nën kontroll vendosi të zgjidhë formën e regjimit. Sipas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913 Shqipëria ishte caktuar principatë, pra monarki dhe sovrani i saj ishte Princ Vidi, ose Vilhelmi I. Ai nuk kishte pranuar të abdikonte dhe në këto kushte një monarki e trashëgueshme mund të zëvendësohej, veçse nëse ndërrohej forma e regjimit. Kongresi i Lushnjës nuk kishte hyrë në këtë histori, me gjasë sepse nuk donte të hapte probleme të tjera brenda, ose sepse nuk donte të kundërshtonte një vendim të Fuqive të Mëdha, por Ahmet Zogu kërcënohej si Kryeministër nga Këshilli i Naltë, i cili luante rolin e regjencës në mungesë të princit. Ai vendosi ta zgjidhë një herë e mirë këtë ngërç. Më 31 janar 1925, ora 3:50, Shqipëria u shpall Republikë nga një Asamble Kushtetuese. Po me të njëjtën mënyrë si Zogu nxorri nga loja Princ Vidin, komunistët do të nxirrnin edhe Zogun më 11 janar të vitit 1946. Princ Vidi e humbi fronin dhe në ora 5:00 mbasdite, një orë pas shpalljes së Republikës, Kryeministri Ahmet Zogu u zgjodh President. Ai mori 60 vota nga 62 të vlefshme.

Shqipëria u shpall Republikë Presidenciale. Parlamenti që ushtronte funksionet si organi më i rëndësishëm politik në vend, kishte dy dhoma, atë të ulëtën dhe senatin. Më 17 maj të 1925-ës u zhvilluan zgjedhjet e para. Ato s’kishin asnjë krahasim me zgjedhjet e prillit të 1921-it apo dhjetorit të 1923-it. Në Shqipëri filloi epoka e

zgjedhjeve të kontrolluara, që do të merrnin fund, plot 66 vjet më pas, më 31 mars të vitit 1991.

Në qershor të 1925-ës disa nga bajraktarët kundërshtarë të veriut morën befasi një ftesë për të festuar bashkë me Presidentin shpalljen e Republikës. Siç u mësua më vonë, pothuajse të gjithë personalitetet me ndikim në vend kishin marrë një ftesë të ngjashme, pavarësisht nëse e donin apo jo Ahmet Zogun. Më 18 qershor të 1925-ës, Zogu priti në fushën e namazgjasë, përballë Parlamentit, 540 krerë lokalë dhe bajraktarë. Ai urdhëroi që të gjithë ata të mbanin me vete armët siç i mbanin kudo ku shkonin. Midis tyre kishte kundërshtarë të betuar, por ai rrëfeu një qetësi befasese kur i takoi dhe i përshëndeti. Pritja ia arriti qëllimit. Ajo e rikonfirmoi, sy më sy, Ahmet Zogun si personalitetin më të rëndësishëm politik në vend.

Një javë më pas, më 25 Qershor ai thirri në fushën e Shallvarit një tjetër dërgatë prej 3500 burrash. Gjatë ceremonisë shpalli faljen e të arratisurve politikë dhe kërkoi rikthimin e tyre normal në vend. Zogu po imponohej, por dukej se Presidenti Zogu kishte të tjera plane.

ZOGU DHE KUNDËRSHTARËT E TIJ POLITIKË

Noli, Konica, Hasan Prishtina apo Bajram Curri

Në pranverën e vitit 1920 kur qeveria ndodhej pa fuqi, pa të holla dhe nën kërcënimin e esadistëve, Zogu më bëri këtë propozim:

Mbasi nuk disponojmë fuqi të organizuar të mjaftueshme për të stabilizuar një shtet modern, kam menduar një rrugë praktike, por barbare për t'i dalë qëllimit në krye. Të ftojme gjithë parinë e Shqipërisë në një kongres... në të njëjtën kohë unë marr përsipër t'i vë dy bomba shtëpisë ku do të mbahet kongresi dhe në çastin e fundit ne me shokët tanë, me një pretekst dalim jashtë para se të hedhim në erë kongresistët. Kështu situata vetvetiu stabilizohet.

Kjo pjesë e marrë nga kujtimet e Sejfi Vllamasit, shkruajtur shumë kohë pasi Zogu nuk jetonte më, shërben më së miri për të kuptuar se si funksiononte politika dhe se cilat qenë raportet mes kundërshtarëve në atë kohë.

Duke iu referuar të njëjtës bisedë të hershme, Vllamasi kujton se i dha argumentin që kjo do të shkaktonte shqetësim dhe përçmim në Europë, por Zogu iu përgjigj fare qetë:

Shqipëria nuk është Përmeti. Të gjithë krerët e Shqipërisë, sidomos ata të veriut, duan të bëhen Kryetarë Shteti, Kryeministra dhe Ministra. Ku do t'i gjejmë gjithë këto vende për të kënaqur këta njerëz

zgjedhjeve të kontrolluara, që do të merrnin fund, plot 66 vjet më pas, më 31 mars të vitit 1991.

Në qershor të 1925-ës disa nga bajraktarët kundërshtarë të veriut morën befasi një ftesë për të festuar bashkë me Presidentin shpalljen e Republikës. Siç u mësua më vonë, pothuajse të gjithë personalitetet me ndikim në vend kishin marrë një ftesë të ngjashme, pavarësisht nëse e donin apo jo Ahmet Zogun. Më 18 qershor të 1925-ës, Zogu priti në fushën e namazgjasë, përballë Parlamentit, 540 krerë lokalë dhe bajraktarë. Ai urdhëroi që të gjithë ata të mbanin me vete armët siç i mbanin kudo ku shkonin. Midis tyre kishte kundërshtarë të betuar, por ai rrëfeu një qetësi befasuese kur i takoi dhe i përshëndeti. Pritja ia arriti qëllimit. Ajo e rikonfirmoi, sy më sy, Ahmet Zogun si personalitetin më të rëndësishëm politik në vend.

Një javë më pas, më 25 Qershor ai thirri në fushën e Shallvarit një tjetër dërgatë prej 3500 burrash. Gjatë ceremonisë shpalli faljen e të arratisurve politikë dhe kërkoi rikthimin e tyre normal në vend. Zogu po imponohej, por dukej se Presidenti Zogu kishte të tjera plane.

ZOGU DHE KUNDËRSHTARËT E TIJ POLITIKË

Noli, Konica, Hasan Prishtina apo Bajram Curri

Në pranverën e vitit 1920 kur qeveria ndodhej pa fuqi, pa të holla dhe nën kërcënimin e esadistëve, Zogu më bëri këtë propozim:

Mbasi nuk disponojmë fuqi të organizuar të mjaftueshme për të stabilizuar një shtet modern, kam menduar një rrugë praktike, por barbare për t'i dalë qëllimit në krye. Të ftojme gjithë parinë e Shqipërisë në një kongres... në të njëjtën kohë unë marr përsipër t'i vë dy bomba shtëpisë ku do të mbahet kongresi dhe në çastin e fundit ne me shokët tanë, me një pretekst dalim jashtë para se të hedhim në erë kongresistët. Kështu situata vetvetiu stabilizohet.

Kjo pjesë e marrë nga kujtimet e Sejfi Vllamasit, shkruajtur shumë kohë pasi Zogu nuk jetonte më, shërben më së miri për të kuptuar se si funksiononte politika dhe se cilat qenë raportet mes kundërshtarëve në atë kohë.

Duke iu referuar të njëjtës bisedë të hershme, Vllamasi kujton se i dha argumentin që kjo do të shkaktonte shqetësim dhe përçmim në Europë, por Zogu iu përgjigj fare qetë:

Shqipëria nuk është Përmeti. Të gjithë krerët e Shqipërisë, sidomos ata të veriut, duan të bëhen Kryetarë Shteti, Kryeministra dhe Ministra. Ku do t'i gjejmë gjithë këto vende për të kënaqur këta njerëz

të cilët kur mërzhiten shkojnë deri në përmbysjen e shtetit. Gazetat e huaja, pas një jave agjitacioni kundra nesh do të bëhen objektive dhe do të pëlqejnë procesin tonë të shkurtër e praktik e deri diku të njerëzishëm mbasi qëllimi ynë asht të shpëtojmë një popull...

Historia e Ahmet Zogut si dhe e gjithë klasës politike të asaj kohe është një histori ku atentati dhe eliminimi fizik i kundërshtarit, shihej si armë normale politike. Zogu iu mbijetoi shumë atentateve, zbuloi shumë tentativa për atentat, por edhe organizoi dhe urdhëroi shumë të tilla. Eliminimi mbështetej mbi një filozofi që sot duket më shumë se barbare, por që në atë kohë ishte pjesë e lojës. Pietro Kuarone, diplomati i Romës në Tiranë e përkufizon kështu këtë anë të politikës shqiptare:

Jeta politike nuk ishte sigurisht e sigurt në Shqipëri dhe vrasja figuronte akoma ndër mjetet e luftës. Shqiptarët e pranonin, me zemërdlirësi të plotë, si një domosdoshmëri të pashmangshme.

Ju keni në dispozicion shumë mjete të tjera, -më thoshte një ditë një personalitet i vjetër shqiptar, -për ta nxjerrë jashtë luftimit një nga kundërshtarët tuaj politik. Te ne këto mjete të ndryshme nuk funksionojnë, prandaj ne jemi të shtrënguar të përdorim, puro dhe thjesht likujdimin.

Nga të gjithë kryetarët politikë të hershëm dhe të sotshëm, janë shumë të rrallë ata, të cilët do të mund të mburrehin që nuk i kanë duart e lyera me gjak. Zogu, sigurisht, nuk bënte pjesë në këtë numër, veç kësaj, vetë ai nuk ka pretenduar asnjëherë të kundërtën.

Kuarone sqaron më pas:

Padyshim, Zogu nuk ka patur gisht në të gjitha dramet politike që njerëzit i atribuonin atij, lista e tyre do të dilte shumë e gjatë: megjithatë.... nëse ia veshin dikujt disa veprime, kjo vjen ngaqë ai ka dhënë prova që është i aftë t'i bëjë ato.

Kuarone është ndoshta i vetmi ndër të huajë që ka hyrë në personalitetin e dyfishtë dhe kontradiktor të Mbretit Zog. Raporti i tij me kundërshtarët politikë është tejet interesant. Ai përfshin joshjen,

korruptimin, tundimin, po aq sa dhunën dhe eliminimin fizik. Historia e dëshmon shpesh që ai dinte t'i përdorte të gjitha mënyrat.

Noli apo Konica, dy kundërshtarë të ashpër, që u bënë më pas aleatë, janë një aspekt i qëndrimeve të Zogut ndaj kundërshtarëve, ashtu si të tjerë që u kthyen e bashkëjetuan me të.

Noli ishte padyshim kundërshtari më klasik dhe më i njohur i Ahmet Zogut në historinë e viteve '20. Pas largimit nga Shqipëria në dhjetor 1924, Noli u end nëpër Europë duke tentuar të organizonte një lëvizje politike, por pa sukses. Ai e zbrazti mllëfin ndaj Zogut në një seri vjershash të mrekullueshme, ritmika dhe vrulli i të cilave mbeten të pakonkurueshme ende. Kur i humbi shpresat, në fund të viteve '20, u vendos përfundimisht në SHBA, duke drejtuar Kishën e Shën Gjergjit në Boston.

Marrëdhëniet mes Zogut dhe peshkop Nolit mbetën problematike në rrjedhën e viteve, por mëria mes tyre filloi të zbehet. Në mes të viteve '30 Zogu i dërgoi atij 890 \$ sipas një kërkesë që vetë Noli i kishte bërë për të paguar shpenzimet e mjekimit. Më pas, ata vendosën një raport normal, siç dëshmon edhe ky reportazh i një prej gazetave më prestigjioze amerikane gjatë vizitës së motrave të Zogut në SHBA, në mars të vitit 1938:

"New York Post", 14 mars 1938

Pas qetësimit të konfliktit ndërmjet Mbretit Zog dhe Nolit Boston, 14 mars.

Mesa duket pas qetësimit të një konflikti të gjatë midis vëllait të tyre, Mbretit Zog të Shqiptarëve dhe peshkopit Fan Noli, dikur Kryeministër i vendit dhe tani kryetar i Kishës Amerikane të Shqiptarëve të krishterë, tre motrat princesha të Mbretit dolën sot në publik.

Princeshat Shqiptare Ruhije, Myzejen dhe Maxhide morën pjesë në Meshën e së Dieles në Kishën Ortodokse Shqiptare të Shën Jorgos. Duke qëndruar të heshtura përpara altarit, Princeshat - myslimane si vëllai i tyre - dëgjuan lutjen e peshkopit Noli për monarkun e mbretërisë ballkanase, ai që e detyroi për t'u larguar nga vendi.

Më pas peshkopi vizitoi Princeshat në suitën e tyre në hotel dhe i përshkroi ato si "shumë tërheqëse".

Faik Konica, ministri Shqiptar në SHBA dhe shoqëruesi i Princeshave tha se peshkopi ka shprehur dëshirën e tij për t'u rikthyer në atdhe, për të hapur një koleg për edukimin e popullit.

Në vitin 1936, pas largimit të Mehdi Frashërit, Mbreti Zog e ftoi Nolin të merrte drejtimin e Qeverisë Shqiptare, por ky refuzoi me argumentin se ishte në gjendje jo të mirë shëndetësore. Po ashtu refuzoi në vitin 1938 që të merrte pjesë në dasmën e Zogut ose që të kthehej në Shqipëri për të themeluar universitetin shqiptar që Zogu kishte ndërmend ta hapte brenda pak vjetësh.

Pas shpërthimit të luftës, edhe Zogu u largua në emigracion. Mes tyre pati një komunikim normal dhe Noli iu drejtua disa herë Departamentit të Shtetit duke sqaruar se Zogu nuk mund të anashkalohej në zgjidhjen përfundimtare të problemit shqiptar pas luftës.

Një ndër figurat më të rëndësishme të kulturës shqiptare në historinë e saj, përkthyes brilant dhe poet fshikullues, Fan Noli vdiq në vitin 1965 në Florida, në shtëpinë e pushimit të dhuruar nga shqiptarët e Amerikës. Ai refuzoi të kthehej në Shqipëri si Kryetar i Asamblesë Kushtetuese e cila rrëzoi Mbretin Zog në vitin 1946. Dukej se zhgënjimi i Fan Nolit me Shqipërinë ishte i madh.

Raporti me Nolin është një nga shembujt tipikë të raporteve që Zogu vendosi gjatë gjithë jetës me kundërshtarët. Ai ishte një qenie tipike orientale që për të neutralizuar apo vënë në shërbim kundërshtarin përdorte si joshjen, tundimin, rryshfetin ashtu edhe eliminimin fizik.

Historia me Konicën është edhe më komplekse, por më pak dramatike. Ata qenë njohur në vitin 1914 në Durrësin e Princ Vidit dhe kishin kaluar edhe disa kohë së bashku në Vjenë në vitet 1917 - 1918. Në fillim të viteve '20 Konica u bë një kritik i madh jo vetëm i Zogut, por edhe i gjithë klasës politike shqiptare, përfshi mikun e tij, Fan Nolin. Në letrën e largimit nga deputet, Konica u shkruante kolegëve të tij:

Hiqni dorë se u bëtë lodra e botës. Ta dini se në sy të Europës së qytetëruar... ca na shajnë, ca na përqeshin, ca u vjen keq, po të

gjithë na përbuzin dhe na kanë për të poshtëruar. Hiqni dorë se u bëmë palaçot e dheut...heshti, shtrohuni, bashkohuni, punoni, bëhuni burra. Puna është më e lartë se trimëria, kazma më fisnike se palla... E kam zemrën aq të mbushur me lot, sa s'qaj dot. Dhe më në fund, aq di, aq them: jini të lirë të bëni si të doni!

Konica u rikthye në Amerikë si Kryetar i Vatrës. Gjatë fillimviteve '20 nuk i pushoi kritikën për Zogun në gazetën "Dielli", por pas ngjarjeve të vitit 1924, kundërshtoi Nolin për qeverisjen e tij dhe u afrua sërish me Zogun. Nuk dihet se si u vendos komunikimi mes tyre, por në vitin 1926, Zogu e emëroi ambasador të Shqipërisë në Uashington, detyrë në të cilën qëndroi deri në vitin 1939, pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia. Konica e vizitoi vetëm një herë Shqipërinë e Zogut dhe raporti i tyre ngjan shumë i çuditshëm. Aspak si raporti i Kryetarit të Shtetit me një ambasador të tijin. Vetë Konica në një shkrim të para vdekjes, kujton një moment nga takimi me Lal Krosin në Nju- Jork më 1938, gjatë vizitës së Princeshave atje:

Abdurrahman Salihu, një mik i vjetër i shtëpisë së Zogut, që kishte ardhur si shoqërues i princeshave, shprehu mirënjohjen për kujdesin tim. As vetë mbreti, - tha ai, - nuk do të mund të bënte më tepër për të motrat. Pastaj plaku shpirtmirë më tha se, po të dëshiroja, mund t'i jepja një mesazh me gojë për mbretin. A më premtoni se do t'ia transmetoni mesazhin tim, pa i bërë asnjë ndryshim? - pyeta unë. Plaku më dha fjalën se ishte i gatshëm.

Mirë atëherë, - thashë unë, - bëji të ditur mbretit se kritikën e mia do të mbeten të kufizuara brenda qarqeve shqiptare, jashtë këtyre qarqeve unë do ta mbroj regjimin me të gjitha fuqitë e mia. Do të vazhdoj t'i shërbej me besnikëri dhe me zemër, sepse jam përfaqësues i tij dhe ai është koka e shtetit shqiptar. Por personalisht, unë ndiej përbuzjen më të madhe për karakterin e tij.

Po në të njëjtin shkrim, pas rënies së Zogut, ai jep këtë shpjegim për Mbretin:

...fama e Zogut si dallaveraxhi i zgjuar mund të përmblihet në një koment që i ka bërë autorit ish - i dërguari i Shteteve të Bashkuara në Tiranë: -"Ishte e lehtë ta blije Zogun, por ai nuk qëndronte i blerë.

Zogu e dinte qëndrimin e Konicës edhe konsideratën që ai kishte për të, por nuk e ngacmoi asnjëherë. Konica qëndroi në detyrë deri ditën e fundit që Zogu ishte Mbret. Më pas, raporti mes tyre u tensionua për probleme financiare që lidheshin me borxhet e Legatës Shqiptare në Uashington. Gjithsesi, në takimin në Departamentin e Shtetit në vitin 1942, vetëm pak përpara vdekjes, Konica, së bashku me Nolin deklaruan se Mbreti Zog ishte një faktor i rëndësishëm për të ardhmen e Shqipërisë. Në dhjetor 1942, mbi arkivolin e Konicës, qëndronte edhe një kurorë me lule orkide e dërguar nga Mbreti Zog. Një gjest i fundit ndaj një miqësie të hershme, ose mbase një shenjë, që sikur donte të tregonte se ai raport aq kompleks, nuk kishte asgjë personale.

Por raporti me Nolin dhe Konicën nuk ishte më tipiku. Bajram Curri, Hasan Prishtina dhe Luigj Gurakuqi, ndryshe nga ata, u bënë pre e atentateve, atentate që historiografia komuniste ia ka atribuar mbretit Zog.

Protagonist i jetës politike shqiptare në vitet 1908 – 1924, Bajram Curri duke se u ftoh me Zogun pas krushqisë që ky i fundit lidhi me familjen Kryeziu të Kosovës. Curri dhe Kryezinjtë ishin në hasmëri. Bajram Curri zgjodhi rrugën e kontestimit të qeverisë që në vitin 1922 kur mbështeti revoltën e Cen Elezit, por ndeshja e tij me Zogun kulmoi në ngjarjet e Qershorit 1924. Pas kthimit të Zogut në pushtet Curri ishte i vetmi që mund t'i bënte atij rezistencë. Në janar 1925, ai u tërhoq në Krasniqe, ku në marrëveshje me bajraktarin e zonës, Sali Manin nisi veprimet kundër Zogut. Më 9 janar ata morën Tropojën, por pas mobilizimit të ushtrisë dhe dërgimit në krye të forcave të vetë ministrit të Brendshëm Ceno bej Kryeziu, e humbën sërish dhe u tëhoqën nëpër male.

Më 9 janar 1925, ministri i Brendshëm i raportonte Ahmet Zogut:

Forcat e Bajram Currit u shkatëruan krejtësisht dhe se Bajram Curri ka marrë të ikun në Krasniqe, ku po ndiqet nga ana e qeverisë.

Po të njëjtën ditë, pak orë më vonë, Zogu urdhëron Ministrin Kryeziu:

Curri gjallë â vdek duhet ta zini dhe fuqinë e tij duhet ta shkatëroni krejt tue marrë gjithë masat që kështu të shuhet revolucioni i Kosovës e të mos përsëritet më.

Më 14 janar Bajram Curri me afro 100 pasues u ngjiti drejt Majës së Hekurave në 2600 metra lartësi dhe në një dimër të egër. 63-vjeçar, ai nuk kishte fuqi të ecte dhe shpesh e tërhiqnin të shtrirë mbi një batanije. Më gjasë, nuk donte që të krijonte problem për ndjekësit e tij. Pak ditë më pas i mblodhi dhe u deklaroi:

Perëndia paska premtue që unë me vdekë mbi borë në majë të këtyne bjeshkëve. Nuk due më kot me ju marrë në qafë edhe ju. Kthehuni menjëherë nëpër shpijat tueja e më lini këtu. I Madhi Zot ju ndihmoftë e udha e mbarë ju qoftë se nuk keni shka bânî mâ!

Ai mbijetoi i rrethuar nga forcat qeveritare ende edhe 2 muaj. Nuk pranoi të dorëzohej. Kërkesës së njërit prej besnikëve që e shoqëronin për të kaluar në Jugosllavi iu përgjigj:

“Preferoj vdekjen në Shqipni se sa jetesën ma të mirë në Serbi”.

Qeveria kishte vendosur një çmim prej 500 napolonash për atë që jepte informata për të. Më 29 mars 1925, si pasojë e një informacioni u rrethua në një shpellë në Grykën e Dragobisë. Shefqet Draga, njëri prej besnikëve që e shoqëronte e ka rrëfyer kështu në procesverbalin e Ministrisë së Brendshme vrasjen e Bajram Currit:

“...kam ndie krismen e pushkve rreth Bajram Begut edhe sa jam sjellë të shikoj shof se edhe Bajram Curri vet mbas një lisit të hollë po qëndron dhe shtie pushkë. Mbas pesë minutash lufte Curri u vra. Vrasjen e Currit e kuptova prej ndalimit të tij tuej shti pushkë si edhe prej zanit gjindarmave të cilët bërtitnë tuej thanë: “U vra Begi”.

Shefqet Draga nuk jep shpjegime nëse Bajram Curri e vranë xhandarët apo vrau veten siç është shkruajtur në gazeta së fundmi. Këtë version e ka mbrojtur edhe sekretari i Bajram Currit, Niman Ferizi, në kujtimet e tij botuar më 1935 në Kostancë të Rumanisë.

Sipas dëshmitarëve:

“xhamadani i Bajram Currit u gjend i hequr dhe i vendosur disa metra larg trupit të tij të vdekur, pa njolla gjaku. Sipas të drejtës zakonore të Veriut të Shqipërisë, ky gjest i tij në momentet e fundit të jetës interpretohej si mesazh për pasuesit e gjakut të tij që ta konsideronin të mbyllur konfliktin e familjes Curri me familjen Kryeziu të Gjakovës.”

Zogu ka mohuar që të ketë dorë në vrasjen e Bajram Currit. Ai ka shtuar se kishte çuar fjalë të dorëzohej dhe të dilte në gjyq sipas ligjit. Në një intervistë të vitit 1999, Leka Zogu është shprehur për këtë çështje:

“E di se çështja e Bajram Currit ka qenë se ai vetë i kishte dërguar lajm të dorëzohej! Nuk donte ta vrisnin dhe bëri çmos që ta kapnin dhe ta binin. Ai do ta falte se e dinte që jugosllavët donin ta vrisnin vetë. Fatkeqësia ka qenë se nipi i vet e ka vrarë”

Më 1 Prill 1925, Qeveria aprovoi një fond prej 400 franga ari për shpenzimet e varrimit të Bajram Currit. Një vit e gjysmë më vonë më 30 tetor 1926, dhoma e deputetëve diskutoi për dhënien e pensionit të përmuajshëm, personave Bajram Curri dhe Hysni Curri. Vendimi ka këtë tekst:

“Tua marrë parasysh gradat ushtarake si kolonel e major, qi kanë pas të ndyerit Bajram e Hysni Curri, me qëllim që të lehtësishet gjendja e vështirë financiare, në të cilën gjendet familja e tyne, u nepet pension i përmuajshëm prej 250 franga ari familjes së Bajram Currit dhe 150 franga ari, familjes së Hysni Currit.”

Vrasja e Luigj Gurakuqit implikon Tiranën shumë më tepër se çdo atentat tjetër politik. Pas largimit nga Shqipëria, Luigj Gurakuqi, një mbështetës i fortë i italianëve ishte vendosur në Bari nën kujdesin e Qeverisë së Musolinit. Më 2 Mars 1925 ndërsa dilte nga hotel “Cavur” ku po darkonte me dy miq, u qëllua me 3 plumba nga një shkodran i quajtur Balto Stamolla. Gurakuqi ndërroi jetë rrugës për në spital.

Balto Stamolla deklaroi në gjyq se e kishte vrarë Gurakuqin rastësisht, kur kishte marrë vesh se ky po organizonte një grusht shteti të mbështetur nga bolshevikët. Por shtypi italian zbuloi se ai ishte kushëri i parë i Konsullit Shqiptar në Bari, Catin Saraçit. Saraçi ishte larguar menjëherë pas atentatit me piroskafin “Molfeta” për në Durrës. Një dëshmitar italian e kishte njohur atë në momentin e atentatit, ndërsa ndiqte skenën e vrasjes nga distanca për t’u siguruar.

Në dosjen e AQSH-së ndodhet edhe një letër e vrasësit Stambolla, drejtuar Catin Saraçit dhe Ceno bej Kryeziut ku shkruhet:

“Kërkoj mbrojtje, dërgoni të holla, ndërmjetësoni për shpëtim pranë qeverisë Italjane. Pyeteni Catin Saraçin ku asht. Besa ndihmë...”

Askush s’di të thotë se përse i shërbeu Tiranës vrasja e Gurakuqit, një njeriu që nuk ishte ndër drejtuesit më të rëndësishëm të opozitës dhe mbi të gjitha një njeri që kishte raporte shumë të mira me Italinë.

Vrasja e Hasan Prishtinës ngjan më e komplikuar. Ai kishte qenë 2 herë organizator i vërtetuar i atentateve kundër Zogut. Së pari më 1928 kur një bombë shpërtheu në shtëpinë e Presidentit pa e vrarë atë dhe së dyti në Vjenë, ku ishte njohur fajtor edhe nga Gjykata e atij vendi.

Duket se Hasan Prishtina ishte tërhequr disi nga politika aktive kur më 14 Gusht 1933 u vra në rrugën Çimisqi të Selanikut nga Ibrahim Çelo, një shqiptar nga Maqedonia, me banim në Francë që njihej si mik i tij. Sipas dëshmitarëve, Çelo rrëfeu një mizori të pashembullt ndaj burrit të moshuar. Pas goditjes së parë që e shtriu atë në tokë, Çelo qëllloi edhe disa herë të tjera.

Ai i shpëtoi zemërimit të qytetarëve që desh e linçuan, por në gjyq deklaroi se Hasan Prishtina i kishte kërkuar të shkonte në Shqipëri e të vriste Zogun. Thënia nuk u vërtetua kurrë dhe vrasja e Hasan Prishtinës mbeti sërish mister.

Padyshim, nëse bëhet fjalë për një vrasje të kundërshtarëve politikë të viteve të Mbretit Zog, ajo e Ceno bej Kryeziut mbetet më klasikja.

Ceno bej Kryeziu ishte djali i Riza bej Kryeziut ose Gjakovës, njërit prej njerëzve më influentë të Kosovës. Ai ishte martuar në vitin 1922 me motrën e Zogut, Ruhijen dhe kishte me të një djalë, të quajtur Esat. Ceno bej Kryeziu kishte luajtur një rol të rëndësishëm në rikthimin e Zogut në pushtet më 1924 dhe kishte marrë si shpërbtim postin e ministrit të Brendshëm. Njeriu i jugosllavëve, Ceno Beu ishte acaruar me Zogun pas nënshkrimit të marrëveshjeve me italianët dhe braktisjes që Zogu i bëri Jugosllavisë. Ai kishte nisur të fliste kundër Zogut dhe në 2 - 3 raste ishte identifikuar si organizator revoltash dhe atentatesh. Zogu e kishte shkarkuar si ministër të Brendshëm dhe e kishte transferuar ambasador në Beograd dhe më pas në Pragë. Më 14 Tetor 1927, ndërsa Ceno Beu hynte në një lokal në Pragë, në ditët e para të mbërritjes aty, u qëllua me tre plumba nga Alqiviadh Bebi, një student i ri shqiptar. Bebi vetë nuk arriti të japë shpjegime. Ai u vra ca ditë më pas nga njerëzit e Beut ndërsa dilte në gjyq.

Trupi i Ceno Beut u përcoll për në Tiranë ku u varros me nderime, por vëllezërit e tij, Hasan dhe Gani Kryeziu identifikuan si organizator të atentatit Shefqet Vërlacin, vjehrrin e Zogut dhe tentuan ta vrasin atë. Vërlaci shpëtoi ashtu si vetë Zogu, pas një atentati të organizuar nga vëllezërit Kryeziu siç dëshmon studiuesi Kastriot Dervishi:

“Në Gusht 1928, vëllezërit e Ceno beut përgatitën një atentat kundër Ahmet Zogut, me zbulimin e të cilit, Hasan dhe Gani Kryeziu u arratisën nga Shqipëria.”

Shefqet Vërlaci, që u akuzua si organizator i vrasjes së Ceno Beut duket se u bë edhe vetë objekt i kërcënimit nga Zogu. Pietro Kuarone e kujton kështu sjelljen e Vërlacit dhe ultimatumit që italianët i dhanë Zogut për të:

“Shefqet Beu bënte pjesë në numrin e miqve të sigurt. Prandaj, pas atentatit të fundit kundër tij, ne i deklarua shumë qartë Zogut që çdo goditje kundër jetës së Vërlacit do të konsiderohej nga ne si një akt jo miqësor ndaj Italisë...”

SHPALLJA MBRET DHE OBORRI MBRETËROR

Ugo Sola ngjiti shkallët e Presidencës në Tiranë me bindjen se ishte në dijeni të bisedës që do të bënte me Kreun e Shtetit. Ishte fillimi i vitit 1928. Presidenti Ahmet Zogu kishte thirrur në takim ambasadorin italian në Tiranë për një problem që do të ndryshonte historinë e vendit. Zogu dhe Sola u ulën bashkë në një verandë të vogël dhe Presidenti, gjithnjë me stilin e tij të të folurit, i sqaroi se mendonte që për të mirën e vendit, për stabilitetin e tij dhe të shqiptarëve, si dhe për një fqinjësi më të stabilizuar, vendi duhej të rikthehej te Mbretëria. Ai i sqaroi se edhe Italia ishte e tillë dhe se kjo formë regjimi mund t'i jepte krahë zhvillimit demokratik në vend.

- Por në këtë rast, duhet të rikthehet Princi Vilhelm, që jeton në Nice, dhe nuk ka abdikuar, - ia ktheu Sola duke e parë në sy.

- Princ Vidin e ka zbritur nga fronti një Asamble Kushtetuese, - ia ktheu Zogu. Mbretin do ta zgjedhin shqiptarët vetë. Ata do të ngrenë një Asamble Kushtetuese dhe do të vendosin nëse do të ftojnë një sovran të huaj apo do zgjedhin dikë nga vendi. Rëndësi ka vendimi.

Duke nisur që nga muaji mars 1928, në shtyp filluan të botohen “thirrje” intelektualësh, njerëzish me ndikim, komunash e fshatrash që bënin thirrje për rivendosjen e monarkisë dhe zgjedhjen e Ahmet Zogut si Mbret i Shqiptarëve. Në fund të gushtit, u zgjodh

një Asamble Kushtetuese që do të zgjidhte formën e regjimit. Në rast se Shqipëria kthehej në monarki ajo do të përcaktonte emrin e monarkut. Asambleja u mbledh më 29 gusht të vitit 1928 në prani të Presidentit të Republikës, Ahmet Zogu. Presidenti ishte në lozhë duke dëgjuar leximin e telegrameve nga gjithë vendi ku kërkohet që Shqipëria të bëhet mbretëri. Diskutimet e asambleistëve i ngjajnë një gare se kush të fliste fjalë më të mira dhe mbresëlënëse për Presidentin që po bëhet Mbret. Të botuara në shtypin e kohës, argumentet e përdorur ngjajnë banale. Në fakt nuk kishte fare argumente. Ja si janë shprehur disa ndër emrat më të njohur:

“Fejzi Alizoti:”... Do t’i lutem komisionit që sipas mandatit që kemi nga populli e pas dëshirit tim personal, që forma e Shtetit të jetë Monarki Konstitucionale dhe Monarkut t’i jepet titulli Mbreti i Shqiptarëve... Se kush e meriton këtë titull është e tepërt ta them, se ky është vetëm Shpëtimtari i Kombit, z. Ahmet Zogu, dhe meriton të thirret me titull “Mbret i Shqiptarëve” e jo me titullin “Mbreti i Shqipnis”.

Javer Hurshit: “... Populli shqiptar, për fat të bardhë, ndërrimin e regjimit nuk e kërkon i shtrënguar nga ndonjë zor po se dëshiron të shohin në Fronin e Kastriotit, si Mbret, të dashturin e vet, Shpëtimtarin e Kombit A. Zogu”

Sulejman Starova: “... Është dëshira e popullit ndryshimi i formës së shtetit në Monarki se ajo formë i përshtatet zakonit, traditave dhe shpirtit të shqiptarëve... Mbretër ka shumë në botë, por janë shumë të paktë ata që kanë marrë titullin “Shpëtimtar i Kombit”. Titulli “Mbret” pra nuk është më i madh se ai Burrë që ka titullin “Shpëtimtari i Kombit”.

Xhafer Ypi: “... Shpëtimtari i Kombit, A. Zogu, të naltësohet Monark; të rrijë në fronin e Kastriotit; të nderohet me kurorën e Skënderbeut. Kur liria e këtij populli kish arritë shumë herë në buzë të varrit, veprat madhështore të Ahmet Zogut e kanë shpëtuar, të cilat vepra janë çmuar e do të çmohen...”

Pjesa më e madhe e diskutantëve, e quajti Zogun hajdut dhe satrap 11 vjet më vonë, kur u largua. Ata u bashkuan me italianët dhe u pushkatuan ose u dënuan nga Komunistët më 1944.

Zogu qëndronte në llozhe. Atë ditë i kishte thënë shtypit gjerman se ideja për t’u bërë Mbret kishte qenë ëndrra e tij e vjetër. Donte t’i ngjante Jul Cesarit dhe Napoleonit. Mbrojtësi i parë i Republikës, po bëhej njëkohësisht edhe varrmihësi i saj. Ai do të bëhej 72 orë më pas, njeriu simbol i monarkisë.

Më 1 shtator paradite, Asambleja Kushtetuese lëshoi këtë mesazh përpara popullit:

“Asambleja Kushtetuese, e mveshun me fuqinat sovrane të kombit, e inspiruar prej dëshirës së shquar të popullit, për interesat vitale të atdheut, në mbledhjen e datës 1 shtator dita e shtunë, ora 9 e 12 minuta, me një za e me një shpirt, zgjedh e proklamon Mbret (Roi) të shqiptarëve, nën emrin Zog I, birin e dalun prej gjinit të vet, shpëtimtarin e kombit, Ahmet Zogun i zbritun prej familjes së famshme Zogu.”

Ahmet Zogu mbërriti vetë në Parlament në orën 5 mbasdite. Jason Tomes, biograf i tij e përshkruan kështu në libër momentin e mbërritjes së Zogut në Parlament:

“Pak më tej një trumbetë oshëtinte dhe një makinë e hapur me një eskortë kalorësiake filloi të afrohej përmes rrugëve të ngushta nën një sërë harqesh triumfale të zbkuruara me monogramin “AZ”. Nga një anë qëndronte Xhemal Aranitasi, komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë dhe nga tjetra Leon Gilardi, inspektor-gjeneral i Ushtrisë. Ora ishte pesë pa njëzet. Një njeri i hollë në një uniformë ngjyrë ulliri zbriti nga makina, u përshëndet me presidentin e Asamblesë Kushtetuese dhe u ngjit në podium duke zgjatur dorën e djathtë për të mbajtur kushtetutën. Dhoma u mbush me britma gëzimi, të cilat ai i përshëndeti me përkulje të lehta nga e djathta në të majtë. Më pas, teksa nderimi i armëve jashtë krijonte një zhurmë shurdhuese ai bëri betimin mbi Kuran dhe Bibël.”

Betimi i Mbretit Zog I u botua të nesërmen në të gjitha gazetat e vendit.

“Unë, Zogu i Parë, Mbreti i Shqiptarëve, me rastin e ngjitjes në fronin e Mbretërisë së Shqipërisë dhe marrjes në duar të pushteti mbretëror betohem përpara zotit të plotfuqishëm që të ruaj unitetin kombëtar, pavarësinë dhe integritetin territorial. Unë do t’i bindem kushtetutës dhe do veproj konform dispozitave të saj dhe ligjeve në fuqi, duke mbajtur gjithnjë parasysh vullnetin e njerëzve. Zoti më ndihet”

Një minutë më pas ai bëri një tjetër deklaratë në mbyllje të fjalës së tij:

“Zotnij, ...t’i thoni popullit sovran se Prijsi i tij e sheh vehten si çdo shqiptar edhe me sa shpejtësi dhe entuziazëm e keni vu në Fronin e Gjergj Kastriotit, aq me shpejtësi e kënaqësi keni me e gjetë gjithmonë gati për me i sakrifikue të gjitha, në është nevoja edhe jetën, mbas dëshirit të tij dhe për të mirën e vendit. Zotnij, dalshim faqebardhë përpara historisë”

Fati e solli që ky betim i tij solemn të vihej në provë më 7 Prill 1939 dhe ai nuk i qëndroi.

Në orën 5 pa 10 minuta të datës 1 shtator 1928, ditë e shtunë, Presidenti Ahmet Zogu u bë Madhëria i tij, Mbreti Zogu I. Ahmet Murtari, emri i fëmijërisë dhe adoleshencës, Ahmet Zogolli i viteve të para politike, Ahmet Zogu, ministri i Brendshëm i viteve 1920 - 1922, Kryeministri i 1922 - 1925 dhe Presidenti i Republikës i 1925 - 1928, mbetën pas, të thërmuara nga një breshëri duartrokitjesh servile. Shqipëria ishte Mbretëria më e re e Europës dhe Zogu, Mbreti i vetëm mysliman i saj.

Nxënësi i kasës së dytë fillore, Kristo Frashëri ishte aty bashkë me klasën, i veshur, siç dëshmon me këmishë të kuqe dhe brekushe të zeza. Ai e kujton kështu atë moment:

“Na vunë në rresht që të duartrokisnim delegatët. Aty erdhi edhe

Zogu në Parlament. Kur u bë ceremonia e monarkisë, e pamë më nga afër, të veshur me një veshje që na u duk sikur ishte me pupla.”

Dokumentet diplomatike italiane sqarojnë se Zogu kishte tentuar disa herë të merrte emrin Skënderbegu III, por Roma, nuk kishte arritur të gjente gjuhën me trashëgimtarët e familjes Kastrioti që paraqitën pretendimet e tyre mbi fronin. Madje e bënë këtë në shtypin e shumë vendeve të Europës. Ashtu si Princ Vidi që nga Nica e Francës, u kujtoi se nuk kishte abdikuar nga largimi i 1914 dhe ende mbetej Mbret i Shqipërisë.

Në përgjithësi reagimi ndërkombëtar ishte i zbehtë dhe indiferent. Jason Tomes e rrëfen atë përmes pranisë së ambasadorëve në ceremoninë e kurorëzimit:

“Krerët e misionëve të huaja ishin gjithashtu të pranishëm, edhe pse përpiqeshin të mos binin në sy. Rasti ngrinte pyetje të vështira protokolli, ndaj duke reflektuar verdiktet pezull të qeverive të tyre, diplomatët kishin zgjedhur veshje mëngjesi, pa dekorime.

Pak më vonë mbërritën tetë makina të mbushura me zyrtarë italianë të veshur me uniformat ngjyrë vjollcë dhe floriri. Verdikti i qeverisë së tyre s’ishte vënë ndonjëherë në dyshim. Ministri jugosllav, dr Mikhajloviç nuk dukej gjekundi, ndaj kjo s’linte shumë dyshime për qëndrimin e qeverisë së tij.”

Jugosllavët ishin padyshim më agresivët kundër. Kontestimi i tyre lidhej sa me raportet e intensifikuara shqiptaro - italiane aq edhe me faktin që Zogu e kishte quajtur veten Mbret i Shqiptarëve dhe jo i Shqipërisë. Ky titull i jepte atij të paktën në mënyrë figurative të drejtën mbi shqiptarët e Kosovës. Jugosllavia e njohu Mbretërinë më 18 Shtator. E para e kishte njohur Italia, ndërsa të fundit vendet e Amerikës Latine, më 10 Dhjetor 1928. E vetmja që nuk e njohu ishte Turqia. Mustafa Qemali, që u përball në një hotel të Ankarasë me ambasadorin shqiptar iu drejtua me fjalët:

“Asaf Bej, shoh shumë piktura qesharake nëpër gazeta. Çfarë po ndodh në Shqipëri? Po vini në skenë ndonjë operetë?”

I referohej uniformës mbretërore të Zogut që kishte ardhur nga Italia. Ajo ishte qepur në Romë sipas një modeli të ngjashëm me atë që kishte pasur Perandori Karl i Austro – Hungarisë më 1917, në ceremoninë ku kishte marrë pjesë edhe Mbreti Zog.

Mustafa Qemali nuk i riparoi kurrë marrëdhëniet me Zogun. Edhe pse ata të dy kishin shumë të përbashkëta siç argumenton Tomes:

“Kemali kishte shumë të përbashkëta me Zogun. Ai ishte pjesërisht me origjinë shqiptare, ishte arsimuar në Manastir dhe Stamboll. Heroi i tij ishte Napoleoni. Ai vizitoi Vjenën në vitin 1917. Ai kishte udhëhequr rezistencën ndaj ndarjes së vendit të tij dhe kishte marrë pozicionin e një diktatori të përkushtuar ndaj modernizimit.”

Mbrëmjen e 1 Shtatorit dhe 6 ditët në vijim në Shqipëri u organizuan veprimtari festive. Shumë prej tyre ngjajnë qesharake. Ato tentonin, pa ia arritur, të krijonin sfondin e një dinastie dhe monarkie të vërtetë. Çdo dyqan dhe kafe u urdhërua të varë në mur foton e Zogut me uniformën mbretërore, nëse nuk bënte këtë merrte një gjobë prej 50 frangash.

Legjisllacioni që Parlamenti aprovoi atë ditë, jo vetëm shpallte atë mbret me titullin “Zog I, Mbret i Shqiptarëve”, por përcaktonte si familjen mbretërore, familjen Zogolli. Dinastia ishte e trashëgueshme në linjën mashkullore, e ngjashme me atë spanjolle.

Shpallja e Mbretërisë sillte automatikisht edhe ngritjen e familjes mbretërore. Brenda mbasdites, nëna e Zogut, Sadije Toptani u quajt Nëna Mbretëreshë, ndërsa gjashtë motrat, Princesha. 2 prej tyre ishin të martuara ndërsa 4 të tjerat, sipas rregullave të monarkisë, duhej që pas kësaj të martoheshin me djem nga familjet mbretërore. Mbreti Zog kishte 6 motra: Princeshën Adile, Princeshën Nafije, Princeshën Sanije (Që më pas u martua me Princin Abid, djali i Sulltan Abdyl Hamitit II), Princeshën Myzejen, Princeshën Ruhije dhe Princeshën Maxhide Zogu.

Fëmijët e 2 motrave të martuara morën titujt Princ. Djali i Ceno bej Kryeziut, Esati u quajt Princi Esat. Xhelal Zogu, gjysmë vëllai që jetonte në Tiranë nuk ra në sy të publikut. Komportimi i tij ishte tejet modest.

Jeta e familjes ndryshoi rrënjësisht pas shpalljes së Ahmet Zogut Mbret. E vetmja që ruajti traditat e saj ishte nëna, Sadija, personi padyshim më influent në familje. Sadije Zogu kishte lindur në Tiranë më 1876. Ishte e bija e Emin bej Toptanit. Shtypi dhe botimet kanë shkruar shumë herë se ishte motra e Esat Pashë Toptanit dhe se Zogu e kishte këtë të fundit dajë. Informacioni nuk është i vërtetë. Sipas librit gjenealogjik të familjes Toptani, lidhja e tyre është fakti se stërgjyshi i Sadijes, Sali Beu, ishte vëlla me gjyshin e Esat Pashës, Ali Beun.

Pietro Kuarone është dëshmitari që ka bërë përshkrimin më interesant dhe realist të familjes mbretërore në ditët e para të transformimit të Shqipërisë në Monarki. Edhe ai nënvizon faktin që personi më interesant në familje mbetej nëna e Zogut:

“Familja qeverisej nga Nëna Mbretëreshë, një zonjë grua me të cilën nuk mund të bëje shaka. Tupvogël, pak si shulake, e gjallë, inteligjente, autoritare, por, sa keq, ajo nuk fliste veçse shqipen dhe çdo bisedë me të kërkonte një përkthyes, gjë që i pengonte takimet direkte. Përgjigjet e saj ishin, megjithatë, përherë të shpejta e të sakta.

Kur Grandi (ministri i Jashtëm Italian) shkoi në Shqipëri për një vizitë zyrtare programi parashikonte edhe një vizitë Nënës Mbretëreshë. Ajo i mbajti atij një fjalim fort kompetent, sa të thoje se ia kishte përgatitur që më parë ndonjë këshilltar. Mirëpo më pas, duke vënë në dukje një pasazh nga përgjigjja e Grandit, ajo u lëshua në një tiradë të dytë, kryevepër e vërtetë, pa asnjë fjalë të tepërt ose të mangët.”

Nëna kishte një ndikim të padiskutueshëm tek Zogu. Ai ishte i lidhur me të si me askënd tjetër. Ishte ndoshta personi i vetëm në botë që i besonte, siç dëshmon Kuaroni:

“Ajo e adhuronte të birin, me të cilin ishte e lidhur, besoj, si asnjë tjetër në botë.

Në të gjitha rrethanat, vetëm në shtëpinë e saj, nën sytë e saj, i përgatitnin ushqimet e Mbretit. Pallati i saj ishte i ndarë nga pallati mbretëror nga një kopsht i vogël publik, kohë më kohë mund të

shihje të dilte që andej një shërbëtor me livre, me doreza të bardha dhe të shoqëruar nga dy ushtarë të gardës bajonetëmbërthyer, që mbante denjësisht, mbyllur me një napë të bardhë të thjeshtë drekën e sovranit.”

Humbja e së ëmës ishte traumatike për Mbretin Zog. Ata që i kanë qëndruar pranë ato ditë, kujtojnë se është ndër të paktat raste në jetë që humbi kthjelltësinë. Sadije Toptani Zogu vdiq papritur nga një krizë zemre në Durrës, më 26 Nëntor 1934 në moshën 58 vjeçare. Doktorët që u lajmëruan për ta shpëtuar mezi u larguan nën zemërimin e Mbretit. Varrimi ishte zyrtar. U varros në një parcelë prej 6 mijë metrash katrorë, të blerë për këtë qëllim, në anë të rrugës së Elbasanit, në atë që quhej Kodra e Gështenjës. Më 30 Dhjetor 1935, Mbreti Zog ndërtoi mbi varrin e saj një mouzaleum të projektuar nga arkitekti më i njohur shqiptar i kohës, Qemal Butka. Mouzaleumi do të shërbente si varrezë e familjes mbretërore. Në derën e tij qëndronin gjithnjë dy roje të armatosura dhe vizitorët e huaj orientoheshin nga protokollit për të bërë aty nderime.

Më 17 Nëntor 1944, ditën që forcat partizane morën në zotërim qytetin e Tiranës, një skuadër e Brigadës së Parë Sulmuese, me urdhër të Komandantit Mehmet Shehut, e hodhi në erë me dinamit mouzaleumin. Varrin nuk u prek, por u rrafshua. Ashtu siç kishte ndodhur me gjithë varret e paraardhësve të Mbretit Zog në Burgajet.

Në nëntor 2012, më rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë, Mouzaleumi u rindërtua sipas projekteve të Butkës. Që prej 17 nëntorit të atij viti aty prehen edhe eshtrat e Mbretit Zog të kthyer nga Franca dhe ato të Mbretëreshës Geraldinë.

Motrat e Zogut ishin pjesa e dytë e rëndësishme e oborrit. 2 prej motrave ishin martuar më herët ndërsa e treta gjatë kohës që ai ishte në pushtet. Ato qenë vajza të reja, të ndrojtura, që befasi, një ditë duhej të luanin një rol publik për të cilin as ishin të përgatitura dhe as e kishin menduar ndonjëherë. Nuk dihet se sa seriozisht e kishin marrë ato rolin e Princeshave dhe nuk dihet se sa realisht besonin se në jetën e tyre do të mbërrinte martesë me një Princ. Me gjasë ky qe shkaku që 3 prej tyre mbetën gjithnjë të pamartuara. Por dihet se jeta përtej shkëlqimit të dukjes duhet të ketë qenë e trishtë. Ajo u

kish ofruar një rol që s' duket se donin ta luanin dhe do të ndiheshin më mirë nëse do kishin vazhduar në po atë rrugë që ishin përgatitur në fëmijëri, atë të një gruaje tipike shqiptare nga një familje e madhe që martohej dhe më pas ngrinte familjen e saj. Pietro Kuarone ka lënë edhe për to një dëshmi interesante:

“Në 1928 dhe gjatë viteve të qëndrimit tim në Shqipëri, fati i të pesë motrave të Zogut nuk ishte aspak për t'u pasur zili. Nuk mund të thuhet me ndërgjegje të pastër, se ato ishin veçanërisht të bukura, por do të kishin qenë të tilla po të kishin mbetur motra të beut të Matit, ato do të kishin patur një jetë pak a shumë të qetë, por tradicionale, gra shqiptare. Ngjitja e familjes e përjashtonte për tri motrat më të vogla mundësinë normale për një martesë shqiptare”.

Më pas ai rrëfen se sipas informacioneve që kishin në ambasadë, jeta e tyre ishte veçanërisht monotone:

“Pak ushtrime me kuaj, mjeshtri i tyre ishte një oficer italian, kapiten Fragi, organizator i gardës kalorse. Një spektakël i vërtetë, Fragi në krye, në largësi të respektueshme, prapa, varg njëra pas tjetrës, princeshat, një simfoni e gjelbër. Çizme me lëkurë të gjelbër shumë të errët, kostume prej një stofi të gjelbër paksa më të çelët, kaska koloniale pajisur me vel të hollë të gjelbër, në shijen më të mirë të shekullit XIX.

Pak automobilizëm. Një italian, liberti, administronte një koncesion të vogël bujqësor në rrugën midis Durrësit dhe Tiranës. Si një gjenovez i mirë, ai kishte gjetur një mjet të shkëlqyer për të shtuar të ardhurat e ndërmarrjes së vet, të administruar shumë mirë. Një nga traktorët e tij rrinte pandërprerje në afërsi të një farë kthese më shumë se të ngushtë për të ndërhyrë çdo herë kur njëra nga princeshat e hidhte veturën e saj në hendek, kurse ato e shpërblenin bujarisht me monedha ari.

Në raste të rralla, ato dilnin gjatë ceremonive zyrtare me kostume kombëtare shqiptare që u rrinin për mrekulli. Por vëllai i tyre i inkurajonte shumë pak këto dukuri. Atij i pëlqente të përsëriste që Mali i Zi qe shkatërruar nga Vejusha Gazmore.”

Në fakt Zogu kishte qenë dorëlëshuar me motrat. Pas ardhjes në krye të shtetit ai u kishte caktuar një rol publik që ishte emancipues për kohën. Motrat dilnin të pambuluara, kalëronin hipur mbi kuaj dhe visheshin sipas modës së fundit perëndimore. Gazeta britanike "Daily Mail" i takoi në Londër gjatë rrugës së kthimit nga Nju-Jorku dhe u kushtoi një reportazh të publikuar më 31 mars 1938. Artikulli i titulluar: "Pizhama dhe make-up në Shqipëri" është shkruajtur nga autori Ralph Heuins:

"Ne besojmë në të qenurit vajza moderne dhe po bëjmë më të mirën për të modernizuar Shqipërinë. Kështu m'u shprehën mua tre motrat shik e brune të Mbretit Zog, Princesha Myzejen 28 vjeç, Princesha Maxhide 26 dhe Princesha Ruhije 24, kur ato më pritën në Suitën e Lui-t të 16 në hotelin "Ritz" natën e kaluar. Ishte pritja e parë private që ato bënë që kur lanë Shqipërinë muajin e kaluar për në SHBA e më pas për këtu në Britani.

Princesha Myzejen kishte veshur një fustan "Oxford blue Georggete", me një lidhëse të hollë të bardhë rreth qafës të kapur me një yll prej diamanti.

Princesha Ruhije kishte veshur një kostum të zi i dizenuar për të qënë i ngushtë në bel e duke nxjerrë në pah shpatullat elegante.

Princesha Maxhide kishte veshur kostum të zi, por me një stoli të artë bizantine pranë shpatullave të saj.

Të treja kishin veshur këpucë me taka të zeza të larta 2 inch me harqe me një numër jo më të madh se 3. Të treja ishin mrekullisht elegante dhe me thonjtë e këmbëve të lyera."

Princeshat ranë veçanërisht në sy në momentin kur u inaguruan banjat mbretërore në plazhin e Durrësit në vitin 1936 dhe në vitin 1938 kur Zogu dekretoi ligjin për heqjen e ferexheve. Motrat e Zogut u shfaqën disa herë me kostume plazhi dhe ky lajm tronditi Shqipërinë e kohës. Ato vetë i kishin deklaruar shtypit britanik po atë vit:

"Pavarësisht se vendi ynë është gjysmë oriental, ne nuk kemi asnjë ndrojtje të prezantojmë risi të tilla si: të shkojmë rregullisht në kinema, të veshim kostume të zbuluara banjoje apo pizhame plazhi, të bëjmë make-up dhe të mos vendosim vello".

Ndërsa Zogu nuk largohej thujse kurrë nga Shqipëria, motrat ishin gjithnjë në lëvizje. Ato vizitonin shpesh Parisin, ku siç kujton gazetari Xoi Xoxa, vendoseshin në hotel "Vendome". Organizonin takime në dyqanet e luksit si atelienë e Chanel ku priteshin në vizita të rezervuara. Xoxa kujton se jeta e tyre e ekzagjeruar kritikohet edhe nga burri i Princeshës Sanije, Princi Abid. Gjatë një vizite në Paris, ai i kërkoi Xoxës;

"Princ Abidi më tha se do të bëja një punë shumë të mirë sikur t'i këshilloja Princeshat të ishin më modeste në veshje dhe në sjellje. Ne jemi në një shekull demokracie, ku pozat "aristokratike" nuk shkojnë aspak dhe këtu, në Paris sidomos, bëhesh lehtë qesharak".

Jeta e dhënë pas luksit i ra në sy edhe gruas së Mbretit, Geraldinës. Në kujtimet e saj ajo kujton se motrat e Mbretit ndiheshin mirë, vetëm në Paris.

"Mendohej që princeshat ndiheshin të lumtura vetëm kur ktheheshin në Paris për periudha kohore prej pak muajsh gjatë nxehtësisë së verës. Qendra e botës për ato ishte sheshi "Vandom" dhe rruga "Fauborg St. Honoré", ku kënaqeshin me blerje."

Fakti që ishin të reja dhe të pamartuara i bënte ato interesante jo vetëm për shtypin, por edhe për diplomatët. Gjatë vizitës së tyre në SHBA, ambasadori britanik në Uashington i dërgon këtë letër Ministrisë së Jashtme më 30 Mars 1938:

"Kam nderin t'ju informoj se Princeshat Ruhije, Maxhide dhe Myzejen, motrat e Mbretit Zog, arritën në Nju-York nga Europa në datën 28 shkurt dhe u larguan për në shtëpi në Shqipëri në datën 23 mars. Princeshat u dukën të turpshme nga publiciteti dhe shtypi amerikan shkroi se ato vizituan Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të gjetur burra të pasur, një sygjërim që u hodh poshtë menjëherë nga ambasadori i Shqipërisë në SHBA Faik Konica. Në kryeqytet sigurisht doli fjala se princeshat morën një telegram ku u ofrohej një kontratë për të bërë film nga një prej kompanive më të mëdha të Hollivudit. Gjithsesi, në aspektin tjetër vizita kaloi normalisht."

Vizita e Princeshave në SHBA ishte vizita e parë e nivelit të lartë mes dy vendeve. Ato shoqëroheshin nga Abdurrahman Krosi, njeriu që kishte shoqëruar Zogun gjatë shkollimit në Stamboll dhe në Vjenë, një besnik i familjes që ishte njëherazi njeriu që vendoste për to. Princeshat kishin mbërritur në Nju-Jork me anijen italiane Savoja të pritura nga një turmë entuziazte që shtyhej në port. Askush nuk di të thotë nëse pritësit e tyre e dinin realisht se ku binte Shqipëria, por mbërritja e Princeshave të reja nga një familje mbretërore intrigonte Amerikën. Vizita kishte edhe aspektin e saj zyrtar, siç raporton sërish ambasadori britanik:

“Nju -Jorku ishte qendra e vendosjes së Princeshave të cilat të shoqëruara nga kolegë shqiptarë erdhën në Uashington në datën 5 mars dhe u takuan me zonjën Rusvelt për një çaj në Shtëpinë e Bardhë. Mora vesh që ato zhvilluan një vizitë të shkurtër në Boston, ku u pritën nga kolegu im shqiptar ambasador, dhe patën një takim me peshkopin Fan Noli. Ato vizituan dy kishat shqiptare ku thanë lutje për Mbretin Zog dhe popullin shqiptar.”

Ato u kthyen mbrapsh thujse një muaj më pas, më anijen “Queen Meri” dhe ndaluan në Londër.

Tentativat për t’i martuar Princeshat me pjesëtarë të familjeve Mbretërore Europiane dështuan. Princesha Sanije ishte e vetmja që arriti të martohet me Princin Abid, njëri prej djemve të Sulltan Hamitit që jetonte në ekzil. Dasma e tyre madhështore është regjistruar në arkivat filmike britanike dhe ato të Institutit Luce. Princi mori pasaportë shqiptare dhe u emërua ambasador i Shqipërisë në Paris.

Sipas rrëfimeve, Sanija ishte më e afërta me Mbretin. Ajo i ndikonte shpesh në vendimmarrjen. Një dokument sekret i CIA-s i datës 30 Shtator 1949, duke iu referuar opinionit të një avokati amerikan 38- vjeçar që përfaqësonte Mbretin Zog në Amerikë shkruan:

“Motra e Zogut, Zenida (Senija), është një grua idiote e cila ka një ndikim të tmerrshëm mbi të vëllanë. Zogu dhe Zenida kanë një lidhje incesti aktualisht, lidhje për të cilën Geraldina nga ana e saj ka dijeni.”

Zyra nuk e vërteton dot saktësinë e informacionit, por as e merr atë për të mirëqënë.

Vështirë ta besosh këtë informacion, aq më tepër që sajime të ngjashme kanë qarkulluar për gjithë familjet Mbretërore të Europës. Por lidhja e motrave me Zogun ishte shumë e fortë dhe pas martesës së tij, motrat asnjëherë nuk e kuptuan vendin real të tyre.

“Princeshat nuk shfaqnin asnjë shenjë stresi. Për aq kohë sa ishin pranë të vëllait, burimit të jetës së tyre, dhe për sa kohë që kishin njëra-tjetrën për të fjalosur, bota e jashtme nuk i tërhiqte fare. Ato ishin gra haremi, në të gjitha kuptimet e fjalës”

Kështu shkruan Guen Robins, biografia e Geraldinës. Geraldina vetë në kujtimet shfaq shpesh pakënaqësinë për Princeshat, kunatat e saj dhe sjelljen e tyre.

Pas largimit nga Shqipëria ato jetuan të pandara me të vëllain gjatë gjithë rrugëtimit të tij. Tre vdiqën përpara Mbretit Zog, ndërsa 3 të tjerat vdiqën njëra pas tjetrës, brenda pak kohe në Kanë të Francës. Ishte një vdekje nga trishtimi siç rrëfen Leka Zogu.

Një tjetër personazh enigmatik dhe misterioz ishte pjesë e oborrit Mbretëror. Sipas protokollit, atij nuk i takonte asnjë titull zyrtar, por ai ishte pjesë e oborrit po aq sa njerëzit e gjakut të Mbretit Zog. Kuarone e kujton kështu këtë personazh:

“Personazhi më piktoresk i familjes ishte një burrë mjaft i çuditshëm, me emrin Abdurrahman Mati, për shkak të vendlindjes së tij, kurse përgjithësisht Krosi, domethënë i zgjebosuri.

Titulli i tij zyrtar, kumbar i mbretit. Përsa i përket asaj se çdo të thotë kjo, këtë akoma nuk e di. Ishte fjala, dukej për një lloj idendenti të shtëpisë Zogolli, që gjatë periudhës të vështirë të vejnisë kishte ndihmuar besnikërisht Nënë Mbretëreshë në administrimin e pasurisë së fisit.”

Abdurrahman Krosi ose Lal Krosi siç njihej në publik, nuk ishte ndarë kurrë nga Mbreti. E kishte shoqëruar në Stamboll, e kishte parë të rritej dhe i kishte shërbyer. Kishte qenë pas tij në Vlorë, në betejat e viteve 1912 – 1920 dhe në Vjenë. Duket se besnikëria ndaj

mbretit ishte e padiskutueshme dhe më shumë ngjante me adhurin. Siç dëshmon sërish Kuarone:

“Ai tregonte ndaj mbretit një besnikëri jashtë çdo prove, asnjë dyshim për këtë. Mjaftonte ta shihje si sillej për qark tij, sikur do ta “pinte me sy”, të mbushur tej e tej njëherësh me dashuri dhe admirim, ai kishte gjestet prekëse të një qeni të vjetër të rënë në dashuri. Gjatë ceremonive zyrtare, duke treguar përbuzjen më të madhe ndaj rregullave të etiketës, ai manovronte në mënyrë të padiskutueshme, që të shfaqej gjithnjë pranë Mbretit.”

Abdurrahman Krosi ishte deputet i Parlamentit të Shqipërisë dhe kishte qenë i tillë që në vitin 1921. Ai ia kishte dalë të fitonte padyshim me ndihmën e Zogut, por pushteti i tij okult ishte shumë më i madh dhe më fitimprurës se sa ai që i njihej zyrtarisht. Fuqia e tij rritej paralel me fuqinë e Mbretit ose disa herë më shumë. Sa më tepër Zogu distancohej nga njerëzit që e rrethonin aq më shumë vendin ia zinte Lal Krosi. Në dokumentet e AQSH-së rezulton se kishte grumbulluar një pasuri përrallore dhe e gjitha në mënyrë abuzive. Ai zotëronte mijëra e mijëra hektarë tokë dhe pyje në gjithë Shqipërinë, kryesisht në bregdet. Lal Krosi nuk ndërtoi kurrë një shtëpi të tijën dhe banoi gjithnjë në pallat. Catin Saraçi deklaroi se ai ishte njeriu që shoqëronte paratë e paligjshme të Mbretit nga Shqipëria për në bankat e Zvicrës. Mbreti i besonte atij dhe vetëm atij. Siç ndodh rëndom në këto raste ai ishte ndër njerëzit më të urryer në Shqipëri. Për shumë vjet, personifikonte arrogancën dhe abuzuesin. Fjalët: “je bërë si Lal Krosi”, dëgjohen ende në Shqipëri për të denoncuar abuzimin me pushtetin, ndërsa dy vargje anonime, kanë hyrë në folklor:

“Lal Kros, lal Kros, vetë shkruaj e vetë vulos!”

Mëria ndaj tij u bë e fortë në fund të mbretërisë, kur së bashku me ministrin e Brendshëm Musa Juka i visheshin shumica e punëve jo ligjore që kryheshin në Shqipëri. Identifikimi si një person problematik me ligjin kishte nisur më herët, siç dëshmon Kuarone në vitin 1928:

“Ka mundësi që pasuria që ai kishte grumbulluar të ishte shumë më e paktë në krahasim me çfarë i atribuonte thashethemnjaja publike, por është fakt që atë e urrenin, të rinjtë sidomos, në veçanti ata që ishin edukuar në Evropë dhe që ëndërronin si patriotë të mirë për një Shqipëri të organizuar pak më mirë, më të ndryshme. Të ndërgjegjshëm për këtë trafik influencash politike dhe ekonomike, ata e konsideronin Krosin si një lloj Rasputini të Shqipërisë.”

Abdurrahman Krosi nuk iu nda Zogut edhe në rrugëtimin e largimit nga Shqipëria. E shoqëroi deri në Stamboll, por jo më tej. Ndërroi jetë në vitin 1943 në shtëpinë e gjysmë vëllait të Zogut, Xhelalit, në qytetin ku kishte jetuar me Ahmet Zogun në vitet e shkollimit të tij.

Imponimi i idesë së një dinastie mbretërore shqiptare ngjante shpesh artificial dhe komik. Historianët dhe shtypi vërtetuan, sipas tyre, se Mbreti Zog rridhte nga familja e Skënderbeut, ndërsa disa të tjerë, e lidhnin atë me familjen e profetit Muhamed. Raportimet e shtypit pro mbretit janë qesharake dhe ngjanë me ato të shtypit komunist për udhëheqësit e mëvonshëm të Shqipërisë. P.sh. në revistën “Diana” vizita e Princeshave në Jug të Shqipërisë portretizohet me titullin:

Shqipëria e Jugut, lule dhe valle për motrat e Mbretit Zog.

Dhe në titullin:

Vizita historike e Princeshave Mbretnore në Jugë (Kudo pritjet madhështore harrijnë kulmin).

Teksti ngjan po kaq ireal:

“Naltësitë e Tyre, Princeshat Mbretnore, Myzejen, Ruhije, dhe Maxhide, të shoqëruara nga Ministri i P. të Brendshme, Shk. e Tij Musa Juka dhe nga Suita e Tyne, u nisën për një tour të Shqipërisë së Jugut. NN. TT do të përshkojnë Qarkun e Elbasanit, të Korçës, të Gjinokastrës, të Vlorës dhe të Beratit.

Populli i madh e i vogël pret me lule, brohoritje dhe duartrokitje NN. TT. Princeshat Mbretnore”.

Në një tjetër reportazh që pasqyron vizitën e Princeshave në Elbasan shkruhet:

“I grumbulluar i madh dhe i vogël, përpara Postës së Bishqemit populli, burra e gra, qytetarë të katundeve të stolisur me kostumet e bukura të vendit, nxanës dhe nxanëse të reshtuara me flamure, afër një harku triumfi të madh ku figuronte e zbukuruar me lule fytyra e N. M. T. Mbretit, pret Personat Auguste të Familjes Mbretërore. NN. TT. afër Tri Urave, zbresin nga automobilët dhe ecin në këmbë në mes të brohoritjeve të pa-reshtura të popullit, deri në Grand-Hotel ku presin homazhet e të gjithë klasave të popullit. Në fjalimin që mbahet nga NN. TT. midis të tjerave thohet: “Vllahu i Jonë August, sado që nuk ndodhet në mes t’onë në këtë çast, por Zemra e Tij asht midis jush dhe i shikon nevojat t’ueja.

NN. TT. të mallëngjyera prej ksaj pritje madhështore të vetvetishme e plot me ndjenja fisnike e adhurimit të qytetit të Elbasanit, mbasi lenë 1000 franga ari për të vobektit e qytetit, u hypin automobilave dhe marrin rrugën për Pogradec, duke u duartrokitur dhe duke brohoritë populli gjatë rrugës.”

Po kaq komike ngjan pritja dhe fjalimet në raste të tjera, si në Korçë, ku kryetari i Bashkisë Agathokli Gjitomi, një deputet i vjetër i Parlamentit dhe figurë e rëndësishme e viteve 1920 – 1924 u drejtohet Princeshave me një vlerësim për Mbretin në prani të mijëra vetëve të mbledhur në shesh:

“Si të mos gëzohet Populli Shqiptar, kur e vizitoni Ju Naltësi!? Ky popull sheh te Ju, idolin e bashkimit Kombëtar, të njësisë Kombëtare, të fuqisë Kombëtare.”Jini motrat e atij që bëri Fiset Komb dhe Kombin, Shtet“.

“Në fytyrat e të gjithëve përshkruhet admirimi për N. M. e Tij Mbretin Zog I dhe për Familjen Mbretnore NN. TT. I afruan një darkë Rinisë Korçare”, – vijon më tej gazeta “Besa” që raporton këtë event.

Pas shpalljes Mbret, fotoja e Zogut bëhet më e pranishme në faqet e para të gazetave. Protokolli imponon rregulla strikte me anë të të cilave qeverisja e vendit bëhet gjithnjë e më e vështirë. Me Zogun fillon të ndodhë ajo që ndodh me të gjithë ata që rrinë gjatë në pushtet, humbja e sensit të realitetit. Sjellja e tij në vitet 1931 – 1939 është shumë larg asaj të Ahmet Zogut në vitet 1912 – 1931.

Pas martesës me Geraldina Nagy Appony, familja mbretërore u shtua me Mbretëreshën Geraldinë, ndërsa në vitin 1939 lindi Princi Leka, trashëgimtari i Fronit. Leka qëndroi në Shqipëri vetëm 36 orë dhe u rikthye sërish 55 vjet më pas, në vitin 1994, për të qëndruar edhe më pak kohë, vetëm 24 orë. Ai u lejua zyrtarisht të kthehet në Shqipëri në vitin 1997 kur udhëhoqi një fushatë të referendumit për formën e regjimit, referendum që u rrëzua, por duke marrë një numër rekord votash, afro 40 %.

Leka u betua mbret pas vdekjes së Mbretit Zog, në Prill 1961 në hotel «Krijon» në Paris. Në vitin 1975 u martua me një qytetare australiane që u bë Mbretëresha Suzanë. Më 1981, lindi Princi Trashëgimtar Leka.

Për 63 vjet, gjatë ekzilit, oborri Mbretëror dhe familja mbretërore shqiptare u vërtitën në shumë vende të botës. Ata jetuan në Turqi, Francë, Angli, Egjipt, Spanjë, Rhodezi, Afrikë të Jugut. Më 2002, Parlamenti mori vendimin për kthimin e tyre në Shqipëri. Leka hoqi dorë nga pretendimi për fronin dhe angazhimi direkt në politikë. Mbretëresha Geraldinë ndërroi jetë në vitin 2002, Mbretëresha Suzanë në vitin 2004, ndërsa Mbreti Leka në vitin 2011. Familja arriti të vendoset në një nga pronat e familjes, pallatin e Princeshave që ndodhet në qendër të Tiranës, ku banon edhe sot Princi Leka.

“KOHA E ZOGUT”

1925 - 1939

Rikthimi i monarkisë dhe shpallja e Zogut Mbret, ishte një hap mbrapa në aspektin afatgjatë politikë. Edhe pse për momentin u duk se siguroi një stabilitet për të cilin vendi kishte pasur nevojë pas shumë vjetëve të trazuara që nga shpallja e Pavarësisë. Prej 1912-ës, këto ishin 3 vjetët e para të një lloj qetësie dhe zhvillimi ekonomik. Në vend nisi biznesi. Për herë të parë, tregtarët filluan të nxjerrin të ardhura më të mëdha se sa klasa e bejlerëve që përfaqësonte pronarët e mëdhenj të tokave.

Në fakt, 15 vjetët e drejtimit të Ahmet Zogut kanë regjistruar një zhvillim në shumë fusha befasues.

I pari dhe kryesori ishte unifikimi përfundimtar i territorit, kontrolli i plotë mbi të dhe shtrirja e autoritetit të shtetit në çdo cep të vendit. Historia e bajraktarëve dhe bandave mori fund. Rendi publik që prej mesit të viteve '20 ishte për t'u admiruar. Zogu mblodhi pjesën më të madhe të armëve dhe i dha fund praktikës së kontestimit të qeverisë me forcë. Ai ndërtoi një xhandarmëri efikase, të stërvitur dhe të drejtuar nga oficerë anglezë që lanë gjurmë në të. Komandanti i xhandarmërisë ishte një gjeneral anglez i quajtur Xho Persi. Zogu nuk i lejoi kurrë italianët që të organizonin xhandarmërinë, duke u justifikuar tek përvoja indiane e britanikëve. Bernd Fisher, një historian amerikan që ka studiuar me vëmendje Zogun shprehet kështu:

“Mendoj se ai kontribuoi në mënyrë domethënëse në krijimin e një shteti por edhe në krijimin e koncepteve të shqiptarëve. Kur erdhi Zogu në pushtet theksoheshin më shumë lidhjet rajonale, lidhjet e klaneve, e fiseve. Kur mbërrimë në vitet 1930, pjesërisht prej politikave të tij, shumë e më shumë njerëz e shohin veten si shqiptarë dhe më pas anëtarë të një grupi të veçantë. Kjo për mendimin tim është një arritje e madhe e tij.”

E dyta ishte ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe portuale. Me ndihmat dhe kreditë që mori nga Italia ngriti një rrjet rrugor jo shumë larg atij të fqinjëve. Në vitin 1939 kur u largua nga vendi, Shqipëria kishte 2600 km rrugë makinash nga 900 km që kishte pasur në vitin 1924, edhe ato, rrugë ushtarake të ndërtuara kryesisht nga ushtritë austro-hungareze dhe italiane të pushtimit. Zogu ndërtoi mbi 90 ura në gjithë vendin. Zgjeroi dhe bëri të aftë për ankorim portet e Durrësit, Vlorës dhe më pas Shëngjinit dhe Sarandën.

Masat që u ndërmorën në vitet e para u evidentuan edhe nga shtypi i huaj. Gazeta Franceze “La Patrie” në një artikull të Pierre Chanlaine shkruante më 18 Shtator 1928:

“Ahmet Zogu u mësoi shqiptarëve të fillojnë të punojnë. Ai ndërtoi rrugën Durrës - Tiranë, Elbasan - Korçë, Tiranë - Shkodër. Në këtë të fundit është ndërtuar ura e mrekullueshme e Matit. Shoqëria franceze e “Fives Lille” ka ndërtuar dy prej këtyre veprave gati artistike në rrugën Tiranë-Durrës, me të cilat ajo ka të drejtë të krenohet. Këtyre rrugëve u shtohet edhe ajo nga Tirana në Berat, e ndërtuar së fundi, ajo nga Saranda në Bresnitza. Ahmet Zogu ka urdhëruar që nëpër këto rrugë të vendoset një shërbim i rregullt autotransporti. Por meqenëse lidhjet janë të ngadalta, pavarësisht përpjekjeve të bëra, ai ka ngritur tri linja avionësh: Tiranë, Vlorë, Korçë; Tiranë - Shkodër, Brindizi - Vlorë.”

Linjat e avionëve qenë vendosur sipas një marrëveshje me kompaninë gjermane të fluturimeve që sot njihet si Lufthansa. Ato kryenin dy fluturime në ditë nga Tirana në drejtim të 3 qyteteve shqiptare dhe 2 qyteteve italiane.

Së treti, Zogu nisi punën për të ndërtuar një kryeqytet relativisht modern. Pas shpalljes përfundimtare të Tiranës kryeqytet në vitin 1925 ai vendosi që ta transformonte atë nga një qytet tipik oriental, në një kryeqytet të vogël, por perëndimor. Arkitektët italianë, që pajtoi për këtë çështje, i sugjeruan që të mos e prekte Tiranën orientale, ta ndante atë nga Tirana e re me një bulevard të gjerë dhe qyteti i ri të shtrihej në pjesën perëndimore. Zogu pajtoi dy arkitektë të famshëm, Arbando Brasini dhe Flaustino de Fausto të cilët projektuan aksin e bulevardit të madh të Tiranës që mban emrin “Dëshmorët e Kombit”, bulevardin që sot mban emrin “Zogu I”, sheshin “Skënderbej”. Anës tyre ndërtuan godinat e Ministrive dhe Bankën e Shqipërisë. Pak përpara, po në sheshin “Skënderbej”, ishte ndërtuar godina e re e Parlamentit të Shqipërisë, e nisur që në kohën e Austro - Hungarisë.

Në fushën financiare ngriti Bankën e Shqipërisë si autoriteti më i lartë financiar në vend. Ajo ishte bankë e përbashkët me kapital shqiptar dhe italian. Krijimi i Bankës solli edhe qarkullimin e kartmonedhës. Për herë të parë në Shqipëri, njerëzit filluan të përdornin kartmonedhën në një vend që gjithë shkëmbimet i bënte me monedha ari ose argjendi. Madje çdo gjë llogaritej me vlerë ari.

Në fushën legjislativë hartoi një kod penal që përmendet ende si ndër më të mirët që Shqipëria ka pasur ndonjëherë. Ngriti një sistem gjykatash që funksiononin në të gjithë vendin. Kodi civil i aprovuar prej tij ishte tejet modern dhe hyri në fuqi në 1 Prill 1929. Ishte kodi i parë civil që njihte historia e Shqipërisë.

Zogu ndërmori disa reforma modernizuese nën shembullin e Mustafa Qemal Atatürkut, idhullit të tij. Në fillim ndaloi festen turke te burrat, më pas ndaloi përdorimin e ferexheve në publik në vitin 1938 dhe së fundmi legalizoi të drejtën e divorcit. Shqipëria ishte ndër vendet e para në botë ku gruas iu njoh e drejta e votës. Në një qarkore të vitit 1938, Ministria e Brendshme njofton gjithë prefekturat se cilido nëpunës, familjaret e të cilit do të shfaqeshin të mbuluara do të largoheshin nga puna. Ligji iu imponua administratës, por Ministria udhëzonte që heqja e ferexheve të mos kthehej në burim konflikti mes xhandarëve dhe grave të mbuluara ose familjarëve të

tyre në rrugë.

Tentativat e Ahmet Zogut për të ndarë fenë nga shteti qenë po ashtu të prera. Më 1921, dhespoti grek Jakov ishte larguar nga Shqipëria si pasojë e presionit të fortë të nacionalistëve shqiptarë. Më 1922 me shtytjen e qeverisë shqiptare, Visorian Xhuvani ishte bërë protagonist i një kongresi të mbajtur në Berat, i cili më 12 shtator 1922 kishte shpallur autoqefalinë e Kishës Shqiptare. Kishës i ndalohej të kishte në krye një klerik grek. Më 18 shtator Qeveria e kishte njohur këtë vendim dhe ministri i Brendshëm Ahmet Zogu mori masa që të shtypte disa turbullira kontestuese në Korçë dhe Gjirokastër.

Feja u nda nga shteti edhe me ligj në vitin 1934. Ai ndaloi shkollat fetare dhe ato të huaja, duke i prerë rrugën ndikimit grek dhe italian. Zogu që ishte betuar si mbret mbi bibël dhe kuran, deklaroi se dëshironte të martohej me një grua kristiane për të harmonizuar kështu bashkëjetesën fetare në Shqipëri.

Historiani Kristo Frashëri, duke iu referuar tentativave të Zogut për të krijuar një shtet të vërtetë shprehet:

“Ahmet Zogu në vija të përgjithshme e stabilizoi shtetin. Kjo nuk ka si i mohohet. Ai e mori pushtetin pavarësisht ambicies së vet, po ambicia e vet i shërbeu dhe shtetit”.

Në politikën e jashtme Ahmet Zogu ndërroi kurs menjëherë pas kthimit në Shqipëri. Ai braktisi jugosllavët, mbështetësit e parë dhe më 10 nëntor 1926 nënshkroi një traktat miqësie dhe bashkëpunimi me Italinë e Benito Musolinit, traktat që u quajt Pakti i Tiranës. Traktati i jepte Italisë prioritet të plotë në Shqipëri dhe krijoi nervozizëm të madh te jugosllavët. Ata reagueshan duke nxitur njerëzit e tyre në Shqipëri. I pari ishte Ceno bej Kryeziu, kunati i Zogut, ish-ministër i Brendshëm në vitin 1925, që tashmë ishte ambasador në Beograd. Kryeziu njihej si një njeri i jugosllavëve dhe me ndikim në malësinë e Gjakovës. Pas tensioneve me jugosllavët, Ahmet Zogu e thirri ambasadorin nga Beogradi në Tiranë. Rrugës së kthimit, ky i fundit artikuloi hapur kritika për qëndrimin e Presidentit në raport me italianët dhe me prishjen me jugosllavët. Por Zogu u informua se Beogradi po punonte me Ceno bej Kryeziun edhe konkretisht

kundër tij. Shtypi i Beogradit u bë tejet agresiv dhe vijoi ta akuzojë Zogun edhe për negociatat e vështira për çështjen e kufirit, ku ishte diskutuar çështja e Vermoshit dhe Shën Naumit.

Çështja e Vermoshit dhe Shën Naumit, caktimi i kufirit mes dy vendeve është parë nga historiografia komuniste si një tradhti e Mbretit Zog. Shqyrtimi i dokumentave e përcakton atë si një akt marrëveshjeje dypalëshe nën sugjerimet e ndërkombëtarëve për të harmonizuar më mirë vijën kufitare. Marrëveshja u firmos më 30 Korrik 1926 dhe njeriu që u mor me të ishte Mehdi Frashëri. Vermoshi dhe Shën Naumi janë përdorur më shumë si argumente të luftës politike se sa si argumente të mirëfilltë historikë.

Kritikat dhe kërcënimet Jugosllave nuk krijuan problem për të. Më 22 Nëntor 1927, një vit më pas, ai nënshkroi një pakt të ri me Italinë që njihet si marrëveshja 20-vjeçare. Marrëveshja i hapte rrugë ndikimit italian në Shqipëri, por mbështetej nga një hua prej 100 milion frangash ari që Italia ia jepte Shqipërisë për zhvillimin e infrastrukturës.

Musolini kishte kërcënuar dhe kishte bërë presioni ndaj Zogut që herët. Në vitet 1920 – 1924 marrëdhëniet e Zogut me Italianët nuk kishin qenë të mira. Përfaqësuesi italian në Tiranë, Kastoldi, e quante atë një njeri të jugosllavëve dhe antiitalian, siç dëshmon ambasada amerikane:

“Ahmet Zogolli është antipatik për zotin Kastoldi, përfaqësuesi italian në Shqipëri. Shtypi italian sulmon Zogun si armik të Italisë dhe mik të Jugosllavisë...”

Mëria e italianëve me Zogun vinte që nga Lufta e Vlorës më 1920. Por presioni italian, madje direkt i Musolinit erdhi në rritje. Përpara nënshkrimit të Paktit të Tiranës, më 30 Qershor 1926, pas refuzimeve të Zogut, ai i kishte nisur këtij një telegram që gjendet i botuar në dokumentet diplomatike italiane:

“Rruga e zgjedhur prej zotit Ahmet Zogu është më e keqja ndër gjithë të tjerat dhe në qoftë se ai do të shmangë kanosjen, ajo është e vetmja që e shpie drejt rrezikut...”

Raportet e Shqipërisë së Zogut me Italinë qenë mjaft komplekse nga viti 1926 kur u nënshkrua traktati i parë e deri më 1939, kur Italia pushtoi përfundimisht Shqipërinë. Aty nga fillimi i vitit 1931 raportet dukeshin më normale. Që nga ky vit fillojnë edhe përplasjet. Italianët piketuan njerëz që i konsideronin të tyrit dhe që ishin kundërshtarë të hapur të mbretit. Ata gëzonin mbrojtjen italiane dhe Zogu e dinte këtë. Italia kishte fituar edhe një të drejtë ndërkombëtare mbi Shqipërinë, edhe në rrafshin ekonomik. Kompania britanike, anglo - persiane që kishte marrë monopolin e kërkimit të naftës në Shqipëri dhe që kish gjetur burimin e parë në Patos në 19 Korrik 1926, ia kaloi këtë monopol kompanisë italiane AGIP.

Ministri i Jashtëm Italian Grandi u bë zyrtari i parë i huaj që vizitoi Shqipërinë që nga shpallja e Pavarësisë më 1912. Vizita e tij më 1930, erdhi plot 18 vjet pasi Shqipëria ekzistonte si shtet. Por më 1934, kur Zogu refuzoi të njihte borxhin ndaj Italisë dhe mbylli shkollat italiane, Musolini dërgoi në Durrës dhe Vlorë luftanijet për të bombarduar qytetet.

Ugo Sola, ambasadori italian që i vetmi që negocioi në kushte normale me të. Një moment ai i shpjegoi filozofinë e tij, diplomatit tjetër, Pietro Kuarone:

“Ti nuk e njeh Zogun! Në qoftë se unë do t’i kërkoja një gjë, ai nuk do ta bënte kurrë këtë. Mënyra e vetme për ta çuar aty ku duam, konsiston t’i thuash që Qeveria Italiane e luste thellësisht të mos bënte asgjë për këtë. Dhe ai bënte ekzaktësisht të kundërtën e asaj që i kërkonim ne.”

Por me kalimin e viteve Zogu nuk po i qëndronte dot më presioneve italiane. Ata filluan të kontrollonin më shumë shtetin, duke e çuar më pas në ngjarjet e prillit 1939. Zogu ka përgjegjësinë e tij në raportet me italianët, por duket se vendimet, kanë qenë thujse të detyruara. Një prej kundërshtarëve të atyre viteve, një militant i grupit komunist të të rinjve dhe më pas historian, Kristo Frashëri e shpjegon kështu këtë marrëdhënie:

“Ende sot ka njerëz që thonë se Zogu e shiti Shqipërinë tek Italia. Nuk e shiti Zogu Shqipërinë tek Italia, e shiti situata. Shqipëria ishte

planifikuar që të futej nën Italinë. Që në vitin 1922 është një marrëveshje me akt ndërkombëtar ku lihet të kuptohet se Shqipëria do të hynte nën shtetullën e Italisë. Zogu u fut nën zgjedhën e Italisë, por u fut në mënyrë totale, nuk diti të mbante një farë distance. Njëherë mbajti një farë distance, por u thye shpejt nga Fuqitë e Mëdha. E dyta, Zogu qëlloi në një periudhë shumë kritike, në krizën botërore të vitit 1929. Zogu u detyrua t’i shtrinte dorën Italisë. U kërkoi të tjerëve kredi, nuk i jepnin”.

Në rrafshin arsimor Zogu ndërtoi institucione të rëndësishme të shkollës së mesme, duke thirrur në ndihmë dhe profesorë të huaj. Veç Normales së njohur të Elbasanit, në atë kohë në Shqipëri funksiononte Liceu Francez i Korçës, një shkollë e nivelit më të mirë të mesëm në botë, një lice klasik, Gjimnazi i Tiranës, Gjimnazi i Shkodrës, Shkolla Tregtare e Vlorës dhe Gjimnazi Jezuit i Shkodrës. Bashkë me to, Shkolla Teknike Amerikane në Tiranë dhe ajo Bujqësore në Golem të Kavajës, plotësonin arsimin profesional. Zogu jepte një numër të konsiderueshëm bursash studimi për në universitetet e Europës dhe të SHBA-ve duke u bërë promotor i krijimit të një klase intelektuale në vend. Që nga viti 1926, 150 bursa studimi jepeshin çdo vit për nxënësit më të mirë të shkollave të mesme për të studiuar në Francë, Austri, Itali, Britani, SHBA, por edhe në Suedi dhe në Gjermani. 150 persona të tjerë dërgoheshin në shkollat ushtarake, kryesisht në ato italiane.

Krijimi i një klase të re intelektualësh properëndimorë, e futi vendin në një përplasje edhe mediatike mes këtyre që ishin shkolluar në Europë dhe njihnin stilin dhe funksionin e saj dhe zyrtarëve të vjetër osmanë që e kishin nisur karrierën në Stamboll dhe që ende dominonin jetën publike në vend. Zogu mbante herë anën e njërit dhe herë të tjetrit, duke zgjedhur gjithnjë në fund brezin e vjetër. Më 1936 ai i dha të drejtën Mehdi Frashërit, një personazh mjaft i njohur dhe ish-gubernator i Jeruzalemit, të krijonte një qeveri që mbante emrin “Qeveria e të rinjve” ose “Dojç qeveria”. Kjo sepse anëtarët e saj qenë shkolluar kryesisht në Austri dhe Gjermani. Qeveria ngjalli ca kohë entuziazëm dhe sidomos ministri i Brendshëm fare i ri, Ethem Toto, por ajo nuk rezistoi më shumë se një vit. Zogu e shkarkoi.

Një vit më pas, më 1937, ish- ministri i Brendshëm tentoi të organizojë një kryengritje, por forcat e tij u shpartalluan. Ai u vra bashkë me 3 vëllezërit. I katërti që shpëtoi, Selahudin Toto, doli partizan, u bë deputet dhe u pushkatua nga Enver Hoxha me grupin e deputetëve më 1947.

Ajo që mund të shënohet është politika tejet liberale që Zogu ndoqi ndaj hebrenjve në një Europë përndjekëse ndaj tyre. Ai pajisi me pasaporta dhe nënshtetësi shqiptare shumë hebrenj austriakë që iknin nga përndjekja. Disa prej tyre qenë mjekë të njohur dhe dhanë kontribut në zhvillimin e mjekësisë. Sipas të dhënave që nuk vërtetohen dot ende, ai pajisi me pasaportë edhe Albert Ajnshtajnin, fizikantin e njohur gjerman që erdhi vetë në Tiranë në atë kohë.

Ndërkohë, Zogu njohu të drejtën e lëvizjes së lirë të qytetarëve. Qytetarët pajiseshin me pasaporta dhe largoheshin jashtë vendit sipas dëshirës. Një marrëveshje me shumë vende europiane, u lejonte atyre lëvizjen e lirë në Itali, Austri, Francë dhe shumë vende të tjera.

Në fund të viteve '30, pavarësisht zhvillimit, vendi kishte shumë probleme dhe Zogu nuk mundi t'i zgjidhte ato. Moszgjidhja e tyre, largimi nga realiteti dhe mbi të gjitha koha e gjatë në pushtet sollën një lloj pakënaqësie që u vu re sidomos tek të rinjtë. Pothuajse të gjithë nxënësit e shkollave të mesme përqaftuan ideologjinë marksiste duke besuar tek një botë më e mirë dhe e barabartë. Grupet komuniste ishin aktivë në vend.

Vitet e fundit, Zogu filloi të shihej si një problem për brezin e ri. Faik Konica, ambasadori i tij në Uashington e portretizon kështu fundin e Zogut në një shkrim të vitit 1940:

“Asnjëherë Zogu nuk kishte qenë një sundimtar i lehtë për t'u duruar, por në vitet e fundit ishte bërë i padurueshëm. I pajisur nga natyra me disa veti të shënuara, në fillim pati aftësinë t'i maskonte të metat e veta të shumta, derisa sukseset e njëpasnjëshme e bënë të humbiste vetëpërmbajtjen dhe atëherë doli në shesh si një barbar endacak dhe i pabesë.”

Më i sigurt se kurrë për pushtetin, nisi të shihej gjithnjë e më shumë interesat e veta. Këto interesa provokuan edhe një seri

kryengritjesh të hapura, siç ishte ajo e Ethem Totos, por sidomos ajo e Fierit e vitit 1935. Një grup oficerësh vendosën të organizojnë një kryengritje dhe ata arritën të mobilizojnë përkrah tyre një grup shumë të madh intelektualësh dhe njerëzish me ndikim. Midis tyre ishte edhe Shefqet Vërlaci, por ky i fundit u tërhoq në momentin e fundit. Kryengritja pritej të fillonte kur të ishte momenti, por ndërsa kryengritësit qenë mbledhur në Fier, ata vunë re të kalonte aty makina e gjeneral Gilardit, një prej oficerëve të lartë dhe besnikë të Mbretit. Ky kroat nuk dihej si pati mbetur në Shqipëri, por ai kishte luftuar që në kohën e Princ Vidit në xhandarmërinë shqiptare. Duke menduar që plani i tyre ishte zbuluar dhe Gilardi kish ardhur t'i arrestonte, ata e vranë atë dhe shpallën kryengritjen. Për çudinë e tij, Zogu nuk dinte asgjë për organizimin, por ai veproi shpejt. Një pjesë e trupave shpartalluan kryengritësit të cilët u vranë, u arrestuan dhe fare pak prej tyre arritën të largohen. Për Kryengritjen e Fierit ai dënoi mbi 61 veta me vdekje, por më pas i fali ata.

Sjellja e Zogut ndaj kudërshtarëve nuk ishte ajo e Enver Hoxhës. Siç dëshmon edhe Kristo Frashëri:

“Zogu ka një meritë. Pasi siguroi pushtetin, bëri të kundërtën e Enver Hoxhës. Ndërsa Enver Hoxha pasi mori pushtetin erdhi duke i shtrënguar rripat apo burgjitë, Zogu erdhi duke i liruar. Sapo mori pushtetin me ndihmën e bejlerëve, Zogu kaloi kundër bejlerëve. Bëri kodin civil që ishte kundër bejlerëve, kodin penal, kodin tregtar, bëri një administratë me elementë perëndimorë, stabilizoi administratën, vendin. Hapi shkolla shqipe, hapi shkolla të një niveli evropian, shkolla laike. Por ka disa anë negative”.

Historia ende nuk e ka zbardhur krejt periudhën e sundimit të tij, por Bernd Fisher duket se bën përcaktimin më të mirë për të:

“Mund të them se si me çdo figurë politike, ka anë pozitive dhe negative. Ka disa fusha ku Zogu mund të kishte vepruar më mirë. Megjithatë, duke paere analizat përfundimtare, mund të them se Shqiptarët e kanë parë Zogun si një figurë pozitive. Mendoj se ai është përgjegjës për një farë shkalle modernizimi, por gjithashtu mendoj se mund të kishte pasur akoma më shumë zhvillim. Për shkak

të paaftësisë së tij për t'u përballur me ekonominë e ndërlikuar, ka pasur shumë humbje që mund të ishte përdorur për të zhvilluar më tej Shqipërinë. Por është e vështirë të përcaktosh se kush tjetër do të kishte mundur ta shtynte më tej procesin e modernizimit më shumë sesa ai. Ai kishte të drejtë të shqetësohej se pari për stabilitetin. Pa stabilitet nuk ke modernizim."

Nëse e sheh më me vëmendje duket sikur në fund të viteve '30, pavarësisht kërcënimit italian, Zogu e kishte konsumuar kurbën e suksesit. Ai kishte qenë një politikan brilant dhe një patriot kontribues deri në vitin 1924. Më pas e bjerr patriotizmin dhe brilantesën duke e zëvendësuar atë me një burrë të vërtetë shteti nga viti 1924 deri më 1931 - 33. Pas vitit 1936, filloi rënia. I kishte mbetur pak nga frymëzimi i rinisë, ishte zbehur idealizmi që e kishte bërë djalin 17-vjeçar faktor për krijimin e shtetit shqiptar, i ishte thyer besimi se ky vend mund të transformohej plotësisht. Ai thjesht ruante ekuilibrat politik dhe garantonte pushtetin në vitet e fundit të sundimit. Të rinjtë ishin të parët që e kishin nuhatur këtë dhe u renditën kundër tij. Nëse Italia nuk do ta kishte pushtuar Shqipërinë, nëse Lufta Botërore nuk do të kishte trokitur, Zogu mund ta kishte shlytur ende për disa dekada sundimin e tij. Por ai nuk kishte më ç'ti jepte vendit. U largua në kohën e duhur, edhe pse, ata që erdhën pas, ishin shumë më pak të aftë dhe patriotë se sa ai. Siç shprehet në fakt edhe at Zef Pllumi, një person që i jetoj të dy regjimet:

"Regjimi i Zogut ishte më i miri i regjimeve të këqija në Shqipëri..."

ZOGU DHE GRATË

Një ditë dhjetori të vitit 1975, në derën e ambasadës shqiptare në Paris, në 16 Rue Della Pompe, u paraqit një grua e moshuar. Më shumë ngjante një grua e pamoshë, e veshur me sqimë, por me rroba që e kishin të vështirë të riprodhonin gjithë shkëlqimin e dikurshëm. E moshuara kërkoi të takonte dikë, pa e specifikuar qartë dhe sqaroi se kishte qenë gruaja e Kryetarit të Shtetit Shqiptar. Për arsye të një kohe jetese të Enver Hoxhës në Paris, roja i ambasadës mbeti i paralizuar. Ai u qetësua pak çaste më vonë, kur gruaja sqaroi se kishte jetuar për 4 vjet pa kurorë me Mbretin e Shqipërisë, Zogun. Me zë të shuar, ajo kërkoi që shteti shqiptar t'i lidhte një pension për shërbimet që i kishte bërë Mbretit dhe kohën që kishte jetuar me të.

Gruaja nuk kishte asnjë dijeni për zhvillimet e mëtejshme. Që prej vitit 1931 kur ishte larguar nga Shqipëria, nuk e dinte që Mbreti Zog kishte rënë nga Froni dhe në atë ambasadë qenë vendosur armiqte e tij. Ata e kishin dënuar me vdekje. Ndoshta dikush ia shpjegoi të gjitha këto, por ajo la sërish një letër të shkurtër që iu përcoll direkt Ministrisë së Jashtme:

"Emri im është Tanja Visarova. Kam qenë në martesë pa kurorë me mbretin Zog nga viti 1929 deri më vitin 1933. Zogu më ka dhuruar një parcelë tokë prej 10 ha, që ndodhet diku në vendin e quajtur Xhafzotaj. Unë nuk e di se ku ndodhet ky vend dhe asnjëherë nuk kam shkelur në atë pronë që më është falur me dokumentet që

kam nga Mbreti. Jam e lodhur, pa të ardhura, pa shtëpi. Banoj në hotel "Pension" në qytetin e Vensës. Kam shitur kujtimet e mia për të fituar pak të holla për jetesë. Nëse autoritetet tuaja mund të më akordojnë një pension të vogël për vitet që kam qëndruar në strehën mbretërore e nëse mund të vihet në shitje sipërfaqja e tokës që më është dhuruar do të isha shumë mirënjohëse".

Ishte hera e parë që emri i Visarovës lidhej me një histori dashurie, ose më shumë erotike të Mbretit Zog. Pak kohë më vonë ajo botoi kujtimet në Paris, të titulluara: "Tania Visirova, nga Kaukazi në Foli Berzher", që ngjallën sërish kuriozitetin e Ministrisë së Jashtme të regjimit komunist. Dy diplomatë u vunë në kërkim të saj, por nuk ia gjetën më adresën.

Edhe pse e rrëfyer vetëm prej saj, historia e Visarovës është shumë interesante. Ajo kishte lindur në Besarabi, Moldavia e sotme, në vitin 1908 dhe ishte transferuar në Kaukaz në vitet e revocionit bolshevik. Në 1927 kishte mbërritur në Paris e shoqëruar nga e ëma. Fotot e rrëfejnë jashtëzakonisht të bukur. Në moshën 19-vjeçare nis të kërcejë nudo në një lokal të quajtur "Radio" dhe më pas në Foli Berzher, kabareja e famshme e Parisit. Brenda pak muajsh bëhet e njohur. Arrin deri aty sa të pozojë për piktorë me emër si Matisi apo Renuari. Në Foli Berzher njihet me emrin "La Visirova". Me po këtë emër nisi të shfaqet në filmat e parë nudo të kohës "Gruaja dhe Platini" apo "Montekristoja". Por karriera e saj në Francë do ndërpritej papritur për disa vjet. Më 1929, pas një koncerti në Bruksel mori një ofertë befasuese nga një përfaqësues i Mbretit Shqiptar. Ftohej të kërcente në Teatrin e Tiranës me rastin e 1 vjetorit të Mbretërisë. Duket se ajo është dyzuar disi, por kontrata 3- mujore ishte shumë e lartë dhe në fund, vendosi ta pranojë:

"Kontrata u nënshkrua në Konsullatën e Shqipërisë dhe me kërkesën time edhe atë të Rumanisë.-, firmosa për një angazhim tremujor. Të ardhurat nga kontrata i depozituam në një bankë të Parisit"

Sipas rrëfimeve mori një shumë prej 25 mijë frangash ari për 3 muaj, por nuk kërceu asnjëherë të vetme në Tiranë. Më 10 Gusht mbërriti në Durrës ku e priste Dedë Suli, i cili do ta shoqëronte

ngado. Ky malësor kishte qenë gjatë Luftës së Parë Botërore, adjutant i komandantit e trupave aleate në Maqedoni, francezit Franchat d'Espery.

"Më 10 gusht mbërritëm në Durrës. Na priste një Roll, ushtarakët na përshëndetën dhe më pas arritëm në një sallon në brigjet e Adriatikut.

-Ky sallon- na thanë- është ndërtuar për ju, për stinën e verës.

-Mirë, po ku është teatri?

-Teatri është në Tiranë. Oborri e kalon verën këtu. Jeni në krah të Sallonit Mbretëror"

Visarova e përshkuan me detaje takimin e parë me Mbretin:

"Pas pak pashë të hynte një burrë i gjatë, i hollë, bjond dhe me sy blu, që e mora për një oficer austriak. Por befas deputeti u nxitua të më prezantonte para Mbretit.

-Ju qenkeni?- thashë e çuditur.

-U zhgënjyhet. Më imagjinonit ndryshe?

-Kam jetuar një pjesë të madhe të jetës midis njerëzish orientale, ndaj më shumë ju përfytyroja si njëfarë pashai. Por ngjani me një oficer austriak ose jugosllav, nuk keni asgjë orientale".

Sipas Visarovës, Zogu ishte mjaft i kujdesshëm me të. Ajo e kuptoi që momentin e parë shkakun se përse gjendej aty:

"Mbreti Zog ka qenë shumë njerëzor me mua, shumë i sjellshëm, i butë. Në fund ai arriti atë çka dëshironte, por vetëm pas një muaji të tërë. Nuk më nxititi, priti sa të isha e gatshme. Dhe besoj e kam çuditur, madje jo në pak gjëra."

Visarova qëndroi, gjithnjë sipas dëshmive të saj, për plot 4 vjet në Tiranë. Nuk dilte publikisht, por shpenzonte kohë me Mbretin. Ajo nuk jep detaje për jetën e tyre seksuale, por sqaron:

"Protokolli parashikonte madje edhe orët tona të dashurisë. Dashuria bëhej gjithnjë në të njëjtën orë, ndoshta mund ta quajë të

gjithë këtë, "nëpunësi", ndonëse unë nuk kisha shpirt prej funksionareje. E megjithatë ajo bëhej, pavarësisht nga unë. Zogu, - mendoj, - nuk ishte një qenie e ndezur në pasion, më dashuronte, kishte dobësi të madhe për mua, por protokolli, kotësitë e funksionit të tij mbretëror merrnin frenat dhe vinin nën kontroll gjithë gjërat e tjera."

Nuk dihet sa të vërteta janë rrëfimet e Visarovës, por ajo vuri në dispozicion të ambasadës në Paris një dokument origjinal që e bën të pronare të një parcele prej 10 mijë metra katorë tokë në Xhafzotaj, tokë që nuk e pa kurrë. Sipas "Collectors Weekly", ajo u largua nga Shqipëria më 1931, e ngarkuar me shumë baulle me plaçka dhe me një koleksion bizhush me shumë vlerë, dhuruar nga Mbreti.

Iu kthye kërcimit në Foli Berzher duke qenë mbretëresha e skenës. Më 1937 publikoi disa foto mjaft të guximshme në revistën "LIFE". Ishte thuajse shkëlqimi i saj i fundit. Nga 1942 deri më 1960 punoi si mësuese baleti në Nice. Pas kësaj kohe jetoi në Vencë dhe ndërroi jetë në një manastir ku ishte strehuar në Roquesteron.

Për raportet e Zogut me femrat ka shumë histori, por është e vështirë që të verifikohen dhe të konfirmohen. Konica kujton se ai kishte mjaft sukses me zonjat gjatë luftës në Vjenë, kur me uniformën e kolonelit, shtatin e gjatë dhe sytë blu u bë gjahu më i pëlqyer i shumë prej tyre.

Historia e parë zyrtare është fejesa me Behije Vërlacin, vajzën e Shefqet Vërlacit, njeriut më të pasur dhe ndër më infuentët e Shqipërisë. Fejesa njoftohet në gazetën "Posta e Korçës" e datës 24 Shtator 1921:

"Urim, zotin Ahmet Bej Zogolli q'u vlua me zojushën Shefqet Bej Vërlaci. I urojmë bashkim të shpejtë dhe jetë fatbardhë të lumtur."

Më shumë se sa një histori për të krijuar familje ajo ngjan si një aleancë politike në një moment delikat për të. Shefqet Vërlaci ishte i lidhur me familjet më të fuqishme në vend me një rrjet krushqish. Nuk dihet se përse fejesa nuk u kthye në martesë, por më 20 mars 1927, gazeta "Nju Jork Times" jep këtë shpjegim për mosmartesën e tij:

"Zogu ishte martuar me vajzën e njeriut më të pasur në hierarki, por, duke iu bindur traditës shqiptare, ai nuk e kishte parë ende të fejuarën, dhe përpara se të martohej me të duhej të martoheshin katër motrat e tij më të reja sesa ai për nga mosha, të cilat jetonin me nënën e tyre në një shtëpi që i bashkëngjitej asaj të Presidentit. Kreu i nderuar dhe i respektuar i një shtëpie shqiptare nuk e tejkalon veten derisa të afërmit e bashkëshortes së tij janë të gjithë dakord."

Në kohën kur reportazhi u botua në SHBA, Zogu duhej të kishte qenë në momentet e ndarjes. Ai u nda me Behijen në vitin 1928. Dokumentimi i vetëm që e dëshmon është qarkorja që Presidenca i dërgon Ministrisë së Brendshme ku jep sqarime për prishjen e krushqisë. Qarkorja gjendet në AQSH në dokumentet e vitit 1928:

"Njoftimi zyrtar (por i fshehtë) mbi ndarjen Zogu Vërlac.

Ju lajmërohet se krushqia midis Mbretit dhe shtëpisë së Vërlacit u çlirue me dëshirën e të dy palëve. Mbi këtë çështje shtypi nuk duhet të shkruaj as gja ma të vogël dhe nuk duhet as të bajë ndonji kush qoftë si do që të jetë, prandaj, thrritni gazetarë dhe i porositni kategorisht në këtë mënyrë. Populli kur të shpallet lajmi asht i lirë të bisedojë mbi çashtjen në formën q'u tha më sipër se çlirimi asht ba me dëshirin e të dy palëve"

Nuk dihet nëse Zogu e pa ndonjëherë të fejuarën. Pak kohë më pas ajo u martua me Xhemil bej Dinon, i cili kishte qenë më parë, sipas Eqrem bej Vlorës, i fejuar me motrën e Zogut, Myzejenin. Dino, pinjoll i një familjeje të pasur nga Çamëria, u emërua nga Zogu ambasador në Londër dhe më pas u bë ministrër i Jashtëm i Shqipërisë.

As Zogu dhe as Vërlaci nuk folën kurrë për ndarjen, por raporti mes tyre përfundoi atë moment. Ata u bënë armiq, duke tentuar, sipas opinionëve, disa herë t'i marrin edhe jetën njëri -tjetrit. Vërlaci u bë Kryeministër, menjëherë pas largimit të Zogut nga Shqipëria më 1939.

Gjatë viteve të beqarisë, që prej ndarjes më 1927 dhe deri më 1938 kur u martua, Mbreti Zog u përfol për disa histori dashurie, ose pasioni. Emra të njohur të femrave të kryeqytetit i atriboheshin

atij si të dashura. Një ndër to ishte Sara Blloshmi, bashkëshortja e një ish- ambasadori të Zogut, Selahudin Blloshmit, femra padyshim më e bukur e Shqipërisë, tejet e emancipuar dhe muzë e poetëve dhe skulptorëve, ajo shfaqej shpesh në pritjet e Pallatit. Një prej ambasadorëve raporton se ajo vallëzonte më shpesh se gratë e tjera me Mbretin. Nuk dihet nëse ka pasur ndonjë lidhje mes tyre. Deri më sot nuk ka asgjë të dokumentuar. Në fakt pas shpalljes Mbret më 1928, preokupimi kryesor i Zogut ishte martesë me një vajzë që të vinte nga familje aristokrate dhe mundësisht mbretërore. Edhe pse dukej pretendim i madh nga një Mbret i vetëshpallur, kjo mund të realizohej për faktin se ai ishte në fron edhe për arsye gjeopolitike. Italianët qenë të parët të interesuar për martesën e tij, një martesë që më shumë se sa e tillë, shihej si një aleancë politike.

Pietro Kuarone dhe Ugo Sola hynë në Pallatin Mbretëror veror në kodrën mbi qytetin e Durrësit një ditë gushti të vitit 1932 me një synim të qartë. Ata kishin marrë si detyrë të shtynin Mbretin Zog drejt martesës me një princeshë ose me një aristokrate italiane, për të fuqizuar ndikimin e tyre në Shqipëri. Në shtypin perëndimor po flitej për martesën e mundshme të Mbretit me një fisnike gjermane dhe kjo i cënonte interesat e tyre. Mbreti i priste në tarracën e vilës së mrekullueshme dhe ra menjëherë dakord me ta. Në kujtimet e tij në librin "Valixhja diplomatike", Kuarone rrëfen:

"Takimi i parë me Zogun për martesën e tij të ardhshme ka qenë një poemë e vërtetë. Ne tanimë e kishim prekur çështjen gjerë e gjatë me ndërmjetës të ndryshëm, por kurrë akoma jo direkt me Zogun. Në një vend tjetër, do ta kishim filluar bisedën, duke shoshitur gjithë ç'kishin arritur ndërmjetësit. Në Orient përkundrazi komedia duhet të luhet gjer në fund. Sola nisi në fillim t'i paraqiste mbretit arsyet e shumta për të cilat, në interesat e tij dhe të vendit ishte e domosdoshme që ai të martohej. Zogu iu përgjegy me një fjalim të paktën dy herë më të gjatë mbi vështirësitë që ai po ndeshte për të gjetur një grua në Shqipëri. Dhe Sola po e ndiqte me shumë vëmendje duke mos ndërhyrë, veçse kohë me kohë me kokë: të dukej sikur një baba i mirë familjar është duke dëgjuar ankesat e djalit të vet. Por pastaj ia ktheu:

- Po atëherë, përse të mos martohej me një të huaj?

Në këtë pikë të bisedës unë thjesht u trallisa nga dhuntitë prej komendiani që tregoi mbreti. Ai e kaloi në revistë, duke theksuar aspektet negative të secilës, të gjitha alternativat e mundshme, që në të vërtetë nuk ishin të shumta, ai nuk njihte asnjëri e asnjëri nuk e njihte atë, Mbretin. Padyshim, zgjidhja më e pranueshme do të kishte qenë ajo e ndonjë princeshe italiane, por a ishte e mundur që ta shtronte seriozisht këtë mundësi?"

Po sipas Kuarones, Zogu kishte hyrë edhe në detaje më të mëdha.

"Zogu hodhi në tryezë tezën që, nëse kjo martesë duhej bërë, mund të bëhej vetëm me të bijën e Mbretit të Italisë, duke thënë se preferencat e tij personale ishin më shumë për Princeshën Marinë. Kjo kandidaturë ndeshte, natyrisht, qëndresë të fortë në Itali. Vinin pastaj, doemos çështje protokolli dhe një mizëri hollësisht të rëndësishme që duheshin rregulluar".

Nuk ka dyshim që Kuarone është i saktë në dëshminë që jep, por në disa libra është shkruajtur që Zogu kishte një tjetër preferencë. Ai tërhoqej më shumë nga Princesha Xhovana, vajza 22-vjeçare e Mbretit Viktor Emanuel III dhe Elenës së Malit të Zi. Një vajzë me personalitet, që në të njëjtën kohë ishte kërkuar edhe nga Mbreti Boris i Bullgarisë. Sipas biografëve të Zogut, Musolini e konsideroi për një farë kohe këtë kërkesë. Martesa e Xhovanës, që ishte edhe mbesa e Knjaz Nikollës së Malit të Zi, do të sillte një fuqizim të pozitive italiane në gjithë rajonin. Por ai u detyrua të kthente mendim pas bisedës që pati me Mbretin Viktor Emanueli III. Savoijat pa dyshim që nuk mund të jepnin Princeshën e re për një Mbret që s'vinte nga një dinasti reale.

Fiksimi i italianëve për martesën e Mbretit Zog me një shtetase të tyre duhet të ketë qenë shumë i madh. Ata përgjonin çdo emër që qarkullonte si kandidaturë e mundshme për Mbretëreshë të Shqipërisë dhe në shumë raste edhe ndërhyjnë për t'i prishur mundësitë. Nëse i referohesh një shkresë që ambasadori britanik në Romë i dërgon më 8 shkurt 1938 ministrit të Jashtëm Anthony Eden, ndërhyrjet dilnin edhe përtej territorit italian:

“Mbreti Zog ka vendosur kohë më parë që kur të martohet, nusja e tij të jetë mundësisht hungareze. Rreth 9 muaj më parë ai ishte i tërhequr nga një grua hungareze dhe nisën negociatat për një martesë. Gjithsesi, italianët u përfshinë në këtë zhvillim për të prishur punë dhe angazhuan 2 nga burrat më të pashëm të cilët shkuan në Budapest për të joshur zonjën në fjalë. Njëri nga ata të dy ia doli dhe mundësia që zonja të bëhej Mbretëreshë e Shqipërisë u venit. Italianët, duke dashur që t’i kthejnë mendjen mbretit Zog, nisën një fushatë për ta martuar me një grua italiane dhe propozuan disa kandidatë.”

Që prej vitit 1931 italianët i dërguan Mbretit një listë të gjatë dhe të përmirësuar çdo vit me markeze, kontesha, barone dhe princesha, kandidatë të mundshme për Mbretëresha, bashkë me fotografite e tyre. Kuarone kujton se Zogu nuk ra asnjëherë dakord dhe madje jep edhe një shpjegim disi interesant për këtë:

“Një nga ministrat e tij më ka treguar se gjatë mërgimit në Jugosllavi, në Novi Sad, Zogu kishte takuar një vajzë të re. Me t’u kthyer në Shqipëri, e kishte thirrur në Tiranë dhe e kishte vendosur në një vilë, brenda rrethojës së pallatit. Ajo quhej Franzi, ne e kishim mbiquajtur madamë Pompadureta. Franzi bënte një gjallim jashtëzakonisht të fshehtë, si në harem. I vetmi ndër ne që ishte lejuar ta shihte, ishte mjeku ynë, thirrur një apo dy herë për konsultë tek ajo. Me ndodhi ta shihja atë natë. Po shkonim në Durrës, duke kaluar rrethojën e rezidencës mbretërore, u kryqëzuam me një siluete, femërore e veshur me të bardha. Përfshirë në fashat e fenerëve të veturës sonë, ajo mbuloi fytyrën me të dy duart. Gjithë ç’pamë që se ajo ishte trupmadhe dhe elegante. Nuk e di gjer në ç’pikë Zogu ishte lidhur me të, kjo lidhje, sidoqoftë, zgjati për shumë vjet. Një martesë do ta detyronte ta ndërpriste këtë lidhje. Zogu ishte i bindur që Franzi i sillte fat. Gjithcka po shkonte mirë për të që kur e kishte njohur, prandaj, shumë supersticioz ai ngurronte. Veç kësaj, e ardhmja tregoi se ai nuk e kishte krejt gabim. Shumë më vonë, për t’u martuar, ai u nda nga Franzi dhe që atëherë gjërat nuk i shkuan kaq mirë. Koicidencë e thjeshtë padyshim.”

Historia e Franzit që bërë publike gjatë vizitës së Mbretit në

Vjenë. Shtypi i atjeshëm kishte zbuluar se në apartamentin ngjitur me atë të Mbretit në hotel “Imperial” ishte vendosur një vajzë e re, e quajtur Francesca Janko dhe motra e saj Maria. Shtypi shkruajti se mes kërcimtares së re austriake dhe Mbretit kishte një lidhje të hershme dashurie. Mbreti Zog u shfaq disa herë në publik me të dhe dyqanet e shtrenjta të Vjenës morën porosi që u paguan nga Mbreti. Nuk dihet se sa kohë qëndroi ende ai me Françeskën.

Nëse është ashtu siç mendon Kuarone, Zogu duhet të ketë qëndruar me Franzin edhe për shumë kohë. Së paku deri në fund të vitit 1937, kur sekretari i ambasadës në Vjenë, Jak Koçi i dërgoi një zarf me foto aristokratesh austriake dhe hungareze, që plotësonin kushtet për të qenë Mbretëresha të Shqipërisë. Sytë dhe vëmendja e Zogut mbeti te njëra prej tyre, Geraldinë de Nagy Appony, një konteshë hungareze e rënë nga vakti, me nënë amerikane, që punonte si guidë në muzeun e Budapestit. Nëna e saj ishte kushërirë e afërt e një djali të ri që më pas do të bëhej president i SHBA –ve, Riçard Niksonit. Pak muaj më parë, kushërirë e parë e Geraldinës kish qenë kandidatja kryesore për martesë me Mbretin Zog. Pas pëlqimit të Mbretit, në fund të vitit 1937, Geraldina u bind të vinte në Shqipëri.

Geraldina ishte zgjidhja përfundimtare e Mbretit. Ata u takuan natën e Vitit të Ri 1938 e madje edhe kërcyen bashkë. Zogu i propozoi martesë që të nesërmen. Fejesa u bë në janar, ndërsa dasma në prill 1938, siç dëshmohet në kapitullin e dytë të këtij libri.

Që nga momenti që Geraldina doli në skenë, historitë rozë të Mbretit duket se marrin fund. Ato nuk u ndanë thujse asnjëherë për 23 vjetët në vijim.

KUSH ISHTE AHMET ZOGU?

“Ahmet Zogu është djalë i ri, 31- vjeçar, por serioz, që flet me zë të ulët dhe në një mënyrë modeste. Asnjë person që e takon atë nuk mendon se ai është nga ata njerëz që kanë luftuar dhe kanë qenë prijës që në moshën 18-vjeçare. Ai i priste vizitorët e tij mjaft thjesht. Një sekretar i veshur me uniformë i drejtonte ata sipër një palë shkallëve të larta druri me një rrip të kuq dhe i shoqëronte ata drejt një dhome me mure blu, me gjatësinë e shtëpisë. Ajo ishte e mbuluar kryesisht me rrugica orientale, të pasura. Në njërin cep të dhomës varej portreti i spikatur i Presidentit me një mbretërim të plotë, ndërsa në tjetrin, prapa një tryeze pune, lartohet figura e një njeriu energjik dhe të sjellshëm, me një kostum gri të mrekullueshëm e me një kollare të kombinuar, çorape mëndafshi dhe këpucë të sheshta, një shami të vendosur me mjaft kujdes në xhepin e sipërm të xhaketës.”

Kështu e portretizon Presidentin Ahmet Zogu, Anne O'Hare Mçormick, korrespondente e “Nju Jork Times” në artikullin e 20 marsit 1927. Gazetarja duket e impresionuar dhe mbase nuk ka faj. Në Europën e atyre viteve një president 31- vjeçar nuk ishte gjë e zakonshme. Aq më tepër një President që kishte qenë anëtar i Kuvendit të Pavarësisë së vendit në moshën 17- vjeçare, ministër i Brendshëm 25, dhe Kryeministër 27. Por të portretizoje liderin e një vendi oriental që sapo kishte nisur të hidhte bazat e shtetit nuk duket e thjeshtë, as për një gazetare të një të përditshmjeje prestigjioze si “Nju- Jork Times”! Gjithsesi, ajo që i bashkon ata që kanë

përshkruar takimin e parë me të, është befasimi. Pothuajse për të gjithë, përballja ka qenë e ndryshme nga ajo që ata prisnin. Zhysten Godar, deputet francez dhe mjaft i lidhur me Shqipërinë, e takoi së pari në vitin 1921. Ja si e përshkruan në ditarin e tij këtë takim:

"1 Prill 1921, e premte

Erdhi Ahmet Bej Zogu, deputet i Matit, një djalë i ri shumë aristokrat, që duket se respektohet. Me siguri ky njeri do të luajë një rol në të ardhmen. Dyshoj nëse ai e ka idenë e interesit të përgjithshëm. Tek ai pashë vetëm ambicie të ftohtë. Ishte shumë i sjellshëm në bisedë."

Pietro Kuarone, një diplomat italian që ka shkruajtur padyshim portretin më interesant të tij, e rrëfen kështu takimin e tyre të parë:

"E kisha parë shpesh mbretin në fotografi me një uniformë të bukur të bardhë, pak teatrale, prandaj po provoja njëfarë habie kur u ndodha përballë një njeriu krejt të ndryshëm. Flokët biondë, të çelët pak të rrallë mbi ballë, një hundë shqiponje, mustaqe të vogla bionde, sy te kaltër të mrekullueshëm të tejdashëm, dhëmbë të bardhë e të rregullt, një buzëqeshje dhe ëmbëlsi e skajshme, një zë i hollë e tingëllues, me ndryshime çuditërisht rinore, një qafë e gjatë, e hollë në tërësi, pamje e një burri të ri mjaft timid."

Shumë i hequr, trupmadh e mjaft i përpjestuar, e mbante bukur uniformën fushore ngjyrë kaki me prerje pak si austriake. Asgjë tek ai nuk dëshmonte një sovran të pakkohshëm. Pamja e tij e përgjithshme ishte jo vetëm e stërholluar, por pothuaj dekadente."

Zogu ishte i sjellshëm. Ai dinte të prezantohej me të huaj dhe me gjasë, në këtë drejtim ka luajtur rol shkollimi në Stamboll, mbi të gjitha dy vjetët e rëndësishme të jetës që kaloi në Vjenë. Biografët kanë shënuar se gjatë gjithë jetës, ai pati pamjen e një oficeri austriak dhe i imitonte ata në veshje dhe sjellje. Në Shqipërinë e atyre viteve, Zogu nuk ishte as ndër më të kulturuarit e të rafinuarit, si Faik Konica, Eqrem Bej Vlora, Fan Noli, por as ndër më orientalët siç ishte shumica e politikanëve shqiptarë. Ai ishte çuditërisht një miksim i orientit me perëndimin. Një miksim i Perandorisë Osmane me atë Austro - Hungareze. Është befasuese, se si tek ky

njeri, ngjizeshin e mishëroheshin dy modele dhe dy filozofi politike që nuk u miksuuan dot kurrë në 200 vjetët e fundit. Gazetarja e "Nju Jork Time", e përshkruan kështu dyzimin e tij:

"Përveç një dukje orientale në përkujdesin e tij dhe syve të përqëndruar, ai ngjante më shumë me perëndimorët. Ai ishte një njeri i qytetëruar, me dinjitet dhe që nuk mbante qëndrim. Nëse ai shfaqej pak i shqetësuar dhe nervoz në mënyrën e tij, ishte pa dyshim, sepse ai nuk ishte mësuar me intervistat, e aq më tepër me gazetaret femra."

Vështirë që në historinë e Shqipërisë të gesh një figurë më të vështirë për t'u përkufizuar. Si gjithë gjërat e papërcaktuara mirë, ai nuk mund të përmbledhet në një fjali. Një paragraf i tërë po ashtu nuk mjafton për t'i dhënë formë karakterit të tij. Për orientalët ai ishte shumë oksidental, për oksidentalët, ai zbatonte stilet më bizantine të Orientit. Asnjëra palë nuk e pranonte edhe pse kjo nuk e pengoi që në jetë t'u imponohej të dyja palëve. Afronte herë njëherë e herë tjetër. Dukej sikur njëherë ecte para dhe njëherë kthehej mbrapsht. Një personazh mjaft i denjë për psikologët, siç e quante Faik Konica, por që fatkeqësisht pak prej tyre janë marrë me të.

"...duam a nuk duam ne, ai mbetet një karakter interesant dhe enigmatik, një përzierje pa kriter kontradiktash të ndryshme, gjysmë hero dhe gjysmë bufon, për të cilin do të interesohen si grumbulluesi i fakteve historike të çuditshme, ashtu dhe studiuesi i psikologjisë"

Kujtimet reale dhe të zhveshura nga meritë e momentit thuajse nuk ekzistojnë. Të gjithë ata që e kanë përkufizuar, për mirë apo për keq, e kanë bërë këtë në momente lajkatimi apo zemërimi. Të qenit objektiv thuajse nuk ka lidhje me përshkrimet që i bëjnë. Kuarone është ndoshta i vetmi që ka lënë një lloj dëshmie, edhe pse, në të ndihet tërheqja që ushtron një njeri me pushtet. Po përmbledh diçka nga përshkrimi i tij me bindjen që askush tjetër nuk do ta bënte më mirë:

"Zogu dinte, me raste, të shpaloste një joshje fort të stërholluar dhe

të përdorte një buzëqeshje të mrekullueshme, të mbuluar sadopak me një vello melankolie krejt romantike. I vështronte krejt në sy me një shprehje simpatike. Toni i zërit të tij ishte i ngrohtë, tinzar dhe si i vulosur me një rezervë prej adoleshenti, të folurit e tij, i thjeshtë, i qartë, nganjëherë me aluzione të shkurtra për problemet politike e personale. Përnjëherësh, të jepte bile përshtypjen se po të linte të depertoje në intimitetin e vet: këndej andej, një gjysmë konfidencë, duke arritur të japë ndjenjën e një sinqeriteti të madh, që në njëfarë kuptimi nuk ishte mashtrues. Shkurt, një personalitet fort kompleks. Dhe e pyesje veten menjehere: - Si drejtin ka mundur të bëhet zot absolut i një vendi kaq të trazuar dhe t'i mbajë gjithë këta lloj njerëzish në një gjendje të shquar...?

Nga njëherë, por mjaft rrallë, një gjest, një qëndrim, i zbulonin fytyrën tjetër të tij. Në raste të rralla, JO e tij dilte si një e shtënë. Burri atëherë transformohej, bëhej dyllë i verdhë, tiparet e tij tendoseshin, buzët i bëheshin më të holla, vështrimi i ngulët, i ftohtë, plot me një dritë të keqe. Befas ai plakej nja 20 vjet. Me dorën e tij të djathtë, pak nervoze, përdridhte mustaqet, ose më shpesh, kreshpëronte grushtet mbi brrylësat e kolltukut.”

Zogu ndërmori disa reforma të rëndësishme emancipuese, por stili i punës i ngjante shumë atij të një sunduesi oriental.

Ai nuk thoshte kurrë atë që mendonte. Ai priste që ministrat e tij, bashkëpunëtorët, ta merrnin vetë me mend mendimin e tij dhe pastaj t'ia impononin atij vetë. Atëhere, përfundimisht, ai nënshtrohej... meqënëse ju po ngulni këmbë! Dhe këta fatkeqë të shkretë shtrydhnin trutë për të zbuluar qëllimet e tij, duke e ditur përndryshe se, nëse nuk arrinin t'ia merrnin me mend saktë idetë, atëhere prania e tyre në qeveri nuk kishte për të zgjatur shumë.

Stili i komunikimit me vartësit ishte i panjohur për çdo vend të Europës së emancipuar. Kjo sjellje i vononte mjaft marrjet e vendimeve. Asnjë nuk e dinte me saktësi se cili ishte opinionimi i vërtetë dhe çfarë donte të thoshte Zogu. Tentativa për të zbuluar se çfarë kishte në kokë ishte një ndërmarrje sfilitesë, si për diplomatët e huaj ashtu edhe për vartësit. Ugo Sola e përshkruante kështu atë:

“Të supozojmë se do të ishte shtruar në tavolinë një çështje e rëndësishme. Zogu jepte urdhër të vinte njeri nga ministrat e tij dhe, me kusht që të mos ia tregonte askujt, i “zbulonte” atij thelbin e mendimit të vet, pastaj thërriste një tjetër dhe i thoshte saktësisht krejt të kundërtën. Pastaj thërriste për këtë një të tretë dhe i thoshte fjalë analoge. Djajtë e shkretë mbledheshin, bashkëpërrallisnin, diskutonin, krahasonin të fshehtat e mbretit dhe përpiqeshin kësisoj që të nxirrnin prej tyre qëllimet e mbretit.

Në këtë mënyrë, për të zgjidhur edhe çështjen më të vogël, duhej një kohë e pakufishme, ndoshta ky ishte sistemi më i mirë për të qeverisur shtetasit e tij, ndoshta kjo i jepte kënaqësi. Sidoqoftë, kjo lojë fort e hollë shtrigash dhe ndryshueshmëri i përgjigjeve si s'ka më mirë disa anëve të karakterit të tij.”

Në karrierën politike ai premtoi dhe i ktheu premtimet me lehtësinë më të madhe. Në politikën e jashtme u përpoq të ishte me të gjithë dhe po të gjithëve u ktheu fjalën. Përpara vdekjes, Kryeministri i Jugosllavisë, Pashiç që e kishte takuar disa herë, deklaroi se Zogu ishte njeriu që e kishte gënjer në mënyrën më të pacipë. Diplomatët e tjerë e konfirmojnë po ashtu këtë gjë:

Zogu dinte të gënjente për mrekulli. Ai nuk kënaqej me dredhi dhe me mohime të thjeshta, edhe kur e dinte që ne ishim shumë mirë në dijeni të rrethanave reale, ai bile nuk kënaqej ta zbulonte versionin e tij me detaje të imta, ai u ngulte ata dy sytë e mrekullueshëm bojëqielli, mbushur tej e tej me një pafajësi të tillë, saqë sytë e një të porsalinduri, do t'ju dukeshin, në krahasim me të tijtë, plot dashakeqësi. Kaq fort e kaq mirë, saqë ai, fundi i fjalës, arrinte t'i vinte në një pozitë të vështirë.”

Në rini kishte lexuar “Princin” e Makiavelit dhe deri në moshë të thyer ishte ende i magjepsur nga ky libër. Ai po ashtu kishte bindjen se qëllimi justifikon mjetin. Luftoi mjaft kundërshtarë, por s'pati asnjë vështirësi të ulej dhe të gjente gjuhën me ta kur ia kërkonte nevoja. Parimet morale s'kishin asnjë vlerë për të, madje i përbuzte. Në një shkrim të vitit 1940, pasi la detyrën si ambasador i Shqipërisë në Uashington, Faik Konica, miku, armiku, miku dhe në fund

sërisht armiku i tij, e përshkruan kështu Ahmet Zogun:

“E për buz mbretin për këto arsye: E kam ndjekur që kur ishte tetëmbëdhjetëvjeçar, por s’e kam dëgjuar një herë të thotë të vërtetën. S’e ka mbajtur kurrë fjalën e dhënë. Nuk ka kurrfarë ndjenje përgjegjësie. Është i pangopur, egoist, zemërgur, i pandershëm. I urren të gjithë ata që kanë diçka, qoftë kjo kulturë, prejardhje familjare, pasuri, ndonjë aftësi në çfarëdo fushe, ose vetëm e vetëm pse janë atdhetarë të ndershëm”.

Emocionet qenë të huaja për të, si dhe gjithë pasionet që njeriu ka në jetë. Pushteti dhe komandimi qenë lumturia, mjerimi dhe droga e tij e vetme. Kuarone kujton se një mbrëmje, pas bisedave të punës, e ftoi për një pije në verandën e vilës së Durrësit, prej nga dukej deti që zhytej në errësirë. Ishte në qejf dhe filloi të rrëfente ngjarjet e jetës, - kujton ai. Në fakt Zogu e bënte këtë gjë shumë shpesh dhe me gjithë të huajtë që takonte. Duke e parë ashtu në qejf dhe të qetë, ndërsa gjerbnim me ngadalë një çaj të zi, kuturisa t’i bëja një pyetje që e kisha në mendje prej kohe, - kujton Kuarone:

“Madhëri, përse ju shërben kjo, që jeni mbret? Ju punoni si një i dënuar nga mëngjesi në darkë. Kurrë nuk merrni një ditë pushim. Përse të mos zgjidhni një Kryeministër të aftë t’u japë rrugë punëve të përditshme? Kjo mund të bëhet. Ju do të keni kështu kohë të udhëtoni, të studioni...A mund një njeri kaq i ri sa ju të mos ketë kurrë dëshirë ta gëzojë pak jetën?”

Zogu qëndroi mendueshëm, vështronte në boshllëk, sipër kokës sime, në drejtim të detit, pastaj, sikur po dilte nga një meditim i thellë u përgjigj ngadalë:

“Padyshim ju keni të drejtë, por a e dini ju se çfarë është përvoja e pushtetit, çdo të thotë të komandosht?”

Zogu e dinte ç’do të thoshte të komandonte. E kishte mësuar këtë që kur ishte 15 vjeç dhe karizma ishte aftësia e tij kryesore. Ai nuk ishte kandidati ideal për të drejtuar Shqipërinë, por kush mund të ishte ideali në rrethanat e asaj kohe. Zogu ishte thjesht më i përshtatshmi. Edhe pse, karizma, ambiciet dhe vendimet erdhën duke u bjerrur në

një dehje vaniteti pa kuptim. Pas vitit 1931, tentoi kinse të dukej si një familje e vërtetë mbretërore ose e besoi këtë. Në ato vite s’kishte asnjë lloj opozite dhe ambienti rreth tij dominohej nga një ton servil, i pabesueshëm. Për këtë mjafton të lexosh shtypin e kohës.

Gazetat perëndimore shpeshherë i kanë kritikuar stilin luksoz të jetës dhe idenë e një oborri mbretëror në një vend që vunte nga varfëria e thellë. Halla e Geraldinës Antuanetë shkruante në ditarin e saj për ditën e fejesës së Mbretit me mbesën e saj:

“Vlera e dhuratave të Mbretit ishte e pallogaritshme: diamante të mëdha, diadema, perla, byzylykë, gjerdanë në një sasi që ne nuk e kishim parë kurrë. Princesha u dhuroi gjithashtu kunatave të saj të ardhshme stoli të zgjedhura nga vetë Mbreti.”

Për vizitën në Vjenë ai harxhoi shuma kolosale që llogariteshin gati sa 1/5 e buxhetit vjetor të Shqipërisë. Planifikoi fonde të mëdha për ngritjen e Pallatit Mbretëror dhe mobilimin e tij. Geraldina kujton se kur i shkoi me një listë kërkesash për pajisjen më të mirë të Pallatit Mbretëror me sende luksi, ai as nuk e pa listën.

- E para, - i tha, - trefishoji sasi të për të gjitha sendet që do sjellësh.

Siç dëshmon Geraldina, jeta e tij deri atë ditë në Pallat ishte e rrëmujshme dhe ndihej mungesa e dorës së një gruaje. Këtë e dëshmon edhe një mik e më pas armik i tij, Çatin Saraçi:

“Në shtëpinë e Zogut nuk kishte shërbyer kurrë më parë ndonjë grua deri ditën që ai u martua. Për një hark kohor 20-vjeçar nuk kam parë as edhe një lule të vetme në shtëpinë e tij”

Kostumet i qepte me porosi në rrobaqepsinë e famshme Norton & Sons në nr. 16 Saville Row në Londër. Një kërkim i thjeshtë në internet sqaron se kostumet e kësaj rrobaqepësie që ka nisur punën ë 1821 kushtojnë sot duke nisur nga 4700 paund, ose 7600 dollarë. Por ky është çmimi bazik dhe askush nuk mund të thotë që Mbreti nuk merrte cilësinë më të mirë, çmimi i së cilës nuk afishohet.

Këmishat dhe kravatat i porosiste në dyqanin Sulka në Paris e më pas në një tjetër emër të madh të luksit, në Charvet, në Place

Vendome, po në Paris. Ai ishte një klient i çmuar. Të afërmit thoshin se kishte një garderobë prej 60 kostumesh, secili prej tyre i kombinuar me 5 këmisha dhe 5 kravata. Këpucët përgatiteshin me dorë në Itali, në një firmë që sot nuk ekziston më në Firenze. Çatin Saraçi deklaroi sërish:

“Kravatat ishin me qindra si dhe një numër i pafund këmishash të të gjitha ngjyrave, nga bluja e errët tek e kuqja dhe nuanca portokalli të ndezur, por as edhe një të bardhë. Kur e pyeta se ku i mbante këmishat e bardha, m'u përgjigj se e bardha ishte demode, çka më bëri të vë buzën në gaz duke i thënë se këmishtari i tij duhej t'i dinte këto punë më mirë se kolegët e tij në Londër. Të nesërmen mbreti porositi dy duzina këmishash të bardha në Vjenë”

Pasioni i Zogut për uniformat ishte edhe më i njohur. Miku i tij i vjetër kujton se ai kishte një koleksion të mrekullueshëm të tyre. Uniformat ushtarake që mbante, qepeshin fillimisht në Vjenë dhe më pas në Romë. Çmimi i tyre ishte shumë i lartë, por kjo nuk e pengonte që çdo vit të porosiste disa të tilla.

Pasioni për armët po ashtu i kushtoi shtrenjtë arkës së shtetit. Në fillimet e veta porositi një revolver prej floriri që e mbajti pranë deri në fund të jetës, ndërsa më pas, edhe një të dytë më të vogël për Geraldinën. Shpata e kolonelit të ushtrisë u prodhua në Itali. Nuk dihet çmimi i saj, por në 2008-ën, kur u shit në një ankand në Londër, ajo u ble për 10800 paund ose afro 14 mijë Euro.

Zogu nuk ishte i apasionuar pas librave, por kishte një bibliotekë prej afro 10 mijë titujsh. Një pjesë, që i bleu gjatë viteve të mërgimit, janë kthyer në Tiranë bashkë me trashgimtarët dhe kanë zënë sallën e bibliotekës në Pallatin e Princeshës. Në vitet e fundit të jetës, -siç dëshmon Leka, - filloi të lexojë frëngjisht dhe kishte një pasion të dukshëm për librat me dedektivë e sidomos për Agata Kristin. Pasionin për Agata Kristin e ndante edhe me armikun kryesor, Enver Hoxhën.

Në vitet e mbretërisë u bë amator i apasionuar i kinemasë. Filmat me Çarli Çaplinin dhe Shirli Tempëll qenë pasioni i madh.

Por të gjitha këto qenë vetëm detaje në jetë. Pushteti ishte pasioni i tij i vetëm dhe për këtë punonte pa pushim. Ugo Sola kujton:

“Zogu punonte si një i dënuar me punë të detyruar. Nga zyra e tij, nga ora tetë e mëngjesit ai nuk dilte veçse në orën 10 të mërkurës, ai mbikëqyrte dhe kontrollonte edhe gjënë më të vogël. Dhe për këtë duhej, me metodat e tij, jo pak kohë.”

Këtë gjë e vërteton edhe “Nju-Jork Time” në vitin 1931:

“Mbreti Zog është një nga njerëzit që punon më shumë se çdokush tjetër në botë. Ai deklaroi se punon 18 orë në ditë dhe se bën gjatë të gjithë ditës vetëm dy pushime nga dhjetë minuta”.

Punën e shoqëronte me cigare dhe kafe. Sipas dëshmitarëve pinte afro 150 cigare në ditë, ose 7 paketa e gjysmë me llogarinë e sotme. Cigaret e markës “Makedonia” i vinin me konfeksione të mëdha dhe i mbante me kujdes në një kuti ari, që kishte mësuar ta hapte me mjaft shkathtësi.

Sipas portaleve të sotme informative, më 1929, një shoqatë e luftës kundër duhanit, këshilloi mbretin Zog të ulte konsumin e cigareve, sepse ajo sakaq i kishte shkaktuar humbjen e zërit. Në përfundim qarkullonin zëra se konsumonte 55 mijë cigare në vit.

Zogu kishte një rrogë prej 35 mijë paund britanikë. E konvertuar me vlerën e sotme (Viti 2014) ajo llogaritet afro 480 mijë USD në vit, ose afro 375 mijë Euro. Por të gjitha këto janë kalkulime të përafërta. Por përfitimet e paligjshme, ose rryshfetet duhet të kenë qenë shumë më të mëdha. Çatin Saraçi në librin e tij shkruajtur pas ikjes nga Shqipëria të Mbretit deklaroi:

“Ahmet Zogu jo vetëm që ka marrë mite (ryshfet), por në çdo rast ishte ai vetë që përcaktonte sasinë që i duhej. I pajisur me pasaportë diplomatike dhe dokumente ekstra, tutori i moshuar i Zogut largohej nga vendi me kamionë të ngarkuar me valutë, i shoqëruar nga roje të armatosura. Këto udhëtime kryheshin rregullisht kurdoherë që Zogu kishte hedhur nënshkrimin mbi ndonjë akt të ri, ndërsa itinerari i rëndomtë ishte: Durrës-Bari, e prej andej në Gjenevë të Zvicrës. Sapo paratë siguroheshin në një bankë të huaj, përcillej urdhër me shkrim që të transferoheshin në një vend edhe më të sigurt se i pari.”

Më pas ai shprehet:

“Për rrjedhojë, pjesa më e madhe e këtyre parave gjendet në Lloyd’s Bankë të Londrës. Unë vetë me dorën time, kam shkruar një sërë urdhrash të kësaj natyre si dhe i kam ardhur në ndihmë tutorit analfabet për të mbërritur në kufi me Zvicrën”

Nuk dihet se sa të besueshme janë dëshmitë e Saraçit. Ato janë bërë në një moment kur ky i fundit kishte hapur edhe një proces legal në Britani për t’i kërkuar një shumë parash që pretendonte. Madje libri u përdor edhe si formë presioni, por citimet e Saraçit janë shumë të detajuara. Dhe përfitimet e paligjshme të Mbretit dhe njerëzve të tij, dëshmojnë edhe nga protagonistë të tjerë.

Shumë dëshmitarë kujtojnë se ai flinte shumë pak. Binte në orët e para të mëngjesit dhe ngrihej të hante mëngjes në orën 8. Çatin Saraçi kujton se këtë gjë ia kanë dëshmuar edhe atij shumë vetë. Madje ai kujton se pyetjes se përse flinte kaq pak, Mbreti i përgjigjej:

“Kur e pyesje Zogun se kur bie për të fjetur, kurdoherë merrja të njëjtën përgjigje lakonike: Napoloni nuk ka fjetur më shumë se pesë orë gjatë gjithë jetës së tij”

Zogu nuk i besonte askujt, madje as njerëzve të afërt që ishin me të prej vitesh. Dëshmitarë njoftojnë se kur mori në punë shofer Vlash Ramën ai i bëri vetëm një pyetje: A je i aftë të shkelësh një njeri nëse ai del përpara makinës për ta na bërë atentat?

Lëvizja e tij shoqërohej me masa sigurie ekstreme dhe asnjëherë nuk ishte e paralajmëruar. Kristo Frashëri, gjimnazist ishte nisur për një ekskursion me shokët e shkollës, kur befas dalluan Mbretin:

“Njëherë u nisëm për ekskursion në Petrelë. Rrugës aty te ura e Mulletit pamë Zogun në makinë. Ne thoshim -”Është apo nuk është Zogu ky?” Zogu kishte vajtur gjer në Ibë të pinte kafe. Ai bënte ndonjëherë dalje të tilla, të paplanifikuara sigurisht”

Zyra ku punonte ishte po kaq e mbrojtur, siç dëshmon Geraldina, vizitën e saj të parë aty më 1 janar 1938:

“Hyra përmes dyerve prej xhami antiplumb, të ruajtura nga dy roje, që ecnin lart e poshtë, në një zyrë të madhe ku ishin shtruar tapete mëndafshi, që shkëlqenin si stoli në rrezet e diellit të pasdites. Mbreti m’u afrua dhe më drejtoi në një kthinë, ku ndodhej një divan i madh me disa kolltukë, si dhe një ekran që e mbronte kthinën nga vështrimet e rojeve.”

Ata që e kanë njohur dhe vëzhgues të huaj e vizatojnë atë gjithnjë si një njeri mosbesues. Pietro Kuarone, kujton se mënyra më e mirë për t’i marrë diçka atij ishte t’i thoshe ekzaktësisht të kundërtën. Ai kujton se në një moment intimiteti gjatë bisedimeve e pyeti Mbretin se përse i zgjaste bisedimet?

“Sepse nëse unë ju jap sot një gjë, ju do të kërkonit nesër një tjetër. E kështu me radhë, ju përgjigj Mbreti!”

Sejfi Vllamasi, një prej miqve e më pas i kundërshtarëve të tij të mëdhenj, në fund të jetës, në kujtime e përshkruan kështu Ahmet Zogun:

“Zogu ka qenë një tip realist, për të cilin si ndjenja, ashtu edhe ana morale e çështjes s’ka patur kuptim. Shoqëria, miqësia dhe intimiteti kishin një farë vlere për të kur këto i shërbenin interesit të tij. Ai vrasjen e pranonte si një mjet jo të keq kur shtrëngohej ta përdorte atë kundër rivalëve të rrezikshëm që pengonin qëllimet e tij...”

Për fatin e tij të keq, vitet e gjata në pushtet dhe dëshira për t’u rrethuar nga servilë e shkëputën atë nga realiteti në vend. Siç dëshmon sërish Vllamasi:

“Zogu ndiente kënaqësi të madhe kur lavdërohej e brohoritej prej veglave e dallkavëve të tij, por nga ana tjetër, gjatë katër vjetëve bashkëpunimi asnjëherë s’kam dëgjuar nga goja e tij fjalë mburrjeje ose lavdrimi për veten e tij...”

Në prag të vdekjes, një prej njerëzve që e ka njohur mirë, Eqrem bej Vlora, e portretizon atë kështu:

“Inteligjenca natyrore e këtij njeriu ishte e mahnitshme. Edhe kur ia donte puna të gjykonte dhe zgjidhte probleme shumë të vështira dhe të huaja për të, ai rrallë gabonte. Sikundër edhe në shoqëri me njerëz shumë më të kulturuar ai nuk bënte kurrë figurë të keqe. Por përveç inteligjencës, ajo që i jepte atij epërsi të padiskutueshme mbi gjithë të tjerët ishte mungesa e çdo ndjesie. Ahmet Zogu as ka dashuruar, as ka urryer kurrë. Veprimi dhe sjellja e tij i nënshtroheshin gjithnjë kontrollit të një mendjeje të ftohtë dhe praktike, udhëhiqeshin gjithnjë dhe vetëm prej interesave të tij...”

PUSHTIMI I SHQIPËRISË

“Lajmi nga Beogradi thotë se Çiano ka rënë dakord me dr.Milan Stojanoviçin (Kryeministrin e Jugosllavisë) për ta ndarë Shqipërinë më dysh, duke mbajtur pjesën më të madhe për vetë. Kjo ide ishte kundërshtuar nga qarqe të përgjegjshme jugosllave, të cilat mendojnë se minoriteti shqiptar në vendin e tyre është shumë i madh dhe do të ishte çmenduri të doje ta zmadhoje këtë shifër. Synimet italiane për mësymje tani janë të qarta”.

Ky ishte telegrami që Mbreti Zog kishte mbi tavolinën e punës më 8 shkurt 1939. Telegrami i referohej vizitës së Çianos në Beograd dhe konfirmonte komentet e shtypit britanik se Jugosllavia kishte rënë dakort në parim për pushtimin e Shqipërisë nga Italia. Ajo që Zogu nuk dinte dhe nuk përcaktonte dot, ishte koha kur Italia do të hidhej në veprim dhe mjetet që do të përdorte. Duket se është Çiano që ka një përgjigje më të qartë për këtë gjë.

5 mars, 1939

Ngjarjet precipituan gjatë natës... trupat gjermane filluan pushtimin e Bohemisë... Është e kotë të mohosh që të gjitha këto shqetësojnë dhe poshtërojnë popullin italian. Është e nevojshme t'i japim atyre kënaqësinë dhe kompensimin, Shqipërinë. Fola në lidhje me këtë me Duçen, të cilit i shpreha bindjen time se në këtë kohë nuk do të gjejmë pengesa vendore, as komplikime serioze ndërkombëtare në rrugën e avancimit tonë.

Ky shënim në ditarin e tij personal, të bërë publik vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, kur Ciano ishte pushkatuar ndërkohë nga gjermanët, është fillimi i rënies së Mbretit Zog. Nëse iu referohesh vetë shënimeve të Cianos, rrëzimi i tij kishte nisur kohë më parë, që kur Mbreti Zog preferoi një Mbretëreshë nga Europa Qendrore, ku mendonte se ndërlikimet politike do të ishin më të vogla. Duke zgjedhur në vend të një princeshe italiane një trashëgimtare të Perandorisë Austro – Hungareze, Ciano mendonte se Zogu po tentonte t'i hapte rrugë ndikimit gjerman. Paranoja e pranisë gjermane në Shqipëri, duket qartë edhe në shënimet e ditarit të tij:

“I telefonova Makensenit (feldmareshalit H.V. von Makensen) dhe e informova se ne e konsiderojmë Shqipërinë si çdo provincë tjetër italiane dhe se çdo ndërhyrje gjermane do të ngjallte zemërim të madh në opinionin publik. Ky fakt, gjithashtu, provon se çështja me Shqipërinë duhet zgjidhur shumë shpejt. Serbët kanë hapur fjalë. Mbreti Zog është vënë në alarm. Do të marrë masa për të na u kundërvënë”.

Në fakt Zogu tentoi të merrte disa masa. Ai besoi deri momentin e fundit që do të gjente një zgjidhje. Në mes të shkurtit ai dërgoi me një mision sekret në Romë, gjeneral Serreqin. Po atë natë i deklaroi Geraldinës:

“Duhet të dërgoj gjeneral Serreqin t'i çoj, personalisht, një mesazh Cianos. Sot Shqipëria është në duart e italianëve që kontrollojnë çdo sektor jetësor të shtetit. Mbreti i nderon ata dhe i dëgjon. Populli të është mirënjohës. E ç'kërkon më tepër Italia? Italianët ia dëgjojnë shumë fjalën Serreqit, ai vetë është filoitalian. Ai është i bindur se në kushtet që jemi nuk kemi se ç'qëndrim të mbajmë veç miqësisë dhe aleancës me Italinë. Kjo është e vërtetë, me kusht që ata të mos kërkojnë asgjë kundër pavarësisë dhe sovranitetit të Shqipërisë.”

Raporti i ndërlikuar mes Zogut dhe italianëve nis që në vitin 1926, kur si President i Republikës, kishte nënshkruar një protokoll që u jepte italianëve shumë të drejta në këmbim të një kredie të majme me të cilën Zogu mbajti në këmbë qeverisjen.

Në fakt në shkurt të vitit 1939, kur Zogu priste një trashëgimtar, raportet me italianët kishin nisur të bëheshin dukshëm dhe hapur problematike. Pas pushtimit gjerman të Bohemisë, pushtimi shqiptar ishte vendosur ndërkohë, siç dëshmon sërish në ditarin e tij konti Ciano më 23 mars të 1939-ës:

Duçja ka vendosur të lëvizë më shpejt për çështjen shqiptare, dhe ai vetë ka hartuar marrëveshjen e planifikuar, e cila është shumë e shkurtër, e përbërë nga tre pika të thata, që të japin më shumë përshtypjen e një akt-pushtimi, se sa të një pakti ndërkombëtar... Ose Zogu pranon kushtet që ne kemi vënë para tij, ose ne do të ndër-marrim pushtimin ushtarak të vendit.

Por Ciano, ashtu si Musolini kishte një problem. Ai donte që aneksimi i Shqipërisë të bëhej jo si akt agresioni, por si bashkim vullnetar. Musolini nuk preferonte që Italia të niste e para agresionin në Europë, ndryshe nga Gjermania që deri atë ditë e kishte bërë pa armë aneksimin e Austrisë dhe të Bohemisë. Më 28 mars, Ciano shkruante në ditar:

“Megjithatë, makina është në lëvizje dhe nuk mund të ndalojë. Ose ajo do të funksionojë me Zogun, ose ndryshe, kundër tij. Për shumë arsye, kryesisht për shkak se ne italianët nuk duam të jemi të parët që të fillojmë luftën në Europë, unë do të preferoja alternativën e parë, por nëse Zogu nuk dorëzohet, do të jetë e nevojshme të përdorim armët.”

Ato ditë Musolini kishte marrë një letër nga Kryeministri Britanik, Çambërlen, që e pyeste se si po shkonte situata delikate në Europë dhe ç'rol do të luante Musolini. Ky i fundit, sipas ditarëve të Cianos, kishte vendosur t'i përgjigjej pas pushtimit të Shqipërisë. Ciano kish llogaritur që Mbreti Zog do të detyrohej të pranonte kushtet e Italisë, nisur edhe nga rrethanat familjare. Në datën 25 mars të vitit 1939 ai shkruante:

De Ferraris u nis për në Tiranë, duke marrë me vete draft-marrëveshjen për protektoratin... me shumë gjasë Mbreti Zog do të

pranojë. Ka një fakt mbi të cilin unë i kam sytë, lindja e fëmijës së Zogut. Zogu e dashuron gruan e tij dhe në fakt tërë familjen e tij, shumë. Unë besoj se ai do të preferonte të siguronte një të ardhme të qetë për njerëzit e tij të dashur.

Po atë ditë Mbreti Zog ishte duke pritur në një takim përfaqësuesin e Ministrisë së Jashtme Britanike, Thomas Hohler. Ky i fundit ishte dërguar për të mësuar se cili do të ishte reagimi i Mbretit në rast të një ultimatumit të mundshëm italian. Hohler e kishte njoftuar Zogun për vështirësitë që e prisnin, por pyetjes së Mbretit sesi do të reagoonte Britania e Madhe në rast të një agresioni mbi Shqipërinë, ai iu përgjigj:

“Ne do të veprojmë sipas qëndrimit që do të mbajnë për këtë çështje aleatët tanë, Athina dhe Beogradi.”

Në një dokument sekret për Departamentin e Shtetit, ambasadori amerikan në Tiranë, Grant, riprodhon fjalët që Mbreti Zog i tha gjatë takimit të fundit në lidhje me ndihmën ndërkombëtare për Shqipërinë nën agresion:

“Mbreti tha se nuk kishte marrë asnjë përgjigje nga asnjëri prej vendeve ballkanike, me përjashtim të një mesazhi nga Beogradi, ku thuhej se qeveria jugosllave besonte se kjo manovër e Italisë ishte një bllof dhe se Italia nuk kishte ndërmend ta pushtonte Shqipërinë. Ai shtoi se nuk kishte marrë ndonjë inkurajim për t’i rezistuar pushtimit italian as nga Britania dhe as nga Franca. (Në lidhje me këtë, ministri britanik, Sër Andreë Ryan më informoi pas krizës se, gjatë një audience me Mbretin Zog më 9 mars, Mbreti e kishte pyetur se çfarë do të kishte bërë Britania nëse zërat për ndërhyrjen italiane dilnin të vërteta. Sër Andreë i kishte thënë se, meqenëse kjo ishte një pyetje hipotetike, ai nuk do t’i përgjigjej zyrtarisht, por mendimi i tij personal ishte se Anglia nuk do të bënte asgjë.)”

Grant ishte thirrur urgjent në zyrën e Mbretit Zog më 6 Prill 1939, në ora 12:30 mbasdite. Veç njoftimit urgjent, pak kohë më pas, ambasadori nisi një raport të hollësishëm që i gjetur në arkivat e

Uashingtonit 83 vjet më vonë nga studiuesi Ilir Ikonomi shërben si dokument brilant për të vërtetuar atë që po ndodhte ato ditë. Veç ofertës për të strehuar në ambasadën e SHBA-ve Geraldinën në prag të lindjes, ambasadori Grant nuk mund t’i ofronte asnjë lloj ndihme tjetër Shqipërisë.

Italia e kishte fituar betejën ndërkombëtare. Kishte mbyllur llogarinë jo vetëm me Britaninë e Madhe, por edhe me fqinjët. Siç dëshmon Ciano më 29 mars 1939:

“Askush nuk do të protestojë, as Jugosllavia... Këtë mbrëmje bisedova gjatë me Christiç-in... Nuk kishte asnjë kundërshtim, ai propozoi si kusht vetëm që Shqipëria të mos përdoret për sulm ndaj Jugosllavisë.”

I braktisur nga Fuqitë e Mëdha, Zogu tentoi të fitonte kohë. Dërgoi në Romë për bisedime adjutantit e tij, Zef Serreqin. Ky i fundit i rrëfeu përpara nisjes se kishte marrë para nga italianët, ashtu si shumë funksionarë të tjerë të shtetit shqiptar. Zogu i kërkoi Serreqit një favor. Me të marrë vesh ditën e pushtimit, 24 orë përpara t’i dërgonte një telegram dorëheqjeje. Në këtë mënyrë do të ishte i informuar.

Më 5 mars kishte përgatitur një plan për mbrojtjen e vendit, por ai nuk funksionoi në asnjë drejtim. Më 30 mars Shqipëria u përfshi nga demonstrata masive që kërkonin mbrojtjen e vendit. Më 6 Prill në orët e para të mëngjesit, ambasadori Grant i shkruante Uashingtonit:

“Pak para orës 20:00 të së enjtes, demonstruesit u larguan nga sheshi i Tiranës dhe marshuan drejt disa prej legatave, duke përfshirë atë amerikane. Rreth dymijë nga këta të rinj, me flamuj të mëdhenj shqiptarë në duar, hynë në kompleksin e legatës në orën 20:00 dhe parakaluan në territorin e saj, duke thirrur në gjuhën shqipe: “Rroftë Shqipëria! Rroftë liria jonë! Rroftë Amerika dhe Presidenti Roosevelt!” Qëndrova me disa anëtarë të stafit tek shkallët e legatës dhe i përshëndeta demonstruesit me mënyrën shqiptare...Thirrjet e këtyre të rinjve simbolizonin ndjesinë se një padrejtësi pa kurrfarë

shkaku përgatitej të kryhej kundër një populli të pambrojtur. Në qoftë se ata nuk kishin mundësi ta përballonin forcën me forcë, të paktën mund ta kundërshtonin me thirrjet e protestës. Por këto ishin thirrje dëshpërimi.”

Zogu doli vetë në ballkon, në orën 22:00, për të mbështetur protestuesit dhe për t'i siguruar se nuk do t'i braktiste. Ai kish vendosur të mos dorëzohet. Siç dëshmon Ciano më 31 mars, të 1939-ës:

“Duket se Mbreti ka vendosur të refuzojë nënshkrimin e një traktati, i cili zyrtarisht dhe në thelb shkel integritetin dhe sovranitetin e Shqipërisë. Lajme nga Tirana konfirmojnë faktin se mbreti po përgatitet për të rezistuar, një fakt që më mërzi shumë, sepse e konsideroj mjaft të rrezikshme të hapë zjarrin e parë në këtë Europë të trazuar dhe të ndezur.”

Po më 31 mars Françesko Jakomoni, ambasadori italian kërkoi një takim me Mbretin, sapo mbërriti në aeroportin e Tiranës. Ai e priti në ora 10:00. Jakomoni i sqaroi se marrëveshja e ofruar nga Musolini ishte rishikuar nga vetë Duçja dhe oferta ishte përmirësuar. Mbreti lutej vetëm të pranonte 2 divizione italiane këmbësorie dhe një të motorizuar në territor shqiptar, si dhe njësi të vogla në disa nga portet kryesore. Mbreti deklaroi se do ta shqyrtonte kërkesën, por se kjo nuk i dukej me vend, sepse Pavarësia e Shqipërisë nuk kërcënohej nga asnjë vend fqinjë. Nëse kjo ndodhte ai do të kërkonte ndihmën ushtarake italiane.

Jakomoni sapo doli, kur ministri i Brendshëm që hyri pas tij, Musa Juka, e njoftoi se italianët dinin çdo urdhër që Mbreti kish dhënë për xhandarmërinë dhe ushtrinë shqiptare. Mbi të gjitha ata zotëronin shifrën e ndërlidhjes dhe të dhëna të sakta për ushtrinë dhe lëvizjet e saj.

Mëngjesin e 1 prillit të vitit 1939, ambasadori shqiptar në Berlin, Rauf Fico dërgoi një telegram urgjent në adresë të Mbretit. Ai e sqaronte se Gjermania i sugjeronte Mbretit të pranonte ofertën italiane për të shmangur kështu një “situatë të komplikuar”. Sipas dokumenteve diplomatike gjermane:

“Rauf Fico, ambasadori shqiptar në Gjermani, i udhëzuar nga qeveria, kërkoi të informohet më 5 prill 1939 pranë MPJ gjermane mbi qëndrimin gjerman. Nënsekretari i Shtetit Ernst Woermann gjatë bisedës bëri të qartë se Shqipëria të mos priste ndonjë ndihmë nga Gjermania.”

Po atë mbasdite Beogradi sugjeroi zyrtarisht një qëndrim të ngjashëm. Qëndrimi u bë edhe më armiqësor më 4 prill, kur komandanti i Ushtrisë Jugosllave në Dibër të Madhe, i komunikoi zyrtarisht prefektit të Dibrës, Kol Mjeda se në rast konflikti, ushtria jugosllave do ta konsideronte kërcënim çdo lëvizje ushtarake 15 km nga kufiri dhe në një rast të tillë, do të hynte, si masë mbrojtëse, 15 – 20 km në brendësi të territorit shqiptar. Kjo deklaratë u përsërit edhe në Shkodër, nga komandanti ushtarak i Podgoricës. Po në datën 1 prill të 1939-ës, Ciano shkruante në ditarin e tij:

“Gjatë pasdites, Sereqi, ministri i ri shqiptar, erdhi të më takonte. Ai tha se ishte dakord me ne.... Sereqi vendosi të niset për në Tiranë me Jacomonin, në mënyrë që të bindë Mbretin. Pastaj, me pretekstin se nuk ishte në gjendje të shkëmbente paratë e tij shqiptare, i kërkoi Jacomonit t'i jepte hua 15.000 lireta, si kësti i parë i një ryshfeti!”

Në datën 5 prill, në orën 5 të mëngjesit, Mbretëresha Geraldina lindi djalë. Ajo e kujton kështu momentin kur Mbreti hyri të shihte foshnjën e porsalindur:

“Mbreti hyri në dhomë duke mbajtur një kuti të gjatë prej palisandre. E vendosi në tavolinën pranë shtratit, e hapi dhe nxori një pistoletë bronzi. Ishte një armë e vjetër shqiptare, vepër arti, me dorezë fildishi të gdhendur me mjeshtëri. Mbreti e vuri pistoletën pranë foshnjës, pastaj ia mori dorën e vockël dhe ia vendosi pranë dorezës së armës. -U bëfsh i fortë dhe trim si paraardhësit e tu! - e uroi. E pushtoi heshtja dhe lotët.”

Trashëgimtari i Fronit u quajt Princ Leka dhe 101 topa përshëndetën lindjen e tij. Leka do të ishte princ i vërtetë për vetëm 48 orë. Më 7 prill ai do të largohej nga Shqipëria, për t'u kthyer aty

përfundimisht në moshën 63 - vjeçare, pasi kishte jetuar në 18 vende të ndryshme të botës. I larguar nga fronti ai ndërroi jetë në pallatin e hallave të tij në qendër të Tiranës, në nëntor të vitit 2011.

Në ora 10:00, Mbreti po përshëndeste nxënëset e shkollave të mesme femërore që po parakalonin për nder të lindjes së trashëgimtarit, kur ministri i Jashtëm, Eqrem Libohova, i kërkoi një takim urgjent. Zogu nuk u befasua nga ajo që ai i lëshoi mbi tavolinë. Ishte ultimatumi i Kryeministrit italian, Benito Musolini, që e priste nga dita në ditë. Ultimatumi prej 14 pikash përqendrohej kryesisht në këto 7 pika:

“Italia me kërkesë të Shqipërisë i jep Mbretërisë së Shqipërisë protektoratin e saj dhe i siguron mbretit Zog dhe trashëgimtarëve të tij, fronin e Shqipërisë.

Italia merr përsipër të mbrojë integritetin dhe Pavarësinë e Shqipërisë në bashkëpunim me forcat ushtarake shqiptare dhe për këtë qëllim ka të drejtën të vendosë forcat e saj ushtarake në ato zona që do të gjykohen me marrëveshje midis palëve, të domosdoshme për mbrojtjen e vendit.

Përfaqësuesi diplomatik dhe konsullor italian në vendet e huaja, do të ngarkohen me mbrojtjen e interesave të Mbretërisë së Shqipërisë dhe të shtetasve të saj.

Italia do të mbajë në Shqipëri, një komisar të lartë që do të marrë rangun e dytë, pas kryetarit të shtetit dhe do të ketë si funksion harmonizimin e politikës shqiptare me politikën italiane.

Italia i njeh Shqipërisë bashkimin doganor dhe monetar.

Simbolet e shtetit shqiptar do të mbahen ashtu si janë, por duke i shtuar fashion Litorio tek e cila do të mbështetet shqiptonja e Shqipërisë.

Italia i siguron Mbretit Zog dhe trashëgimtarëve të tij të ligjshëm një listë civile prej 3 milion lirash në vit.”

Mo zbatimi i tyre do çonte në hyrjen me forcë të trupave italiane në Shqipëri. Kishte vetëm 24 orë kohë të përgjigjej.

Zogu reagoi me qetësi. Në ora 14:00 një mbledhje e përbashkët e Asamblesë Kombëtare dhe Qeverisë e hodhi poshtë ultimatumin italian si të papranueshëm dhe e konsideroi akt agresioni. Ajo rivotëbesoi qeverinë me Koço Kotën Kryeministër. Ndërkohë Tirana

dhe qytetet e tjera të Shqipërisë zienin nga demonstratat e rinisë që kërkonte armë për të mbrojtur vendin. Zogu fillimisht i kishte përshëndetur edhe vetë demonstratat, por më pas i kish frenuar ato. Këshilltarët i kishin thënë se demonstratat po instrumentalizoheshin nga italianët për të nxitur një frymë kundër Romës që më pas ta shfrytëzonin si pretekst për ndërhyrjen ushtarake. Demonstratat qenë ndezur në fakt edhe më shumë nga avionët italianë që mëngjesin e 6 prillit kishin hedhur me mijëra fletushka kundër Mbretit dhe pro Italisë në territorin shqiptar.

Në orën 2 të natës, midis 5 dhe 6 prillit, Mehmet Konica, ish-përfaqësuesi i Qeverisë së Vlorës, në Londër, në vitin 1913, kërkoi të takonte urgjent Mbretin. Ky e priti në apartamentin e tij. Konica i sqaroi Mbretit se ambasadori jugosllav në Tiranë, i kishte deklaruar në mënyrë informale, por për të vënë në dijeni Mbretin se ministri i Jashtëm, Markoviç, kishte sugjeruar që në rast të një sulmi të Italisë mbi Shqipërinë, kufiri do të mbyllej. Jugosllavia nuk do të lejonte asnjë zyrtar shqiptar që të kalonte në territorin e saj.

Mbreti thirri Kryeministrin Koço Kota dhe diskutoi me të fatin e Mbretëreshës. Ata vendosën t’i kërkojnë Parlamentit që të merrte vendim për strehimin e saj në një vend tjetër, pasi Tirana nuk ishte më e sigurt. Të gjithë e dinin që gjithçka ishte tani çështje orësh.

Më 6 prill mbledhja e Këshillit të Ministrave që drejtohej nga Mbreti u ndërpre nga një lajm urgjent. Benito Musolini kish dërguar një ultimatum të fundit. Ultimatumi niste në orën 14:00 dhe Mbreti Zog kishte 5 orë kohë për të pranuar kushtet e Italisë. Në ora 19:00 Italia do të merrte vendimin për të ndërhyrë ushtarakisht.

3 orë më vonë, në ora 5 mbasdite, ministri Eqrem Libohova solli telegramin e Zef Serreqit që e njoftonte për dorëheqjen e tij. Ishte shenja që sulmi italian do të fillonte brenda 24 orëve. Orën e saktë nuk e dinte askush. Në ato momente, atë ishte duke e vendosur Kryeministri Benito Musolini dhe Konti Ciano. Ky i fundit, po sqaronte se do të fluturonte edhe vetë mbi Tiranë me bombarduesin e tij.

Në orën 12:30 të datës 6 Prill 1939, ambasadori amerikan Grant mbërriti në Pallatin Mbretëror. Ai i shkruan Departamentit të Shtetit:

përfundimisht në moshën 63 - vjeçare, pasi kishte jetuar në 18 vende të ndryshme të botës. I larguar nga fronti ai ndërroi jetë në pallatin e hallave të tij në qendër të Tiranës, në nëntor të vitit 2011.

Në ora 10:00, Mbreti po përshëndeste nxënëset e shkollave të mesme femërore që po parakalonin për nder të lindjes së trashëgimitarit, kur ministri i Jashtëm, Eqrem Libohova, i kërkoi një takim urgjent. Zogu nuk u befusua nga ajo që ai i lëshoi mbi tavolinë. Ishte ultimatumi i Kryeministrit italian, Benito Musolini, që e priste nga dita në ditë. Ultimatumi prej 14 pikash përqendrohej kryesisht në këto 7 pika:

“Italia me kërkesë të Shqipërisë i jep Mbretërisë së Shqipërisë protektoratin e saj dhe i siguron mbretit Zog dhe trashëgimtarëve të tij, fronin e Shqipërisë.

Italia merr përsipër të mbrojë integritetin dhe Pavarësinë e Shqipërisë në bashkëpunim me forcat ushtarake shqiptare dhe për këtë qëllim ka të drejtën të vendosë forcat e saj ushtarake në ato zona që do të gjykohen me marrëveshje midis palëve, të domosdoshme për mbrojtjen e vendit.

Përfaqësuesi diplomatik dhe konsullor italian në vendet e huaja, do të ngarkohen me mbrojtjen e interesave të Mbretërisë së Shqipërisë dhe të shtetasve të saj.

Italia do të mbajë në Shqipëri, një komisar të lartë që do të marrë rangun e dytë, pas kryetarit të shtetit dhe do të ketë si funksion harmonizimin e politikës shqiptare me politikën italiane.

Italia i njeh Shqipërisë bashkimin doganor dhe monetar.

Simbolet e shtetit shqiptar do të mbahen ashtu si janë, por duke i shtuar fashion Litorio tek e cila do të mbështetet shqiponja e Shqipërisë.

Italia i siguron Mbretit Zog dhe trashëgimtarëve të tij të ligjshëm një listë civile prej 3 milion lirash në vit.”

Mo zbatimi i tyre do çonte në hyrjen me forcë të trupave italiane në Shqipëri. Kishte vetëm 24 orë kohë të përgjigjeje.

Zogu reagoi me qetësi. Në ora 14:00 një mbledhje e përbashkët e Asamblesë Kombëtare dhe Qeverisë e hodhi poshtë ultimatumin italian si të papranueshëm dhe e konsideroi akt agresioni. Ajo rivotëbesoi qeverinë me Koço Kotën Kryeministër. Ndërkohë Tirana

dhe qytetet e tjera të Shqipërisë zienin nga demonstratat e rinisë që kërkonte armë për të mbrojtur vendin. Zogu fillimisht i kishte përshëndetur edhe vetë demonstratat, por më pas i kish frenuar ato. Këshilltarët i kishin thënë se demonstratat po instrumentalizoheshin nga italianët për të nxitur një frymë kundër Romës që më pas ta shfrytëzonin si pretekst për ndërhyrjen ushtarake. Demonstratat qenë ndezur në fakt edhe më shumë nga avionët italianë që mëngjesin e 6 prillit kishin hedhur me mijëra fletushka kundër Mbretit dhe pro Italisë në territorin shqiptar.

Në orën 2 të natës, midis 5 dhe 6 prillit, Mehmet Konica, ish-përfaqësuesi i Qeverisë së Vlorës, në Londër, në vitin 1913, kërkoi të takonte urgjent Mbretin. Ky e priti në apartamentin e tij. Konica i sqaroi Mbretit se ambasadori jugosllav në Tiranë, i kishte deklaruar në mënyrë informale, por për të vënë në dijeni Mbretin se ministri i Jashtëm, Markoviç, kishte sugjeruar që në rast të një sulmi të Italisë mbi Shqipërinë, kufiri do të mbyllej. Jugosllavia nuk do të lejonte asnjë zyrtar shqiptar që të kalonte në territorin e saj.

Mbreti thirri Kryeministrin Koço Kota dhe diskutoi me të fatin e Mbretëreshës. Ata vendosën t'i kërkojnë Parlamentit që të merrte vendim për strehimin e saj në një vend tjetër, pasi Tirana nuk ishte më e sigurt. Të gjithë e dinin që gjithçka ishte tani çështje orësh.

Më 6 prill mbledhja e Këshillit të Ministrave që drejtohej nga Mbreti u ndërpre nga një lajm urgjent. Benito Musolini kish dërguar një ultimatum të fundit. Ultimatumi niste në orën 14:00 dhe Mbreti Zog kishte 5 orë kohë për të pranuar kushtet e Italisë. Në ora 19:00 Italia do të merrte vendimin për të ndërhyrë ushtarakisht.

3 orë më vonë, në ora 5 mbasdite, ministri Eqrem Libohova solli telegramin e Zef Serreqit që e njoftonte për dorëheqjen e tij. Ishte shenja që sulmi italian do të fillonte brenda 24 orëve. Orën e saktë nuk e dinte askush. Në ato momente, atë ishte duke e vendosur Kryeministri Benito Musolini dhe Konti Ciano. Ky i fundit, po sqaronte se do të fluturonte edhe vetë mbi Tiranë me bombarduesin e tij.

Në orën 12:30 të datës 6 Prill 1939, ambasadori amerikan Grant mbërriti në Pallatin Mbretëror. Ai i shkruan Departamentit të Shtetit:

“Mbreti, i cili m’u duk më i dobët se zakonisht, kishte veshur një xhaketë prej stofë ngjyrë blu dhe këmishë e kollare që i shkonin me kostumin. Më përshëndeti me përzemërsinë e zakonshme, më bëri shenjë të ulesha dhe më zgjati një cigare. Ne e pinim të dy duhanin. Gjatë bisedës, e cila zgjati rreth dyzet e pesë minuta, Mbreti i bëri një përshkrim gjendjes politike.”

Grant dëgjoi nga Mbreti të gjitha pretendimet e italianëve dhe shpjegimin e tij se nëse ato pranoheshin vendi humbiste pavarësinë. Grantit ju komunikua zyrtarisht se Qeveria Shqiptare i kishte hedhur poshtë këto pretendime dhe Mbreti i dha një mesazh me gojë për Presidentin Ruzvelt. Ai rikonfirmonte edhe njëherë mbështetjen e Shqipërisë dhe bënte parashikimin e zymtë, që ky ishte vetëm fillimi. Sipas Grant, Mbreti iu përgjigj prerë pyetjes së cili do të jetë reagimi i Shqipërisë në rast sulmi:

“Kam urdhëruar mobilizimin e përgjithshëm dhe evakuimin e popullatës civile të Durrësit, ku, qysh tani shumë shtëpi janë marrë nga ushtria. Meqenëse kam pak trupa, kam dërguar vetëm dy batalione në Vlorë. Forcat e tjera të mbrojtjes janë civile, të cilëve u janë shpërndarë armë. Kam dërguar ushtarë në të gjitha qytetet, por natyrisht, numri ynë është i vogël dhe ne nuk mund t’u bëjmë ballë gjatë forcave të fuqishme. Qëndresa jonë do të jetë një protestë kundër agresionit italian dhe një demonstrim përpara botës se shqiptarët mund të vdesin me trimëri dhe me nder dhe jo të dorëzohen si çekoslovakët.”

Grant shkruan se ai e mbante veten dhe vetëm një moment tregoi dobësi:

“Kur Mbreti foli për atë që e përshkroi si një “çast delikat, pikërisht kohën kur Mbretëresha kishte lindur fëmijën”, që italianët kishin zgjedhur për t’i bërë atij trysni, ai e hodhi vështrimin jashtë dritares dhe me vështirësi i mbajti lotët, që po i mbushnin sytë. Mendova për një çast se do të thyhej, por ai shpejt e rifitoi qetësinë, e cila ishte e dukshme gjatë gjithë audiencës.”

Grant doli nga Pallati Mbretëror Shqiptar në ora 13:20 minuta. Ai ishte në ambasadë kur dëgjoi në radio fjalimin e Mbretit. Fjalimi ishte dhe qëndrimi zyrtar i Shqipërisë ndaj ultimatumit italian. Në orën 19:00, pikërisht në atë minutë, që skadonte ultimatumit i Italisë, Mbreti Zog lexoi në radio Tirana këtë deklaratë me zërin e tij:

“Italia i ka bërë Shqipërisë disa kërkesa që, nëse do të plotësoheshin, do t’i hiqnin vendit tonë Pavarësinë.

Unë dhe qeveria ime nuk do të pranojmë kurrë kushte të tilla që kanë për qëllim minimin e lirisë së fituar me gjakun e popullit. Përballë pushtimit, e ftoj popullin shqiptar të bashkohet sot, në këtë moment rreziku, të mbrojë sigurinë e vendit dhe pavarësinë e tij deri në pikën e fundit të gjakut. Unë jam i bindur se populli shqiptar, i vogël në numër, por i madh në shpirt e guxim, do të dijë të tregojë ato ndjenja të larta nacionaliste që kanë frymëzuar atë dhe paraardhësit e tij.

I bindun, që një komb i bashkuar në këtë frymë, do të ketë mbështetjen e Zotit, u bëj thirrje të gjithë shqiptarëve të mos e humbin guximin dhe dashurinë për atdheun. Rroftë Shqipëria! Rroftë Populli shqiptar!

Zogu I, Mbret i Shqiptarëve, 6 prill 1939.

Ishte komunikimi i fundit publik i Mbretit me shtetasit. Ishte deklarata e fundit si kreu i shtetit shqiptar. Pak orë më pas, afër mesnatës, komandanti i përgjithshëm i Mbrojtjes Kombëtare, Xhemal Aranitasi, i kërkoi takim urgjent. Ai i vendosi mbi tavolinë një zarf. Ishte dorëheqja nga detyra. Po në ato momente ushtria italiane, e hipur në anije, qe nisur drejt bregdetit shqiptar.

Në mëngjes herët ata hodhën mbi Tiranë, Durrës, dhe Vlorë qindra mijëra fletë më një thirrje ku shkruhej:

“Shqiptarë!

Ushtarët italianë që po zbarkojnë sot në territorin tuaj janë ushtarë të një populli, i cili ka qenë miku juaj në shekuj dhe ju ka dhënë prova për këtë miqësi. Mos bëni rezistencë të kotë, e cila do të shtypet. Mos dëgjoni njerëzit e qeverisë suaj, të cilët ju kanë varfëruar dhe duan që tani ju të derdhni kot gjakun tuaj. Trupat e Madhërisë

së Tij, Mbretit të Italisë dhe Perandorit po vijnë dhe do të qëndrojnë aq sa është nevoja për të rivendosur rregullin, drejtësinë dhe paqen.”

Në ora 4 të mëngjesit, të datës 7 prill 1939, Mbretëresha Geraldinë, në gjendje të rënduar shëndetësore, princi i sapolindur Leka dhe një numër i madh shoqëruesish u nisën për në Korçë. Parlamenti kishte aprovuar nisjen e tyre, pak pas mesnate. Ai pati autorizuar që në kushte më të vështira, Mbretëresha të largohej jashtë vendit për në Greqi. Një makinë Mercedes u adoptua me një barelë ku qëndronte Geraldina:

“Makinat hynë në oborrin e Pallatit dhe valixhet ishin bërë gati. Gjithsecili hipi në makinën që i ishte caktuar dhe priste. Dy shërbyesit e Mbretit mbartën në krah Mbretëreshën e zbehtë si meit, të shtrirë mbi një dyshek, nga shkallët e mëdha deri tek makina tip Chrysler që ishte përshtatur për të.

Sapo vargani me makina la pas Shqipërinë, Mbretëresha mblodhi të gjitha forcat dhe urdhëroi makinën të ndalej. Hoqi disa stoli nga njëra qese dhe kërkoi që ajo të mbushej me dhé. Dheu u vendos në varrin e Mbretit Zog, 22 vjet më pas në Paris.”

Karvani me Mbretëreshën mori rrugën e Elbasanit në qetësi. Zogu i përcolli vetë dhe vijoi të shëtiste ende në oborr me Kryeministrin Koço Kota dhe me ministrin e Jashtëm, Eqrem Libohova. Ende nuk ishte zbardhur kur ai mori raportet e para nga rojet kufitare. Teksti dhe shënimet e tyre të marra me nxitim e sipër në telefon ishin këto:

-Saranda raporton: Flota Italiane hyri në portin e Sarandës dhe filloi shkarkimin në tokat tona. Kam në dispozicion vetëm një togë, ushtarë të rojës së kufirit. Luftën e fillova. Kam për të bërë detyrën, për të vdekur për mbret e atdhe. Rroftë Mbreti e rroftë Shqipëria! Togër Taifur Dibra.

-Vlora raporton: Flota Italiane tani filloi bombardimet prej detit e ajrit dhe shkarkoi në portin e Vlorës e Karaburun. Luftën e fillova vetëm me një kompani ushtarake të rojeve të kufirit nën komandën e kapiten, Dodë Nikollës e 50 xhandarësh. Asnjë fuqi tjetër akoma nuk

kam. Jam duke u tërhequr ndër shpatet e Sevasterit e të Llogorasë, për sistemimin e ndërlydhjeve me fuqitë tona që po i presim orë më orë. Rroftë Mbreti! Rroftë Shqipëria! Kolonel Ali Rizaja.

-Durrësi raporton: “Flota italiane ka rrethuar Durrësin dhe hyri në port. Janë më se 30 copë anije në Durrës, Porto Romano e zonat e Banjavet. Nuk patëm kohë për të minuar portin. Ne do të bëjmë detyrën, aviacioni po na dëmton shumë. Urdhëroni komandën e Shijakut që të na vijnë në ndihmë e sidomos të sigurojë zonjën e Banjavet. Tani që po raportoj filloi bombardimi dhe mitralozat, dhe u ndërpre telefoni. Lufta vazhdon, por menjëherë dërguam një stacion radio R3 në Shijak. Major Abaz Kupi.

-Shëngjini raporton: Flota italiane filloi shkarkimin në zonat e Shëngjinit, luftën e filluam me një togë ushtarësh të rojeve të kufirit, nën komandën e togër Mark Jakut dhe 30 xhandarëve. Jemi në pritjen e ndihmave dhe jemi duke luftuar në afërsi të Kokarriqit. Do ta vazhdojmë deri në fund. Rroftë Mbreti! H.Bekteshi dhe togër M.Jaku.

Një numër i vogël xhandarësh, rojesh bregdetare dhe pak vullnetarë arritën të luftojnë atë ditë për thujse 10 orë. Një mbrojtje më e organizuar mund të kishte qenë katastrofë për Italinë dhe do ta kishte ngritur lart emrin e Shqipërisë. Gjithsesi trupat e Musolinit u pritën me luftë. Zyrtarisht 11 ushtarë italianë u vranë dhe dhjetëra të tjerë u plagosën atë ditë në portet shqiptare. 21 ushtarë dhe vullnetarë shqiptarë humbën jetën. Por ambasadori amerikan në Tiranë, një dëshmitar okular, njofton Uashingtonin se numri është shumë më i madh:

“Numri i të vrarëve në Durrës nuk u bë kurrë i ditur, me sa duket për shkak të synimit të italianëve për të mbuluar humbjet e vërteta. Ata pretendojnë se humbjet e tyre ishin shumë të vogla, vetëm 11 të vrarë dhe 43 të plagosur. Ky njoftim është natyrisht i pavërtetë, sipas rrëfimeve të disa dëshmitarëve. Një kapiten i ri shqiptar i korpusit mjekësor, i cili ishte me trupat në Durrës dhe në Shijak, më ka informuar kohët e fundit se në Durrës të vrarët ishin të paktën 200 e ndoshta shumë më tepër nga italianët dhe 35 ose 40 nga shqiptarët. Ai tha se praktikisht, e gjithë kompania që zbarkoi e para, ose rreth 150 italianë, u asgjësua, kryesisht nga njëri prej tre mitralozëve

shqiptarë, i vendosur në një park të vogël ngjitur me bankinën. Ai tha gjithashtu se pas tërheqjes së parë, anijet filluan të bombardojnë qytetin, ndërsa pas sprapsjes së dytë, shqiptarët u sulmuan me mitralozë nga rreth 50 aeroplanë.”

Rezistenca vijoi gjatë gjithë datës 7 Prill. Shqipëria u bë vendi i parë i Europës që iu përgjigj me armë një agresioni. Austria dhe Çekosllovakia përpara saj, nuk kishin rezistuar.

Në Ora 6:30 të datës 7 prill, Eqrem Libohova njoftoi Fuqitë e Mëdha dhe lidhjen e kombeve për sulmin. Ai nuk mori asnjë përgjigje. Madje as konfirmimin se telegramet u vendosën mbi tryezat e punës së Kryeministrave të Europës. Por nëse të gjitha fuqitë botërore mbyllën sytë, aprovuan në heshtje apo me miratim të hapur pushtimin e Shqipërisë, shtypi botëror, në të gjithë kontinentet u vu në mbrojtje të saj. Siç dëshmojnë këto copa gazetash:

“Journal Des Debats” - Vërtetohet sot se megjithëse lajmet që vijnë nga Italia përpriqen t’i paraqesin operationet të përfunduara pa asnjë kundërshtim, trupat italiane përkundrazi, gjetën një qëndresë të rreptë kur mbas shkatërrimit të qyteteve të zgjedhura si pika zbarkimi, filluan të zbresin në tokë.

“Le Journal” - Një fuqi detare e rëndësishme e përbërë prej 180 anijesh dhe 200 mijë ushtarësh pushtoi gjithë pikat kryesore të bregdetit shqiptar dhe vazhdon përparimin në thellësi. Aviacioni Italian i përbërë prej 400 aeroplanësh bombardoi rreptësisht qytetet, duke vrarë e masakruar gratë, fëmijët dhe pleqtë e pambrojtur. Disa qytete janë krejtësisht të shkatërruar.

Nga zelli për t’i dalë në krah Shqipërisë, disa prej tyre botuan edhe reportazhe të ekzaltuara si “The Times”:

”Mbreti Zog i Shqipërisë, i veshur me kostum kombëtar, udhëhiqte sot ushtrinë e tij në një luftë që do t’u ndalonte italianëve zbarkimin në Durrës. Zëra nga Tirana thanë se shqiptarët po qëndrojnë heroikisht dhe në shumë vende italianët janë detyruar të kërkojnë shpëtim në det. Duket se tratativa e parë italiane për të zbarkuar ka

qenë dramatike. Afro 20 oficerë italianë zbritën nga një varkë e një kryqëzori që ndodhej jashtë portit. Kur u kërkuan dokumentet ata u përgjigjën:-Kemi ardhur ta pushtojmë vendin tuaj. Disa pushkë u dëgjuan dhe u ndalua kalimi. Mbas kësaj, lufta filloi.”

Por gazeta si “The Daily Telegraph” që akuzuan ashpër Kryeministrin britanik, Cambërle, për dorëzimin e Shqipërisë i dedikuan asaj një editorial që fillon me këto fjalë:

“Shqipëria foli me një gjuhë të cilën Europa e kish humbur zakonin ta dëgjonte. Shqiptarët refuzuan të nënshtrohen dhe po vazhdojnë luftën. Pushtuesit u përballën me një qëndresë të fortë, por dje, sipas njoftimeve tona, po përparonin në thellësi të vendit.”

Në ora 11:30 në pallatin e Mbretit erdhi telegrami i Musolinit, në përgjigje të një kërkesë të Mbretit Zog. Ai i kërkonte mbretit të dërgonte përfaqësues pranë gjeneral Guxonit në Durrës për t’u marrë vesh.- Ekziston ende mundësia për një marrëveshje, - shkruante Musolini. Mbreti Zog nisi ministrin e Ekonomisë, Rrok Gerën dhe kolonel Sami Kokën. Forcat e mbrojtjes në Shijak u njoftuan të lejonin delegacionin që të kalonte për në Durrës. Gjeneral Guxoni u sqaroi dy përfaqësuesve të Mbretit se kishte urdhër që të priste deri në orën 6 për plotësimin e kushteve të Musolinit.

Në ora 5 mbasdite trupat italiane, që tashmë kishin zbarkuar në Durrës, çanë mbrojtjen në Shijak, ku u zhvilluan edhe luftimet më të ashpra dhe u nisën drejt Tiranës. Por hedhja në erë e urës mbi Erzen i vonoi disa orë. Në ora 7:00 anëtarët e Parlamentit u nisën me kamionë drejt Korçës.

Mbreti Zog qëndroi ende, sipas kujtimeve të vetë atij, deri në datën 8 prill në orën 3 të mëngjesit. Qysh në mbrëmje, Parlamenti kishte votuar spostimin e Mbretit dhe të Oborrit në qytetin e Korçës. Parlamenti kishte shpallur Korçën kryeqytet të përkohshëm të Mbretërisë. Korça do të qëndronte kryeqytet vetëm për 4 ditë. Zogu bashkë me qeverinë mbërriti në Pogradec në ora 10:00 të mëngjesit.

Po atë ditë, herët në mëngjes, pak orë pasi Zogu kish ikur, trupat italiane hynë në Tiranë në një atmosferë të qetë. Akti i vetëm heroik i ditës ishte ai i Mehdi Frashërit, një zyrtari të moshuar,

ish-Kryeministër, që u mbyll në godinën e Bashkisë prej nga u drejtoi qytetarëve një fjalim prekës, patriotik dhe frymëzues në radio. Mëngjesin e asaj dite, ai i kishte dërguar një telegram publik Musolinit ku shprehej:

“...shpirti i Gjergj Kastrioti Skënderbeut na thërret për sakrificën supreme. Ne parapëlqejmë të vdesim sesa të humbasim nderin tonë... Para pesë shekujsh, duart e gjakosura kundër nesh ishin ato të barbarëve aziatikë. A duhet atëherë që pas pesë shekujsh, në emër të kombit italian, ju të jeni barbarët e Perëndimit? Unë nuk do ta besoja...”

Mehdi Frashëri vendosi të rezistojë personalisht. Ai ishte 67 vjeç dhe në jetë kishte përballur shumë okupacione. Në kujtimet e tij, Mehdi Frashëri e përshkruan kështu këtë moment:

“Atë çast përpilova një thirrje për gjithë popujt e botës në gjuhën frëngjisht, të cilën intelektualët që u mblodhën rreth meje e përkthyen në dhjetë gjuhë njëherësh. Radio zuri ta përhapë në gjithë botën...”

Pa e ditur edhe vetë, Mehdi Frashëri po luante rolin e një Kasandre. Fjalimi i tij drejtuar botës, që kishte frymëzuar atë ditë shqiptarët ishte një paralajmërim që u vërtetua shumë shpejt:

“Një popull prej 44 milionësh sulmoj sot më ora 4:30 të mëngjesit një popull prej një milionësh, që po qëndron me trimëri. Armiku me gjithë forcën e tij ka pasur katër humbje gjer më tani në Sarandë, Vlorë, Durrës e Shëngjin.

Nofta armiku do ta fitojë luftën, por do të marshojë mbi kufomat e të gjithë shqiptarëve, burra dhe gra. Popull i botës! Ngrihuni kundër barbarëve modernë se nesër do të jetë rrezik për të gjithë, por do të jetë edhe vonë. Ajo që na ngjet ne sot, do t’ju ngjasë të tjerëve nesër”.

I pajisur me një pistoletë, bashkë me disa djem të rinj, Mehdi Frashëri rezistoi edhe pak kohë, derisa kërkoi strehim politik në ambasadën turke. Në kujtime ai shpreh keqardhjen për mungesën e organizuar të qëndresës:

“...gjithë populli bërtiste se donte armë të luftonte. Për fat të keq Mbreti, ministrat dhe servilët e tij kishin frikë për kokat e tyre. U diftua edhe një herë në faqen e botës historike se despotizma është tradhëtar i kotë e gjithnjë ka frikën e tij...”

Gjesti i Mehdi Frashërit befasoi edhe vetë italianët, që i prematuan se do ta falin dhe më pas e internuan në Itali. Ai do të luante sërish një rol në vitet 1943 – 1944.

Mbreti Zog kujton se më 9 prill 1939, ora 19:00 eskorta e Mbretit, Qeveria e Shqipërisë, deputetët e Asamblesë, një pjesë e Gardës, thuajse 1300 vetë në total, dolën nga kufiri shqiptar në doganën e Kapshticës. Deri atë moment kishte pasur disa tentativa të pasuksesshme për t’u lidhur me Kryeministrin grek Metaksa. Në pikën e kufirit Autokolona ndali një moment aty. Garda u rreshtua, flamuri shqiptar u ul dhe Mbreti e vendosi në makinën e tij. Një kolonel, një major dhe një kompani ushtarësh grekë po prisnin për t’i bërë nderimet e rastit. Zogu vetëm sa i përshëndeti dhe iku tej, pa e ditur, që kjo ishte ikja e fundit e tij nga Shqipëria, ku nuk do të kthehej më kurrë, madje as i vdekur.

Në fakt pretendimi i Zogut dhe shoqëruesve se e kanë kaluar kufirin në datën 9 prill, disa thonë në mëngjes e disa në mbrëmje, hidhet poshtë nga burime të tjera. Një korrespondent i AP-së deklaroi se e ka parë Mbretin Zog në Sheshin Qëndror të Follorinës në orën 1:20 minuta ta datës 8 Prill 1939. Një tjetër burim sqaron se kjo ka qenë rreth orës 2:30. Hysen Selmani sqaron se ata kanë mbërritur aty më 10 Prill në orën 2 të mëngjesit. Ndërkohë është i vërtetuar fakti që Mbreti ka kaluar një natë në fshatin Zemblak, në shtëpinë e kryeplakut. Por e gjitha kjo ka pak rëndësi. Zogu ishte laguar nga Shqipëria dhe ato momente ajo kontrollohej pothuajse krejtësisht nga italianët.

Largimi i Mbretit nga Shqipëria ka qenë pika që është sulmuar më shumë. Ai është akuzuar se e braktisi vendin dhe gjesti i tij u quajt për shumë vjet “tradhti”. Në fakt, pothuaj të gjithë mbretërit e Europës morën po atë vendim. Bernd Fisher, historiani i njohur i Zogut dhe viteve të luftës, në një intervistë në “Opinion” më 2010, e komenton kështu këtë vendim:

“Sigurisht që imazhi i tij në Shqipëri do të kishte qenë shumë më ndryshe nëse ai do të qëndronte të rezistonte. Por nga ana tjetër mendoj se ndoshta rezistenca do të kishte qenë e paqëndrueshme. Nuk mendoj se mbreti Zog do të kishte mundur të bashkonte një ushtri guerile që t’i mundte ata. Mund të mbulohej me prova se duke u larguar nga Shqipëria Zogu e dëmtoi shumë rëndë reputacionin e tij. Por ai ndoshta shpëtoi shumë jetë gjatë këtij procesi, sepse nuk do të ishte e mundur një rezistencë e suksesshme ndaj italianëve.”

Në autokolonën e mbretit udhëtonin edhe 11 valixhe me afro 178 kg flori që ai kishte marrë me vendim të Këshillit të Ministrave mbrëmjen e datës 6 prill të 1939-ës. Historia e floririt që Zogu mori me vete ka qenë gjithnjë objekt debati. Dokumentet e Arkivit të Shtetit sqarojnë se në datën 6 prill të 1939-ës rreth orës 21:00 Mbreti urdhëroi ministrin e Financave, Kol Thaçi, që e gjithë gjendja e Thesarit të Shtetit t’i bëhej atij prezent. Në fakt, ari i Shqipërisë ruhej kryesisht në Banka di Napoli (2454 kg ar) dhe vetëm një pjesë e vogël floriri (afro 178 kg) gjendej në kasafortën e Bankës së Shqipërisë. Arkëtari i përgjithshëm, Ramadan Berberolli, sipas urdhrave të qeverisë, i dorëzoi Mbretit shumën prej 448535 monedhave ar në shtëpinë e Koço Kotës dhe afro 118195 monedha, vonë në mesnatë në shtëpinë e vëllait të Mbretit në afërsi të stadiumit të sotëm “Qemal Stafa”. Zogu i zhvillonte mbledhjet e qeverisë aty. Sipas dokumenteve Mbreti Zog tërhoqi në total 566975.5 franga ari. Thua se gjithë atë që kishte në dispozicion Thesari Shqiptar. Nisur nga llogaria që një napolon flori përbëhej nga 20 franga ari, Mbreti kishte marrë me vete një shumë prej 27848 napolonash flori. E kalkuluar me kursin e floririt të sotëm (kursi i datës 10 Shtator 2014), rezulton se Mbreti Zog kishte marrë me vete, një shumë të barabartë sot me 5 milion e 936757 euro. Në kujtimet e tij Mbreti sqaron se pjesa kryesore u shpërnda nën kujdesin e një komisioni prej 7 vetash për zyrtarët e dalë në Larisa, Follorinë dhe Beograd. Por askush nuk di të thotë sot sesa mund të ketë qenë sasia e arit që Mbreti posedonte personalisht dhe që e ruante në kasafortën e tij në Pallat, por ashtu si edhe bizhuteritë dhe gjërat e tjera me vlerë.

Geraldina që vendosur në Follorinë disa orë më parë. Një prej

shoqërueseve të saj dëshmon:

“Kur mbërritëm në kufirin grek, nga njëra anë, një grup ushtarësh shqiptarë nderuan teksa vargani kaloi vijën kufitare. Në anën tjetër një rojë greke, me pushkën e tij me bajonetë, u prek aq shumë nga kjo situatë, sa që i ra kapela teksa vraponte drejt telefonit. Gjysmë ore më vonë, erdhi një xhip plot me oficerë grekë dhe një eskortë motoçikletash, për të na shoqëruar drejt Follorinës, një qytet i vogël kufitar. Më në fund, gjetën një hotel karakatinë dhe Mbretëresha u mbart me një palë shkallë të vjetra druri në një dhomë të pluhurosur dhe bosh. Mbretëresha Geraldinë, e zbehur nga lodhja, si një fantazmë me këmishë nate, nuk e lëshonte nga dora foshnjën. Vetëm profesor Uebeli dhe infermierja lejoheshin të hynin në dhomën e saj, por edhe atëherë ajo u kërkonte ta linin të qetë”.

Mbreti dhe Mbretëresha u takuan në Greqi. Udhëtimi i tyre i përbashkët zgjati plot 22 vjet, ndërsa ai i Oborrit Mbretëror, 63 vjet.

Më 9 Prill 1939, gjithë shtypi i Tiranës botonte telegramin që Xhaferr Ypi, ish- inspektor i Oborrit i drejtonte Musolinit:

“DUÇE, kemi pritur sot ushtrinë glorioze italiane me të njëjtin shpirt e me të njëjtën zemër që Ju Duçe e keni treguar sa herë se ushqeni kundrejt Shqiptarvet”.

Konti Ciano mbërriti edhe vetë në Tiranë me avionin e tij po atë ditë. Pararoja e trupave italiane, të drejtuara nga gjeneral Guxoni, kishte hyrë realisht në Tiranë më 8 prill në orën 9:38 minuta, thua se po në atë kohë kur autokolona e Oborrit Mbretëror, Qeverisë Shqiptare dhe Parlamentit po hynte në Pogradec. Guxoni dukej i trembur nga vonesa që kishte pasur për të hyrë në Tiranë. Atij i ishin dashur më shumë se 28 orë për 36 kilometrat që ndanin Durrësin me Tiranën dhe siç dëshmon Ciano, Duçja ishte shumë i nervozuar. Shkaku i nervozizmit ishte se për arsye të vonesës, shtypi botëror kishte raportuar plot 24 orë lajme në favor të shqiptarëve duke i konsideruar hapur italianët si invazorë dhe duke hedhur poshtë propagandën italiane se trupat e tyre qenë thirrur nga shqiptarët.

Edhe Ciano ishte i nervozuar nga komentet negative të shtypit, në kontrast me qeveritë e gjithë vendeve perëndimore që e kishin aprovuar në heshtje pushtimin. Ai e dinte tashmë se shpejtësia në lëvizje dhe mbyllja e "problemit Zog" ishte çelësi për ta quajtur të zgjidhur problemin shqiptar. Ciano ishte tejet i kënaqur, siç shkruan në ditar, që Zogu nuk ishte tërhequr në drejtim të Matit ku mund të bënte një rezistencë të papritur, por kishte dalë në Greqi. Me gjasë, italianët ishin vetë të interesuar që Zogu të ikte dhe s'donin të kishin të bënin me të.

Në mungesë të qeverisë që ishte larguar bashkë me Mbretin Zog, në Tiranë ishte krijuar një Qeveri Provizore, e drejtuar nga Xhaferr Ypi dhe e përbërë nga sekretarët e përgjithshëm të ministrive. Më 12 prill, 4 ditë pas hyrjes së trupave italiane në Tiranë dhe 3 ditë pas largimit të Mbretit Zog, u mbledh Asambleja Kushtetuese që do të merrte vendimet në raport me situatën e re. Mbledhja e një Asambleje në kaq pak ditë, tregon se italianët qenë kujdesur në avancë për të gjitha dhe se ata kishin kontaktuar shumicën e personaliteteve që do të merrnin pjesë aty. Lista e Asamblesë është bërë publike, por shumë emra janë përfshirë aty pa dijeninë e tyre dhe as nuk kanë marrë pjesë. Mbledhja kryesohej nga Xhaferr Ypi dhe u zhvillua në sallën e Parlamentit shqiptar. Në një kohë rekord dhe pa diskutime të mëdha Asambleja vendosi: shfuqizimin e Mbretit Zog, rrëzimin e Statutit Themeltar të Mbretërisë, rrëzimin e Qeverisë së Koço Kotës dhe ngritjen e Qeverisë së Shefqet Vërlacit. Por më e rëndësishmja mbetej pika e 4 e vendimeve të Asamblesë që thoshte:

"Asambleja Kushtetuese kombëtare, interprete e vullnetit të njëzënë ringjallje kombëtare e popullit shqiptar dhe si besë solemne për kryerjen e saj, vendos që t'i ofrojë në formën e një bashkimi personal, Kurorën e Shqipërisë, Madhnisë së tij, Vittorio Emanuele III, Mbreti i Italisë dhe Perandor i Etiopisë, për Madhësinë e tij dhe për trashëgimtarët e Tij Mbretënorë."

Problemi i kurorës shqiptare kishte qenë objekt i fortë debati po atë mëngjes në legatën italiane, ku disa përfaqësues shqiptarë të thirrur nga Jakomoni, përfshi Gjergj Fishtën, nuk kishin qenë dakord për bashkimin e kurorave. Ata kishin sugjeruar kalimin e

kurorës së Shqipërisë një princi nga familja Savoja, por jo bashkimin e dy kurorave nën Viktor Emanuelin III. Por Asambleja kishte vendosur sipas dëshirës së Cianos.

Mëngjesin e 12 prillit 1939, Ciano priste në Selinë e Legatës përfaqësinë e Asamblesë që do t'i bënte prezent vendimet e saj. Delegacioni prej 10 vetash eci në këmbë nga Parlamenti, përballë Bankës, drejt Legatës tek Ura e Tabakëve. Shoqëruar nga trima të armatosur dhe nga zyrtarë më të ulët, ata hynë me vrull dhe rrëmujë në Legatë, ku Ciano, siç dëshmon sërish në ditarin e tij: *"Nuk pa ndonjë entuziazëm të veçantë popullor!"* Ai njoftoi dërgatën se në datën 16 prill do të paraqiteshin përpara Mbretit në Romë për t'i ofruar atij kurorën.

Dërgata e drejtuar nga Kryeministri, Shefqet Vërlaci, mbërriti vërtet më 16 prill 1939 në Pallatin Kuilinale në një audiencë tek Mbreti. Përpara tij ata qenë takuar me Kryeministrin, Musolini, dhe kishin sfiluar hipur në karroca me kuaj të bukur, nëpër rrugët qendrore të Romës. Po atë mbrëmje, Mbreti shtroi edhe një darkë për të pranishmit, në fund të së cilës, u zbulua se mungonin disa lugë ëmbëlsirash të lara në flori.

Më 22 prill, Mbreti Viktor Emanueli III, i cili nuk mund ta ushtronte pushtetin drejtpërdrejt në Shqipëri, emëroi si nënmbret të Shqipërisë, ose mëkëmbës, ish-ambasadorin italian në Tiranë, Francesco Jakomoni di San Savino.

Zogu ishte shfronësuar tashmë edhe legalisht.

NË RRUGËT E EUROPËS

1939 - 1940

Mbreti Zog mbërriti në Stamboll më 1 maj 1939. Pritja nuk ishte ajo që përshkruhet në kujtimet e Geraldinës dhe të tijat. Gjenco Naçi, konsulli shqiptar në Stamboll që kishte dalë ta priste e kujton kështu atë moment dhe qëndrimin e Turqisë në përgjithësi:

“Mbreti i shqiptarëve u prit në Turqi vetëm prej kryetarit të policisë dhe prej ndonjë përfaqesuesi të shtetit. Ardhja e tij u rregullua në mënyrë që treni të arrijë në Stamboll nga mesi i natës, në mënyrë që të mos bëhej ndonjë manifestim. S’ka dyshim se populli i Turqisë që në favor të Shqipërisë dhe të Mbretit Mohamedani cili në sytë e popullit ishte një fytyrë tragjike dhe simpatike. Por, një pjesë e madhe e klasës qeveritare nuk i shikonin me sy të mirë as shqiptarët dhe as Mbretin e tyre. Turqit që kishin qenë xhoturq në rininë e tyre kishin disa ankime të forta ndaj shqiptarëve e që nuk mund t’i harronin. Kemalistët, nga ana tjetër, nuk harronin zemërimin e Gaziut kur Ahmet Zogu ktheu Republikën në Mbretëri, as lidhjen e Zogut me familjen perandorake të rrëzuar të Turqisë.”

Mbreti Zog u vendos në hotel “Pera Palace”, ku rezervoi një kat. Pjesa tjetër e shoqëruesve u vendosën nëpër shtëpitë e shqiptarëve të Stambollit ose tek të afërm. Pothuaj të gjithë ata që shoqëronin Mbretin kishin jetuar për disa kohë në Stamboll ose kishin familjarë aty.

I vendosur mbi një kodër që dominon Bririn e Artë, "Pera Palace" ishte hoteli më luksoz i Stambollit. Ai ishte ndërtuar më 1896 për udhëtarët e Orient Ekspresit që udhëtonin nga Parisi në Stamboll. Zogu e kishte frekuentuar në rini hotelin, një vend ku mblidheshin deputetët shqiptarë të Parlamentit Osman. Aty ishte bërë takimi i famshëm i janarit 1912 që kishte inicuar Pavarësinë e Shqipërisë. Ismail Qemali ishte nisur prej aty për të shpallur Pavarësinë. Mbreti figuron ende në librin e nderit të hotelit.

Zogu nuk kishte qenë në Stamboll që prej 28 vjetësh, por u ndje mjaft familjar me qytetin. Ai kishte humbur shkëlqimin e kryeqytetit të Perandorisë, por vijonte të mbetej magjepsës. Geraldina kujton se njohja e gjuhës dhe e mendësisë së vendasve, e bënte atë të ndihej si në shtëpi. Ajo kujton se në 22 vjetët e mërgimit, muajt e Stambollit qenë ato më të bukurit. Qyteti me kodrat dhe ngushticat e kishte magjepsur edhe vetë Mbretëreshën.

Jeta në Stamboll qe intensive. Detyra kryesore ishte të mernte informacion nga Shqipëria, të vendoste lidhje me Qeverinë Turke dhe fuqitë aleate.

Lajmet nga Tirana ishin gjithnjë e më të këqija. Njerëzit që e shoqëronin kujtojnë se Mbreti ndihej i lënduar, sa herë mësonte që ndonjë prej njerëzve që kishte mbajtur afër apo kishte favorizuar ishte bërë me italianët apo kishte bërë deklaratë kundër tij. Goditja e mbretit Zog ishte bërë modë në Tiranë dhe protagonistë të kësaj goditje ishin në shumë raste persona që ai i kishte privilegjuar dhe pasuruar në vite. Në një takim i kishte thënë Ferit Ypit diçka që nuk ishte e zakonshme për të:

"Paskam pasur kaq shumë palaço rrotull dhe s'i kam njohur! Të tjerët po, e dija. Këtë që po bëjnë me mua e kanë bërë edhe me gjithë të tjerët që nga Pavarësia!"

Kontaktet me Qeverinë Turke qenë vendosur ndërkohë, por Ankaraja i ruhej mjaft ndonjë zemërimi italian. Presidenti Turk Inonuen, një bashkëpunëtor i Mustafa Qemalit, e pranoi kërkesën e Zogut për takim, por nuk e priti në selinë zyrtare. Inonuen e

ftoi Zogun dhe Geraldinën për drekë në vilën e tij në Yallovë pranë Stambollit. Sipas kujtimeve që ka lënë Zogu, dreka shkoi mirë dhe Presidenti i konfirmoi vendimin që ai mund të qëndronte në Stamboll sa kohë të donte. Por aktiviteti politik duhej të reduktohej.

Problemi i tretë me të cilin përballlej ishte vendosja e problemit shqiptar në axhendën e Fuqive Kryesore Europiane, Britanisë së Madhe dhe Francës. Të dy shtetet ishin treguar indiferente ndaj pushtimit të Shqipërisë, por reagimi i shtypit dhe kërcënimet në rritje të Gjermanisë, po bënin që politikën e tyre të ndryshonin. Zogu e dinte se për të siguruar mbështetjen e tyre, duhej të ishte në Londër ose Paris. Ai i tentoi të dyja këto mundësi. Më 26 qershor 1939, priti në një takim Zhysten Godarin, deputetin e njohur francez që kishte qenë pranë Shqipërisë që në vitet e Luftës së Parë Botërore. Godar, duket se ka luajtur rol që Franca të pranonte që Zogu të vendosej në Paris. Zogu vendosi realisht të largohej.

Stambolli ishte qyteti që njihte më mirë pas Tiranës. Ishte qyteti ku qe shkolluar dhe formuar, një qytet ku mund të bënte një jetë komode, por vendosi ta sakfirikojë për hir të karrierës, edhe pse po shkonte drejt të panjohurës.

Zogu u nis më 30 Qershor 1939 nga Porti i Karakoyt. Një skuadër ushtarake i bëri atij nderimet e rastit siç ndodh me një kryetar shteti. Ka shumë mundësi të besohet që Turqia, ishte e kënaqur që u largua nga territori i saj. Në largim, Mbreti besonte se do të kthehej shpejt aty, por nuk u kthye më kurrë për së gjalli. Vetëm në datën 15 nëntor 2012, një avion i "Turkish Airlines" që fluturonte nga Parisi, u ul në Stamboll duke mbajtur në kargon e tij arkivolin me eshtrat e Mbretit, për t'u varrosur në Shqipëri. Mbreti po udhëtonte 73 vjet më vonë, në drejtim të kundërt me atë të 1939. Paris - Stamboll - Tiranë.

Mbreti kishte dy rrugë për të udhëtuar drejt Francës, por ajo nëpër Mesdhe e trembte. I duhej të kalonte fare pranë brigjeve italiane, ku flota e Romës ishte aktive. Ndaj zgjodhi një itinerar të dytë që kalonte larg tyre. U nis me anije drejt Rumanisë, e prej këtej nëpër Poloni, vendet Balltike, Suedi, Belgjikë e Francë.

Geraldina kujton:

"Udhëtimi drejt Francës i gjithë Familjes Mbretërore ishte një

vështirësi më vete, pasi asnjë kompani tragetesh nuk donte të merrte përgjegjësinë e transportimit të tyre. U detyruan të bënin një rrugë të gjatë përmes Rumanisë, Polonisë dhe vendeve balltike. Familja, që tani ishte reduktuar vetëm me Mbretin, Mbretëreshën, Princin Leka dhe mëndeshën, tri nga princeshat dhe dymbëdhjetë oficerë shqiptarë, u ngjit më në fund në Bazarabia-n (Dikush tjetër thotë Transilvania), një anije rumune që lundronte përmes Konstancës, një port në Detin e Zi, prej nga hipën në një tren të posaçëm drejt Bukureshtit, ku arritën në datën 2 korrik.”

Zogu dhe Geraldina, bashkë me 15 shoqëruesit e tyre mbërritën në Bukuresht më 2 Korrik 1939 dhe u vendosën në Hotel “Athens Palace”. Po në të njëjtin hotel, madje në të njëjtin kat ku ndodhej suita e Mbretit, ishte vendosur edhe një ministër i Musolinit me mision në Bukuresht. Rojet e tij dhe të mbretit shiheshin kërcënues me armët gati sa herë që shkëmbeheshin aty.

Pritja në Bukuresht ishte e mirë, por as protokollare dhe as entuziazte. Ajo u mbajt në heshtje. Në kujtimet, Geraldina shprehet se pritja e popullit kudo ku ata kaluan ishte mbresëlënëse dhe masive, me shprehje të qartë simpatie. Por shoqëruesit e mbretit dhe shtypi i kohës, jep një tablo të ndryshme. Në shumicën e vendeve ku Mbreti ndali autoritetet u munduan ta shmangin atë nga frika se kjo do të acaronte Italinë e Musolinit. Ata i rezervuan në shumicën e rasteve takime në nivele të larta, deri me krerë shtetesh, por gjithnjë kjo bëhej privatisht dhe pa praninë e mediave.

Të vetmet vende ku pritja ishte mbresëlënëse dhe tejet entuziazte ishin Polonia dhe Letonia. Në Varshavë, kërcënimi gjerman ishte bërë më i pranishëm se kurrë. 2 muaj më pas, edhe Polonia pushoi së ekzistuari si vend i pavarur. Dukej se polakët, po ndanin me Mbretin e larguar shqiptar fatin e tyre të trishtë. Letonia po ashtu ndiente kërcënimin gjerman dhe sovjetik. Në mbarim të luftës ajo do pushonte së ekzistuari si shtet i pavarur, për të rifituar pavarësinë vetëm në vitin 1991.

Të nesërmen e mbërritjes Mbreti me Mbretëresha, patën një drekë pune me mbretin Karol që i priti në shkallët e pallatit. Ishte takimi i parë me Mbretin e Rumanisë, edhe pse Geraldina kishte

një lidhje të largët fisnore me të. Ajo kujton se u hutua momentin e parë, por Mbreti Zog e nxorri nga situata:

“Mbreti, një burrë i gjatë, simpatik, përqafoi tim shoq dhe mua m’u drejtua me një buzëqeshje të lezetshme, por vetëm kaq. Mbreti Zog e qortoi duke i thënë:- Puthe kushërirën! Mua m’u duk shumë i këndshëm.”

Të dy mbretërit qëndruan ende pak kohë vetëm për vetëm. Që nga takimi i parë me Presidentin e Turqisë, ky me Mbretin e Rumanisë dhe në gjithë takimet e tjera, Mbreti Zog gjithnjë fliste për rrezikun e një lufte në Europë. Lufta do të niste realisht vetëm 2 muaj më pas, por atë moment të gjithë besonin se ajo do të shmangej.

Familja Mbretërore u nis nga Bukureshti, pasi kishte vizituar edhe Sinajen, me një tren special. Më 6 Korrik 1939 mbërriti në stacionin qendror të Varshavës në Poloni. Varshava kishte organizuar pritje zyrtare mbresëlënëse. Me mijëra vetë shtyheshin në stacion duke brohoritur: Rroftë Shqipëria! Nga kaosi, eskorta harroi në tren Lekën 2- muajsh dhe dadon e tij. I gjetën të dy, të strukur në vagon, tejet të trembur nga turma që brohoriste jashtë.

Në Poloni Mbreti nuk pati takime të nivelit të lartë, por pritja e publikut ishte befasuese. Kudo që shkoi rrethohej nga simpatia e njerëzve. Ky Mbret i mbetur pa atdhe, po shfaqej si paralajmërimi ogurzi i asaj që pritej t’i ndodhte Europës disa muaj më pas. Që nga 1 Shtatori 1939 një numër i madh mbretërisht do humbisnin fronet e tyre, por një numër akoma më i madh qytetarësh, me miliona, do humbnin jetën apo gjithçka kishin në një luftë të frikshme botërore.

Nga Varshava kolona mbretërore vijoi për në Riga. Ajo u vendos në hotel “Shën Petërsburg”, në qendër të qytetit. Një moment që u afrua në dritare, Mbreti vuri re një turmë prej qindra vetësh që qëndronin në shesh dhe mbanin në dorë pankarta kundër pushtimit të Shqipërisë. Letonët ishin tejet të frikësuar dhe besonin se fati i Mbretit Zog do të priste elitën e tyre disa kohë më pas.

Nga Riga u nisën 2 ditë më pas për në Stokholm. Kur anija e vogël që do t’i transportonte nga Riga u nis drejt kryeqytetit suedez, befas një stuhi e fuqishme u ngrit në det. Pothuajse të gjithë

pasagjerët i zuri deti, ndërkohë që kapiteni njoftoi Mbretin se për arsye sigurie u duhej të ankoroheshin në portin e një ishulli të vogël gjerman. Ndalimi në Gjermani ishte fatal. Ai mund të arrestohej nga autoritet gjermane dhe t'u dorëzohej italianëve që ndërkohë kishin nxjerrë një urdhër arresti dhe u kishin kërkuar gjithë vendeve ku kalonte që ta ekzekutonin. Ata kishin kryer gjithashtu konfiskimin e të gjitha pasurive të Mbretit Zog në Shqipëri dhe ato në bankat italiane.

Zogu iu dorëzua fatalitetit. Ai pranoi idenë që për të shpëtuar thuajse 200 pasagjerët që ishin në bord, të ndalonin në ishullin gjerman. Po kësaj here fati ishte me ta. Stuhia u qetësua pa arritur në port dhe ata vijuan udhëtimin drejt Stokholmit, ku Geraldina kujton:

“Kisha dalë në kuvertë në orën gjashtë të mëngjesit për të parë hyrjen në portin e Stokholmit që ishte i shpërndarë në ishuj të vegjël, veshur me një tapet lulesh të egra. Mbreti u këndell aq shumë nga Stokholmi dhe natyra përreth, sa që menjëherë donte të shpenzonte disa napolona floriri për të blerë një kështjellë të vogël në një nga ishujt. Me shumë takt iu bë e ditur se klima suedeze në dimër është totalisht ndryshe nga butësia e Adriatikut.”

Në fillimet e udhëtimit të tij, Zogu dukej mjaft i stabilizuar ekonomikisht. Shtypi i vendeve ku mbërrinte i komentonte shpesh pasurinë, e cila shfaqej në formën e një thesari të mbyllur në disa valixhe të rënda që udhëtimin bashkë me të. Zogu nuk besonte që ta mbyllte atë në bankë. E mbante gjithnjë me vete. Gjenço Naci, sekretar i Mbretit, e përshkruan kështu situatën e valixheve në kujtimet e mbetura në dorëshkrim:

“Kur hypa në vapor në Stamboll hodha një sy nga dritarja në kabinën e Mbretit dhe atje pashë të mbledhura njëra mbi tjetrën “valixhet” e famshme. Që atëherë vështrova që këto valixhe ishin objekt i një kujdesi të veçantë. Lëviznin vetëm prej oficerëve dhe asnjëherë ndonjë hamall nuk u lejua që t'i prekte me dorë. Bashkë me to shkontë gjithnjë një nga nipërit e Mbretit, Hyseni ose Tati. Në trena dhe në hotele gjendeshin gjithnjë në dhomat e princeshave. Njerëzit i shikonin

me kureshtje dhe disa me armiqësi. Ishin të rënda dhe vetëm oficerët dinin diçka rreth peshës së tyre. Më duket se ishin 11 dhe njëra prej tyre duhet të kishte shumë rëndësi, sepse kishte një trajtim të veçantë dhe udhëtonte gjithnjë nën sytë e vetë Mbretit. S'ka dyshim që ishin shumë të vlefshme.”

Shtypi, sidomos në Francë dhe në Britani, i komentoi gjatë valixhet. Pati shumë hamendje se çfarë gjendej brenda tyre. Herë flitej për monedha apo shufra ari, herë për diamante dhe gurë të tjerë të çmuar. Valixhet i shpëtuan thuajse në të gjitha rastet kontrolleve dhe asnjëherë nuk u bë një inventar i tyre. Me kalimin e viteve, nga udhëtimi në udhëtim, numri dhe kujdesi ndaj tyre u bjerr, sa në vitin 1955, kur u transferuan nga Aleksandria në Kanë, në vend të 11 valixheve, familja mbretërore ushtronte kujdes vetëm ndaj një çante të vogël. Por valixhet e mbretit u bënë sa shpëtimi edhe problemi i tij, siç dëshmon sërish Gjenço Naci:

“Dihej që në këto valixhe kishte një pasuri të madhe. Disa thonin pasuria e shtetit shqiptar. Mbreti thoshte pasuria e tij. Unë nuk di gjë. Nuk i pash kurrë të hapura. Por sido që të jetë puna një gjë është e sigurt, këto valixhe gjatë udhëtimit nuk qenë vetëm mërzitja e oficerëve që i mbanin por edhe elementi më i keq i propagandës që u bë për Shqipërinë me rastin e këtij udhëtimi”.

Familja mbretërore shqiptare u prit në Stokholm me mjaft kujdes. U vendos në “Grand Hotel” një vend ku prej afro 100 vjetësh vendosen fituesit e Çmimit Nobel që vijnë për të marrë pjesë në ceremoni. Shtypi suedez që miqësor dhe shkroi për Lekën se me flokët biondë, posa e shikoje mendoje se kishte prejardhje suedeze. Në fakt, Geraldina ishte e lidhur me Suedinë përmes gjyshit të gjetur të saj, Gustav de Strale d'Ekna, një fisnik suedez.

Në Stokholm, Zogu zbuloi edhe ambicien për t'u vendosur jo në Francë, ku mendonin ata që e shoqëronin dhe ku kishte deklaruar në nisje të udhëtimit, por në Londër. Me gjasë, ai e shihte kërcënimin italian dhe gjerman më të vogël në Londër. Ose ndoshta vendim-marrjen politike ndërkombëtare më të madhe atje. Në Stokholm bëri takimin e parë me gazetarët e shtypit të huaj. Ai u pasqyrua

më 20 korrik 1920, në gazetat më të mëdha britanike, midis të cilave "Daily Telegraph" dhe "Morning Post". Titujt e shtypit ishin: "Mbreti Zog po vjen në Britani për t'u vendosur afër Londrës". Ndër të tjera aty shkruhej:

"Mbreti Zog i Shqipërisë dhe Mbretëresha Geraldinë do të qëndrojnë në Suedi për afro një javë para se të udhëtojnë drejt Norvegjisë dhe Francës. Mbreti Zog priti gazetarët sot dhe tha se më pas ai do të shkojë drejt Anglisë, një vend që ai e admiron. Mbretëresha Geraldinë tha se ata mendojnë të marrin me qera një pronë në afërsi të Londrës derisa të kthehen në Shqipëri. Bashkëshorti i saj është duke punuar për një Shqipëri të lirë dhe do të kurorëzohet sërish. "Ne e dimë që Shqipëria është duke na pritur", - tha Geraldina. Shfaqja e motrave të mbretit Zog në rrugët e Stokholm po shkakton mjaft interes."

Zogu dhe familja e tij qëndruan në Stokholm më shumë se sa kishin parashikuar. Për të përshkruar distancën nga Stambolli në Paris atyre iu deshën 43 ditë. Nga Suedia ndaluan në Oslo ku pritja e familjes mbretërore që e ftohtë dhe refuzimi për t'i takuar befasues. Geraldina kujton se ca muaj më vonë, edhe Familja Mbretërore Norvegjeze u detyrua të largohet nga pushtimi gjerman dhe ata ishin bashkë në Londër, por në kryeqytetin britanik sjellja e tyre kishte qenë krejt ndryshe nga ajo që ishte në Oslo, ca muaj më parë.

Nga Norvegjia, ata vijuan me anije në Antverp. Prej këtu me tren për në Paris. Në Belgjikë Mbreti qëndroi vetëm 24 orë. Këtu kërkoi me ngulm të vizitonte Vaterlonë, vendin e famshëm ku Napoleoni humbi betejën me Uellingtonin dhe prej nga nisi rënia dhe ekzili i tij. Vështirë të kuptosh se çfarë ka menduar Mbreti, edhe ai në ekzil, ndërsa këqyrte nga këmbët e kodrës, majën ku lartohet luani britanik. Fati i mëtejshëm i Napoleonit, heroit të tij kishte qenë i trishtë dhe Zogu, nuk ishte optimist që me të, fati do të ishte më bujar.

Zogu dhe Oborri mbërritën në Paris më 8 Gusht 1939. Atmosfera aty reflektonte fare pak luftën që po trokiste në derë.

Familja mbretërore u vendos fillimisht në hotel "Trianon Palace" në Versajë, i ndërtuar pranë vendit të preferuar të Napoleomit dhe më pas, u sistemua në "Chateaux de la Maye", në periferi të Parisit. "Chateaux de la Maye", ishte veçanërisht e njohur, sepse ajo

i përkiste ish -Mbretit të Anglisë Eduard VIII që kishte lënë fronin, sepse dashuronte një grua të divorcuar. Zogu e kishte marrë me qira për një vit. Në fakt Mbreti me familjen qëndruan më pak se një vit në Francë. Muajt e fundit ata u detyruan të ndërrojnë disa herë adresë, fillimisht në një shtëpi në rrugën "Loti" dhe më pas në hotelin e famshëm "Plaza Athens" në Avenue Montagne ku zunë thuajse një kat.

Zogu nisi një aktivitet mjaft intensiv në Paris. Mendoj të transferonte aty qeverinë që të njihej si një qeveri në mërgim dhe takoi disa drejtues të lartë politikë, përfshi anëtarë të qeverisë. Franca e kishte njohur në heshtje pushtimin e Shqipërisë, por së fundmi, marrëdhëniet e saj me Romën ishin mjaft problematike.

Më 1 shtator 1939, Mbreti mori një letër nga 3 oficerë shqiptarë që ishin të burgosur në Tuluz. Të tre ata ishin larguar nga Shqipëria disa vjet më parë dhe kishin marrë pjesë në Luftën e Spanjës. Militantë komunistë, ata qenë burgosur nga autoritetet franceze pas ardhjes nga Spanja dhe tani ndodheshin në vështirësi. Letra që firmosur nga Ymer Puka, togër Mehmet Shehu dhe togër Hulusi Spahiu.

Në notimet e tij, Zogu kujton se sapo mori letrën dërgoi konsullin Molto Noçka që të merrej me lirin e tyre duke përdorur garancinë e Qeverisë Shqiptare në mërgim. Ai pagoi gjithë shpenzimet e lirit dhe veshjes dhe u kërkoi që nga Tuluzi të transferoheshin në Paris. Por asnjë nga të 3 nuk erdhi në Paris, siç donte Mbreti. Ata vijuan për në Shqipëri, ku u bënë protagonistë të njohur të luftës. Më pas Mehmet Shehu u bë Kryeministër i Shqipërisë për 27 vjet, ndërsa Hulusi Spahiu gjeneral i njohur. Të dy u goditën nga Enver Hoxha. Spahiu përfundoi në burg, ndërsa Shehu në vetëvrasje.

Në muajt e qëndrimit në Francë, Mbreti Zog dhe stafi kanë nisur me dhjetëra letra në adresë të autoriteteve të rëndësishme botërore. Paralel me këtë ai tentoi unifikimin e gjithë faktorëve shqiptarë në mërgim duke ftuar në Paris për konsultime, imzot Fan Nolin, kundërshtarin e vjetër dhe Faik Konicën, ambasadorin shqiptar në Uashington deri pak kohë më parë. Asnjëri nga të dy nuk udhëtoi drejt Francës, por kundërshtarë të tjerë tradicionalë e vizituan atje. Ndër më kryesorët, Tajar Zavalani, ish-komunist që kishte studiuar në Moskë dhe që më pas kishte braktisur ideologjinë e majtë dhe

Said Kryeziu. Saidi ishte vëllai i vogël i Ceno bej Kryeziut që ishte vrarë nga Zogu dhe i Hasan e Gani Kryeziut që ishin arratisur pas një tentative për ta vrarë Mbretin. Takimi me Said Kryeziun ishte i vështirë, por ai dëshmonte se Zogu ishte i gatshëm për pajtim me të gjithë në ato momente. Sipas kujtimeve të Geraldinës, Zogu besonte se qëndrimi ndaj tij do të ndryshonte me fillimin e Luftës Botërore dhe me angazhimin e Francës dhe Britanisë kundër Italisë.

Më 10 Maj 1940, Gjermania nisi sulmin mbi Belgjikën, Luksenburgun, Holandën dhe më 1 qershor hyri në Francë. Menjëherë pas sulmit, Zogu u nis për një vizitë 5-ditore në Angli për të zgjidhur një problem financiar. Viza iu dha me shumë vështirësi, gjë që e bëri atë të besojë se vendosja në Angli nuk do të ishte e lehtë. Britanikët i kërkuan të mos bënte asnjë deklaratë në shtyp dhe asnjë takim politik që mund të prekte Italinë. Geraldina kujton:

“Mbreti Zog u nis për në Londër, për të shpëtuar dhjetë mijë stërlina që ishin vendosur në bankën e Italisë atje para disa vjetësh. I shoqëruar nga oficerët shqiptarë, ai shkoi në bankë, ku u përshëndet nga zyrtarët me një sërë shfaqësimesh dhe vështirësish. Mbreti ishte i prerë dhe u tha se nuk do të hezitonte të përdorte edhe forcën, nëse do ishte e nevojshme për të marrë paratë e tij.”

Zogu i mori paratë dhe kur u kthye nga Londra, e zhvendosi familjen në Bretanjë, nga frika se në Paris mund të kishte sulme ajrore. Në Bretanjë qëndruan në një hotel të vogël dhe Geraldina kujton se ajo ka qenë koha më e lumtur e tyre.

“Qëndruam në një hotel të rehatshëm dhe shijuan për një kohë të shkurtër qetësinë e natyrës përreth. Ishin ditët tona më të bukura dhe muaji ynë i vërtetë i mjaltit”.

Gjermanëve iu deshën fare pak ditë për të shpërthyer mbrojtjen franceze dhe për të kërcënuar Parisin. Në fillim të qershorit jeta në kryeqytetin francez ishte kaotike dhe rrugët të mbushura me refugjatë. Pikërisht ato ditë, mbreti pati një vizitë befasuese. Me një avion të vënë në dispozicion nga Ministria e Mbrojtjes, mbërriti në Paris, gjeneral Xho Persi, ish-komandanti i xhandarmërisë.

Gjeneral Persi bisedoi me Mbretin për afro 4 orë në apartamentin e tij në Rue Lotti. Sipas kujtimeve të Gjenço Nacit, Zogu i konfirmoi Persit se në rast sulmi ndaj Greqisë, ai mund të mobilizonte një ushtri prej disa mijëra vetësh në Selanik për të luftuar italianët. Gjenerali mbajti shënime, - thotë Naci, - dhe më pas u largua.

Javën e dytë të qershorit qeveria u largua nga Parisi që tashmë po rrethohej nga gjermanët. Zogu vendosi të ndiqte qeverinë, fillimisht në Tur dhe më pas në Bordo. Ai u nis nga Parisi më 10 qershor 1940. Po atë ditë, pak orë më vonë, Musolini i shpalli luftë Francës dhe Britanisë. Ishte ajo që mbreti e kishte pritur prej më shumë se një viti e gjysmë.

Familja mbretërore u nis me një autokolonë makinash, midis të cilave dallohej Mercedezi i madh i kuq i Hitlerit. Geraldina besoi gjithë jetës, se mbijetesa në rrugët kaotike dhe nën bombardime të Francës i dedikohet pikërisht asaj makine. Ajo ia ka shprehur këtë biografes së saj që rrëfen:

“Mbretëresha i qëndron mendimit se vetëm falë vullnetit të Zotit Familja Mbretërore nuk u copëtua nga bombat falë një rastësie të thjeshtë. Fakti është që Mbreti Zog dhe Mbretëresha Geraldinë po udhëtonin me Mercedesin e kuq, të cilin Hitleri ua kishte bërë dhuratë për dasmë, një kopje e makinës së tij personale. Piloti, që do të merrte guximin të gjuante atë që dukej si makina personale e Fyhrerit, nuk kishte lindur ende. Kështu që pilotët nuk rrezikuan, por e kaluan limuzinën e kuqe, duke goditur në shënjestra më pak të rrezikshme.”

Rrugët e Francës qenë krejt të bllokuara nga refugjatët dhe makinat ushtarake. Udhëtimi zgjati tej çdo limiti, karburant nuk gjendej dhe as ushqim. Në Tur, qeveria thujse nuk ekzistonte ndërsa në Bordo ishte një kaos i plotë. Nën kërcënimin se po arrihej nga gjermanët ai duhej të merrte një vendim, dhe të gjente zgjidhje për të. Në jetë kishte ikur shumë herë, i ishte shmangur shumë atentateve dhe kurtheve, por tashmë jo çdo gjë varej prej tij. Geraldina kujton:

“Megjithëse në ato çaste Mbreti me të vërtetë do të kishte parapëlqyer të shkonte në Spanjë, nuk donte që shqetësimeve të gjeneral

Frankos t'i shtonte edhe barrën e një monarku të mërguar. I dëshpëruar, i dërgoi një telegram mbretit Xhorxh VI në Angli dhe brenda pak orësh mori një përgjigje plot kortezi. Ai e mirëpriste në Britani dhe e këshillonte që në një datë të caktuar, në një orë të caktuar, të merrte anijen e fundit që do të nisej nga Bordoja.”

Biografia e Geraldinës, sqaron se ky vendim u mor pasi Britania u sigurua se mbreti do ta përballonte vetë jetesën dhe ai nuk do të kërkonte asgjë nga Qeveria e Londrës:

“Në letërkëmbimin me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe me konsuj të ndryshëm, që tani gjendet në zyrën e Arkivave Publike në Kju-Gardens, bëhej e qartë se, megjithëse mbreti Xhorxh VI ishte i gatshëm t'i ofronte azil në Britani, ai kërkonte të sigurohej se shqiptarët ishin në gjendje ta përballonin jetesën vetë. Kjo u bë e ditur për Viskontin Halifaks nga Sër Andrea Rajën, ish -zëvendësambasadori britanik në Durrës, i cili raportonte se Mbreti Zog kishte nxjerrë nga vendi i tij ar me vlerën e 50 mijë sterlinave dhe se kishte një llogari bankare prej 2 milionë dollarësh pranë “Chase Manhattan Bank” në Amerikë. Gjithashtu, ai kishte depozituar në “Lloyd Bank” në Londër 50 mijë sterlina. Nuk ishte përmendur shuma prej 10 mijë sterlinash në bankën e Italisë në Londër. Me sa dukej, Mbreti Zog nuk do t'i bëhej barrë askujt dhe kjo i ra në vesh edhe Mbretit Xhorxh. Fakti që shoqëruesit e Mbretit ishin tridhjetë veta, u bë shkak për këqyrje të mëtejshme, pasi askush nga Ministria e Punëve të Jashtme nuk arrinte të kuptonte se përse duhej të merrte me vete aq shumë njerëz në Angli.”

Ky është versioni i Geraldinës. Gjenco Naço që shoqëronte ato ditë mbretin e rrëfen kështu atë moment në kujtime:

“Por më së fundi morëm leje për në Angli. Nuk e morëm lehtë. U desh të vinte vet Mbreti në Bordeaux dhe të bisedojë me ministrin anglez. Mbreti më tregoi pastaj se anglezi insistoi t'i tregojë rrugën e Spanjës. Gjatë vizitës së Mbretit në Bordeaux kaluam një natë në rrugët e qytetit, sepse nuk kishim ku të shkonim. Atë natë qyteti u bombardua keqaz prej gjermanëve dhe pata rastin të shikoj se edhe

ata që e quajnë veten trim dhe luftëtar nuk janë kaq gjakftohtë në raste të tilla. Kështu u nisëm nga Royani përmes Bordeaux-s për në jug të Francës ku duhej të merrnim vaporin për në Angli”

Vapori duhej të merrej në Sen Zhan de Lyz dhe ishte mjeti i fundit që largohej nga Franca drejt Britanisë. Ishte një anije që mban-te 800 vetë, por mbi të cilën ishin tashmë thujse 2500 pasagjerë. Dhe askush nuk dëshironte të zbriste. Familja Mbretërore shqiptare mbërriti pak kohë përpara se kapiteni të jepte sinjalin e nisjes. Ata qenë të detyruar të linin në mol pothuajse gjithë bagazhet së bashku me 9 makinat, përfshi edhe Mercedesin e dhuruar nga Hitleri. Zogu i kërkoi Xheladin Nushit, një besniku të tij, që t'ia niste makinat nga Spanja, sepse imbarkimi nga çdo port francez ishte thujse i pamundur. Shumë vjet më vonë është botuar edhe një letër e firmosur nga mbreti, ku i beson transportin e makinave Nushit, të cilin e quan: “Directeur de la Maison Royale”. Dokumenti është firmosur teksa ndodhej në pritje të imbarkimit në portin e Sen Zhan de Lyz. Dokumenti, ka gjasa, të jetë nënshkruar kur sovran i rrëzuar ndodhej në kalatë gati për t'u larguar. Nënshkrimi i Mbretit Zog të Shqiptarëve është legalizuar, po më 22 qershor 1940, në Sen Zhan de Lyz, nga Milto Noçka, i ngarkuari me punë i Shqipërisë. Nushi i çoi bagazhet në Angli nëpërmjet Spanjës dhe Portugalisë. Valixhet mbërritën në Angli më 22 maj 1941, por makinat mbetën në Portugali. Nushi arriti të shpëtonte 7 nga 9 makinat që kishte Zogu kur u largua nga Shqipëria. “Mercedes-Benz” mbërriti në Angli me anijen avulllore “Gothland” më 24 tetor 1941.

Por udhëtimi drejt Anglisë nuk ishte ende i sigurt. Në anije nuk kishte asnjë kabinë dhe as telegrami me firmën e Mbretit Xhorxh nuk bënte punë. Gjithçka u zgjidh momentin e fundit, siç dëshmon Geraldina:

“Në fund, kapiteni hoqi dorë nga kabina e vet dhe arriti të gjente edhe një tjetër të lirë për pjesën tjetër të familjes, duke më thënë se ishte e nevojshme që të niseshim po atë natë.”

Ndërsa mbreti po ngjitej në kuvertë, ndodhi edhe një incident

që mund të kishte pasur kosto të jashtëzakonshme për familjen mbretërore. Askush më mirë se Geraldina që u ndodh aty nuk mund ta përshkruajë atë moment, që gjithsesi, e vërtetojnë edhe personat e tjerë që udhëtonin me ta:

“Në kuvertë, po prisja të vinte im shoq, të cilit i ishte bërë një nder i madh, duke i dhënë një motoskaf vetëm për vete dhe për dy oficerë që kishin përgjegjësi të ruanin baulet me sendet e çmuara. Aty ishin jo vetëm sëndukët me napolonat e floririt që Mbreti i kishte marrë prej kasafortës në zyrën e tij, por edhe stolitë e Oborrit dhe një sasi e konsiderueshme që u përkiste gjashtë princeshave. Mbreti kërkoi të shikonte me sytë e tij që ari dhe stolitë ishin ngarkuar në anije para se të largohej nga motoskafi, por kapiteni po turfullonte nga inati, pasi bartja e atyre bauleve aq të rënda në errësirë dhe në atë det të trazuar ishte një operacion i vështirë. Ju lutem, tani jam unë përgjegjës për sigurinë e Mbretit, – bërtiti, – le të hipë ai i pari. Ju jap fjalën që sëndukët do të ngarkohen pas tij!

Mbreti pranoi dhe filloi të ngjitej, kur, e tmerruar, pashë motoskafin të largohej pa pritur që të shkarkoheshin baulet. I nxirë në fytyrë, im shoq iu kthye kapitenit dhe e urdhëroi t’i jepte mjetet e duhura për të ndjekur motoskafin dhe të rimerrte sëndukët. Kapiteni iu përgjigj se nuk do të lejonte që Mbreti të largohej nga territori anglez.

Pastaj shpërtheu një sherr me të bërtitura gjithë inat, por më në fund, im shoq mori motoskafin e anijes dhe u nis në kërkim të ngarkesës së çmuar. Ai u kthye në anije dy orë më vonë, i gjithi qull, i rraskapitur dhe duarbosh. Dukej i drobitur, por mua më tha vetëm: -Ti nuk e ke idenë se ç’do të thotë të jesh pa asnjë kacidhe dhe të kesh mbi vete tridhjetë e gjashtë veta, përfshirë dhjetë gra dhe një foshnjë.”

I bindur se kishte humbur gjithë pasurinë, njëkohësisht garancinë e vetme për mbijetesë, Mbreti ishte shtrirë të flinte në njërin prej shtretërve marinarë të kabinës së tij. Sapo kish nisur të zbardhte, kur Mbretëresha ishte ngjitur në kuvertë për të parë nisjen e anijes. Ishte e trembur dhe e tronditur thellë nga ajo që kishte ndodhur një ditë më parë. Anija kishte ngritur spirancën, kur ajo pa nga larg një motoskaf që vinte me vrull nga porti. 3 burra tundnin duart për të

bërë shenjë. Në motoskaf kishte dalluar shoferin e tyre hungarez dhe dy marinarë, me gjithë baulet me flori dhe bizhuteri. Kapiteni e shtyu pak minuta nisjen e anijes. Baulet u ngarkuan në bord. Asnjë prej atyre të treve që i solli baulet e Mbretit në anije nuk e dinte se çfarë kishin brenda ato... Geraldina e shpjegon kështu në kujtime atë që kishte ndodhur:

“Shtjellimin e asaj ngjarjeje nuk mund ta besojë. Duke e pasur të pamundur të punonin në errësirë dhe në detin me tallaze, marinarët ishin kthyer në kalatë, e kishin lënë motoskafin dhe kishin shkuar në një bar të hidhnin nga një gotë derisa të vinte agimi. Pasi u dëndën me verë të kuqe, u çapitën deri në barkë dhe i kaploi gjumi. Shoferi, që kishte kërkuar gjithë natën nëpër kalatë, i vuri re marinarët dhe i urdhëroi të shkonin tek anija që sapo kishte filluar të lëvizte. Megjithëse në ankth për t’u nisur sa më parë, kapiteni, tani në një gjendje më miqësore, priti derisa u ngarkuan baulet”

VITET E LUFTËS NË ANGLI

1940 - 1946

Familja Mbretërore mbërriti në Angli më 26 Qershor 1940. Ajo përbëhej nga 35 vetë, ku përfshiheshin edhe 8 oficerë roje të Mbretit, dy infermiere dhe stafi i tij personal bashkë me gratë e tyre.

Situata në Angli ishte e ndryshme nga ajo në Francë. Lufta ndihej më pak. Praninë e saj, më shumë se sa mobilizimi, e sillte në sallonet e Londrës ushtria e shtetarëve dhe monarkëve europianë që me vendet e pushtuara nga Gjermania apo Italia, kishin gjetur strehim në kryeqytetin britanik. Mbreti Zog ishte njëri prej tyre, por ai ra më shumë në sy për arsye të ekstravagancës që shfaqti që ditët e para. Grupi prej 35 personazh okupoi thuhet një kat të hotelit "Ritz", padyshim më i famshmi i Londrës. Zogu mori me qera edhe një ambient brenda hotelit ku organizonte takimet, duke e kthyer hotelin në zyrë të Qeverisë Shqiptare në mërgim. Në disa libra thuhet se njeriu që ekzekutoi mbërritjen dhe vendosjen e Mbretit në Britani ishte Jan Fleming, autori i famshëm i Xhejms Bond, por kjo mbetet për t'u verifikuar.

Ajo që dihet është se Zogu mbërriti në Londër me një axhendë të qartë. Ai nisi një aktivitet intensiv. Vendosi kontakte dhe siguroi takime që kishin një lloj rëndësie, por nuk arriti asnjë takim të nivelit të lartë. Në kujtimet e saj, Geraldina rrëfen se Mbreti ishte takuar edhe me Kryeministrin Çerçill.

“Gjatë kësaj periudhe, im shoq pati disa takime me Uinston Çerçillin. Për fat të keq, për shkak të gjuhës, nuk mund të komunikohem drejtpërdrejt dhe takimet bëheshin me ndihmën e një përkthyesi. Mbaj mend që u kthye në hotel duke qeshur, sikundër nuk e kisha parë të bënte për ca kohë, më tregoi sesi po priste për të filluar takimin, teksa Çerçilli dhe De Goli ishin në një konferencë. Kishte mundur të dëgjonte të bërtiturat e De Golit: *La France... La France... La gloire de France!* Pastaj kishte dëgjuar ngritjen e zërit të Çerçillit, teksa përpiqej ta qetësonte.”

Në fakt kjo nuk figuron e vërtetë. Zogu nisi letra në drejtim të Kryeministrit, Mbretit dhe ministrit të Jashtëm, por nuk u pranua asnjëherë në ndonjë takim prej tyre. Më e ashpër që përgjigja e Kryeministrit Çerçill ndaj letrës që i kishte dërguar më 1 Nëntor 1941. Kryeministri sqaronte se nuk kishte kohë gjatë luftës për takim me të. Për ta përforcuar tezën që Britania nuk kishte dëshirë të përfshihej në çështjen shqiptare, Dixon, i ngarkuari me Shqipërinë, i deklaroi jo zyrtarisht Sotir Martinin se:

“*Britania e Madhe e kishte njohur gjendjen e re në Shqipëri si një gjendje de fakto!*”

Takimet që Mbreti arriti të realizonte qenë me njohës të Shqipërisë dhe kryesisht ata që kishin luajtur një farë roli në vitet '20. Pjesa më e madhe qenë modestë si nivel. Ajo që bie në sy është se në asnjë rast Zogu nuk mori premtimin se do të njihej si qeveri në mërgim. Anglezët kishin dy ndalesa të mëdha për ta marrë këtë vendim.

E para ishte fakti që ata e kishin njohur pushtimin italian të Shqipërisë, duke besuar se kjo do të ishte shfryrja e fundit e Musolinit. Në një dokument të rezervuar të Kryeministri Britanik, më 10 Prill, në përgjigje të pakënaqësisë së Parlamentit për mosreagimin e Londrës, shënohet fakti që sulmi italian ndaj Shqipërisë ishte organizuar shumë më parë se sa të nënshkruhej pakti britaniko – franko – polak, që mbronte vendet e vogla nga sulmet e Boshtit. Kryeministri sqaronte se Britania, nuk mund të ishte më agresive se sa Jugosllavia që prekej direkt nga ky pushtim. Ai vinte

në dijeni deputetët se ambasadori italian në Londër, Crolla i kishte kërkuar atij një takim urgjent në të cilin kishte shprehur pakënaqësinë e madhe të Musolinit për mbështetjen që shtypi britanik i kishte dhënë Shqipërisë, për talljet me Italinë dhe kishte dorëzuar një dokument me 7 pika.

Pika 1 e dokumentit nënvizonte se Italia ka pasur një ndikim thuajse 100- vjeçar në Shqipëri dhe kontrollin ndaj këtij vendi ia kishte caktuar Konferenca e Ambasadorëve.

Pika 5 shënonte faktin se Jugosllavia dhe Greqia, aprovuan në heshtje pushtimin dhe ishin mjaft të qeta.

Pika 6 shënonte faktin që pushtimi i Shqipërisë, nuk cënonte marrëveshjen anglo – italiane të Prillit 1938.

Kryeministri Britanik, sqaronte se Anglia nuk mund të rrezikonte stabilitetin në Mesdhe për hir të pavarësisë së një vendi të vogël dhe shtonte se Musolini mori paralajmërim që mos të sulmojë Korfuzin.

Qëndrimi i Britanisë mbeti konstant. Edhe në vitin 1942, kur krijimi i grupeve dhe i partive të para të rezistencës tërhoqi vëmendjen e aleatëve, britanikët që e dinin se Abaz Kupi ishte besnik i Zogut nuk pranuan ta përdorin. Ata refuzuan t'i dërgonin Kupit, sipas kërkesës së tij, një letër të firmosur nga Mbreti ku flitej për angazhimin në luftë kundër gjermanëve. Nuk pranuan ta bëjnë këtë sepse kishin refuzuar t'i njihnin Zogut të drejtën e një qeverie legjitime në mërgim siç kishin bërë me qeveri të tjera. Arsyen e shpjegon fare mirë P.Dixon në një relacion të *Foreign Office* më 10 korrik të 1942-it:

“*Mbreti Zog është si të thuash një viktimë e politikës së dakordësimit. Sikur italianët ta kishin pushtuar Shqipërinë pasi hynë në luftë kundër Britanisë së Madhe, Mbreti Zog padyshim do të ishte pritur në vendin tonë si një mysafir nderi, njëlloj si monarkët e tjerë që kanë ikur nga vendet e tyre pasi këto u pushtuan nga fuqitë e boshtit. Mirëpo ndodhi ndryshe, Shqipëria u pushtua një vit më parë dhe ne e gjetëm të leverdishme të njihnim aneksimin italian dhe njëkohësisht të pranonim vlerësimin që i bënin italianët Mbretit Zog si një sundimtar i pakënaqshëm.*”

Problemi i dytë ishte ai i kufijve. Të gjithë shqiptarët influentë, përfshi Mbretin Zog, kërkonin nga Britania dhe SHBA-të garanci për të ardhmen e Shqipërisë dhe paprekshmërinë e kufijve të saj. Garanci që ministri i Jashtëm, Eden, i shkruante Çerçillit që s'mund të jepeshin sepse do të krijonin probleme me qeverinë aleate greke në mërgim që kishte pretendime territoriale. Problemi i Greqisë dhe pretendimeve të saj ishte problemi më i madh me të cilin përballlej Shqipëria. Në një dokument të arkivave Britanike, sqarohet se Mbretit Zog i ishte kërkuar si kusht për lejen e qëndrimit në Britani, që të mos jepte asnjë intervistë për shtypin pa marrë më parë pëlqimin e Ministrisë së Jashtme Britanike. Përveç kësaj, tezat e intervistës duhej të aprovoreshin po nga zyrat e kësaj Ministrie. Në një rast, ja çfarë shkruan çensori i Ministrisë së Jashtme për shefin e tij, pasi ka parë përgjigjet që Zogu i ka dhënë gazetës "Daily Telegraph":

"Intervista më duket jo e dëmshme dhe në fakt është ndihmuese përveç paragrafit numër 5 që ka të bëjë me të ardhmen e Shqipërisë. Me publikimin e kësaj interviste do të vijë publicitet i madh dhe gazetarë të tjerë britanikë do të ndjekin Zogun, por nuk besoj se ne mund ta ndalojmë këtë fakt. Por Mbreti Zog duhet të mbajë kryesisht linjën e paraqitur në këtë intervistë. Nëse qeveria greke apo ambasadori grek do të tregojë nervozitet, ne mund t'i shpjegojmë atij se në pikëpamjen tonë të politikës aktuale ndaj Mbretit Zog (e cila është që ta mbajmë "ngrohtë") u ndjemë të detyruar që të heqim këtë ndalim për të folur me gazetarët..."

Zogu e dinte fare mirë që Greqia dhe pretendimet e saj territoriale do pengonin njohjen e një qeverie shqiptare në mërgim. Gjatë sulmit italian ndaj Greqisë më 1940 dhe rezistencës së kësaj të fundit ai qe ftuar nga britanikët të transferohej në Selanik prej nga mund të komandonte një ushtri të vogël vullnetare shqiptare në front. Mbreti i kishte premtuar gjeneral Persit se mund të grumbullonte nga 10 në 40 mijë vetë dhe në dimrin e 1940-ës.

Gjatë javëve të para të Luftës italo - greke, dy zyrtarë të Departamentit të Jashtëm u takuan me të dhe i bënë ofertën që të nisej. Nisja do të bëhej po atë mbrëmje. Geraldina kujton se ai u bë gati, madje u përgatitën edhe valixhet, por makina që do ta çonte në

aeroport nuk erdhi as atë ditë dhe as të nesërmen. Kohë më vonë, sërish Dixon i dha këtë shpjegim Sotir Martinut:

"Ata që erdhën ishin zyrtarë të Foreign Office, por çështja ndryshoi sepse nuk deshën grekët."

Ky ishte një refuzim zyrtar, por edhe një shans personal. Avioni me të cilin do të nisej Mbreti për Kajro, e prej këtu për në Selanik u rrëzua po atë mbrëmje nga stuhia mbi Mesdhe.

Më rënien e Greqisë dhe me vendosjen e Qeverisë Greke në mërgim në Londër, Zogu kishte bërë disa përpjekje për të vendosur marrëdhënie me ta. Gjenco Naçi, sekretari i tij dëshmon:

"Sapo erdhi qeveria greke në Londër, u munduam të marrim kontakt me z. Çudheros. Z. Kerran mundi t'a sillte në një drekë tek Mbreti, drekë ku mori pjesë dhe deputeti F.Noel Baker. Çudheros ishte tepër i rezervuar. S'tha gjë mbi kërkesat greke dhe teza e tij ishte se puna e Shqipërisë do të rregullohej pasi të rregulloheshin definitivisht marrëdhëniet greko-jugosllave. Mbreti u mundua ta "përkëdhelë" duke i thënë se duhej të punonte "dhe për Shqipërinë si për Greqinë." Nuk doli gjë prej këtij takimi. z.Çudheros madje as që e ktheu drekën, por vetëm dërgoi sekretarin e tij t'i paraqesë falenderimet e tij Mbretit. Darka i bindi grekët që ne nuk kishim fare fuqi. Mbreti u mundua me çdo mënyrë që të mos hapet plagë greko-shqiptare."

Në fakt, grekët kishin protestuar zyrtarisht më 13 shtator 1942, ndaj një interviste që Mbreti kishte dhënë një ditë më parë për gazetën "Manchester Guardian" me titull: "E ardhmja e Shqipërisë", ku shprehej:

"Përderisa Karta e Atlantikut siguron pavarësinë dhe lirinë për të gjithë kombet është e qartë se siguron Pavarësinë e Shqipërisë në sovranitet të plotë dhe me kufijnjtë e saj kombëtarë. Asnjë përjashtim s'mund të imagjinohet nga asnjë shtetar apo të pranohet nga një opinion demokratik".

"Kur Italia sulmoi Shqipërinë me 7 prill 1939 ne treguam se

zgjedhëm të mbrojmë territorin dhe pavarësinë tonë. Nëse rrethanat nuk do të ndalonin fqinjët tanë si Greqia dhe Jugosllavia për të dhënë ndihmën e tyre (siç duhej të kishin bërë, sepse ishte një agresion racional) Shqipëria do të ishte në gjendje t'i rezistonte sulmit."

Zogu kishte sulmuar hapur grekët dhe Jugosllavët për dakordësimin e heshtur me pushtimin e Shqipërisë më 7 Prill 1939.

Problemi i kufijve të Shqipërisë do të zgjidhej përfundimisht në fund të vitit, por sërish britanikët do të ishin me qëndrim të papërcaktuar. Më 1942 edhe Uashingtoni kishte nisur të lëvizte në këtë drejtim. Më 19 nëntor të 1942-it Fan Noli dhe Faik Konica u ftuan për t'u dëgjuar mbi të ardhmen e Shqipërisë nga Earl Brennan, i Zyrës së Shërbimeve Strategjike. Ky kishte marrë porosi të veçantë nga Cordell Hull, Sekretari Amerikan i Shtetit. Dy ditë më pas, Hull mori një letër-deklaratë të Faik Konicës dhe Fan Nolit ku ata konkludonin:

1) Vetëm një front i bashkuar shqiptar që do të përfshinte të gjitha personalitetet e mundshme shqiptare do të kishte shans që të tërhiqte nga pas të gjithë popullin shqiptar dhe të ishte i dobishëm për Kombet e Bashkuara.

2) Mbreti Zog mbetet personaliteti shqiptar më i shquar që është gjallë (the foremost living Albanian personality), dhe përjashtimi i tij do ta zhvishte lëvizjen e propozuar nga fuqia e saj.

3) Asnjë pjesëtar i këtij fronti të bashkuar nuk duhet të detyrohet të heqë dorë nga ideologjia e vet politike, por do të bashkëpunojë derisa integriteti territorial dhe pavarësia e Shqipërisë të sigurohen në Konferencën e Paqes, paskëtaç secili do të rifitojë lirinë e vet të veprimit.

Faik Konitza

† F. S. Noli.

Më 10 dhjetor të vitit 1942, Cordell Hull lexoi dhe shpërndau para shtypit këtë deklaratë:

"Qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk e ka harruar qëndresën e vazhdueshme të popullit shqiptar kundër pushtuesve italianë. Ne

i admirojmë dhe i çmojmë përpjekjet e grupeve të ndryshme guerilase që luftojnë kundër armikut të përbashkët në Shqipëri. Qeveria dhe populli i Shteteve të Bashkuara e presin me padurim ditën kur këtyre burrave trima të mund t'u japim të gjithë ndihmën efektive ushtarake që të çlirojnë vendin e tyre nga pushtuesi. Në përputhje me politikën e qartë dhe të pandryshuar për mosnjohjen e asnjë pushtimi të arritur me forcë, Qeveria e Shteteve të Bashkuara nuk e ka njohur kurrë aneksimin e Shqipërisë prej kurorës italiane."

Një javë më pas, më 17 dhjetor të 1942-it, Entoni Eden, ministri i Jashtëm britanik deklaroi se Shqipëria duhej të shihej e çliruar prej zgjedhës italiane. Të njëjtën deklaratë përsëriti edhe ministri i Jashtëm sovjetik, Molotov. Pak kohë më vonë, Eden shtoi se çështja e kufijve do të diskutohej gjithsesi në Konferencën e Paqes.

Zogu nuk i rreshti asnjë moment përpjekjet për t'u njohur si monark në mërgim. Kishte gjithnjë shpresën se mbarimi i luftës, do të harmonizonte me rendin e ri botëror edhe rivendosjen e disa ekuilibrave të humbur. E dinte që fatkeqësia e tij ishte ajo e një vendi të vogël që nuk luante asgjë në balancat e reja botërore. Ishte një vend aq i parëndësishëm sa Çerçilli dhe Stalini gjatë takimit të Moskës, ku ndanë Europën e ardhshme më 1944, harruan ta përmendin. Harresa u plotësua të nesërmen kur për pak sekonda të dy ranë dakort që Shqipëria të marrë drejtimin që do të merrte Jugosllavia.

Shqyrtimi i letrave dhe intervistave që Zogu dha gjatë luftës, të çon në përfundimin se ai ishte njeri me nuhatje të jashtëzakonshme politike. Ishte një talent i lindur në këtë drejtim, por një talent që nuk mund të vendoste asgjë, as fatin e tij. Mund t'i referohesh edhe vetëm një interviste të tijës në "Manchester Guardian" më 12 shtator 1942. Ai e vendos Shqipërinë gjithnjë në një kontekst rajonal. I pyetur për marrëdhëniet e Shqipërisë me Italinë shprehet:

"Gjëja e parë është që Italia duhet të kthehet në anën tjetër të Adriatikut njëherë e përgjithmonë. Ballkani nuk është një zonë për t'u kolonializuar. Nëse Italia pas një kohe pendese dhe ndërskimi rimerr rolin e saj në jetën evropiane ajo mund të ketë marrëdhënie normale me Gadishullin Ballkanik. Nëse Ballkani është i bashkuar

dhe shtetet të kenë konfidencë tek njëri-tjetri, ne nuk kemi për t'u trembur aspak nga një Itali e re. Në një konkurrencë të lirë të tregut të Europës Juglindore, qytetarët italianë do të ketë shanset e tyre, por ajo që duhet të kuptohet është se bashkëpunimi ekonomik nuk mund të jetë prelude i një penetrimi politik apo ushtarak”.

Eshtë e çuditshme se si në mes të luftës, pa u mësuar ende qartë fati i saj, Zogu flet për bashkëpunimin ekonomik në vend të imponimit ushtarak. Më tej flet për Europën e pasluftës me po atë vizion që ajo u ndërta vërtet:

“Mënyra më e mirë për të organizuar një paqe jetëgjatë do të jetë atëherë kur Europa të jetë vendosur mbi një sistem të përbashkët sigurie. Por, kjo nuk duhet të organizohet në marrëveshje individuale mes shteteve. Duhet të formohet përmes ngjitjes e bashkimit të një grupi shtetesh, kështu që vendet e vogla nuk do të mund të paralizojnë aksionet e vendeve të mëdha, por as vendet e mëdha të mos jenë në gjendje që të ushtrojnë influencën e tyre mbi asnjë vend të vogël.”

Duket sikur sistemi për të cilin ai flet, janë BE-ja dhe NATO-ja e pasluftës.

Si një lojtar i dëshpëruar Mbreti Zog përdor të gjitha mjetet që ka në dispozicion për të tërhequr vëmendjen e Londrës politike dhe për të siguruar aleancën e saj. Mban kontakte të forta në Shqipëri dhe i instrukturon mbështetësit e tij që t'i imponohen misioneve britanike, i dërgon fjalë Abaz Kupit që në këmbim të luftës frontale me gjermanët t'u kërkojë britanikëve një letër prej tij, përpiket të organizojë mbështetës për Shqipërinë e pasluftës, dërgon letra në Uashington dhe Moskë, mundohet të bashkojë gjithë figurat me ndikim që janë në diaporë. Së fundmi, bën premtime që edhe ai e di që s'kanë shumë sens. Siç vërtetohet nga kjo memo e datës 24 janar 1944 e Ministrisë së Jashtme:

“Duket që mbreti Zog ka pasur një takim, me 4 anëtarë të shoqatës anglo-hebraike, përfshirë z. Montefiore dhe z. Robert Ualey Cohen, ku ai ofroi mundësinë e sponsorizimit të një plani për strehimin e

hebrenjve në Shqipëri nëse hebrenjtë e ndihmojnë atë të rifitojë sërish fronin e tij. Shoqata anglo-hebraike është e mendimit se vlerësimi i Zogut për një reagim të mundshëm, për një projekt të tillë në Shqipëri, vjen për shkak të besimit të tij të dukshëm në fuqinë e hebrenjve.

Nuk u dorëzua deri në fund. Dhe po ashtu deri në fund besoi se mbështetësit e tij në Shqipërinë e pas luftës do të ishin më shumë se sa ata të komunistëve. Në fakt, duket se nuk kishte informacionet e duhura. Ose ata që e informonin e gënjenin, ose ai nuk arrinte t'i vlerësonte si duhet paralajmërimet e tyre. Por më 14 prill 1944, Ragip Frashëri, djali i regjentit Mehdi Frashëri, ish- Kryeministër i mbretërisë, arriti të dilte nga Shqipëria dhe të organizonte një vizitë në Stamboll. Misioni ishte kontakti me britanikët dhe konfirmimi tek ta se Qeveria e Tiranës ishte gati për një marrëveshje, dhe që gjermanët qenë thjesht tranzit. Po atë ditë ai takoi Kolonel Hysen Selmanin, të cilit i citoi këto 4 rreshta për Mbretin:

“Babai më dërgoi tek ju dhe Vehbiu në Zvicër (Vehbiu ishte djali tjetër i Mehdi Frashërit që mbante postin e ministrit të Jashtëm). I thoni Mbretit që Shqipëria, nëse nuk i bini mbrapa, ka mbaruar krejtësisht. E kanë marrë komunistët në dorë. Kjo 100 përqind e vërtetë.”

Mesazhi mbërriti në Londër tek Mbreti Zog në datën 22 Maj 1944. Si për ironi të fatit, po atë ditë, komunistët qenë mbledhur në një kongres që do të merrte vendimin për t'ia ndaluar Mbretit Zog rikthimin në Shqipëri pas luftës. Asnjë referendum nuk do të mbahej. Dhe komunistët po përdornin për ta larguar nga fronti po atë formë që ai kishte përdorur për të lënë jashtë tij, Princ Vidin.

Qëndrimi i familjes Mbretëror në Londër ishte po ashtu histori më vete. Ata banuan për shumë muaj në hotel “Ritz”, duke tërhequr vëmendjen e mediave, por edhe në kushte të vështira. Hoteli ishte i hapur për klientë dhe një grup prej 35 vetësh që jetonte përditë aty përbënte problem. Fatura ishte shumë e lartë edhe pse për Mbretin ishte bërë çmim special shumë larg nga ai i një zyrtari.

Hoteli është ndërtuar në një nga rrugët më të populluara të Londrës dhe dalja apo shëtitja rrotull bëhej shumë e vështirë.

Lëvizjet në "Haid Park" u rralluan për arsye se gjermanët nisën bombardimet ndaj Londrës. Geraldina kujton se një kat i "Ritz" u godit nga një bombë ndërkohë që në "Haid Park", vetëm pak metra prej vendit ku dadoja po shëtiste Lekën 2- vjeçar ra një bombë që vrau shumë vetë. Fati e shpëtoi foshnjën e vogël. Të shqetësuar nga qëndrimi në qendër të qytetit, ata vendosën të transferoheshin në ndonjë zonë në periferi, aty ku bombat nuk binin dhe jetesa e përditshme ishte më e thjeshtë. Por atë moment zbuluan që pikërisht për këtë arsye çmimet e shtëpive në periferi të Londrës ishin ngritur mjaft ndërsa ofertat për të siguruar një tillë ishin fare minimale. Në një nga këto ditë, Mbretëresha Gerladinë që ishte e vëmendshme ndaj lajmeve të shtypit lexoi në gazetë se lordi Pamur, ish- deputet i Parlamentit Britanik, kishte ndërruar jetë dhe familja donte ta jepte shtëpinë me qira. Ajo u nis menjëherë për atje dhe fati e ndihmoi. Mbërriti në shtëpinë e nxjerrë për shitje vetëm 1 orë përpara se autoritetet e Aviacionit Ushtarak të shkonin me ofertën për ta marrë me qira shtëpinë. Duket se familja gjykoj që qëndrimi i Mbretit të Shqipërisë, ishte më komod se sa ai i oficerëve të aviacionit. Një rol luajti në këtë drejtim edhe komuniteti i banorëve që mendonin se prania e ushtrisë në atë vend mund të provokonte bombardimet gjermane. Zogu e mori shtëpinë me qera.

"Parmoor House" ishte një vilë që më shumë mund të quhej pallat. Ajo kishte 40 dhoma, shumë banjo, disa sallone, një shtëpi miqsh në oborr dhe mbi të gjitha një kopsht magjeps. Geraldina e përshkruan kështu atë:

"Ishte një ngrehinë e stërmadhe që lartësohej në kodrat Çiltern midis Henli-mbi-Tamiz dhe qytezës së vjetër të Hai Uikombit. Shtëpia e madhe gjendej në park, në mes të pyllit. Pranë saj kishte edhe një stallë të vogël dhe një kopsht të madh ku rriteshin perime. Mobilimi ishte në stilin e shtëpive të fshatit, tipike angleze, mjaft e rehatshme dhe tejmasë e përshtatshme për tridhjetë e katër veta".

Familja Mbretërore u vendos në vilën qendrore, ndërsa oficerët në shtëpinë e miqve në fund të oborrit. Mbreti bleu 4 qen të mëdhenj që vërtiteshin nëpër oborr e luanin me Lekën. Bashke më ta edhe një dhi. Më këmbënguljen e Geraldinës u blenë pula që siguronin vezë

të freskëta për 34 banorët e vilës. Disa banorë lokalë u punësuan si shërbyes në vilë, në ndihmë të stafit të Mbretit. Për të pasur kontakt me Londrën, Mbreti mbajti gjatë gjithë viteve të luftës një Suitë në hotel "Ritz", që e përdorte si zyrë për takime të rëndësishme, por që siç shkruan Rows, një historian amator që ka qëmtuar jetën e Zogut në Angli, përdorej nga nipat e mbretit edhe për takime dashurore me gratë e zonës. Sipas tij, shumë gra të moshuara e kujtojnë me nostalgji kohën kur mungesën e djemve që kishin në luftë e plotësonte stafi i Mbretit pa dijeninë e këtij të fundit.

Më 5 maj 1941, bagazhet që ishin braktisur në Francë, pasi kishin udhëtuar përmes Spanjës dhe Portugalisë, kishin mbërritur me anije nga Lisbona në Liverpul. Geraldina kujton:

"Pasi ishim shpërngulur në shtëpinë Parmur, na erdhi lajmi se sendet tona personale të lëna në Bordo kishin mbërritur në Liverpul, ku qenë vendosur në një magazinë. Mezi prisja të vishja rrobat e firmës Maggy Rouf dhe gjashtë palltot me gëzof të blera që kur isha në Shqipëri.

Pesë veta nga shpura jonë, morën trenin për në Liverpul që të nesërmen e lajmit. Nuk çuam dem asnjë sekondë kohë. Të nesërmen në mëngjes, një zë i ngrysur na telefonoi për të na bërë të ditur që gjithçka, përveç një makine, ishte shkatërruar plotësisht nga goditja e drejtpërdrejtë e një bombe."

Bombat kishin goditur depon ku ndodheshin bagazhet e Mbretit në portin e Liverpult në datat 5 dhe 6 maj 1941. Bombardimi kishte qenë i ashpër. Të gjitha bagazhet dhe 7 makina qenë djegur. Si për ironi të fatit, e vetmja që qëndronte e paprekur, në mes të rrënimit ishte makina Mercedes Benz që Hitleri i kishte dhuruar Mbretit Zog për dasmë. Geraldina iu lut Mbretit që ajo makinë të mos vinte më në shtëpi dhe thujse asnjëherë nuk hipi në të. Zogu doli një herë të vetme me makinën e madhe, por ajo u bë shkak për një incident me banorët që nuk donin që makina e Hitlerit të endej në rrugët e tyre. Zogu nuk e përdori më derisa e shiti.

Shkatërrimi i bagazheve u bë shkak për një çështje legale të Mbretit me kompanitë e sigurimeve. Ajo nisi që në vitin 1941 dhe përfundoi më 22 Qershor 1948, kur Bordi i Tregtisë vendosi që ai të dëmshpërblehej për humbjen. Shkresa thotë:

“...u vendos për të pranuar kërkesën që të paguhet sa më shpejt dëmshpërblimi sipas pjesës së dytë të Aktit për Dëmet e Luftës dhe u pagua një total prej afërsisht 51.500 paund britanik, duke e ndarë në 10 mijë paund për Mbretin Zog, 6126 paund për secilën nga tre princeshat motra të mbretit, 3 478 paund për princeshë Nafije Kosova, dhe një shumë më e vogël për pjesëtarët e tjerë të familjes dhe oborrtarët e Zogut”

Mosregjistrimi i bagazheve në hyrje, në kaosin e luftës, u bë shkak për një problem politik, por edhe mediatik në Angli. Gjatë viteve të luftës, disa herë Ministria e Jashtme Britanike “i kishte sugjeruar” Mbretit Zog që të vendosej në SHBA. Ata besonin se largimi do t’i lehtësonte nga një telash. Nuk është çudi që këtë gjë, t’ua ketë çuar nëpër mend vetëm Mbreti që herë-herë deklaronte se do të vendosej në SHBA. Por në fund të luftës dhe kur u bë e qartë se Zogu nuk do të kthehej më në Shqipëri, britanikët u ndjenë shumë të lehtësuar, kur ai vendosi të largohej për në Egjipt. Me këtë rast, ata vunë në dispozicion të transportit, disa dhoma në një anije luftime që udhëtonte nga Liverpuli në Port - Said. Më të u transportua gjithë bagazhi i Mbretit si dhe grupi prej 19 vetash që e shoqëronte. Por në shkurt 1946, deputeti House, e ktheu këtë favor ndaj Zogut në një problem politik. Ai i shtroi këtë pyetje ministrit të Jashtëm të Britanisë dhe ministrit të Marinës:

“Dua të pyes Sekretarin e Shtetit për Punët e Jashtme nëse ai është në dijeni se ish- Mbreti Zog në largimin nga Britania për në Egjipt, ka marrë me vete 2 mijë copë valixhe dhe pse kjo mënyrë aspak ekonomike e hapësirës së anijeve tona, kur dihet se vendi ynë ka një nevojë dhe kërkesë të madhe për hapësirë në transportin detar?”

Nëns sekretari i Shtetit për Punët e Jashtme z. McNeil iu përgjigj zyrtarisht më 14 shkurt 1946.

“Me kërkesë të Mbretit Zog ne bëmë përgatitje përmes Ministrisë së Transportit të Luftës për të pasur hapësirën e duhur në transportin me anije në udhëtimin e tij drejt Egjiptit. Duhet të pranojmë se ai është sjellë mjaft mirë gjatë qëndrimit të tij në Britani dhe natyrisht

nuk ka asnjë arsye të derdhim lot për largimin e tij.

Në lidhje me pyetjen e valixheve, departamenti i komunikimit ka deklaruar se Qeveria Britanike nuk ka qënë e përfshirë në përgatitjet të cilat u bënë nga kanalet private të transportit por ne asistuaam vetëm në gjetjen e hapësirës për një makinë të vogël.”

Në fakt Zogu nuk transportonte 2000 valixhe, por debati në Parlament u kthye në një debat të hapur mediatik. Shtypi e zgjati historinë disa javë me radhë duke shtuar se kishte transportuar në to mallra të blera gjatë viteve të luftës pa kupon tatimor. Si shembull për këtë, shtypi mori aktin që ai kishte dalë nga Londra me 30 kostume, kur në një intervistë në fillim të saj kishte deklaruar se kishte vetëm 5 kostume. Çështja e bagazheve u bë një problem spekulativ. Siç dëshmon studiuesi Erald Kapri, më 16 Shkurt 1946, nipi i Mbretit Zog, përgënjeshtroi në gazetën “Times” në lidhje me lajmin për 2 mijë valixhet e Mbretit Zog, Salih Dohshishti i dërgoi këtë përgënjeshtroim gazetës “Time” të Londrës:

“...personalisht jam marrë me përgatitjet për transportin e valixheve të Mbretit Zog të Shqipërisë dhe grupit të tij, dhe u ndjeva i surprizuar kur lexova artikullin në “The Times” për 2 mijë valixhet dhe 30 kostumet e xhaxhait tim.

Faktet janë se grupi që shoqëroi Mbretin Zog përbëhej nga 19 vetë dhe kishin me vetë vetëm 136 copë valixhe dhe jo 2 mijë saç raportuat ju. Në to përfshihen objekte si një Gramafon, dy kapakë për mbajtjen e disqeve të gramafonit, dy makina shkrimi, një radio set, disa valixhe me libra, disa dosje si dhe një biçikletë fëmijësh.

Në lidhje me raportim për 30 kostumet e Mbretit Zog është po ashtu e pavërtetë. Valixhet personale të Madhërisë së tij u shkatërruan nga bombardimet gjermane në dokun e portit të Liverpulis në vitin 1941 dhe kur ai u largua nga Britania e Madhe kishte me vete vetëm 5 kostume.”

Pak ditë më vonë, përgënjeshtrimi u publikua edhe në gazetën “Daily Herald”:

“Në datën 21 shkurt në një lajm të botuar në lidhje me veshjet e Mbretit Zog i cili tashmë është larguar për në Egjipt, Gazeta “Daily

Herald "pranon se nuk kishte asnjë të vërtetë në lajmin e botuar se Mbreti Zog kishte më shumë se 5 kostume me vete. Ai nuk ka blerë asnjë veshje në këtë vend pa kuponin tatimor. Çdo kërkesë që ai ka bërë për qepje kostumi do t'i dërgohet në Egjipt brenda të gjitha ligjeve të tregtisë së eksportit. Ne ndihemi keq dhe kërkojmë falje për çdo impresion të kundërt që lajmi i botuar nga ne mund të ketë dhënë.

2 mars 1946"

Çështja e Mbretit Zog dhe e parave të tij ishte bërë problem mediatik gjatë 5 vjetëve që qëndroi në Londër. Marrëdhëniet me shtypin nuk ishin të mira dhe Gjenco Naçi kujton se ai nuk e njihte dhe nuk e kuptonte këtë aspekt. Mbreti i përzuri pa i takuar gazetarët që pritën 2 ditë rresht në hollin e hotel "Ritz" për ta takuar, - kujton ai. Ditën e tretë ata ikën dhe nuk erdhën më. Zogu nuk e njihte funksionimin e një shoqërie të lirë dhe rolin e shtypit në të. Njeri i lindur në një botë tjetër, ai besonte shumë më tepër tek prapaskenat dhe intrigat e politikës se sa tek komunikimi me publikun. Ky i fundit duket se nuk i interesonte fare dhe kjo gjë, ndodhi deri në fund të jetës. Ngjan normale për një njeri që e kishte nisur karrierën me Sulltan Hamitin dhe që po jetonte në botën moderne të Pas Luftës së Dytë Botërore.

Tashmë që komunistët ishin instaluar në pushtet dhe që lajmet nga Shqipëria nuk ishin aspak optimiste, Zogu kishte vendosur të largohej nga Anglia. Ai duhej të gjente një vend që ia njihte statusin e Mbretit dhe që vijonte të pranonte qeverinë e tij në vend të qeverisë së re të Tiranës. Në fund të vitit 1944 ai bisedoi me njerëzit e afërt dhe përcaktoi se cili prej tyre do ta shoqëronte në udhëtimin e mëtejshëm dhe cili do të mbetej në Britani. Kjo ishte një zgjedhje me vullnet të lirë. 19 veta vendosën të vijojnë aventurën me të, 15 të tjerë u ndalën në Angli.

Geraldina e kujton kështu momentin kur u shpall mbarimi i luftës, që ishte njëherazi edhe mbarimi i shpresës së tyre për t'u rikthyer menjëherë në atdhe:

"Mbah mend ditën kur shkuam në një festë zyrtare në ambasaden braziliane. Dritaret ishin hapur kat më kat dhe mund të dëgjonim zërin e Çerçillit që jepte lajmin e përfundimit të luftës. Në

tavolinë ndodheshin vetëm personalitete politike dhe unë u trishtova shumë, pasi të gjithë nuk flisnin për gjë tjetër veçse për luftën që do të shpërthente prej Rusisë. Gjithkush në tavolinë e kuptoi rrezikun e madh të ndarjes së botës nga dy ideologji katërcipërisht të kundërta."

Pikërisht atëherë Mbreti vendosi të shihte drejt vëllezërve myslimanë, të kthehej dhe të ngrinte bazën dhe shtëpinë e tij në një vend islamik.

ZOGU DHE SHQIPËRIA KOMUNISTE

“Zogu rron në një pallat larg Londrës duke pasur me vete familjen e tij dhe disa oficerë...”

Zogu këtë kohën e fundit ka lojtur një politikë gjoja për të mirën e vendit. Ka kërkuar marrjen pjesë të Shqipërisë në San- Francisko dhe ka bërë presion për njohjen e qeverisë shqiptare. Është treguar si njeri që nuk e shtron çështjen e regjimit, por është treguar sikur do ta lërë në dorë të popullit.”

Ky shënim që mban datën 20 Tetor 1945 dhe titullin “*Informata nga Londra për vendndodhjen e Zogut*”, është raportimi i parë i dosjes prej mijëra faqesh që Sigurimi Shqiptar i Shtetit ngrii për ndjekjen e Mbretit Zog në mërgim. Që nga kjo ditë e deri në vdekje, dosja që plotësohej rregullisht me informacione përfshin brenda saj edhe dokumenta që vinin nga UDB – ja jugosllave dhe më pas nga KGB – ja sovjetike. Asnjëherë nuk është mësuar kostoja e përgjimit të Mbretit Zog dhe shuma që u harxhua për agjunkturën që vepronte pranë tij, sa ishin shifrat që u dhanë për të blerë njerëzit afër apo personat e huaj që jepnin informata. Nga shqyrtimi i dosjes del se në 15 vjet, afro 35 informatorë të ndryshëm kanë ndjekur itinerarin e tij dhe ndër këta përfshihen edhe njerëz që punonin shumë afër. Emri i tij i koduar ishte “Macukulli”. Nuk dihet si dhe përse i ishte vënë ky emër, por dihet se dosja e Macukullit është më e rëndësishmja që Sigurimi Shqiptar ngrii në 46 vjetët e ekzistencës së tij.

Në fakt, mbarimi i luftës dhe fitorja e komunistëve në Shqipëri, e kishte lënë Mbretin Zog jashtë zhvillimeve politike në vend. Ai e kishte humbur shpresën që qeveria e tij të restaurohej si një qeveri e larguar nga pushtimi italian dhe e kuptoi që rrethanat politike dhe afërsia e qeverisë së Tiranës me Moskën e bënë të pamundur kthimin. Qëndrimi i Hoxhës ndaj tij ishte tejet i ashpër. Në dhjetor 1944 dhe në shkurt 1945, Hoxha u kishte kërkuar britanikëve kthimin e Mbretit forcërisht në Shqipëri. Ahmet Zogu ishte shpallur kriminel luftime dhe mbante numrin 1 në listën e personave në kërkim. Nuk kuptohet se si akuzohej për kriminel luftime, kur ishte larguar nga Shqipëria 6 muaj pa nisur zyrtarisht lufta dhe i kishte kaluar gjithë vitet e saj në Angli.

Nga ana ligjore Hoxha veproi po kaq shpejt dhe me të njëjtin stil që vetë Zogu kishte vepruar më 1925 dhe 1928. Më 10 janar 1946, Asambleja Kombëtare, e dalë nga zgjedhjet e 2 dhjetorit të 1945-ës u mbledh në Tiranë. Hoxha hyri vetë në punimet e saj duke ecur në këmbë i shoqëruar nga Tuk Jakova. Ishte ora 10:00 paradite. Një dëshmitar e kujton kështu vendimin e saj:

“Asambleja vendosi në mënyrë unanime që Shqipëria të shpallej Republikë. Me solemnitet kryetari Asamblesë e shpalli Shqipërinë Republikë Popullore. Të gjithë deputetët u ngritën më këmbë dhe vazhduan me duartrokitje të zjarrta. Në vazhdim kryetari lexoi formulën me anën e së cilës argumentohej heqja e regjimit monarkist dhe shpallja e Shqipërisë Republikë Popullore.

Shpallja e Republikës, u bë një ditë më pas, më 11 janar të vitit 1946. Deputetët e Vlorës, përmes Hysni Kapos, kërkuan nga Asambleja që Mbretërisë t'i jepej fund dhe vendi të shndërrohej në Republikë Popullore. Propozimi u hodh në votë dhe 100 % u shprehën pro tij. Vendimi i Asamblesë i mbylli derën përgjithmonë Mbretit Zog që të kthehej në Shqipëri, qoftë edhe si qytetar i thjeshtë, pa harruar dënimin e tij në mungesë.

Që nga ky moment ai i kaloi për ndjekje drejtorisë së Sigurimit të Shtetit duke u shndërruar në personin më të rëndësishëm dhe të mbikëqyrur të kundërzbulimit. Ai u vu në ndjekje të rreptë për 16

vjet. Çdo lëvizje i raportojë me detaje dhe për të vihej në dijeni direkt Enver Hoxha. Nga shqyrtimi qoftë edhe i përciptë i dosjes, mund të krijosh një ide të qartë të itinerarit të tij:

Shkurt, 1948

Zogu arriti në Port Said më 23 shkurt 1948. Me atë janë gruaja e tij Geraldina, djali i tij Skënderi, dhe tri motrat. Në emër të mbretit Faruk kishte dalë për ta pritur Fuad Krelin, guvernatori i Zonës së Kanalit, duke i uruar mirëseardhjen. Për nder të Zogut parakaloi garda dhe një pjesë e ushtrisë. Zogu në Port Said ndenji një ditë dhe pastaj do të kalonte për në Kairo.

Shkurt, 1948.

Ahmet Zogu shtroi në Aleksandri një darkë për nder të Mehdi Frashërit, Xhaferr Devës, Xhelal Mitrovicës dhe Hiqmet Delvinës, merrnin pjesë dhe një numër i madh nga autoritetet e vendit ndër të cilët: sekretari i përgjithshëm i Legatës Arabe Azan Pasha, nënsekretar i shtetit për punët e jashtme Qemal Abduramani, shefi i kabinetit mbretëror Ibrahim Abdylhoti, kryetari i organizatës “Vëllezërit mysliman” Shel El Hana, princi Amur Ibrahim, Sir Ëalter Smert ministër fuqiplotë pranë ambasadës aritane në Kajro dhe mjaft të tjerë.

Romë, 1 tetor 1951

Ahmet Zogu u kthye nga New - York për në Egjipt. Në Amerikë do të marri dhe familjen e tij, të cilën do ta sistemojë atje përfundimisht. Në New -York ka blerë një çiflig të madh dhe një vilë. Prej qeverisë amerikane ka kërkuar të marrë me vete 170 shqiptarë nga besnikët e partisë së tij, por qeveria amerikane i ka lejuar vetëm 60 veta prej tyre.

3 shtator, 1952.

Kemi mësuar se gruaja e Zogollit para 10-15 ditëve ka ardhur në Napoli dhe flitet se do takohet me Papën. Ka qenë me të birin e saj dhe përveç tij ka pas edhe të tjerë eksponente, njerëz të Zogollit, të cilët disa prej tyre do të instalohen në Itali.

Romë, 17 shtator 1952

Ardhja e Geraldinës u konfirmua. Sipas Gaqo Goges pritet që të vijë shpejt edhe Zogolli, por që akoma nuk dihet se ku do të stabilizohet. Ka të ngjarë që të stabilizohet në Francë ose në Firence.

3 tetor, 1952

Pritet të vijë në Paris Ahmet Zogu ku do të qëndrojë për disa ditë dhe pastaj do të shkojë në Amerikë ku atje do të stabilizohet përgjithmonë. E shoqja e tij Geraldina bashkë me djalin e saj qëndrojnë në vendbanimin e saj, në vendin ku ka banuar në kohën kur ka ikur nga Shqipëria.

3 gusht, 1955

Zogu së bashku me të shoqen, djalin dhe pjesëtarë të tjerë të familjes, gjithashtu dhe suita e tij janë nisur nga Egjipti në datën 30 korrik 1955, në drejtim të Francës ku kanë zënë me qira dy vila, një në qytetin Antibe dhe tjetrën në Kane, ku do të rrijë një vit dhe pastaj do të nisët për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vuan nga zemra, ka ardhur që të kurohet.

Më 22 shkurt, 1956

"Agimi" raporton se "Macukulli" i kishte rregulluar dokumentet për të qëndruar në Francë së bashku me njerëzit e tij. Dokumentet i rregulloi Sabriu dhe për këtë është i pakënaqur sepse "Macukulli" nuk i dha asnjë gjë për shpenzimet që kishte bërë vetë. Vazhdon të qëndrojë në Kanë dhe ekonomikisht nuk është mirë.

20 dhjetor 1957

Më 11 dhjetor 1957 njoftohemi se Zogu ishte shumë i sëmurë nga zemra dhe doktori ia ka ndaluar çdo takim me cilindo që qëndron dhe ai qëndron i izoluar në vilën e tij. Çdo ditë shkon një doktor Riza për ta pasur në kontroll të vazhdueshëm.

Në prill 1957 me rastin e ditëlindjes së djalit të Zogut, ky i fundit deklaroi të birin si princ trashëgimtarë. Me rastin e 28 Nëntorit kishte dhënë një pritje në një nga hotelet e vendit ku banon. Kishte ftuar mjaft njerëz. Kishte qenë në pritje edhe ish-Mbretëresha e Bullgarisë, Xhovana. Ekonomikisht nuk ishin mirë.

Data 24 Shkurt, 1961

Zogu me suitën e tij është shpërngulur nga Kana dhe është vendosur afër Parisit në Ablon rreth datës 15 ose 19 janar. Ai është i sëmurë mbasi vuan nga kanceri. Në Paris ndodhet i biri dhe motrat e tij.

Dosja është e mbushur me raportime të hollësishme, shpesh edhe me detaje si këto:

Romë, 11 gusht 1951

Flitet shumë se Zogu largohet nga Egjipti në marrëveshje me mbretin Faruk për arsye se dy sekretarët e tij privat Gaqo Gogo dhe Skënder Vigu kanë shkaktuar skandale duke dashuruar.

Gaqo Gogo ka rrëmbyer të bijën e një pasaniku influent egjiptian, me të cilën bashkëjeton. Skënderi ka rrëmbyer gruan e një princi arab. Këta, të dyja gratë e rrëmbyera i kanë marrë me vete, njëri në Romë dhe tjetri në Paris ku bashkëjetojnë pa qenë të martuar.

Apo:

Më 24 shkurt 1956 raportohet nga "Drini" për "Sopotin" se me kërkesë të tij Papa ka takuar Geraldinën.

Në Kanë Zogu banonte në vilën ku kishte lindur Don Zhuani.

Në datën 12 mars të 1962-it, thuajse një vit pas vdekjes së ish-Mbretit, mbi dosjen e tij në sigurim u shënuan këto fjalë:

"Meqenëse Ahmet Zogu ka vdekur do arkivohet dosja formulare e tij."

Shefi i seksionit të Emigracionit, nënkolonel Kleanth Andoni.

Pas largimit nga Londra drejt Egjiptit, Zogu thuajse i humbi shpresat për një rikthim të menjëherëshëm në Shqipëri. Siç dëshmojnë njerëzit që i rrinin pranë, ai shpresonte vetëm tek ndonjë rastësi politike dhe mbi të gjitha tek përplasja e vendeve perëndimore me Bashkimin Sovjetik. Në jetë Zogu ishte larguar disa herë nga Shqipëria dhe e dinte se kombinimi i rrethanave mund ta rikthente

sërish. Siç dëshmon Skënder Zogu, i nipi që e shoqëroi në Egjipt dhe vitet e fundit në Francë:

“...nuk e kishte humbur shpresën se do kthehej në atdhe edhe pse në atë kohë Mbreti Zog ndryshoi pak pasi kishte idenë se populli shqiptar duhej ta zgjidhte lirisht formën e regjimit”

Ky vendim për një lloj referendumi mbi formën e regjimit duhet të ketë ardhur pas shumë përpjekjesh dhe pasi Zogu e kuptoi se largimi i komunistëve nga vendi ishte shansi i vetëm për rikthimin e tij. Ai filloi ta kuptonte që koha e tij po mbaronte dhe lëshimi i monarkisë në dorën e një referendumi popullor do të ishte më i rëndësishëm se sa mërgimi i përjetshëm.

Kalimi në këtë ide nuk ka qenë pa vështirësi. Geraldina kujton se në muajin maj 1949, dy agjentë amerikanë të CIA-s, Robert Lou dhe Robert Manor si dhe dy britanikë, Xhulian Emeri dhe Bill Maklin, mbërritën në Aleksandri me kërkesën për të takuar Mbretin. Ata e dinin që më 17 shtator 1947, Mbreti kishte qenë inisiator i një mbledhjeje në hotel “De Gasper” në Romë, ku misionarët e tij kishin grumbulluar disa nga personalitetet e rëndësishme të emigracionit politik dhe kishin krijuar komitetin për sistemimin e emigrantëve. Komiteti financohej nga Zogu dhe mbështetej tek ideja që falë ndërmjetësimit të tij, emigrantët politikë shqiptarë të mbe- tur pa mbështetje në Itali, Zvicër dhe Britani, të transferoheshin në vendet arabe ku do të ishin të mirëpritur. Në krye të komitetit ishte ish- kreu i Ballit Kombëtar, Mithat Frashëri.

10 ditë më pas krerët e komitetit kishin udhëtuar për në Aleksandri dhe Mbreti Zog kishte shtruar për ta një darkë. Ai qëndronte ulur përballë Ali Këlcyrës dhe Mustafa Krujës, dy kundërshtarë të vjetër. Por të gjithë bashkë, përfshi edhe Ernest Koliqin, Mehdi Frashërin apo Ago Agajn kishin një shqetësim të përbashkët. Komunizmi i kishte përzënë forcërisht këta protagoniste të jetës politike të viteve 1912 – 1944. Mjeshttrat e politikës që kishin luftuar e organizuar kaq atentate ndaj njëri – tjetrit, që ishin dënuar reciprokisht me vdekje në mungesë, tani qëndronin pa atdhe në një restorant të hotel “Mediterrane” në Aleksandri me

bindjen që vetëm bashkimi mund t’i bindte amerikanët dhe britanikët t’i mbështesnin.

Katër agjentët amerikanë dhe britanikë, e dinin se Mbreti po i harronte meritë e vjetra dhe në maj 1949 kur mbërritën në sallonin ku i priste bashkë me Geraldinën që shërbente si përkthyes, kishin me vete një propozim konkret. Propozimi vinte në emër të Qeverive të Londrës e Uashingtonit dhe synonte rrëzimin e regjimit komunist në Shqipëri. Ai ishte aprovuar në instancat më të larta dhe për të qenë i suksesshëm kërkonte bashkimin e gjithë faktorëve politikë në mërgim. Në këtë aspekt, Zogu ishte më i rëndësishmi, por ai duhej të hiqte dorë nga Froni dhe të pranonte një sistem republikan në Shqipërinë e lirë. Vetëm ky vendim do të krijonte mundësinë për bashkim të gjithë faktorëve kundërshtarë. Propozimi anglo – amerikan e tërboi Mbretin. U kërkoi atyre të largoheshin menjëherë duke shtuar, siç kujton Geraldina:

“Unë e bëra Shqipërinë. U largova nga vendi me vendim të Asamblesë Kombëtare dhe e kam për detyrë ta mbroj Shqipërinë. Nuk e pranoj një kusht të tillë dhe më duket e pakuptueshme që mund t’ju shkonte ndër mend të më parashtronit një propozim të tillë. Një Mbret nuk mund të heqë dorë nga të drejtat e tij, pasi kjo është e paligjshme. Këtë detyrë nuk mund t’ia lë askujt tjetër, përveç trashëgimtarit tim.”

Geraldina kujton se ata u larguan ndërsa Xhulian Emeri qëndroi ende pak kohë për të folur me Mbretin. Ai premtoi se do të kthehej sërish nesër pas konsultimeve me eprorët. Propozimi i të nesërmes ishte më tolerant dhe përputhej me idenë ku po afrohej edhe vetë Mbreti. Ideja ishte krijimi i një fronti që bashkonte gjithë shqiptarët e mërguar kundër komunizmit, një front që krijonte një komitet të mbështetur nga Mbreti që qëndronte mbi palët. Forma e regjimit vendosej më pas nga populli. Më 14 qershor të vitit 1949, ai firmosi këtë deklaratë:

“E përshëndes me gëzim të madh formimin e Frontit të Bashkuar Shqiptar, si një mënyrë për të arritur bashkimin e gjithë shqiptarëve që gjenden jashtë vendit të tyre, si edhe si një mënyrë për t’u siguruar

mbështetje morale shqiptarëve brenda vendit, që tani gjendet nën drejtimin e qeverisjes së komunistëve që orientohen nga jashtë. Do t'i jap, me sa fuqi që kam, gjithë mbështetjen time Frontit të Bashkuar Shqiptar dhe komitetit të tij. Do të bind të gjithë shqiptarët që të tregojnë besnikërinë e tyre në këtë lëvizje, qëllimi i së cilës është restaurimi i pavarësisë së Shqipërisë. E gjykoj këtë mënyrë tërësisht në përputhje me parimet demokratike.

Deklaroj se nuk do të ushtroj asnjë prej të drejtave të mia mbretërore kundër Frontit të Bashkuar Shqiptar, kundër veprimtarive dhe komitetit të tyre, të kryesuar nga Mithat Frashëri, me kusht që ata të mos shkojnë kundër aspiratave të kombit shqiptar dhe se qëllimi i tyre i vetëm të jetë restaurimi i Pavarësisë së Shqipërisë dhe pacënueshmëria e territorit të saj.”

Ai firmosi po atë ditë një marrëveshje me përfaqësuesit e Britanisë dhe Amerikës ku thuhej:

“Deklaratës që firmosa në 14 qershor 1949, do t'i bëj shtesën e mëposhtme, e cila është pjesë e pandashme e deklaratës sime dhe që mund të përmbledhet në tri pika.

1. Duke qenë se unë përfaqësoj Legalitetin, kërkoj që të më bëhen të ditura të gjitha çështjet me interes madhor që do të diskutohen prej komitetit drejtues të Frontit të Bashkuar Shqiptar, në bashkëpunim të plotë, dhe nëse do të jetë e nevojshme, prej zyrave të autoriteteve kompetente amerikane.

2. Sipas parimeve të Legalitetit të përmendura më sipër dhe të sanksionuara në Kushtetutë, unë do të formoj një qeveri në Shqipëri plotësisht asnjënjëse gjatë fazës përgatitore menjëherë pas çlirimit të Shqipërisë.

3. Miratoj zgjedhjen e Mit'hat Frashërit si president i Komitetit dhe drejtues i Frontit të Bashkuar Shqiptar, me arsyen e besimit të plotë që kam te patriotizmi i tij, por në rast se Mit'hat Frashëri jep dorëheqjen apo për arsye të tjera të paparashikuara, anëtarët e Komitetit duhet të konsultohen me mua për drejtimin e Komitetit. Këto tri pika detajojnë dhe kushtëzojnë deklaratën time, e cila nuk duhet të botohet deri pas realizimit të marrëveshjes midis palëve të ndryshme shqiptare.

Deklarata nuk u bë publike deri më 30 gusht 1949, kur në Romë u krijua komiteti “Shqipëria e Lirë” i drejtuar nga Mithat Frashëri. Komiteti do funksiononte si një qeveri në mërgim. Do të kishte seli në Romë dhe Nju- Jork dhe do të mbështetej ushtarakisht nga SHBA-të dhe Britania. Disa mijëra emigrantë politikë u rekrutuan nga shërbimet sekrete të këtyre dy vendeve dhe filluan të stërviten. Leka Zogu kujton se kjo ka qenë njëra nga dy tentativat serioze të tij për të rrëzuar regjimin komunist.

“E para ka qenë në vitet 1946-47. Një numër refugjatësh që kishin ikur nga komunizmi me ndihmën e shteteve arabe i stërvitëm për t'i kthyer në Shqipëri. Fatkeqësia ishte se filloi lufta e shteteve arabe me Izraelin dhe kjo u ndërpre. Tentativa e dytë ka qenë me përkrahjen e britanikëve edhe me amerikanët, por që u shkatërrua nga tradhtia e Kim Filbit. Ju e njihni tani këtë histori dhe në të ne kemi humbur disa nga njerëzit tanë më të mirë.”

Kim Filbi, një agjent sekret britanik vuri në dijeni Moskën për gjithë planet anglo – amerikane mbi Shqipërinë. Grupet e armatosura që u desantuan me qëllim destabilizimin e situatës në Shqipëri priteshin nga agjentët e sigurimit. Për thujse 2 vjet, sigurimi zhvilloi një radiolojë me Shërbimin Sekret Amerikan, duke kërkuar të tjerë vullnetarë për në Shqipëri. Grupi i fundit qenë oficerët besnikë të Mbretit Zog, midis të cilëve Zenel Shehu, ordianca e tij. Të gjithë u arrestuan dhe u dënuan me një gjyq publik që Mbreti dhe Geraldina e dëgjuan në Aleksandri në valët e Radio Tiranës. Përpjekja dështoi dhe komiteti “Shqipëria e Lirë”, pas vdekjes së Mithat Frashërit në Nju- Jork, e humbi peshën e tij.

Zogu humbi dhe shansin e fundit për t'u kthyer në vendlindje. Ai duhej të mësohej me fatin e tij, siç dëshmon ky dokument sekret anglez i shkruajtur në vitin 1952 në formën e një memoje për Kryeministrin Britanik:

“Qeveria britanike nuk e njeh Zogun si mbret të Shqipërisë. Nëse ai vjen në Britani, statusi i tij do të jetë i atij të një individi privat, por gjithsesi ne mund t'i kërkojmë doganës që t'i sigurojë disa lehtësira, në respekt të rolit dhe statusit të tij të mëparshëm.”

Mbreti po humbiste edhe aleatët e fundit që kishte. Më 5 gusht 1953, Egjipti mbylli Legatën Mbretërore dhe vendosi marrëdhënie diplomatike me Qeverinë e Tiranës. Ndërkohë, Mbreti Zog vijonte të konsiderohej person tejet i rrezikshëm në Shqipëri. Mbështetësit e tij po merrnin dënime të rënda, ndërsa çdo kujtim i shkulej me rrënjë. Në Burgajet varret e të parëve iu shembën me traktor, veç atij të Xhelal Pashë Matit që u mbulua me ferra nga një banor dhe që ia rrëfeu si amanet djalit të tij.

Ndërkohë ai filloi të modifikonte qëndrimet politike ndaj Tiranës. Isuf Mullai, agjenti kryesor i Sigurimit që e takoi atë në Francë, kujton:

“Ishte burrë me autoritet. Nuk fliste shumë, fliste rrallë, ishte shumë serioz. Mendimet kur i jepte, i jepte të rralla, por dëgjonte më shumë. Kishte informacione. Unë bëra dhe 2 ndërhyrje për udhëheqësit në Shqipëri.

- Edhe ata nuk kanë bërë keq, kanë vepruar sipas situatave, - tha Zogu.

- Po çfarë thonë për ne andej nga Shqipëria, -më tha.

- Thonë pse mbreti iku, ai të kishte qëndruar dhe të kishte luftuar bashkë me popullin.

- Për atë tha, e kanë një farë të drejte, por ata nuk e dinë se çfarë marrëdhëniesh kam pasur unë me anglezët dhe amerikanët.”

Më 5 mars 1950 bëri një tjetër deklaratë mbështetëse për Qeverinë e Hoxhës në shtypin grek, në një moment tensioni në kufirin e Jugut. Deklarata ngjalli reagimin e ashpër të Athinës. Nëse i referohesh kujtimeve të Hysen Selmanit, më 6 mars 1950 një delegacion i qeverisë greke i përbërë nga gjeneral Napolon Zerva, Spiro Milo dhe nipi i Marshallit Papagos vizitoi Mbretin në Aleksandri. Ata i kërkuan mbështetje kundër regjimit komunist, por Mbreti refuzoi ta bëjë këtë për sa kohë ishin ende në diskutim kufijtë e Shqipërisë. Kjo bisedë është e vështirë të vërtetohet, por përputhet me qëndrimet zyrtare të tij.

Qëndrimi i fundit publik ndaj qeverisë shqiptare është një deklaratë e lëshuar nga Kana ku ishte vendosur tashmë më 21 dhjetor 1955, po atë ditë që Shqipëria u bë anëtare e OKB – së.

“Pranimi i Shqipërisë në OKB është një eveniment po aq i rëndësishëm sa edhe ai i pranimin në Shoqërinë e Kombeve në vitin 1920 – 21. Kjo gjë garanton edhe një herë më shumë pavarësinë dhe integritetin e këtij vendi në kombet europiane. Të gjithë shqiptarët që e dinë këtë, duhet të bashkojnë bindjet e tyre politike për kohën e realizimit të kësaj ngjarje. Shqipëria duhet të gjejë vendin e saj të merituar në radhën e OKB – së, dhe tani, i takon Shqipërisë t’i tregojë botës se është një komb vërtet i lirë, demokratik dhe sovran”.

Një vit e gjysmë më pas, më 5 Prill 1957, sapo mbushi moshën 18-vjeçare, ai shpalli Lekën Princ trashëgimtar me titullin Princ Leka.

VITET E FUNDIT TË MBRETIT ZOG

“Zogu arriti në Port Said më 23 shkurt 1946. Me atë janë gruaja e tij Geraldina, djali i tij Leka, dhe tri motrat. Në emër të mbretit Faruk kishte dalë për ta pritur Fuad Krelin, guvernatori i Zonës së Kanalit duke i uruar mirëseardhjen. Për nder të Zogut parakaloi garda dhe një pjesë e ushtrisë. Zogu në Port Said ndenji një ditë dhe pastaj do të kalonte për në Kajro.

Zogu në Egjipt ka lidhje me Princin Muhamet Ali dhe me sekretarin e Lidhjes Arabe Hasan Bej. Këta dy të fundit i paskan bërë një vizitë Zogut kur ishte në Londër duke i premtuar çdo ndihmë dhe duke i siguruar se do të gjejë përkrahjen e duhur dhe në Egjipt.”

Kështu e raporton mbërritjen e Mbretit Zog në Egjipt për llogari të Sigurimit Shqiptar një burim i UDB – së. Zogu kishte udhëtuar me anije nga Liverpuli në Egjipt në dimrin e parë të pasluftës dhe largimi i tij e kishte lehtësuar Qeverinë Britanike. Ikja i zbehte pretendimet politike dhe britanikët e dinin këtë gjë shumë mirë. Në një dokument sekret të pak kohëve më vonë, dërguar nga Ministria e Jashtme për Kryeministrin shkruanin:

“Zogu është një person sensibil e i arsyeshëm, i cili asnjëherë nuk e ka shqetësuar shumë qeverinë britanike gjatë luftës, edhe pse ish- mbretërit e tjetër kërkonin ndihmë për partitë e tyre në favor të

mbretërisë. Ai ka qëndruar jashtë politike në një kohë të madhe dhe duket se e ka pranuar psikologjikisht "pensionin" e tij."

Duket se "pensionin" egjiptian i Mbretit kishte qenë zgjidhja më e mirë. Egjipti kishte një klimë të favorshme mesdhetare. Ishte një vend pa kosto të mëdha jetese dhe mbi të gjitha, Mbreti Faruk, një vend pa kosto të mëdha jetese dhe mbi të gjitha, Mbreti Faruk, rridhte nga dinastia shqiptare e Muhamet Aliut dhe e pranonte publikisht origjinën e tij. Me gjasë kishte edhe një arsye më shumë për këtë vendim. Egjipti ishte kthyer në ato vite, në parajsën e familjeve mbretërore të rrëzuara nga pushteti. Në Aleksandri jetonte familja e Osmanllinjve që nga rrëzimi prej Fronit të Perandorisë në fillim të viteve '20, familja Romanov e Carit të Rusisë, Hohenzollern - Coburgët e Gjermanisë, Familja Mbretërore greke që sapo ishte rikthyer në Athinë, familja Mbretërore Bullgare dhe mbi të gjitha ajo Savoja e Italisë, Viktor Emanueli III që kishte abdikuar pas luftës në favor të të birit, Mbretit Umberto, Mbretëresha Elena dhe gjithë familja banonte në vila "Polenco", një pallat i vogël dhe modest i lënë në përdorim prej kontit italian me të njëjtin emër.

Zogu me familjen u vendos fillimisht në Kajro. Ai qëndroi për 7 muaj në hotel "Mena House", një ndër më luksozët e kryeqytetit. Ende sot emri i tij përmendet në librin e hotelit, së bashku me një kuriozitet:

"Mbreti Zog dhe Mbretëresha Gerladinë e Shqipërisë kaluan shtatë muaj në "Mena House" në vitin 1946. Sekretari privat i Mbretit Zog kishte një kasafortë gjigande për të ruajtur thesaret e oborrit. Ajo ishte sjellë ekskluzivisht nga Kajro dhe ishte aq e madhe sa për ta futur brenda u desh ta ngjisin nga dritarja me vinç."

Mbretëresha Geraldinë, por edhe stafi i Mbretit e kujtojnë me mjaft nostalgji periudhën e qëndrimit në Kajro. Ishte një kohë e qetë që Geraldina e shfrytëzonte për të ndenjtur më shumë me të shoqin dhe për të shëtitur në rrugët e lagjes më shik të qytetit që quhej Zemblak, sipas emrit të fshatit afër Korçës prej nga e kishte origjinën Muhamet Aliu. Si për ironi të fatit, Zemlaku ishte fshati ku Mbreti Zog kishte kaluar natën e fundit në Shqipëri në 8 Prill 1939.

Familja qëndonte në dimër në Kajro dhe në Aleksandri në verë. Kjo ndodhte sepse atje transferohej gjithë Pallati Mbretëror me në krye Mbretin Faruk. Farukut i pëlqente të organizonte dreka dhe darka me familjet mbretërore të mërguara, por ai bënte kujdes që Mbreti Zog të mos përballej me Savojat. Viktor Emanueli kishte qenë njeriu që i kishte marrë Zogut kuroën më 12 Prill 1939.

Gazeta "The sydney morning herald" e shtatorit 1946 e përshkruan kështu situatën e dy familjeve në Aleksandri:

"Jo shumë larg prej tyre (Savojave) banon ish- Mbreti Zog i Shqipërisë. Por lëvizjet e dy familjeve janë rregulluar në një mënyrë të tillë që asnjëherë të mos e shohin njëra - tjetrën. Nëse kjo do të ndodhë ata nuk do të flasin me njëri - tjetrin. Në kontrast me aktivitetin e ngjeshur të Vilës Polenco (ku banonin Savojat), ish -Mbreti Zog çon një jetë të qetë, thujse prej pensionisti në një vilë të mrekullueshme private, rrethuar nga një oborr i madh, fare pranë detit.

Zakonisht ai bën një ecje të gjatë buzë detit në mëngjes, shoqëruar nga oficerët e tij dhe më pas merret me djalin, Lekën. Mbretëresha Geraldinë, të cilës duket se i pëlqen shumë noti, shihet shpesh duke bërë banjo dielli, me Princ Lekën në plazhin e Sidi Bishr, ku Mbretëresha Nazli, e ëma e Mbretit Faruk i lë në dispozicion kabinën e saj luksoze"

Në fillim të vitit 1947, një makinë Roll -Rojs me regjistrim të Mbretërisë Italiane ndaloi përpara derës së vilës së marrë me qira nga Mbreti Zog. Rojet njoftuan se në derë kishte trokitur adjutanti i Mbretit Umberto II i Italisë. Kishte një mesazh për Mbretin Zog, ish- Mbreti i Italisë kërkonte takim me ish- Mbretin Shqiptar dhe ishte gati të takoheshin menjëherë. Përgjigja e Zogut ishte e shpejtë:

- Mund të vijë që tani.

Geraldina kujton se Mbreti u ndje mjaft mirë nga kjo vizitë dhe i kërkoi asaj të vishte një fustan të bukur dhe të priste aty. Ai do ta takonte Umberton i vetëm, por më pas ajo do të ftohej në dhomë.

"Nga dritarja, pashë makinën që mbërriti, si edhe Mbretin Umberto, i hijshëm teksa dilte prej saj, i shoqëruar nga dy ndihmës. Rreth dhjetë minuta më vonë, ministri i Oborrit, kolonel Martini, u ngjui për të më"

shoqëruar mua poshtë. Zbrita shumë e emocionuar dhe nervoze. Kur hyra në zyrën e tim shoqi, vura re që të dy mbretërit ndiheshin mjaft në siklet. Im shoq më tha:- Mbreti Umberto po përpiqet të shprehë keqardhjen e tij, si edhe atë të mbretit Viktor Emanueli për atë që ka ndodhur mes nesh. Ju lutem, a mund ta përqafoji? E putha mbretin e gjatë në të dyja faqet, ai më puthi dorën dhe pastaj të gjithë u ulëm.”

Zogu e dinte se familja Savoja kishte qenë kundër pushtimit të Shqipërisë dhe se ky kishte qenë një vendim direkt i Musolinit. Ai e dinte se Viktor Emanueli kishte qenë i detyruar ta pranonte kurorën, por Umberto po ia përforconte këtë ide. Geraldina po luante rolin e përkthyeses:

”Duke m’u drejtuar në anglisht, mbreti Umberto më kërkoi të përpiqesha t’i shpjegoja tim shoqi se ai personalisht nuk ishte pyetur fare. Kishte qenë Musolini, diktatori që kishte urdhëruar të atin të merrte kurorën e Shqipërisë. Mbreti Umberto më kërkoi që përkthimi të më dilte nga zemra dhe teksa po bisedoja me tim shoq, vura re se Mbreti Italian po lotonte. Kur pa këtë, pasi ishte mallëngjyer edhe vetë, im shoq u çua dhe e përqafoi. Atëherë, Mbreti Zog, hodhi një hap fisnik duke i thënë mbretit Umberto se do të dëshironte të takonte të atin, mbretin Viktor Emanueli të nesërmen.”

Ish- Mbreti i Shqipërisë dhe ish- Mbreti i Italisë që i kishte marrë kurorën u takuan po atë mbasdite në vilën “Polenco.” Biseda mes tyre nuk ka fare dëshmitarë, por ngjarja bëri bujë në Aleksandrinë që vlonte nga thashethemet. Një ditë më vonë, Mbreti Faruk u takua me Mbretin Zog:

- Tani më trego, është e vërtetë? – e pyeti, tregojnë dëshmitarët.

Zogu ia aprovoi dhe Mbreti i Egjiptit vendosi ta festojë pajtimin e vështirë mes dy kurorave. Pak ditë më pas shtroi në pallatin “Montaza”, një darkë të madhe ku ftoi Mbretin Zog dhe Mbretëreshën Geraldinë, të dy Mbretërit e Italisë dhe familjet e tjera mbretërore: Romanovët dhe Hesesët, familjen otomane, Mbretëreshën Xhovana të Bullgarisë dhe motrën e saj konteshën Kalvi de Bergolo, vajza e madhe të mbretit Viktor Emanueli.

Fotot e darkës u bënë publike në shtypin egjiptian, por edhe atë italian e britanik të kohës. Ato janë dëshmia e vetme e Viktor Emanuelit dhe Zogut, ulur në një tavolinë me gjithë familjet e tjera mbretërore. Është ironike, që familjet mbretërore europiane që thuajse nuk e njohën dhe begenisën Zogun sa kohë ishte në fron, e kishin pranuar në gjirin e tyre, tashmë që nuk kishte më thuajse asgjë.

Viktor Emanueli vdiq pak muaj më vonë, më 28 Dhjetor 1947. Në varrimin e tij, një ditë më pas, në ora 3 mbasdite, ish- Mbreti i Shqipërisë qëndronte në rreshtin e parë, i veshur me kostum të zi, ndërsa mbi varrin e sapombuluar të Mbretit më jetëgjatë të Italisë qëndronte një kurorë në emër të Mbretërisë Shqiptare.

Në vitin 1948 Mbreti Zog vendosi të transferohet përfundimisht nga Kajro në Aleksandri. Nën kërkesën e përsëritur të Geraldinës, vendosi të blejë një tokë në një nga lagjet më shik të qytetit, në kodrat e Ramleh, buzë detit. Aty ku kishin vilat pothuajse gjithë tregtarët e pasur të pambukut dhe aristokracia e zonës. Shtëpia u projektua nga një prej arkitektëve më të njohur egjiptianë sipas kërkesave të Mbretëreshës Gerladinë. Shtypi e përshkruan si një vilë të mrekullueshme, me shkallët e bardha të mermerit dhe me kopshtin përrallor ku lartoheshin palmat spanjolle. Sipas rrëfimeve të vetë Zogut, toka dhe vila kushtuan afro 120 mijë stërlina dhe ajo ishte parashikuar si një vend ku ai dhe familja do të kalonin gjithë vitet e mbetura të jetës.

Pas hyrjes në vilë, jeta ishte edhe më e bukur. Në vitin 1947, Mbreti dhe Geraldina kishin bërë një kruiz në Nil, ndërsa më 1 janar 1950 ata vizituan për një muaj, me një anije të vënë në dispozicion nga oborri mbretëror egjiptian Luxorin dhe Asuanin. Herë-herë transferohej në Kairo për disa javë ose edhe muaj, duke marrë me qira vila ose duke u vendosur në një kat me suite në hotel “Shepherd Intercontinental.” Shtypi egjiptian raporton jo rrallë praninë e tyre në ndeshjet e tenisit në Zemlak, apo në pastiçerinë “Groppi.” Por më shpesh, Zogu shpenzonte kohë në Teqenë e Mukattamit, ku disa dervishë shqiptarë ishin bashkëbisedues të këndshëm të tij. Jeta ishte fare e qetë, deri më 1951, kur vendosi të vizitojë SHBA-të. Zogu nuk kishte qenë asnjëherë përtej kufijve të Europës dhe ky ishte udhëtimi i parë përtej Atlantikut.

I shoqëruar nga disa besnikë dhe protokolli, Mbreti Zog u nis për në Nju- Jork, duke kaluar nga Parisi më 15 Korrik 1951. Në Nju- Jork u vendos në hotel "Reix Tauer". Zogu kishte shumë shpresë tek mbështetja amerikane dhe arriti të sigurojë takime të rëndësishme me zyrtarë të shërbimeve sekrete. Ai e shihte Amerikën si një vend ku mund të vendosej përfundimisht në një kohë që në Egjipt kishin nisur përplasje të forta politike. Veç takimeve zyrtare, ai po kërkonte një banesë në Nju- Jork, të tillë që të akomodonte gjithë grupin prej afro 40 vetësh. Në atë kohë, Zogu vijonte të ishte në gjendje të mirë financiare. Sipas një informacioni sekret të CIA-s, të datës 30 Shtator 1949, që i referohej avokatit të Zogut në SHBA, Edgar M. Church, pasuria e tij i kalonte disa milion dollarë amerikanë të kohës. Dokumenti sqaronte:

"Asetet e ish-Mbretit Zog përfshijnë:

- a) 108 mijë dollarë në "National City Bank" Nju- York"*
- b) Afërsisht 5 mijë dollarë në "Garante Trust Company"*
- c) Një ndërtesë dhe truall në Aleksandri, Egjipt, e vlerësuar 140 mijë lira egjiptiane*
- d) Bizhuteri të kurorës shqiptare që kapin një vlerë rreth 100 mijë dollarë, ndoshta dhe më tepër.*
- e) Rreth 450 mijë dollarë, të mbetura nga rezervat e arit të cilat Zogu i mori nga Shqipëria dhe i çoi në Egjipt dhe që në total vlerësohen si 3 milionë dollarë."*

Kërkimet për shtëpi në disa zona të Nju- Jorkut, e çuan tek një pronë e mrekullueshme në Long- Island. Në gusht të vitit 1951, një shoqëri shitjesh të pasurive të patundshme e njoftoi se pallati "Nollvud", ose "Estate" siç i quajnë amerikanët, ishte vënë në shitje. Zogu shkoi vetë ta shihte atë.

Vila "Nollvud" ishte një ndërtesë e mrekullueshme në stilin e Rilindjes Italiane e ndërtuar mbi një kodër, në mes të një prone prej 106 hektarësh ose 1 milion e ca metra katrorë. Vetë vila kishte 60 dhoma, pa llogaritur dy vila më të vogla për shërbyesit dhe miqtë që akomodoheshin në fund të një oborri të rregulluar sipas stilit të Versajës. Ajo ishte ndërtuar në vitet 1906 – 1911 nga Carl Hudson, një manjat i çelikut dhe një ndër njerëzit më të pasur të Nju- Jorkut.

Ndërtimi kishte bërë aq bujë sa më 1911 revista "Architecture Magazine" i kishte kushtuar asaj disa faqe ilustrime.

Zogu vendosi ta blejë vilën me idenë se do të shpërngulej shpejt aty dhe ajo do të bëhej rezidenca e përhershme e tij. Pas një negociimi të shkurtër ai pagoi për të, 102 mijë dollarë amerikanë. Sipas shtypit, Zogu e pagoi atë jo me banknota, as me çek, por me diamantë dhe gurë të çmuar që sipas argjendarëve të rrugës 47 në Nju- Jork, plotësonin këtë shifër.

Zogu e vendosi shtëpinë nën kujdestarinë e Major Lev Sukaçevi, me gjasë një rus i bardhë që kishte ardhur me të nga Beogradi në Tiranë në vitin 1924 dhe la dy roje shqiptarë.

Por, Zogu nuk jetoi asnjë ditë në atë godinë të jashtëzakonshme. Fati i godinës qe më dramatik se sa ai i vetë Mbretit Zog. Ende pa u largua Mbreti, shtypi lokal Nju- Jorkez shkruajti se Mbreti e kishte blerë shtëpinë me diamante dhe se kishte zgjedhur një shtëpi të tillë për të vendosur aty thesarin. Pas ikjes së Mbretit, nga viti 1951, pothuajse çdo natë, gjuetarë thesaresh nisën të rrëmojnë në muret e vilës, ilegalisht, me shpresën se do të binin në gjurmët e thesarit të Mbretërisë shqiptare. Zogu u bllokua në Egjipt dhe rikthimi në SHBA qe i pamundur. Vila mbeti pa zot dhe në vitin 1955 ajo ishte thuajse e shkatërruar. I detyruar nga rrethanat, Mbreti i kërkoi avokatëve ta nxirrnin në shitje. Ai që e bleu, një gjeneral amerikan në pension që ishte pasuruar me minierat e diamantit në Liberi, Lansdell Kristi, mendoi se do të arrinte ta rikonstruktonte. Por arkitektët që u pajtuan për këtë punë, hoqën dorë. Shtëpia kishte pësuar kaq shumë dëmtime nga gjuetarët e thesareve sa nuk restaurohej më. Leka Zogu e kujton kështu shitjen e shtëpisë:

"Më 1951 kur im atë shkoi në Amerikë për një takim me senatorët, pati rastin të blejë një shtëpi që e kishim lënë aty. Po çmimi u rrit dhe ajo shtëpi që u ble 100.000\$ u shit për 350.000\$ sa mbërritëm në Francë më 1955, se ishim të detyruar. Dhe më vjen keq të them se po ta kishim dhe një vit, çmimi do të ishte shumë më i lartë. Ajo iu shit qeverisë së qytetit të Nju- Jorkut për 5.000.000\$."

Sipas shtypit amerikan, shtëpia u ble nga Bashkia e Nju- Jorkut në vitin 1956 pasi Kristi dështoi ta restauronte. Fillimisht u mendua të

përdorej si seli e një fondacioni të qytetit, por kostot e rregullimit ishin shumë të larta, ndërkohë që rrënimi nuk ndalej. Më 1959, Bashkia mori vendimin që vila të shembej nga frika se muret dhe tavanet e dobësuar të saj mund të zinin brenda njerëzit që vijonin të kërkonin aty thesarin që s'ekzistonte. Rrënojat e vilës janë ende në Long- Island, bashkë me rrethimin e saj dhe emërtimin që i bëjnë banorët: Vila e ish-Mbretit Zog! Sot, vlera e tokës së saj, çmohet afro 100 milion dollarë.

Eshtë befasues dhe fatal raporti që Mbreti Zog ndërtoi me shtëpitë dhe selitë gjatë jetës. Ky njeri i apasionuar pas pallateve, nuk pati kurrë një shtëpi të tijën, ose për fare pak kohë dhe me periudha të shkurtra. Pjesën më të madhe të kohës e kaloi në seli me qira. Thua se asnjë prej vilave që i ndërtoi me aq përkushtim nuk i gëzoi deri në fund.

Në Tiranë ai që quhej Pallati Mbretëror ishte vila e Zija Toptanit e marrë me qira. Pallatin Mbretëror, që sot njihet me emrin Pallati i Brigadave, nisi ta ndërtojë, e projektoi vetë, por nuk hyri kurrë në të. Kur u largua nga Shqipëria, në Prill 1939, Pallati ishte ende në themele.

Pallatin Veror ose atë që njihet si Vila e Durrësit e rikonstrukttoi dhe e rimobiloi për dasmën e tij në vitin 1938, por qëndroi vetëm një verë. U detyrua ta linte dhe as familja nuk e gëzoi kurrë., si edhe vilat e tjera të tij, ajo u rrënuar. U shkatërrua gjatë ngjarjeve të vitit 1997 në Shqipëri, vetëm 5 vjet përpara se sa t'i rikthehej në pronësi familjes së tij.

Po kështu u shkatërrua vila që kishte në Shirokë, buzë Liqenit të Shkodrës.

Në Francë dhe në Angli jetoi gjithnjë me qira, në Chateaux de la May ose në *Parmoor House!*

Në vilën që ndërtoi në Aleksandri ndenji vetëm 2 vjet dhe pastaj ia shiti Princit Talal të Arabisë Saudite. As Princ Talali nuk e gëzoi deri në fund, sepse iu konfiskua nga Naseri. Deri në fillim të viteve '60 vila ishte ende në këmbë, por e shkretë. Më pas u shemb për të ndërtuar pallat nga investitorët lokalë.

Në pallatin e Nju- Jorkut nuk ndenji kurrë. Edhe ai u shkatërrua, duke mbetur si gjithë rezidencat që lidhen me emrin e Zogut, thjesht një gërmadhë.

Në fillim të shtatorit 1951, Zogu u kthye nga SHBA-të në Francë. Ai kishte qëndruar në Nju -Jork dhe Uashington thuajse një muaj dhe tani, parashikonte edhe dy javë në Paris. Në kryeqytetin francez kishte një tjetër kontratë për të mbyllur. Pas vendimit për t'u larguar përfundimisht nga Egjipti në SHBA, kishte vendosur të shiste vilën e Aleksandrisë. Princi Talal, djali i Mbretit të Arabisë Saudite, Abdyl Aziz, kishte shprehur interesin ta blinte dhe takimi mes të dyve që lënë në Paris. Ata u takuan dy herë, përpara se të firmosnin një kontratë për blerjen e shtëpisë me 285 mijë USD. Kontrata u firmos në hotel "Krijon". Zogu mori përsipër ta dorëzonte shtëpinë në datën 15 tetor, ndërsa Princi Talal të bënte pagesën brenda datës 1 Tetor 1951. Zogu kishte parashikuar që në kohën tranzit që nevojitej për pajisjen me vizat e emigracionit të SHBA-ve të qëndonte në Francë. Po ato ditë, ai mori me qira dy shtëpi në Kanë dhe i parapagaoi ato për 6 muaj duke nisur nga data 1 dhjetor 1951.

Asnjë nga afatet e përcaktuara në kontratë nuk u respektua. Më 20 tetor 1951 Princ Talali, i cili nuk po i përgjigjej më mesazheve të Mbretit mbërriti në Aleksandri dhe në një takim kokë më kokë me Mbretin i sqaroi se ai i kishte prishur paratë e caktuara për vilën, iu lut këtij të fundit që t'ia lironte banesën brenda 15 ditëve dhe në dy muajt në vijim do t'i bënte pagesën e plotë. Në atë moment i dorëzoi shumën e vetme që kishte në dispozicion, 25 mijë stërlina.

Mbreti nuk kishte zgjidhje tjetër. Qiraja e parapaguar në Kanë kishte nisur dhe vendimi për t'u transferuar në SHBA që marrë. I liroi Princ Talalit vilën dhe u vendos me gjithë njerëzit që e shoqëronin në hotel "Mediterrane", në qendër të qytetit. Të gjitha moblijet dhe plaçkat e tjera u paketuan dhe u depozituan në një shoqëri transporti në pritje të nisjes brenda një apo dy muajve. Koha do të varej nga shpejtësia me të cilën Princi do të bënte pagesën. Shuma që ai do të jepte ishte e madhe. E konvertuar me kursin e sotëm ajo llogaritet afro 2.5 milion dollarë amerikanë.

Në fakt, Zogu qëndroi në Egjipt edhe 4 vjet të tjerë. Vendimi për të pritur paratë e Princit Talal që po të largohej nga Aleksandria kishte frikë që nuk i merrte më i dhanë atij kosto të frikshme. Princi Talal u vonua më shumë se 2 vjet. Ende nuk dihet në fakt

nëse ai i pagoi ndonjëherë paratë e shtëpisë. S'ka asnjë dokument për këtë. Mbreti Zog u detyrua të qëndronte në hotel, thuhet 4 vjet, madje të kishte në dispozicion një kat të tërë hoteli. Në vitin 1953 u transferua me pak vetë në një vilë me qira, ndërsa stafi vijoi të qëndrojë aty. Plaçkat e paketuara dhe të depozituara në një depo porti për 2 muaj qëndruan 4 vjet duke lënë pas një faturë të frikshme. Në këtë moment humbi edhe mbështetjen politike. Më 22 Korrik 1952 shpërtheu revolucionin e kolonëve të ushtrisë kundër Mbretit Faruk. Atë natë, Faruku kishte njoftuar që do të vinte për një vizitë në vilën e Zogut. Banesa u rrethua me ushtarët që ruanin Mbretin, por Zogu e priti kot deri më 2 pas mesnate. Ai nuk do ta shihte më kurrë nga afër Farukun. Ky i fundit iu shmang përplasjes dhe më 24 Korrik në mëngjes, Mbreti dhe Geraldina panë jahtin mbretëror që po nxirrte Mbretin Faruk, Mbretëreshën, fëmijët e tyre dhe rojet shqiptarë të tij nga Aleksandria. Faruku u vendos në mërgim në Romë, ku ndërroi jetë më 1965, në moshën 45 -vjeçare.

Në Egjipt pushtetin e morën në dorë ushtarakët. Presidenti i Republikës u zgjedh gjeneral Mohamed Negibe. Ky i fundit i konfirmoi Zogut statusin e Mbretit më 12 Korrik 1953 në një takim privat, por vetëm një javë më vonë, e humbi pushtetin edhe vetë. President u zgjedh Gamal Abdel Naseri. Një kolonel që kish qenë shpirti i revolucionit dhe i lidhur me sovjetikët. Më 5 gusht 1953 ai ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Mbretërinë dhe vendosi ambasadën me Shqipërinë Komuniste. Zogut iu lejua të qëndrojë në Egjipt deri në transferimin përfundimtar në SHBA.

Më 20 Gusht 1953 një prokuror i Aleksandrisë, i shoqëruar nga disa policë, trokiti në derën e vilës së Mbretit Zog. Ai kërkoi të bënte një kontroll të parave kesh dhe sendeve me vlerë të Mbretit Zog. Sipas ministrit të Financave, Mbreti Zog nuk kishte më imunitet diplomatik dhe duhej të paguante taksat. Mbreti refuzoi që të pranojë kontrollin. Ai e quante vilën territor shqiptar dhe jashtë autoritetit të policisë egjiptiane. Rojet e Mbretit u armatosën, por rreth vilës mbërritën disa skuadra të ushtrisë egjiptiane. Përleshja ishte shumë afër, por momentet e fundit ndërhyri kryetari i Bashkisë së Aleksandrisë. Zogu pranoi kontrollin dhe inventarizimin e sendeve, por shtoi se këto i kishte sjellë me vete nga Britania. Për fat të keq,

nuk ish kontrolluar në hyrje dhe nuk kishte asnjë dokument që ta vërtetonte këtë. Në kasafortë iu gjetën 9 mijë napolona flori dhe disa gurë të çmuar. E gjithë vlera iu kthye prapë, por atij, familjes dhe personave që e shoqëronin iu morën pasaportat deri në verifikimin e plotë të rastit. Një muaj më vonë, ministri i Financave i Egjiptit, i sqaronte me një letër ambasadorit amerikan, në përgjigje të interesimit të tij, se Mbreti Zog ishte kapur me evazion të lartë fiskal dhe se çështja po gjykohej.

Zogu u detyrua të qëndronte ende 2 vjet të tjera thuhet në arrest shtëpie. Leja për t'u larguar nga Egjipti i mbërriti më 12 Korrik 1955 e shoqëruar me një gjobë të paapelueshme. Ai u detyrua ta paguajë, por ky ishte vetëm fillimi. Në ato vite kishte rënë shumë fizikisht, por po kaq kishte pësuar edhe goditje ekonomike. Jetesa në hotel 4 vjet kish qenë e shtrenjtë, shtëpia nuk u shit dhe gjoba që pagoi ishte një shifër e madhe dhe abuzive. Por ai kishte ende një sasi ari, që e kishte vendosur në bankën Misir në Kajro që në kohën që kishte mbërritur në Egjipt.

Tërheqja e asaj sasi ari, rezultoi një tjetër goditje. Drejtori i bankës i deklaroi Mbretit se sasia mund të tërhiqej vetëm në lira egjiptiane dhe jo në 5 napolonësh ari, siç ishte depozituar. Pra, në vend të arit po merrte letra. Mbreti u detyrua të pranojë pasi largimi duhej bërë brenda 48 orësh. Kur mbërriti kursi i këmbimit, drejtori i bankës i deklaroi se me vendim të Parlamentit, kursi i arit që deri një ditë më parë kishte qenë 28 lira për 5 napolona, tani ishte 11. Zogu refuzoi, por nuk kishte zgjidhje tjetër. Ai tërhoqi sasinë që i dhanë dhe brenda 1 ore humbi 147 mijë stërlina ose me kursin e gushtit 2014, afro 2.04 milion dollarë amerikanë. Një ditë pas largimit, po me vendim Parlamenti, kursi i arit u rrit sërish.

Në Port iu desh të paguante edhe borxhet ndaj kompanisë së depozitimit 4 -vjeçar të plaçkave. Më 20 Korrik 1955 u nis nga Aleksandria në Marsejë me anije. Stafi i tij përbëhej nga 43 vetë, ndërsa në kuletën e tij, ishin afro 1500 dollarë amerikanë. Pasuria e vetme e Mbretit të Shqipërisë në kesh. Leka, në atë kohë, 16-vjeçar, kujton:

"Pas largimit nga Aleksandria mbetëm 40 veta me 1000 paund. Në këtë mënyrë, dolëm nga Egjipti me një shumë të vogël lekësh, rreth 1 mijë stërlina ose 1500 dollarë".

Dy ditë më vonë mbërriti në Marsejë dhe prej këtu, me tren u transferua në Kanë. Ideja fillestare ishte vijimi i udhëtimit drejt SHBA-ve siç dëshmon edhe ky raport i sigurimit i gushtit 1955:

“Kemi njoftuar se Zogu së bashku me të shoqen, djalin dhe pjesëtarë të tjerë të familjes, gjithashtu dhe suita e tij janë nisur nga Egjipti në datën 20 korrik 1955 në drejtim të Francës ku kanë zënë me qera dy vila: një në qytetin Antibes dhe tjetrën në Kanë, ku do të rrijë një vit dhe pastaj do të niset për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vuan nga zemra, ka ardhur që të kurohet.”

Por ideja për t’u transferuar në Amerikë ngeli në vend nga përkeqësimi i menjëhershëm i shëndetit të tij. Që pas vitit 1956, rrëtimi fizik i Mbretit që i shpejtë. Profesor Leneger, një ndër kardiologët më të rëndësishëm të botës që e vizitoi, deklaroi se kishte pak probleme me zemrën, por më shumë me stomakun. Një ulçera e vjetër që e kishte kërcënuar që në rini dhe prej të cilës ishte kuruar në Vjenë iu riaktivizua. Po rëndohej çdo ditë. Katër vjetët e qëndrimi në Kanë thuajse nuk sollën asgjë për të. Në fund të vitit 1960 u rëndua aq shumë sa mjekët kërkuan që për mjekim më të specializuar të dërgohej në Paris.

VDEKJA E MBRETIT

Familja Mbretërore me gjithë Mbretin Zog, sipas librit të autores britanike Guen Robyns, u transferua në Paris nga Kana me tren më 3 janar të vitit 1961.

“Udhëtimi u bë i mundur në sajë të vullnetit të hekurt të Mbretit dhe shërbimit të devotshëm të mjekut francez, dr. Burgua Kavardin, i cili pranoi të udhëtonte me Mbretin që ishte nën dhimbje të vazhdueshme. Doktorët e kishin paralajmëruar që edhe troshitja më e lehtë e trenit mund të ishte fatale dhe gjatë gjithë udhëtimit të gjithë ishin aq shumë të merakosur”.

U sistemuan në Ablon, por ai qëndroi aty fare pak. Mjekët arritën në përfundimin që Mbreti Zog ishte aq i sëmurë sa duhej çuar në spitalin “Foch” në Suresnes, ku gjendej edhe laborator i mirë kërkimor në Paris. Më 20 mars, u shtrua përfundimisht në spital. Dëshmitarët kujtojnë që vijonte të pinte cigare pa fund edhe pse jo 150 në ditë si në rininë e tij dhe të konsumonte kafe të zezë. Doktorët nuk i imponoheshin dot. Kishte rënë shumë në peshë dhe ishte zverdhur. E ndiente që i kishte ardhur fundit dhe një ditë i deklaroi Gerladinës se nëse do të ekzaminohej me kancer, do të vriste veten për t’i kursyer dhimbjet që kishte ndjerë në vdekje e motra. Geraldina kujton se gjatë gjithë kohës, mbante nën jastëk revolverin prej ari që nuk e kish hequr nga brezi që në vitet që ishte President i Republikës. Por revolveri ishte i rëndë dhe pak nga pak e

ndjeu se nuk e ngrinte dot më. Atë ditë i kërkoi Geraldinës revolverin e saj të vogël e të lehtë, të larë me ar që ia kishte faluar në ditën e fejesës së tyre. Biografia e Geraldinës kujton:

“Mbretëresha i kishte kërkuar fshehurazi Princit Leka t’ia hiqte plumbat, por kur ia vendosën mbi tavolinën pranë tij, Mbreti urdhëroi: Hape! Kur pa që në revolver nuk kishte plumba, e detyroi të birin t’i fuste përsëri.”

Geraldina ishte e para që e mësoi se Mbreti vuante nga kanceri në stomak. Atë ditë u ul me djalin e saj 22 -vjeçar, Lekën dhe bisedoi gjerë e gjatë. Sëmundja kërkonte trajtim special dhe ata kishin fare pak para mënjanë. Për Mbretin kishin ardhur ditë të vështira. Atëherë ajo mori njërin prej vemdimeve më të rënda të jetës. Vendosi të shesë stolitë e hershme, përfshi unazën e fejesës, e prodhuar nga firma Cartier me një diamant blu, 14 karatësh.

“Kur e morëm vesh përtej çdo dyshimi se ai kishte kancer, i telefonova zotit Ostier, në Nju- Jork, ku kisha lënë pjesën e fundit të stolive të mia, dhe i kërkova të dërgonte në emrin e Lekës 10 mijë dollarë. Kishim bërë një kontratë në Nju- Jork që stolitë nuk do të shiteshin poshtë një shume të caktuar, por për fat të keq nuk u shitën shumë sipër saj. Sot ato stoli do të vlenin shumë më tepër.”

Pric Leka premtoi se sapo të rimëkëmbeshin ekonomikisht do t’i riblinte ato stoli. I ndoqi për një kohë të gjatë nëpër ankande derisa i humbi nga vëmendja. Më 1999, Geraldina deklaronte në emisionin OPINION:

“Për këdo që i ka blerë, ato përbëjnë një stoli të bukur dhe me vlerë. Për mua ishin më shumë se kaq, ishin fejesa, dashuria dhe jeta- sa ime me burrin që doja”

12 vjet pasi Mbretëresha Geraldinë ndërroi jetë, në 2014, unaza e saj u shit në një ankand në Zvicër. Blerësi mbeti anonim ashtu si shuma që ai pagoi, sipas shtypit: disa milion dollarë!-

Veç sëmundjes së Mbretit situata në spital ishte kaotike. Kur Mbretit i filluan dhimbjet, Geraldina i kërkoi doktorëve që t’i injektonin morfinë për t’ia lehtësuar ato. Por motrat e Zogut që ndodheshin aty deklarun se kjo nuk mund të ndodhte, sepse ato ishin besimtare. Kërkesa e tyre fitoi, siç kujton Geraldina:

“Në vend të morfinës, u vendosën në anët e shtratit të Mbretit dy roja shqiptare që të ishin pranë e të mos e linin mbretin të binte nga krevati, prej agonisë, dhe të mos dëmtohej. Iu mohua edhe dinjiteti i një vdekjeje të qetë”.

Më 9 prill 1961, Princi Leka shkoi në varrezat e Tie për të prenotuar një parcelë të vogël për varrin e Mbretit. Nipi tjetër, Skënderi, u drejtua në një shoqëri funeralesh për t’u marrë me procedurat e varrimit. Pak pas orës 15:00 një prej oficerëve hyri me nxitim në dhomën ngjit ku po pushonte Mbretëresha.

- Hajde me urgjencë!- i tha pa i dhënë shpjegime.

Ajo arriti të shihte vetëm se si ai hapi sytë thellë, psherëtiu dhe vdiq.

Geraldina u përkul mbi të ngadalë:

“Zoti më dha kurajë t’i mbyllja sytë e tij të bukur para se të gjunjëzohesha para shtratit për t’u lutur.”

Dhoma u mbush me vajtimet e motrave të Zogut, me psherëtimat e oficerëve dhe mjekët që kërkonin të kryenin formalitetet e fundit. Geraldina kujton sërish:

“Njëri prej miqve të vjetër të Mbretit shkoi menjëherë të thërriste kryeimamin e Komunitetit Islamik në Paris. Shpejt katër imamë erdhën në spital dhe vunë duart në kokë nga tmerri. E kthyen shtratin e Mbretit në drejtim të Mekës, bash kur hynë infermieret për ta çuar trupin në kishëzën e morgut, gjë që ishte e papranueshme për një Mbret mysliman.”

Trupi i Mbretit u vendos në një dhomë të veçantë dhe në derën e saj qëndronin roje dy oficerë të armatosur. Atë mbrëmje dhe të

nesërmen në mëngjes, me qindra dhe mijëra shqiptarë filluan të vijnë nga Franca, Belgjika dhe Italia. Homazhet u kryen po aty, ndërsa 2 ditë më pas, në kohën e varrimit, një skuadër e Legjionit të huaj Francez, e drejtuar nga një kolonel dhe një bandë frymore, i bënë nderimet e fundit ushtarake Ahmet Murtarit, Ahmet Zogollit, Ahmet Zogut, ose Mbretit Zog I. Njeriut me shumë emra, që kish pasur në jetën e tij, aq poste, sa vështirë se mund t'i ketë të gjitha bashkë një person i vetëm: Ministër, Deputet, Kryeministër, President dhe Mbret!

Mbreti Zog u varros në Tie të Parisit, në po atë varrezë ku prehej edhe kushëriri dhe kundërshtari i tij i madh, Esat Pasha. Ceremonia u krye më 11 prill 1961. Po më 11 prill, por 34 vjet më vonë, ndërroi jetë edhe armiku i tij i madh, Enver Hoxha.

Mbretëresha Geraldinë dhe i biri kaluan plot 63 vjet në mërgim, në Spanjë, Rhodezi, Afrikën e Jugut, përpara se të ktheheshin përfundimisht në Shqipëri në qershor 2002. Më 1997, Mbreti Leka humbi një referendum për formën e regjimit. Gjatë gjithë jetës, Leka nuk pushoi se rrëfyeri fjalët e fundit që shkëmbeu me të atin para vdekjes së tij në spitalin "Foch", Suresnes, në Paris, më 9 prill 1961.

"Ndërsa po i rrija pranë shtratit, ai u zgjua nga një gjumë i thellë, më pa drejt e në sy dhe më tha:- Pashë një ëndërr. Pashë nënën tënde të hipur në një anije. Ishte shumë e moshuar, por sërish shumë e bukur dhe flokët po ia përkundte puhiza. Anija po futej në molin e Durrësit...

Pastaj, im atë më përshkroi me detaje skenën që kishte parë në ëndërr. Më tha se më kishte parë mua që udhëhiqja një kolonë me trupat ushtarake me uniforma të ndotura, sikur të kishim kaluar nëpër mulli. Interesant në këtë bisedë është fakti se ai s'kishte parë kurrë ndonjë fotografi të portit në gjendjen që është sot, çka ishte krejt e papërfytyrueshme rreth pesëdhjetë vjet më parë. Megjithatë, përshkrimi i tij përputhej plotësisht me fotografitë që kam parë së fundmi. Nga ana tjetër, vetëm kohët e fundit, Luftëtarët e Lirisë së Shqipërisë po përdorin uniformat me lara. Ai më përshkroi mua me uniformë kamuflazhi të cilën ne filluam ta përdorim vetëm dy vjet më parë. Para kësaj, në kohën e tij, trupat vishnin rroba ngjyrë gri me jeshile.

Të gjithë shqiptarët kanë prirjen t'i interpretojnë ëndrrat. Është pjesë e karakterit tonë. Në këtë kontekst im atë ose bëri një parashikim, ose pati një haluçinacion. Shpresoj të ketë qenë e para. Është pak e çuditshme, por edhe interesante, se, pasi më tregoi ëndrrën, im atë mbylli sytë dhe ra në koma, nga e cila nuk u zgjua më."

EPILOG

15 nëntor 2012, 51 vjet më pas

Lopatat goditën xhamin e blinduar të arkivolit dhe varrmihësit, ndaluan. Një kolonel i Legjonit të huaj dha komandën me zë të lartë dhe mbushja e armëve, që tingulli i vetëm që trazoi heshtjen mortore të varrezës. Truproja e nderit, që përfaqësonte gjithë armët dhe racat e ushtrisë franceze u vendos në dy anët e varrit. Pak njerëz, përfshi përfaqësuesit zyrtar të shtetit francez dhe shqiptar, nisën të ndjekin ngjitjen lart të arkivolit të mbretit. Po ngjitej sërish mbi tokë, 51 vjet pasi që ndryrë aty, tashmë, një kuti e blindur, për t'i shpëtuar disa tentativave për ta rrëmbyer edhe pas vdekjes.

Ishte 15 nëntor 2012. Trupi i Mbretit po zhvarrosej nga Parisi, për t'u nisur drejt Shqipërisë. Disa fjalime e deklarata, një bandë ushtarake që luajti himnin e flamurit dhe muzikë funebre mbi arkivolin. Pastaj u nis, ashtu siç kishte lënë amanet dhe ashtu siç besoi gjithnjë, drejt vendit ku kishte lindur dhe të cilin e dominoi kaq vjet.

Rastësitë janë shpesh mahnitëse, - thoshte Fan Noli, rivali i vjetër që prehej edhe ai nën dhe. Mbase kthimi i eshtrave të Zogut është shembulli më i veçantë për këtë. Arkivoli udhëtoi nga Parisi në Vjenë, nga Vjena në Stamboll e prej këtu në Tiranë. Në 48 orë, ai kishte prekur, edhe pse tashmë pa frymë, gjithë qytetet që shenjua jetën e tij. Sikur të donte të çmallej me to, dhe t'u kujtonte, jo pa triumf, se Mbreti, po kthehej në shtëpi.

APENDIKS - FOTO

Mbledhja dhe paraqitja e fotografive janë bërë pjesë e librit për të evidentuar, edhe në këtë formë, veprimtarinë dhe aktivitetin e jashtëzakonshëm të Ahmet Zogut. Pjesa më e madhe e fotografive botohen për herë të parë. Shumë prej tyre i përkasin fondit Marubi - i falënderoj për kontributin.

Fotografitë janë grupuar sipas disa linjave kryesore:

- F. 224-233 Foto personale të Ahmet Zogut, civil ose me uniformë. Dokumentat flasin për dëshirën e tij për të pozuar me uniformë.
- F. 234-248 Foto që evidentojnë aktivitetin e tij shumëdimensional.
- F. 249-251 Foto familjare, në periudhën e aktivitetit të tij në Shqipëri. Motrat e Zogut kanë qenë shumë aktive në mbështetjen e veprimtarisë së të vëllait, - në shumë fotografi janë edhe ato të pranishme.
- F. 252-255 Foto nga dasma.
- F. 256-265 Foto në ekzil: Londër, Aleksandri dhe Nju-York. Me shumë interes janë edhe paraqitjet që revista të ndryshme i kanë bërë jehonë, kësaj pjese të jetës dhe veprimtarisë së tij. Nga moria e madhe, janë zgjedhur disa faksimile të një reviste të njohur, *Life Magazine*.
- F. 266-270 Foto nga ceremonia mortore e Ahmet Zogut në Paris, si dhe nga ceremonitë e zhvarrimit dhe varrimit të tij në Tiranë.




Ahmet Zogu Kryeministër, foto 8 maj 1923.



Ahmet Zogu në uniformë.



Ahmet Zogu President, foto profil, 28 shtator 1925.



Ahmet Zogu President.



Ahmet Zogu. Photo credits K. Marubi, viti 1928.




Foto personale Ahmet Zogu.




Ahmet Zogu në uniformë. Foto datë 5 prill 1934.



Mbreti Zog I me Uniformë. Foto datë 5 prill 1934.



Ahmet Zogu (bust).




Ahmet Zogu në banjat e Durrësit.



Qeveria e dalë nga Kongresi i Lushnjës hyn në Tiranë, shkurt 1920.




Ahmet Zogu viziton banjat e Durrësit.



Me Deputetët e Partisë Popullore, gusht 1921.


Nga e majta, lart: Ali Koprencka, Loni Kristo, Mustafa Maksut, Qemal Mullai; në mes: Qazim Kokoshi, Ali Këlcyra, Sejfi Vllamasi, Ahmet Zogu, Pandeli Cale, Banush Hamdi, Bajram Fevziu, Leonidha Frashëri (Zallari); poshtë: Dhimitër Kacimbra, Agathokli Xhitoni, Rexhep Mitrovica, Eshref Frashëri, Stavro Vinjau, Bahri Omari, Syrja Pojani.



Me deputetët e parlamentit shqiptar.
Photo credits K. Marubi, viti 1921.



Qeveria e parë e kryesuar nga Ahmet Zogu (27 dhjetor 1922 – 25 shkurt 1924). Foto e vitit 1922.



Ahmet Zogu në takim me Bajraktarët e Veriut, viti 1925.




Ahmet Zogu dhe Ceno Beg Kryeziu. Foto e vitit 1925.



Ahmet Zogu President viziton Shkodrën. Foto e vitit 1927.



Ahmet Zogu President viziton Shkodrën. Foto e vitit 1927.



Ahmet Zogu pret ekipin kombëtar të futbollit.



Ahmet Zogu së bashku me katër adjutantët e tij.
Nga e majta Hysen Selmani, Zef Serreçi, Ahmet Zogu,
Llesh Topallaj, Allaman Çupi.



Ahmet Zogu së bashku me katër adjutantët e tij.




Njëra ndër katër linjat e brendshme ajrore që vendosi
Ahmet Zogu pasi erdhi në fuqi. Shërbimi realizohej nga
një shoqëri gjermane.



Presidenca e Republikës së Shqipërisë, ose ndryshe Pallati Presidential. Kjo godinë nuk ekziston më dhe ndodhej në lulishten e sotme, përpara Kuvendit.



Shpallja e Mbretërisë më 1928.




Qeveria e parë e Monarkisë, pak minuta pas betimit.
Nga e majta: Hiqmet Delvina, Iliaz Vrioni, Kostaq Kotta, Ahmet Zogu, Xhafer Ypi, Sali Vuçiterni, Musa Juka. Foto e vitit 1928.



Pamje e pallatit mbretëror dhe oborrit të tij.



Paradë me rastin e ditëlindjes së Mbretit Zog. 8 tetor 1929.




Mbreti Zog viziton legatën amerikane në ditën e përrimit, *Thanksgiving Day*, 27 nëntor 1930.

Në krah të tij është Ministri Fuqiplotë i SHBA-së në Tirane, Herman Bernstein.



Parada e 25 vjetorit të Pavarësisë. Foto e vitit 1937.



Parada e 25 vjetorit të Pavarësisë. Foto e vitit 1937.




Ahmet Zogu me krerët e komuniteteve fetare në Pallatin Mbretëror.

Nga e majta: Kryeministri Kostaq Kotta, Arqipeshkvi katolik, Mbreti Zog, Kryemyftiu muslyman Bexhet Shapati, Kryegjyshi bektashi Sali Njazi Dedei dhe Kryepeshkopi ortodoks Kristofor Kissi. Foto e vitit 1938.



Foto e vitit 1938.



Salla e fronit, Vila Mbretërore në Durrës, viti 1938.



Ahmet Zogu me të motrat.



Ahmet Zogu me të motrat.



Vitet '30.



Ahmet Zogu me familjen 1937.



Mbretëresha Geraldinë me motrat e Ahmet Zogut,
foto e vitit 1938.



VISIROVA

E dashura e mbretit Ahmet Zog, Visirova.

POSTA E KORÇËS

URIM

Zotin Ahmet Bej Zogolli, deputet' i Matit, q'u vlua me zojushen Shefqet Bej Vërlaci, i urojmë baskim të shpejtë dhe jetë fat-bardhë e të lumtur.

"Posta e Korçës"

Dheshpot vizhana, fshatra që flasin Sh...

Gazeta Posta e Korçës, 24 shtator 1921, uron Ahmet Zogollin (përdor akoma mbiemrin Zogolli) me rastin e fejesës me të bijën e Shefqet Bej Vërlacit, Behijen.



Foto nga ceremonia e dasmës, festime, 27 Prill 1938.



Foto nga ceremonia e dasmës.



Foto nga ceremonia e dasmës, me Mbretëreshën Geraldinë, 27 Prill 1938.



Foto nga ceremonia e dasmës.

THE ITALIANS TAKE OVER ZOG'S PETS, HIS POLITICIANS AND HIS PALACE



King Zog's favorite vulture became the spontaneous captive of an Italian *bersagliere*. Zog's title had been "King of the Sons of the Eagle."



Thanks to Italy for having been a good friend were voted by the Minister of Justice, Khafiz Ypi. Delegates from Albania's ten provinces cheered Ypi's speech, invited Victor Emmanuel III to become King of Albania.

Faksimile nga *Life Magazine*: Çfarë ndodhi në Pallatin Mbretëror dhe në Tiranë pas ikjes së Ahmet Zogut.



Faksimile nga *Life Magazine*: Pallati mbretëror i Ahmet Zogut më datë 8 prill 1939, të nesërmen e largimit, plaçkitur nga qytetarët.



Stander, deposed Crown Prince of Albania and grandson of Gladys Virginia Stewart Agnew's fiancé, of New York. Real Italian articles at the age of sixty-two days. This is his first photograph.



Queen Geraldine, fully recovered from her harrowing flight from the Balkans across two days after giving birth to the crown prince, in Rome, Italy.

ALBANIA'S ROYAL FAMILY, EXILED BY ITALY, TREKS AROUND EUROPE



King Zog, Queen Geraldine and one of Zog's sons. Left: one's back view. Geraldine is identical. The first and photos. Below: Zog's baggage with Albanian treasure of \$4,000,000.



What shocked American women about Italy's seizure of Albania last April was the fact that pretty Queen Geraldine had borne a son two days before. The Hungarian daughter of an American mother was obliged to flee from her bed and the ever-persistent mountain roads to Greece. It nearly cost her her life. By last week most articles and child had reached Norway in exile. King Zog's amazing odyssey around the world's periphery of Europe to avoid the Russo-German Axis. In Stockholm the child fell ill. Many show Zog's remarkable route. He had saved a part of his treasure and a rumored \$4,000,000 in treasure. His entourage divided from 100 to twelve, but Romanians, Poles, Latvians and Swedes gave the party a big hand.



Zog's flight route through Europe to avoid the Italian-German, Bulgarian and Nazi Germany. Last week he sailed for Norway. The dotted line shows his tentative plans.

Faksimile nga *Life Magazine*: Rrugëtimi i Mbretit Zog në ekzil.




Foto familjare, Ahmet Zogu, Mbretëresha Geraldinë dhe Leka, Hotel Ritz, Londër.



Foto familjare, *Parmoor House*, Londër.



Foto familjare, *Parmoor House*, Londër.



Foto familjare, *Parmoor House*, Londër.



Dalë përpara *Parmoor House*, shtëpisë ku jetoi për një periudhë, me qira, në Londër.



Foto në tavolinën e punës, *Parmoor House*, Londër.



Egjipt, darka e shtruar nga Mbreti Faruk për pajtimin e Mbretit Zog me Mbretin Viktor Emanuel të Italisë.



Egjipt, darka e shtruar nga Mbreti Faruk për pajtimin e Mbretit Zog me Mbretin Viktor Emanuel të Italisë.



Dërgata e emigrantëve politikë të A. Zogu, Aleksandri, Egjipt. Foto e vitit 1949.

Nga e majta Odhise Dhima, Ministri Sotir Martini, dr. Qemal Jusufatti, Koço Muka, Myrvet Sula (e shoqja e konsullit), Prof. Ernest Koliqi, Sali Myftija, Myfiti i Madh i Shkodrës, Kolonel Hysein Selmani, Ali Klissura, Qemal bej Messarea, oficer i policisë egjiptiane.



EAST NORWICH

This well known community is on the famous North Shore of Long Island, just a short distance from Oyster Bay. Locust Valley, Wheatly Hills, Syosset and Old Westbury with their diversified social and sporting activities are nearby. This section of Long Island is noted for its fine residences and estates with proper restrictions to safeguard owners. Commuting by fast electric trains. Excellent roads including the Grand Central Parkway and Northern State Highway facilitate motoring.

Vila e Ahmet Zogut në *Long Island*, Nju-Jork, foto e vitit 1990.



Foto nga ceremonia mortore e njërës prej motrave të Ahmet Zogut, Egjypt.




Foto nga ceremonia mortore e Ahmet Zogut.
Paris, 11 prill 1961.






Foto nga ceremonia mortore e Ahmet Zogut.
Paris, 11 prill 1961. Mbretëresha Gerladinë në varrim.




Foto nga ceremonia mortore e Ahmet Zogut.
Paris, 11 prill 1961.



Varri i Ahmet Zogut në Tie të Parisit.



Ceremonia e zhvarrimit të Mbretit Zog në Paris,
15 nëntor 2012. Legjioni i huaj nderon arkivolin.
Photo credit AFP.



Ceremonia e varrimit në Tiranë. *Photo credit AP.*



Arkivoli hyn në Pallatin e Brigadave që ai e nisi, por nuk hyri dot i gjallë.

BIBLIOGRAFI

- Austin, Robert C. *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*
 Baku, Gazmend *Shqipëria Politike.*
 Baku, Gazmend *Zogu I, Mbret i Shqiptarëve*
Balcony Empire
 Basha, Ydriz *Esat Pasha dhe Shqipëria, 1912 - 1920.*
 Ciano, Galeaco *Ditare*
 Dako, Kristo *Ahmet Zogu, Mbret I Shqiptarëve.*
DAP 100 vjet administratë.
 Dardania *Diplomatë amerikanë për Mbretin Zog.*
 Dedet, Josephine *Geraldina, Mbretëresha e Shqiptarëve.*
 Dervishi, Kastriot *Historia e Shtetit Shqiptar 1912- 2005.*
 Dervishi, Kastriot *Plumba Politikës.*
 Dervishi, Kastriot *Shërbimi Sekret Shqiptar 1922 - 1944.*
 Di Nicola, Andrea *Ngritja dhe rënia e Partisë Fashiste Shqiptare 1939 - 1943.*
 Duka, Valentina *Histori e Shqipërisë, 1912- 2000.*
 Ferizi, Niman *Familja Curri.*
 Fevziu, Blendi *Jeta ime... Intervistë me Blendi Fevziu.*
 Filbi, Kim *Lufta ime e heshtur.*
 Fisher, Bernd *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri.*
Fjalori Enciklopedik Shqiptar
 Gaçe, Bardhosh *Ata që shpallën Pavarësinë.*
 Giannasi, Andrea *Vrasja e Telinit.*
 Godart, Justin *Ditarët shqiptarë.*
 Gurakuqi, Romeo *Shqipëria 1911- 1913.*

- Gurakuqi, Romeo *Shqipëria dhe çështja shqiptare pas luftës së dytë botërore.*
 Guy, Nicola *Lindja e Shqipërisë.*
 Ikonomi, Ilir *Faik Konica, jeta në Uashington.*
 Ikonomi, Ilir *Pavarësia, udhëtimi i paharruar i Ismail Qemalit.*
 Ikonomi, Ilir *Pushtimi.*
 Instituti i Historisë *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj.*
 Jakomoni, Francesco *Gjysma ime shqiptare.*
 Jarai, Gabriel Luis *Shqipëria e panjohur. Në Mbretërinë e re të Shqiptarëve.*
 Këlcyra, Ali *Shënime për historinë e Shqipërisë.*
 Konica, Faik *Vepra*
 Krasniqi, Afrim *Partitë politike në Shqipëri 1920 - 2006.*
 Kruja, Mustafa *Kujtime vegjëlie e rinie.*
 Kuarone, Pietro *Valixhja Diplomatike.*
 Larbaud, Valery *Java jonë shqiptare.*
 Lauka, Islam & Ymeri, Eshref *Shqipëria në dokumentat e arkivave ruse.*
 Marubi, *Shqipëria-Albania.*
 Mbi të ashtuquajturën "Një histori e jetuar" të Cetin Saraçit
 Mëhilli, Spiro *Tiranë, 1920 - 1944.*
 Montaneli, Indro *Shqipëria një dhe një mijë*
 Moroco, dela Roka Roberto *Kombësia dhe Feja në Shqipëri, 1920 - 1944.*
 Myzyri, Hysni *Pandeli Evangjeli.*
 Naska, Kaliopi *Shën Naumi dhe diplomacia e kohës.*
 Nosi, Lef *Dokumente historikë, 1912 - 1913.*
 Pllumi, At Zef *Rrno vetëm për me tregue.*
 Puto, Arben *Pavarësia Shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha, 1912 - 1914.*
 Puto, Arben *Shqipëria politike 1912 - 1939*
 Radi, Lazër *Shqipëria në vitet '30.*
 Robins, Guen *Geraldina*
 Selenica, Teki *Shqipëria e Ilustruar.*
 Selenica, Teki *Shqipëria më 1927.*
 Selenica, Teki. *10 vjet mbretëri.*
 Selmani, Hysen *Nga Notimet e Zogu I, Mbret i Shqiptarëve.*
 Suire, Joseph *Shqipëria, ngritja e një Mbretërie.*
 Tourenne, Jean Luc *Një mbret në Shqipëri.*
 Ulqini, Kahreman *Gjurmë të historisë kombëtare në fototekën e Shkodrës.*
 Ushtelenca, Ilir *Diplomacia e Mbretit Zog I.*
 Vllamasi, Sejfi *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942.*

Vlora, Eqrem *Kujtime. I dhe II.*

Vlora, Syrja *Kujtime.*

Vrioni, Jusuf *Botë të harruara.*

Xoxa, Zoi *Kujtimet e një gazetari.*

Zejnati, Novruz *Ahmet Zogu, Politikan apo ushtarak.*

BURIME ARKIVORE

AQSH

Arkivi i Departamentit Amerikan të Shtetit

Arkivi i Ministrisë së Jashtme Italiane

Arkivi i Ministrisë së Jashtme të Britanisë së Madhe

Biblioteka Kombëtare

Fondi Marubi

SHTYPI DHE TV

Associated Press

Chicago Daily Tribune

Chicago Sunday Tribune

Daily Citizen

Daily Mail

Daily mirror

Detroit Evening Times, Detroit

Emisioni OPINION

Gazeta e Korçës

Gazeta Shqiptare

Herald tribune

Java

Life Magazine

Mapo

Miami Daily News

New York Post

New York Times

New York World - Telegram

NEWSWEEK

Newsweek

Panorama

Revista Klan

BIBLIOGRAFI

Shqiptarja
St. Louis Post-Dispatch
Telegraph and morning post
The Bergen Evening Record
The Chicago Daily News
The Daily Clintonian
The Daily Telegraph and Morning Post
The Denver Post
The Denver Post
The Eansville Courier Eansville
The New York Sun
The Sun
The Washington Daily News

"...duam a nuk duam ne, ai mbetet një karakter interesant dhe enigmatik, një përzierje pa kriter kontradiktash të ndryshme, gjysmë hero dhe gjysmë bufon, për të cilin do të interesohen si grumbulluesi i fakteve historike të çuditshme, ashtu dhe studiuesi i psikologjisë"

FAIK KONICA

" Zogu dinte të shpaloste një joshje fort të stërholluar dhe të përdorte një buzëqeshje të mrekullueshme. Toni i zërit të tij ishte i ngrohtë, të folurit e tij, i thjeshtë, i qartë. Nganjëherë të jepte përshtypjen se po të linte të depërtojë në intimitetin e vet, duke arritur të japë ndjenjën e një sinqeriteti të madh, që në njëfarë kuptimi nuk ishte mashtrues. Shkurt, një personalitet fort kompleks. Nga ndonjëherë, por mjaft rrallë, një gjest, një qëndrim, ju zbulonin fytyrën tjetër të tij. Në raste të rralla, JO e tij dilte si një e shtënë. Burri atëherë transformohej: bëhej dyllë i verdhë, tiparet e tij tendoseshin, buzët i bëheshin më të holla, vështrimi i ngulët, i ftohtë, plot me një dritë të keqe"

PIETRO KUARONE

"Zogu ka qenë një tip realist, për të cilin si ndjenja, ashtu edhe ana morale e çështjes s'ka patur kuptim. Shoqëria, miqësia dhe intimiteti kishin një farë vlere për të kur këto i shërbenin interesit të tij. Ai vrasjen e pranonte si një mjet jo të keq kur shtrëngohej ta përdorte atë kundër rivalëve të rrezikshëm që pengonin qëllimet e tij... Zogu ndjente kënaqësi të madhe kur lavdërohej e brohoritej prej veglave e dallkaukëve të tij, por nga ana tjetër, gjatë katër vjetëve bashkëpunimi asnjëherë s'kam dëgjuar nga goja e tij fjalë mburrjeje ose lavdrimi për veten..."

SEJFI VLLAMASI

"Inteligjenca natyrore e këtij njeriu ishte e mahnitshme. Edhe kur ia donte puna të gjykonte dhe zgjidhte probleme shumë të vështira dhe të huaja për të, ai rrallë gabonte. Sikundër edhe në shoqëri me njerëz shumë më të kulturuar ai nuk bënte kurrë figurë të keqe. Por përveç inteligjencës, ajo që i jepte atij epërsi të padiskutueshme mbi gjithë të tjerët ishte mungesa e çdo ndjesie. Ahmet Zogu as ka dashuruar, as ka urryer kurrë. Veprimi dhe sjellja e tij i nënshtroheshin gjithnjë kontrollit të një mendjeje të ftohtë dhe praktike, udhëhiqeshin gjithnjë dhe vetëm prej interesave të tij..."

EQREM BEJ VLORA

Çmimi 1000-Lekë

ISBN 978-9928-190-09-3



9 789928 190093



UETPRESS

tkian